

NDËRMJETËSIMI SI MJET ALTERNATIV PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË (VËSHTRIM KRAHASUES)

Loren Liço


Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkencat Juridike, me profil E Drejta Civile, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Arta Mandro

Numri i fjalëve: 72, 283

Tiranë, Prill 2016



DEKLARATA E AUTORËSISË

©E drejta e autorit: Loren Liço. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit

Në përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është origjinal i shkruar prej meje, i pa prezantuar apo botuar më parë. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përvec rasteve kur përdorimi i ideve, i të dhënave, ose i gjuhës së një subjekti tjetër është bërë sipas referencës specifike të cituara dhe referuar.

ABSTRAKTI

Ky studim synon të japi një panoramë të përgjithshme mbi institutin e ndërmjetësimit në mënyrë të tillë që t'i japë lexuesit një ide sa më konkrete përsa i përket asaj që ky institut përfaqëson. Një institut i ri me ligj, por jo dhe aq i ri në historinë e njerezimit, shumë i domosdoshëm për institucionet e drejtësisë, që shihet si një rrugëzgjdhje e kalvareve të gjata nëpër dyert e gjykatave, çështjeve të shumta, që zgjasin më shumë se sa fjalet që përmban një kërkesë padi apo dokumentet që përmban një dosje civile, tregtare apo penale.

Ndërmjetësimi shihet si një mjet alternativ për të parandaluar konfliktin ose shkallëzimin e tij, për të qënë efektiv në konflikte emocionalisht komplekse, për të arritur mirëkuptimin dhe pajtimin mes palëve si dhe për të arritur në një zgjidhje të pëlqyeshme dhe të pranueshme nga të dyja palët. Ndërmjetësimi ofron privilegjin e mos-paragjykimit, çka do të thotë që ç'është ofertë apo pohim i bërë nga palët gjatë procesit të ndërmjetësimit nuk mund të përdoret si provë në gjykatë, pa cënuar të drejtën e palëve për t'iu drejtuar gjykatës në çdo kohë nëse marrëveshja nuk arrihet. Ndërmjetësimi ju garanton palëve kontroll mbi procesin dhe rezultatin, reduktim të polarizimit, bashkëpunim dhe përfitim të dyanshëm.

Në këtë studim trajtohen dallimet mes parakushteve dhe faktorëve që ndikojnë në ndërmjetësimin e aplikuar në republikën e shqipërisë, duke i parë ato edhe në një këndvështrim krahasues.

Studimi trajton gjithashtu rolin e Ndërmjetësit si katalizator ndërveprimi midis palëve, edukues i palëve nga pikëpamja e propozimeve ose refuzimeve të kërkesave të tyre, perkthyes që i përcjell gjërat tek palët me një gjuhë të kuptueshme, informues që ndihmon palët me informacion divers, kontrollues i situatave problematike, dhe pragmatist që nuk mbetet rob i një zgjidhjeje por eksploron disa rrugë në përputhje me faktet reale.

Për të analizuar parakushtet, faktorët dhe tipare që karakterizojnë ndërmjetësimin në Republikën e Shqipërisë, janë mbledhur informacione nga burime të ndryshme me anë të pyetësorëve, informacione të cilat janë analizuar më metodën "SPSS", për të dalë në konkluzionet përfundimtare.

ABSTRACT

This study aims to give a general overview on the mediation institute in such a way as to provide to the reader a more concrete idea in terms of what this institution represents. An institute new by law, but not so new in human history, a necessity for the institutions of justice, considered as a way of long ordeals in front of the doors of the courts, of many cases lasting more than words contained in a lawsuit or documents containing a civil, commercial or criminal file.

Mediation is seen as an alternative mean to prevent conflict or escalation thereof, to be effective in emotionally complex conflicts, to achieve the understanding and reconciliation between the parties and to come at a congenial and acceptable solution to both sides. Mediation offers the privilege of non-prejudice, which means that the offer or statement made by parties during the mediation process can not be used as evidence in court without prejudice to the right of the parties to address to the court at any time if the agreement is not reached. Mediation guarantees to the parties control over the process and outcome, reduction of polarization, cooperation and mutual benefit.

In this study are analyzed the differences between preconditions and factors affecting mediation applied in the Republic of Albania, seeing them also in a comparative perspective.

The study discusses also the role of Intermediary as a catalyst for interaction between the parties, educator of parties in terms of proposals or refusals of their requests, interpreter who transmit things to the parties through an understandable language, informant helping the parties with divers information, controller of problematic situations and pragmatist who does not remain hostage to a solution but explores several ways in accordance with the real facts.

To analyze the preconditions, factors and features that characterize mediation in the Republic of Albania, it is collected information from various sources through questionnaires, information analyzed with the “SPSS” method to come to final conclusions.

DEDIKIMI

Dedikuar familjes time...!

FALENDERIME

Falenderoj për zemërsisht udhëheqësen time të doktoraturës, Prof.Dr Arta Mandro. Ndhima e saj e çmuar dhe e pakursyer, më ka orientuar në këtë kërkim shkencor, në thellimin e njohurive përkatëse, në suksesin e prezantimeve të punimeve të mia nëpër konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në botimin e artikujve të ndryshëm në revista kudo nëpër botë dhe së fundmi në organizimin, strukturimin dhe mbylljen me sukses të këtij punimi.

Falenderoj për zemërsisht Z. Rasim Gjoka për ndihmën e tij të çmuar dhe e pakursyer duke më vënë në dispozicion të dhënave nga Fondacioni i Zgjidhjes së Konfliktëve dhe Mosmarrëveshjeve.

Falenderoj për zemërsisht dekanin e Fakultetit të drejtësisë pranë Universitetit Europian të Tiranës, Prof.Dr Ksenofon Krisafi, për mbështetjen e vazhdueshme të tij ndaj të gjitha sfidave dhe problemeve gjatë ciklit të studimeve doktoratorale.

Falenderoj për zemërsisht Shkollën Doktorale, për ndihmën që më ka dhënë, ndaj të gjitha problemeve që shfaqeshin në punën time si kërkues shkencor.

Falenderoj për zemërsisht Rektorin e Universitetit Europian të Tiranës, Prof.Dr.Tonin Gjura, si një person gjithmonë përkrahës dhe mbështetës për çdo situatë të vështirë të shfaqur gjatë ciklit të Doktoraturës.

Falenderoj për zemërsisht Administratorin e Universitetit Europian të Tiranës, Z. Henri Cili, i cili me përkushtim ka ndjekur të gjitha proceset gjatë ciklit të doktoraturës.

Falenderoj për zemërsisht koleget nga Londra, Prof.Paul Rendolf dhe Prof.Andrew Goodman, për mbështetjen që më kanë dhënë nëpërmjet materialeve të shumta në fushën e ndërmjetësimit dhe ndihmën e madhe me njohuritë e përcuara nga praktika e tyre.

Falenderoj të gjithë koleget e mi, me të cilët kam shkëmbyer eksperiencë të cilat më kanë vlejtur shumë gjatë punimit tim si dhe të gjitha institucionet që më kanë ndihmuar me informacionet e nevojshme si Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, Gjykata e Tiranës, Durrësit, Gjirokastrës, Korçës, .

Dhe në fund kam dëshirë të falenderoj familjen për mbështetjen që më ka dhënë në këtë rrugëtim që më ka mbajtur shumë ore larg tyre.

Faleminderit...

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE DHE BAZIM TEORIK

1.1. Hyrje.....	fq. 1
1. 2. Përse ka vlerë Studimi i Ndërmjetësimit.....	fq. 6
1.3. Nga Ç’Perspektivë e Analizon ky Studim ndërmjetësimin?.....	fq.32
1.4. Përse ky Studim Zgjedh Shqipërinë si Rast për Analizimin e Ndërmjetësimit.....	fq. 33
1.5.Variablat e studimit.....	fq. 38
1.6. Hipotezat e Studimit.....	fq. 39
1.7. Pyetjet Qëndrore dhe Sekondare të Studimit.....	fq. 39
1.8. Rastet Studimore dhe Metoda e Studimit.....	fq. 40
1.9. Si është i Organizuar dhe Strukturuar Studimi.....	fq. 42

KAPITULLI II: ZANAFILLA, KUPTIMI, ROLI DHE ZHVILLIMI I INSTITUTIT TË NDËRMJETËSIMIT NE SHQIPERI

1. Perkufizimi dhe natyra e institutit të ndërmjetësimit.....	fq.45
2. Historiku i krijimit dhe zhvillimit të institutit të ndërmjetësimit në Shqipëri.....	fq.46
3. Ndërmjetësimi dhe ndërmjetësi, sipas kuadrit ligjor shqiptar.....	fq.47
3.1. Kuadri ligjor për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Shqipëri.....	fq.49
3.2. Karakteri i ligjit 10385 “Për Ndërmjetësimin më zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.....	fq.53
3.2.1. Licencimi i ndërmjetësit.....	fq.60
3.2.2. Heqja e licencës së ndërmjetësit.....	fq.61
4. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve	fq. 62
4.1. Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve.....	fq. 64
4.1.1. Funksionimi i Mbledhjes së Përgjithshme.....	fq. 67
4.2. Anëtarët e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.....	fq.70
4.3. Kryesia si një organ ligjor i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.....	fq. 72
4.3.1. Funksionimi i Kryesisë së DHKN-së.....	fq. 73
4.3.2. Kryetari i DHKN-së.....	fq. 74
4.3.3. Sekretari i DHKN-së.....	fq.75

KAPITULII III: ROLI I NDËRMJETËSIT, PALET NË KONFLIKT DHE PROCEDURA E NDËRMJETËSIMIT

1. Arsyet përse të ndërmjetësosh.....	fq. 76
2. Kushtet për të qënë ndërmjetës.....	fq. 76
3. Profili i ndërmjetësit.....	fq. 77
4. Objektivi i ndërmjetësimit dhe procedura e organizimit të ndërmjetësit.....	fq. 78
5. Kuptimi i rolit të Paleve në Konflikt.....	fq. 79
5.1. Çështja e kuptimit dhe perkufizimit të Konfliktit dhe Paleve në Konflikt	fq. 79
5.2. Çështja e Debatit rreth Rolit të Konfliktit dhe Paleve në Konflikt	fq. 82
5.3. Çështja e Aspekteve të Sjelljes Konfliktuale.....	fq. 83
6. Procedura e Ndërmjetësimit.....	fq. 86
6.1. Ku bazohet procedura e ndërmjetësimit?	fq. 86
6.2. Sa ndërmjetës mund të marrin pjesë në një proces ndërmjetësimi.	fq. 88
6.3. Procedura që duhet të ndjekë gjykata kur referon në ndërmjetësim në procesin civil.....	fq. 89
6.4. Procedura për ndërmjetësim në procesin penal	fq. 94
6.5. Disa tipologji ndërmjetësimi.....	fq. 102
6.6. Mbyllja e ndërmjetësimit.....	fq. 103
6.7. Njohja ligjore e ndërmjetësimit.....	fq. 105
6.8. Pavlefshmëria e ndërmjetësimit.....	fq. 105

KAPITULLI IV: APLIKIMI I NDËRMJETËSIMIT NË FUSHA TË NDRYSHME TË SË DREJTËS

1. Hyrje.....	fq. 107
2. Tematikat rreth të cilave mund të ndërmjetësosh.....	fq. 108
3. Fushat e aplikimit të ndërmjetësimit.....	fq. 108
3.1. Ndërmjetësimi në Çështjet Civile dhe Tregtare.....	fq. 109
3.2. Ndërmjetësimi në çështje Familjare.....	fq. 111
3.2.1. Lindja dhe perhapja e ndërmjetësimit familjar.....	fq. 112
3.2.2. Rëndësia e rolit të ndërmjetësit për zgjidhjen e konflikteve familjare.....	fq. 113
3.3. Ndërmjetësimi në Çështjet administrative;	fq. 115
3.4. Ndërmjetësimi në çështjet Penale.....	fq. 115

3.4.1. Veprat Penale qe mund të zgjidhen me ndërmjetësim.....	fq. 118
---	---------

KAPITULLI V: PARIMET QË PALËT DUHET TE NDJEKIN NË NJË PROCES NDERMJETËSIMI NË KENDVËSHTIMIN E KODIT ETIK EUROPIAN DHE LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

1. Kodi Etik European për Ndërmjetësit.....	fq. 127
1.1. Kompetenca, emërimi, tarifat dhe promovimi i shërbimeve të ndërmjetësve.....	fq. 127
1.2. Pavarësia, paanshmëria dhe konfidencialiteti.....	fq. 128
1.3. Marrëveshja, proçesi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve.....	fq.129
2. Parimet kryesore të Ndërmjetesimit Sipas Legjislacionit Shqiptare.....	fq. 129
2.1. Parimi i Barazise.....	fq. 132
2.2. Parimi i Konfidencialitetit.....	fq. 133
2.3. Parimi i fleksibilitetit të procedurës.....	fq. 137
2.4. Parimi i transparencës së procedurave.....	fq. 138
2.5. Parimi i efikasitetit.....	fq. 139
2.6. Parimi i drejtësisë.....	fq. 142
2.7. Parimi i vullnetit te lire ne pjesemarrje.....	fq.143
2.8.Parimi i paanëshëmërisë.....	fq. 144
2.9.Parimi i profesionalizmit.....	fq. 145
2.10. Parimi zgjidhjes pa pargjytime.....	fq. 146

KAPITULLI VI: ANALIZË E TË DHËNAVE PARËSORE TË GRUMBULLUARA ME ANË TË PYËTËSORËVE NGA INTERVISTIMI I AKTORËVE QË MARRIN PJESË NË PROCESIN E NDERMJETËSIMIT

1. Përpunimi statistikor.....	fq. 148
2. Palët dhe procesi i ndërmjetësimit.....	fq. 149
2.1. Lidhjet statistikore.....	fq. 151
2.2. Lidhjet funksionale.....	fq. 154
3. Ndërmjetësit dhe procesi i ndërmjetësimit	fq. 160
3.1. Lidhjet statistikore (Ndërmjetësit)	fq. 163
3.2. Lidhjet funksionale (Ndërmjetësit)	fq. 168
4. Gjyqtarët dhe Gjykata në procesin e ndërmjetësimit	fq.179

4.1. Lidhjet statistikore.....	fq. 181
4.2. Lidhjet funksionale.....	fq. 182

KAPITULLI VII: NDËRMJETËSIMI NË EKSPERIENCAT E SHTETEVE TË

HUAJA

1. Ndërmjetësimi në kuadër të infrastrukturës gjyqësore në 11 shtete europiane.....	fq. 189
2. Franca.....	fq. 190
2.1. Ndërmjetësimi në Francë.....	fq. 191
2.1.1. Mosmarrëveshjet civile përfshirë këtu edhe mosmarrëveshjet familjare.....	fq. 192
2.1.2. Mosmarrëveshjet e punës.....	fq. 195
2.1.3. Mosmarrëveshjet administrative, ku përfshihen dhe mosmarrëveshjet në lidhje me mjedisin.....	fq. 195
3. Belgjika.....	fq. 196
3.1. Ndërmjetësimi në Belgjikë.....	fq. 196
3.1.1. Mosmarrëveshjet civile.....	fq. 197
3.1.2. Mosmarrëveshjet në punë.	fq. 198
3.1.3. Mosmarrëveshjet në familje.....	fq. 199
3.1.4. Mosmarrëveshjet administrative, duke përfshirë edhe konfliktet në fushën e mjedisit.	fq. 200
4. Spanja.....	fq. 200
4.1. Ndërmjetësimi në Spanjë	fq. 201
4.1.1. Mosmarrëveshjet civile, duke përfshirë dhe mosmarrëveshjet në fushën familjare që nga viti 1881.	fq. 201
4.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e punës.....	fq. 202
5. Italia.....	fq. 203
5.1. Ndërmjetësimi në Itali.....	fq. 203
5.1.1. Mosmarrëveshjet në fushën civile, duke përfshirë ato në fushën familjare.....	fq. 204
5.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës.....	fq. 204
5.1.3. Mosmarrëveshje në fushën administrative, duke përfshirë ato në fushën e mjedisit.....	fq. 205
6. Gjermania.....	fq. 205
6.1. Ndërmjetësimi në Gjermani.....	fq. 206

6.1.1. Mosmarrëveshjet në fushën civile.	fq.206
6.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës.	fq. 208
6.1.3. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës familjare.	fq. 209
6.1.4. Mosmarrëveshjet në fushën administrative.	fq. 209
7. Austria.....	fq. 209
7.1. Ndërmjetësimi në Austri.....	fq.210
7.1.1. Mosmarrëveshjet civile.	fq.210
7.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës.	fq.210
7.1.3. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës familjare.	fq.211
7.1.4. Mosmarrëveshjet në fushën administrative, duke përfshirë ato në fushën e mjedisit	fq.212
8. Zvicra.....	fq. 212
8.1. Ndërmjetësimi në Zvicër.....	fq. 212
8.1.1. Mosmarrëveshjet në fushën civile.	fq. 212
8.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës.	fq. 213
8.1.3. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës familjare.	fq. 213
8.1.4. Mosmarrëveshjet në fushën administrative.	fq. 213
9. Danimarka.....	fq. 214
9.1. Ndërmjetësimi në Danimarkë.	fq. 214
9.1.1. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës.	fq. 214
9.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës familjare.	fq. 216
9.1.3. Mosmarrëveshjet në fushën e mjedisit.	fq. 216
10. Suedia.....	fq. 217
10.1. Ndërmjetësimi në Suedi.....	fq. 217
10.1.1. Mosmarrëveshjet në fushën civile.	fq. 218
10.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës.	fq. 219
10.1.3. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës familjare.	fq. 219
10.1.4. Mosmarrëveshjet në fushën administrative.	fq. 219
11. Norvegjia.....	fq. 220
11.1. Ndërmjetësimi në Norvegji.....	fq. 220
11.1.1. Mosmarrëveshjet në fushën civile.	fq. 221

11.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës.....	fq. 221
11.1.3. Mosmarrëveshjet në fushën familjare.....	fq. 222
11.1.4. Mosmarrëveshjet në fushën administrative.....	fq. 222
KAPITULLI VIII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	fq. 223
BIBLIOGRAFIA.....	fq. 231
ANEKS PYETËSORËT PËR NDËRMJETËSIT.....	fq. 246
ANEKS PYETËSORËT PËR PALËT.....	fq. 252
ANEKS PYETËSORËT PËR GJYQËTARËT.....	fq. 255
APENDIKS.....	fq.258

KAPITULLI I: HYRJE DHE BAZIM TEORIK

1.1. Hyrje

Në kontekstin e zgjidhjes së konfliktit, ndërmjetësimi përfaqëson brenda sistemit gjyqësor një praktikë dhe instrument të rëndësishëm për trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve mes dy palëve. Rëndësia e ndërmjetësimit ka filluar të vihet në dukje që në vitet 1980-të, nga një numër studiuesish, si: Sander (1977), Johnson, Kantor dhe Schwartz (1977), Baldwin (1978), Sander dhe Snyder (1979), apo Stulberg (1981) dhe ky numër ka vazhduar të rritet e të pasohet nga studiues të tjerë, si: Riskin (1997), Brown, Cervenak, dhe Fairman (1998) Cloke (2001), Kelly (2004), Boulle (2005), Chornenki dhe Hart (2005), Ridley-Duff dhe Bennett (2010), apo Henry dhe Marriott (2011). I aplikuar fillimisht, në zgjidhjen e konflikteve në familje¹, ndërmjetësimi është përdorur po aq, madje mos më shumë, se rrugët e tjera të zgjidhjes së konfliktit, si: negocimi, diplomacia aktive ndaj palëve, vlerësimi fillestar neutral, këshillimi, pajtimi, arbitrazhi, apo vetë procesi gjyqësor². Rëndësia dhe aplikimi në rritje i ndërmjetësimit ka qenësi rezultat i një numri karakteristikash që ndërmjetësimi ka.

Parë si proces, rëndësia e ndërmjetësimit buron nga fakti se bazohet mbi parimet e neutralitetit të ndërmjetësit, të mos parit e palës tjetër si armik, disponimit bashkëpunues, reagimit të përgjegjshëm, vetëvendosjes dhe autonomisë së palëve, si dhe udhëheqjes, që palët marrin nga ndërmjetësi gjatë procesit, në funksion të arritjes së zgjidhjes së konfliktit. Ndërmjetësimi shihet i aftë për të parandaluar konfliktin ose shkallëzimin e tij³, për të qenë efektiv në konflikte emocionalisht komplekse⁴, për të arritur mirëkuptimin dhe pajtimin mes palëve⁵ dhe çuar në zgjidhje të pëlqyeshme për të dy palët⁶. Ndërmjetësimi ofron privilegjin

¹ Kelly, J. (2004), "Family Mediation Research: Is There Empirical Support for the Field?", *Conflict Resolution Quarterly*, Vol. 22, No. 1-2, pp. 3-35.

² Simkin, W. E., (1971) Bureau of National Affairs Books, *Mediation and the Dynamics of Collective Bargaining*, Washington DC, pp.35-47.

³ Charlton, Ruth and Micheline Dewdney (1995) *The Mediator's Handbook: Skills and Strategies for Practitioners*, Law Book Company, Sydney, pp.53-68.

⁴Roche, D. (2003) "Gluttons for Restorative Justice", *Economy and Society*, Vol. 32, No. 4, pp. 630-644.

⁵Tjosvold, D., Poon, M. and Yu, Z. (2005) "*Team Effectiveness in China: Cooperative Conflict for Relationship Building*", *Human Relations*, Vol. 58, No. 3, pp. 341-366.

e mosparagjykit, d.m.th. çdo ofertë apo pohim i bërë nga palët nuk mund të përdoret si provë në gjykatë dhe iu mundëson palëve të mos heqin dorë nga përdorimi i sistemit të drejtësisë, të drejtat ligjore ose të kërkuarit e dëmshpërblimit përmes një procesi gjyqësor, nëse marrëveshja nuk arrihet⁷. Mbi të gjitha, ndërmjetësimi ofron mundësinë e eksplorimit të padrejtësive të së shkuarës, prekjen e një game çështjesh më të gjëra se ç'do të lejonte një proces gjyqësor, bën më të lehtë të falurin e tjetrit, gjeneron një shkallë më të lartë kënaqësie tek palët në konflikt, dhe kontribuon në ruajtjen e marrëdhënieve mes palëve edhe pas procesit⁸.

Parë nga ana e palëve në konflikt, rëndësia e ndërmjetësimit buron nga fakti, se ai iu garanton palëve kontroll mbi procesin dhe rezultatin, reduktim të polarizimit, bashkëpunim dhe përfitim të dyanshëm⁹, si dhe kohë të shkurtër e kosto të ulët të zgjidhjes së konfliktit¹⁰. Mbi të gjitha, ndërmjetësimi iu garanton palëve një mundësi të lartë të zbatimit të marrëveshjes, qoftë për shkak të arritjes së saj me pajtimin e dy palëve, qoftë për shkak të imponimit që mund t'i bëjë gjykata zbatimit të marrëveshjes si dhe konfidencialitet të procesit. Ndërmjetësimi zhvillohet privatisht dhe askush veç palëve dhe ndërmjetësit nuk ka dijeni të ofertave apo pohimeve të bëra. Këto të fundit, nuk dokumentohen dhe ndërmjetësi, në rastet kur mban shënime, jo vetëm që i eliminon ato, por edhe është i detyruar të mos dëshmojë rreth tyre, nëse konflikti përfundon në gjykatë¹¹. Nisur nga rëndësia në rritje e

⁶Ridley-Duff, R. J. (2006) *The Evolution of Corporate Cultures*, Sheffield Hallam University, pp.12.

⁷Charlton, R. and M. Dewdney (2004). *The Mediator's Handbook. Skills and Strategies for Practitioners*, pp. 126; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*), pp.12; Bernardine Van Gramberg (2006) "*Managing Workplace Conflict*" FEDERATION Press, pp.173.

⁸ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) (*veper, e cit.*), pp.11-12.

⁹ Boulle, Laurence (2005). *Mediation: Principles, Processes, Practice*, Australia, Butterworths, pp. 87; Schellenberg, R., Parks-Savage, A. and M. Reh fuss (2007) "*Reducing levels of elementary school violence with peer mediation*," Professional School Counseling, Vol. 10, pp. 475–481 ;Bernardine Van Gramberg (2006), (*veper, e cit.*), FEDERATION Press, pp.173; Dale Bagshaw (1999) "Conflict Resolution Quarterly, pp. 117-143.

¹⁰ Boulle, Laurence (2005), (*veper, e cit.*), Australia, Butterworths, pp. 87; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*), pp.11-12; Bernardine Van Gramberg (2006) ,(*veper, e cit.*)" FEDERATION Press, pp.173.

¹¹ Charlton, R. and M. Dewdney (2004). *The Mediator's Handbook. Skills and Strategies for Practitioners*, pp. 344; Spencer, D. and T. Altobelli (2005). *Dispute Resolution in Australia. Cases, Commentary and Materials*. Riverwood NSW, Ligare Pty Ltd. Pp.261 ;Boulle, Laurence (2005), *Mediation: Principles, Processes, Practice*,

ndërmjetësimit, si instrument zgjidhjeje të konfliktit mes palëve, mund të bëhen katër vëzhgime rreth ndërmjetësimit si praktikë.

Së pari, ndërmjetësimi po shihet dhe tentohet gjithnjë e më shumë, si rruga më e parë e trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit mes palëve, në raport me rrugët e tjerë. Konsiderohet kështu, sepse e dallon nga rrugët e tjera thjeshtësia, informaliteti, fleksibiliteti dhe ekonomizmi¹².

Së dyti, numri i fushave dhe marrëdhënieve ku ndërmjetësimi përdoret për të zgjidhur konfliktin mes palëve, ka njohur një rritje të konsiderueshme. Për dekada të tëra, ndërmjetësimi ka qenë praktikë e zakonshme dhe dominante për konfliktet në sferën e të drejtës kushtetuese¹³, aktivitetit kriminal¹⁴, apo marrëdhënieve familjare. Por, në ditët e sotme, përdorimi i ndërmjetësimit për zgjidhjen e konflikteve ka hyrë edhe në sferën e marrëdhënieve në punë¹⁵, marrëdhënieve industriale¹⁶, çështjeve ambientale¹⁷, konflikteve

Australia, Butterworths, pp. 539; Van Gramberg, Bernadine. (2006) *Managing Workplace Conflict: Alternative Dispute Resolution in Australia*, The Federation Press, Sydney, Australia, pp.38.

¹² Boulle, Laurence (2005), (*veper, e cit.*), Butterworths, pp. 134.

¹³ Fiss, Owen (1984) "Against Settlement," *Yale Law Journal*, Vol. 93, pp. 1073-1087 ;Fiss, Owen (1985) "Out of Eden," *Yale Law Journal*, Vol. 94, pp. 1669 ;McThenia, Andrew W. and Thomas L. Shafer (1985) "For Reconciliation," *Yale Law Journal*, Vol. 94, pp. 1660 ;Riskin, Leonard L (1997) "Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed," *Harvard Negotiation Law Review*, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 10.

¹⁴ Alschuler, Albert. (1986) "Mediation with a Mugger: The Shortage of Adjudicative Services and the Need for a Two-Tier, Trial System in Civil Cases," *Harvard Law Review*, Vol. 99, pp. 1808-1810 ;Umbret, Mark S (1994) *Victim Meets Offender: The Impact of Restorative Justice and Mediation*, pp. 61-73, Riskin, Leonard L (1997), (*veper, e cit.*), pp. 10.

¹⁵ Boulle, Laurence (2005), (*veper, e cit.*), pp.298 ;Noaks, J. and Noaks, L. (2009) "School-based peer mediation as a strategy for social inclusion," *Pastoral Care in Education*, Vol. 27, No. 1, pp. 53-61;Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*) pp. 1;Billikopf, Gregorio (2014) *Party-Directed Mediation: Facilitating dialogue between individuals*, 3th Edition, University of California, pp. 341-373; Stitt, Allan J. (2003) *Mediating Commercial Disputes*. Aurora, ON: Canada Law Book Inc, pp.76-107; Cloke, Kenneth. and Joan Goldsmith (2000) *Resolving Conflicts at Work: A Complete Guide for Everyone on the Job*, San Francisco: Jossey-Bass, pp.34-58.

¹⁶ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution", *British Academy of Management*, University of Sheffield, 14th-16th September pp. 1.

personale me rrënjë të thella¹⁸,apo në sferën e konflikteve me karakter multikulturor apo multietnik¹⁹. Kështu, në marrëdhëniet familjare, ndërmjetësimi përdoret për zgjidhjen e konflikteve mbi pronën, biznesin, të ardhurat, marrëveshjet paramartesore, ndarjen, divorcin, kujdesin për fëmijët apo prindërit; në marrëdhëniet në punë: për pushimin nga puna, shpërblimin, diskriminimin, apo ankesat; në marrëdhëniet ambientale: për përdorimin e tokës, ujërave, pyjeve; në marrëdhëniet industriale: për kontratat, menaxhimin e resurseve, partner-ship-et, marrëdhëniet kontraktorë-ndërtues; ndërsa, në marrëdhëniet personale: për konfliktet qiradhënës-qiramarrës, praktikat mjekësore, plagosjet dhe dëmtimet personale. Së treti, në praktikimin e ndërmjetësimit nuk aplikohet një mënyrë e vetme, por vëzhgohen disa tipe të ndryshme ndërmjetësimi. Në vitet 1980-1990, flitej për tipin e ndërmjetësit me “fokus të ngushtë” ose me “fokus të gjerë” të definimit të problemit²⁰, ndërmjetësim “vlerësues”²¹ apo ndërmjetësim “lehtësues”²².

¹⁷ Susskind, Lawrence (1981), Environmental Mediation and the Accountability Problem, *Vermont Law Review*, Vol. 6, No. 1, pp. 46; Stulberg, Joseph B. (1981) “The Theory and Practice of Mediation: A Replay to Professor Susskind,” *Vermont Law Review*, Vol. 6, pp. 106; Van Gramberg, Bernadine. (2006) *Managing Workplace Conflict: Alternative Dispute Resolution in Australia*, The Federation Press, Sydney, Australia, pp.38; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*) pp. 1.

¹⁸ Schellenberg, R., Parks-Savage, A. and M. Rehfuss (2007) "Reducing levels of elementary school violence with peer mediation," *Professional School Counseling*, Vol. 10, pp. 475–481; Cremin, H. (2007).*Peer Mediation: Citizenship and Social Inclusion in Action*, Maidenhead, Open University Press, pp.119; Billikopf, Gregorio (2014) *Party-Directed Mediation: Facilitating dialogue between individuals*, 3th Edition, University of California, pp. 374-396.

¹⁹Gerber, S. (1999) 'Does peer mediation really work?', *Professional School Counseling*, Vol. 2, No. 3, p. 169, Schellenberg, R., Parks-Savage, A. and M. Rehfuss (2007), (*veper, e cit.*), pp. 475–481;Billikopf, Gregorio (2014), (*veper, e cit.*) pp. 4341-472.

²⁰ Riskin, Leonard L (1997), (*veper, e cit.*) pp. 25.

²¹ Keating, Michael J. Jr. and Margaret L. Shaw (1990) “Compared to what? Defining terms in court-related ADR programs,” *Negotiation Journal*, Vol. 6, pp. 217 ;Riskin, Leonard L (1997),(*veper, e cit.*) pp. 19-25.

²² Friedman, Gary J. (1993) *A guide to divorce mediation*, pp.27; Dauer, Edward A. (1994) *Manual of dispute resolution: ADR law and practice*, pp. 11-45; Princen, Thomas (1994) “Joseph Elder: Quiet peacemaking in a Civil War,” in *When talks works*, pp. 428,

Riskin, Leonard L (1997) “Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed,” *Harvard Negotiation Law Review*, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 19-25; Ridley-Duff, R. J. and A.

Që nga vitet 1990 e sot, përveç tipeve të mësipërme të ndërmjetësimit, flitet edhe për ndërmjetësim “transformativ”²³, ndërmjetësim “narrativ”²⁴, ndërmjetësim “të njëanshëm”²⁵, apo ndërmjetësim “i drejtuar nga palët”²⁶. Së katërti, praktikimi i ndërmjetësimit, si instrument zgjidhjeje konflikti, ka çuar në kryerjen e ndryshimeve brenda sistemit të drejtësisë.

Ndërmjetësimi është inkorporuar brenda sistemit të drejtësisë, si një instrument plotësues i metodave të tjera të zgjidhjes së konfliktit dhe program që i paraprin procesit gjyqësor²⁷.

P.sh. në SHBA, ndërmjetësimi jo vetëm përbën instrumentin kryesor të zgjidhjes së konflikteve, por ka çuar edhe në ngritjen e një agjencie të veçantë në nivelin e qeverisë federale, e cila merret specifikisht me ndërmjetësimin²⁸.

J. Bennett (2010) "Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution", *British Academy of Management*, University of Sheffield, 14th-16th September pp. 2.

²³ Bush, Robert A. B. (1994) “*The Dilemmas of Mediation Practice: A Study of Ethical Dilemmas and Policy Implications*,” *Journal of Dispute Resolution*, Vol. 1, No. 54. pp. 46-65; Lang, Michael (1996) “Transformative Approaches to Mediation”, *Mediation Quarterly*, Vol. 13, No. 4, pp. 35-54; Mareschal, P. (2003) "Solving problems and transforming relationships: The Bifocal Approach to Mediation", *The American Review of Public Administration*, Vol. 33, pp. 423-448; Gaynier, L (2005) "Transformative Mediation: In Search of a Theory of Practice", *Conflict Resolution Quarterly*, Vol. 22, No. 3, pp. 397-408, Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (veper, e cit.)pp. 2.

²⁴ White, Michael (2000) *Narrative Mediation: A New Approach to Conflict Resolution*, pp.68-84; Winslade, John and Gerald Monk (2000) *Narrative Mediation: A New Approach to Conflict Resolution*. San Francisco: Jossey-Bass, pp.68-84.

²⁵ Svensson, Isak (2009). "Who Brings Which Peace? Neutral versus Biased Mediation and Institutional Peace Arrangements in Civil Wars," *The Journal of Conflict Resolution*, Vol. 53, No. 3, pp. 446–469.

²⁶ Billikopf, Gregorio (2014), (veper, e cit.) pp.58-83.

²⁷ Stulberg, Joseph B. (1975) “An Civil Alternative to Criminal Prosecution,” *Albany Law Review*, Vol. 39, pp. 359; McGillis, D. And J. Mullen (1977) *Neighborhood Justice Centers: An Analysis of Potential Models*, US Department of Justice, pp.152-183; Stulberg, Joseph B. (1981), (veper, e cit.), pp. 84-117.

²⁸ Mareschal, P. (2003) "Solving problems and transforming relationships: The Bifocal Approach to Mediation", *The American Review of Public Administration*, Vol. 33, pp. 423-448, Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (veper, e cit.) pp. 2.

1.2. Përse ka vlerë studimi i Ndërmjetësisimit

Studimi i ndërmjetësisimit, si instrument për zgjidhjen e konfliktit midis palëve dhe i dinamikave të tij, në realitetin praktik paraqet interes nga pikëpamja teorike, ashtu si edhe nga ana praktike.

Nga pikëpamja teorike, arsyeja e parë që e bën me vlerë studimin e ndërmjetësisimit, ka të bëjë me vetë natyrën e tij. Qoftë praktika e ndërmjetësisimit, qoftë roli dhe ndikimi i tij si instrument, është pasqyrë jo vetëm e veprimit të faktorëve të ndryshëm, por edhe të ekzistencës ose jo, të një numri parakushtesh. Fakti, nëse plotësohen ose jo disa parakushte përcakton, në mund të flitet apo jo për praktikimin e instrumentit të ndërmjetësisimit në zgjidhjen e konflikteve mes palëve. Ndërsa, fakti, nëse një apo disa faktorë specifikë kanë një veprim dhe ndikim më të madh se faktorë të tjerë, përcakton në një masë të konsiderueshme tipin dhe efektivitetin e ndërmjetësisimit, në përdorimin e tij si një ndër instrumentet e disponueshëm për zgjidhjen e konflikteve. Në këtë kuptim, në analizimin se sa i rëndësishëm shfaqet ndërmjetësimi në zgjidhjen e konflikteve mes palëve në Shqipëri, plotësimi i parakushteve merr vlerën e “kushteve të domosdoshme”, d.m.th. shkalla e plotësisimit apo jo të këtyre parakushteve, shërben edhe si tregues se sa i përhapur, i shpeshtë dhe i rëndësishëm është përdorimi i instrumentit të ndërmjetësisimit në Shqipëri. Ndërsa, në analizimin se cilët faktorë shoqërojnë praktikimin e ndërmjetësisimit në Shqipëri, fakti, se cili faktor apo grup faktorësh veprues është më dominant, merr vlerën e “kushteve të nevojshme”, d.m.th. cili grup faktorësh është më shumë ose më pak influencues, përcakton edhe shkallën e ulët apo të lartë të efektivitetit të ndërmjetësisimit.

Nisur nga dallimi mes parakushteve dhe faktorëve, studiuesit identifikojnë disa parakushte dhe grupe faktorësh. Në grupin e parakushteve, studiuesit përfshijnë tre parakushte kryesore: 1) normat dhe zakonet kulturore në raport me përdorimin e ndërmjetësisimit për zgjidhjen e konflikteve; 2) rëndësia që i jep dhe trajtimi që i bëhet ndërmjetësisimit brenda kuadrit ligjor dhe sistemit të drejtësisë; dhe 3) shkalla e përgatitjes dhe profesionalizmit të ndërmjetësisimit. Në aspektin kulturor, parakushtet nënkuptojnë pranimin dhe praktikimin nga individ, grupet dhe shoqëria të rrugëve informale të zgjidhjes së konfliktit, të besuarit tek standardet e drejtësisë dhe trajtimin të barabartë, të besuarit tek ndershmëria dhe të sjellit në mënyrë të ndershme, si dhe të zbatimit të vendimeve, si të atyre që gjenerohen nga marrëveshjet mes palëve, ashtu edhe ato që burojnë nga vendimet e

gjykatave²⁹. Në dimensionin ligjor, parakushtet nënkuptojnë garantimin nga ligji të të drejtave dhe barazisë së palëve, në procesin e ndërmjetësimit, të mbrojtjes së palës që gjendet në një pozitë më të dobët, të konsiderimit të autoritetit të palëve si i vetmi burimi legjitimiteti për negociata, të menaxhimit të fakteve, apo edhe të standardeve dhe sistemit të akreditimit të ndërmjetësve³⁰. Parakushtet e natyrës juridike nënkuptojnë, gjithashtu, edhe vullnetin e gjykatave për të imponuar përdorimin e ndërmjetësimit, si rrugën më të parë të zgjidhjes së një konflikti dhe për t'i dërguar palët në ndërmjetësim, përpara se ato të vendosin t'i hyjnë procesit gjyqësor për të zgjidhur konfliktin mes tyre³¹. Në aspektin profesional, përtej cilësive personale të ndërmjetësit, si person i artikuluar, i durueshëm, joparagjykses, fleksibël, parakushtet nënkuptojnë ekzistencën e një ndërmjetësi me përgatitje, kualifikim dhe eksperiencë profesionale, si dhe aftësi të kultivuara në funksion të rolit të ndërmjetësit. Nga ana e përgatitjes dhe kualifikimit, një ndërmjetës profesionist nënkupton zotërimin e njohurive teorike dhe praktike rreth konfliktit, negocimit, dhe ndërmjetësimit, të qenurit i arsimuar, trajnuar, dhe certifikuar, të gëzuarit e reputacionit dhe përvojës personale në ndërmjetësim, të qenurit i besueshëm, me integritet, objektiv dhe neutral³². Nga ana e aftësive, një ndërmjetës i kultivuar nënkupton zhvillimin dhe zotërimin e aftësive për t'u familjarizuar me problemin në qendër të konfliktit, për të analizuar situatat, dinamikat, kufizimet, presionet e konfliktit; për të qenë dëgjues efektiv dhe inteligjent, komunikues i fortë, bindës, me imagjinatë, i informuar dhe me akses në burime të ndryshme; për të planifikuar dhe ndërtuar një strategji që të përcaktojë nevojat dhe synimet e palëve, të

²⁹ Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp.27-28; Ridley-Duff, R. J. (2006) *The Evolution of Corporate Cultures*, Sheffield Hallam University, pp.84-112; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution", *British Academy of Management*, University of Sheffield, 14th-16th September, pp. 11.

³⁰ Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp. 31.

³¹ Spencer, D. and T. Altobelli (2005). *Dispute Resolution in Australia. Cases, Commentary and Materials*. Riverwood NSW: Ligare Pty Ltd, pp.223; Michael Borgan, David Spencer (2006) "*Mediation Law and Practise*", Cambridge University Press, pp..54.

³² Stulberg, Joseph B. (1981) "The Theory and Practice of Mediation: A Replay to Professor Susskind," *Vermont Law Review*, Vol. 6, pp. 94-96; Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998), (*veper, e cit.*), pp.29.

formatojëpjesëmarrjen e palëve, të qartësojë procedurat, juridiksionin dhe zbatimin e marrëveshjes, të zgjedhë dhe menaxhojë raste, të vendosëvlerësimin e procedurave efektive dhe të nxjerrë palët nga një situatë pa rrugëdalje³³.

Ndërsa përsa i përket faktorëve influences, studiuesit identifikojnë tre grupe kryesore faktorësh: 1) ato që kanë të bëjnë me ndërmjetësin; 2) faktorët që kanë të bëjnë me konfliktin; dhe 3) ato që kanë të bëjnë me palët në konflikt. Në faktorët që lidhen me ndërmjetësin studiuesit i japin rëndësi rolit dhe tipit të ndërmjetësit³⁴, strategjisë së ndërmjetësit³⁵, përgatitjesdhe përgjegjësisë ligjore të tij³⁶. Në faktorët që lidhen më konfliktin, studiuesit i japin rëndësi, fazës së konfliktit³⁷dhe objektivave të konfliktit³⁸. Ndërsa në faktorët që lidhen me palët në konflikt, studiuesit i japin rëndësi rolit dhe

³³ Charlton, Ruth and Micheline Dewdney (1995) *The Mediator's Handbook: Skills and Strategies for Practitioners*, Sydney: Law Book Company, pp.73-96; Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*,Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp.33.

³⁴ Stulberg, Joseph B. (1981) "The Theory and Practice of Mediation: A Replay to Professor Susskind," *Vermont Law Review*, Vol. 6, pp. 94-96; Nelson, Lisa (2012) "What is a Divorce Mediator?" Mediation Blog, Billikopf, Gregorio (2014) *Party-Directed Mediation: Facilitating dialogue between individuals*, 3th Edition, University of California, pp.58-83.

³⁵ Menkel-Meadow, Carrie (1984) "Toward another view of legal negotiation: The structure of problem-solving," *UCLA Law Review*, Vol. 31, p. 754-762; Gifford, Donald G. (1985) "A context-based theory of strategy selection in legal negotiation," *Ohio State Law Journal*, Vol. 46, pp. 41-49; Fisher, Roger and Scott Brown (1988) *Getting together*, pp. 23-30; Ury, William (1993), *Getting past*, pp.47-59; Riskin, Leonard L (1997) "Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed," *Harvard Negotiation Law Review*, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 13-14.

³⁶Zutter, Deborah (2004) *Preliminary Mediation Practices*, Bond University, Australia: Unpublished Thesis, pp.80-98; Zutter, Deborah Lynn (2005) *Preparing for Mediation: A Dispute Resolution Guide*. Toronto: Trafford Publishing, pp. 64-87.

³⁷ Spillman, Kurt R. and Kati Spillman (1991) "On Enemy Images and Conflict Escalation," *ISSS Journal*, Vol. 27,pp. 57; Noll, Douglas E. (2001) "A Theory of Mediation," *Dispute Resolution Journal*, February, pp. 84-106.

³⁸ Wilmot, William W. and Joyce L. Hocker (1998) *Interpersonal Conflict*, 5th edition, New York: McGraw-Hill,pp.35-60; Noll, Douglas E. (2001), (veper, e cit.) pp. 84-106.

pjesëmarrjes së palëve³⁹, përzgjedhjes së ndërmjetësit, si dhe disponimit që tregojnë palët në konflikt⁴⁰.

Arsyeja e dytë teorike, që e bën interesant studimin e ndërmjetësit, është numri i madh i përqsasjeve të analizimit të ndërmjetësit⁴¹. Dallimet në përqsasje ekzistojnë jo vetëm nga pikëpamja e konceptimit që i bëhet ndërmjetësit, supozimeve mbi të cilat ngrihet, faktorëve që theksojnë dhe modeleve të ndërmjetësit që ato gjenerojnë e iu sugjerojnë për përdorim ndërmjetësve profesionistë, por edhe nga pikëpamja e vendndodhjes, ku dallimet më të mëdha vihen re midis studiuesve amerikanë dhe atyre europianë⁴². Të ngritura fillimisht mbi dikotomi konceptesh, të tilla si: ndërmjetësimi “vlerë-krijues” apo “vlerë-pretendues”⁴³, negociata “distributive” apo negociata “integrative”⁴⁴, studiuesit i kanë zhvilluar, më pas, analizat e tyre mbi dikotomi përqsasjesh, ndër të cilat, më kryesoret shfaqen “përqsasja problem-zgjidhëse” përkundër “përqsasjes transformuese”⁴⁵ dhe “përqsasja

³⁹New South Wales the Law Society, *A guide to the rights and Responsibilities of participants*.

⁴⁰ Menkel-Meadow, Carrie (1994) “Ex Parte Talks with Neutrals: ADR Hazard,” *Alternatives to the High Cost of Litigation*, September 1994, Vol. 1, pp.156-189; Nolan-Haley, Jacqueline M. (1996) “Court mediation and the search for justice through law,” *Washington University Law Quarterly*, Vol. 74, pp. 501; Riskin, Leonard L (1997) “Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed,” *Harvard Negotiation Law Review*, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 11-46.

⁴¹ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution", *British Academy of Management*, University of Sheffield, 14th-16th September, pp. 2-27,

⁴² Fritz, Jan Marie (2004) *Behind the Magic: Mediation Models, Approaches and Theories*, pp. 65-83; Fritz, Jan Marie (2006) *Approaches to Conflict: Social Theory and Mediation*, pp. 24–36; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*) pp. 2-27

⁴³ Lax, David A. and James K. Sebenus (1986) *The manager as negotiator*, pp. 29-45, 88-153.

⁴⁴ Raiffa, Howard (1982) *The art and science of negotiation*, pp.33-34,

Walton, Richard E. and Robert B. McKersie (1991) *A behavioral theory of labor negotiations*, 2nd Edition, pp.4-11; Riskin, Leonard L (1997) (*veper, e cit.*)pp.13-14.

⁴⁵ Bush, R. and J. Folger (1994) *The Promise of Mediation: Responding to Conflict through Empowerment and Recognition*, San Francisco: Jossey-Bass, pp.27-48; Bingham, L. and Pitts, D. (2002) "Highlight of Mediation at Work: Studies of the National REDRESS Evaluation Project", *Negotiation Journal*, April 2002, pp. 135-146; Gaynier, L (2005) "Transformative Mediation: In Search of a Theory of Practice", *Conflict Resolution Quarterly*, Vol. 22, No. 3, pp. 397-408,

udhëzuese” përkundër “përqasjes lehtësuese”⁴⁶. Ndonëse përqasjet dallohen nga fakti, nëse ato i japin përparësi çështjeve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet dhe detyrat mes palëve apo rolin e ndërmjetësit dhe rezultatit⁴⁷, në realitetin praktik, ndërmjetësit shpesh përballen me situata ku përqasjet interferojnë me njëra-tjetrën, duke bërë që një rast specifik as të mos analizohet nga një përqasje e caktuar, as të mos trajtohet në bazë të një modeli të vetëm specifik ndërmjetësimi⁴⁸. Gjithsej mund të përmenden tetë përqasje, të cilat dallohen nga faktorët që theksojnë, supozimet që bëjnë, fokusi që kanë dhe konceptimi që i bëjnë ndërmjetësimit, ndërmjetësit dhe palëve.

Në përqasjen “Problem-zgjidhëse,” në fokus janë shkaqet e konfliktit dhe çështjet që karakterizojnë marrëdhëniet mes palëve⁴⁹. Faktori kryesor që thekson është roli i ndërmjetësit. Përqasja ngrihet mbi supozimet se zgjidhja e konfliktit është e mundshme, vetëm kur identifikohen shkaqet e tij dhe, se palët për të arritur një pajtim të interesave, kanë nevojë të motivohen që të negociojnë⁵⁰. Sipas kësaj përqasjeje, roli i ndërmjetësit konsiston në të qenurit aktiv në ndërhyrjet e tij dhe në arritjen e zgjidhjes⁵¹. Ndërmjetësimi ka karakter vlerësues dhe lehtësues⁵².

Në përqasjen “Transformuese”, në fokus janë aftësitë dhe detyrat negociuese të palëve⁵³. Faktorët kryesorë që theksohen janë roli i ndërmjetësit dhe roli i palëve në konflikt, nga pikëpamja e përgatitjes dhe aftësive të tyre negociuese. Përqasja ngrihet mbi supozimet,

Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution", *British Academy of Management*, University of Sheffield, 14th-16th September, pp. 2-27.

⁴⁶ ACAS (2005) "Evaluation of the ACAS Pilot of Mediation, Appeals and Employment Law Visit Services to Small Firms," ; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*) pp. 2-27

⁴⁷ Po aty, pp.12.

⁴⁸ Riskin, Leonard L (1997) “Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed,” *Harvard Negotiation Law Review*, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp.13-14.

⁴⁹ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*), pp. 2-27

⁵⁰ Riskin, Leonard L (1997), (*veper, e cit.*) pp.13-14

⁵¹ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) (*veper, e cit.*)pp.5.

⁵² Po aty, pp.2-5.

⁵³ Bingham, L. and Pitts, D. (2002) "*Highlight of Mediation at Work: Studies of the National REDRESS Evaluation Project*", *Negotiation Journal*, April 2002, pp. 137,
Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*), pp.2-5.

se qëllimi i ndërmjetësimit nuk është arritja e një marrëveshjeje, edhe pse kjo nuk përjashtohetë ndodhë, dhe se qëllimi i ndërmjetësimit është aftësimi i palëve në njohuritë dhe fuqinë për të trajtuar dhe zgjidhur problemet që kanë mes tyre⁵⁴. Sipas kësaj përjasjeje, roli i ndërmjetësit konsiston në dhënien e ndihmës ndaj palëve, në mënyrë që, palët në konflikt të kontrollojnë edhe procesin, edhe rezultatin⁵⁵. Roli i palëve konsiston në përcaktimin e rregullave të lojës, të mjeteve që do përdoren për të arritur rezultat dhe vetë përcaktimin e rezultatit⁵⁶. Vetë procesi i ndërmjetësimit ka karakter më së shumti lehtësues.

Në përjasjen “Drejtuese”, në fokus janë aftësitë dhe cilësitë e ndërmjetësit⁵⁷. Faktori kryesor është rëndësiaqë i jepet rolit të ndërmjetësit, nga pikëpamja e aftësive të tij. Përjasja ngrihet mbi supozimet, se rezultati i ndërmjetësimit varet nga aftësitë dhe cilësitë e ndërmjetësit; se rezultati i ndërmjetësimit reflekton atë, që ndërmjetësi ka arritur ose jo të bëjë, për të inkurajuar palët të shkojnë drejt një zgjidhjeje⁵⁸. Sipas kësaj përjasjeje, roli i ndërmjetësit konsiston në të qenurit “gardian” dhe kontrollues i procesit dhe në bërjen e rekomandimeve për palët⁵⁹. Palët kontrollojnë vetëm rezultatin e ndërmjetësimit⁶⁰. Vetë procesi i ndërmjetësimit ka karakter ose drejtues ose lehtësues.

Në përjasjen “Lehtësuese”, në fokus është procesi i ndërmjetësimit nga pikëpamja e arritjes së rezultatit dhe suksesit në gjenerimin e një rezultati të pranueshëm nga të dy palët në konflikt⁶¹. Faktori kryesor që theksohet është roli i ndërmjetësit nga pikëpamja e kushteve, të cilat u krijon palëve dhe ndihmës që jepet për arritjen e rezultatit⁶². Përjasja ngrihet mbi

⁵⁴ Bingham, L. and Pitts, D. (2002) "*Highlight of Mediation at Work: Studies of the National REDRESS Evaluation Project*", *Negotiation Journal*, April 2002, pp. 137.

⁵⁵ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "*Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution*", British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.2-5.

⁵⁶ Po aty, pp.2-5.

⁵⁷ Po aty, pp.2-5.

⁵⁸ Po aty, pp.12.

⁵⁹ ACAS (2005) "Evaluation of the ACAS Pilot of Mediation, Appeals and Employment Law Visit Services to Small Firms,"; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*)pp.2-12.

⁶⁰ ACAS (2005) "Evaluation of the ACAS Pilot of Mediation, Appeals and Employment Law Visit Services to Small Firms,"; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*), pp.2-12.

⁶¹ Po aty, pp.12.

⁶² Po aty, pp.12.

supozimin se procesi i ndërmjetësimit, që të arrijë rezultat pozitiv dhe një marrëveshje të pranuar nga të dy palët, ka nevojë për krijimin e kushteve dhe inkurajimin e palëve për të gjetur zgjidhje⁶³. Sipas kësaj përqasjeje, roli i ndërmjetësit konsiston në inkurajimin e palëve, të skicojnë vetë zgjidhjen që duan dhe kontrollimin e procesit⁶⁴. Ndërsa roli i palëve konsiston në skicimin e zgjidhjes që duan, kontrollin dhe përcaktimin e rezultatit të procesit⁶⁵. Procesi i ndërmjetësimit ka karakter lehtësues dhe udhëzues.

Në përqasjen që analizon ndërmjetësimin nisur nga “Natyra e Konfliktit”, në fokus janë palët nga pikëpamja e veprimeve, perceptimeve, besimeve, interesave, të drejtave dhe fuqia e tyre⁶⁶. Faktorët kryesorë që theksohen janë palët, nga pikëpamja e motiveve, veprimeve, dhe interesave, si dhe ndërmjetësi, nga pikëpamja e analizës dhe trajtimit të veprimeve, perceptimeve, dhe besimeve të palëve në konflikt. Përqasja ngrihet mbi supozimet: se konflikti është racional dhe i pashmangshëm dhe kjo bën të nevojshme krijimin dhe përdorimin e proceseve ndërmjetëse, që bazohen në miratimin e palëve në konflikt; se palët kanë arsyet dhe mundësitë të bashkëpunojnë drejt arritjes së objektivave të përbashkëta; dhe se konflikti, përtej të qenurit i pashmangshëm, është sa produkt i ndryshimeve, aq edhe nxitës i vetë ndryshimit; dhe se natyra e konfliktit⁶⁷. Sipas kësaj përqasjeje, roli i ndërmjetësit konsiston në eksplorimin, njohjen, analizimin, dhe adresimin e besimeve dhe perceptimeve të palëve rreth konfliktit, të veprimeve të tyre, si dhe në tentimin që të arrijë një përputhje të interesave ekonomike dhe sociale të palëve në konflikt⁶⁸. Vetë

⁶³ Po aty, pp.5.

⁶⁴ Po aty, pp.2-12.

⁶⁵ ACAS (2005) "Evaluation of the ACAS Pilot of Mediation, Appeals and Employment Law Visit Services to Small Firms; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "*Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution*", British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.5.

⁶⁶ Ury, William (1993), *Getting past*, pp.47-59; Huczynski, A. and Buchanan, D. (2007) *Organizational Behaviour*, Harlow: Prentice Hall, pp. 764; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*) pp.1-3.

⁶⁷ Fox, A. (1985) *Man Mismanagement*, London: Hutchinson & Co, pp. 89-136; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010), (*veper, e cit.*) pp.1-3.

⁶⁸ Huczynski, A. and Buchanan, D. (2007) *Organizational Behaviour*, Harlow: Prentice Hall, pp.764; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "*Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution*", British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.1-3.

procesi i ndërmjetësimit karakterizohet nga vështirimi i problemeve në mënyrë të ngushtë ose të gjerë, vlerësuese ose lehtësuese.

Në përqasjen, që e analizon ndërmjetësimin nisur nga “Autoriteti, Dija, dhe Pushteti”, në fokus janë ndërmjetësi dhe palët nga pikëpamja e veprimeve dhe qëndrimeve që mbajnë. Faktorët kryesorë që theksohen janë ekspertiza e ndërmjetësit dhe statusi i palëve. Përqasja ngrihet mbi supozimet, se proceset janë legjitime kur autoriteti është i përcaktuar qartë; se ndërmjetësimi mund të gjenerojë kënaqësi për të dy palët kur karakterizohet nga zhvillimi tek palët i aftësive të nevojshme për komunikim, negocim, dhe marrëdhënie barazie mes tyre; dhe se procesi dhe rezultati janë të mundshëm dhe të drejtë, kur marrin parasysh qëndrimet dhe interesat e të dy palëve⁶⁹. Sipas kësaj përqasjeje, roli i ndërmjetësit konsiston në identifikimin e atij që ka autoritetin për të negociuar, në zhvillimin e aftësive negociuese tek të dy palët; në krijimin e një atmosfere, ku palët të ndjehen se trajtohen në mënyrë të barabartë dhe, në konturimin e një zgjidhjeje, që merr parasysh vërejtjet dhe interesat e të dy palëve⁷⁰. Procesi i ndërmjetësimit ka karakter, edhe lehtësues, edhe drejtues.

Në përqasjen, që i sheh “Palët si Kundërshtarë”, në fokus janë palët në konflikt nga pikëpamja e burimeve financiare. Faktori kryesor që theksohet janë interesat e palëve nga pikëpamja e motiveve dhe veprimeve. Përqasja ngrihet mbi supozimet, se thelbi i negociatave mes palëve janë paratë; se qëllimet e palëve janë të kundërta, pasi ato e shohin situatën sipas modelit “humbja ime” është “fitim i tjetrit”⁷¹. Sipas kësaj përqasjeje, roli i ndërmjetësit konsiston në lehtësimin e komunikimit mes palëve, ndërsa roli i palëve është të vendosin, nëse paratë do të ndahen apo jo, dhe, nëse po, si do të ndahen⁷². Procesi i ndërmjetësimit ka karakter lehtësues, me palët që marrin rol qendror në proces, duke kontrolluar si procesin edhe rezultatin.

Në përqasjen e fundit, që e sheh ndërmjetësimin të “Drejtuar nga Palët”, në fokus janë palët në konflikt nga pikëpamja e veprimeve dhe pjesëmarrjes. Faktori kryesor që theksohet janë aftësitë e palëve. Përqasja ngrihet mbi supozimet, se ndërmjetësimi mund të arrijë në

⁶⁹ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) (*veper, e cit.*), pp.1-3.

⁷⁰ Po aty, pp.1-3.

⁷¹ Riskin, Leonard L (1997) “*Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed*,” Harvard Negotiation Law Review, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp.13-14

⁷² Po aty, pp.13-14.

marrëveshje, nëse palët në konflikt aftësohen që të mbartin peshën e procesit. Sipas kësaj përjasjeje, roli i ndërmjetësit konsiston në ndihmën e palëve, që ato të përmirësojnë aftësitë e tyre negociuese, dhe në mbajtjen e seancave private dhe të përbashkëta⁷³. Procesi i ndërmjetësimit ka karakter lehtësues, ku ndërmjetësi shfaq një status pasiv dhe këshillues, ndërsa palët ruajnë kontrollin e procesit, negociatave, dhe rezultatit⁷⁴.

Arsyeja e tretë teorike, për studimin e ndërmjetësimit, reflekton gamën e gjerë të çështjeve që mbeten të hapura në debatin shkencor dhe akademik për ndërmjetësimin. Debati i sotëm për ndërmjetësimin ka lëvizur nga diskutimi për qëllimin, objektivat, vlerat, parakushtet e procesit⁷⁵, tek qartësimi i çështjeve që kanë të bëjnë me përcaktimin e përmbajtjes së ndërmjetësimit, rolin dhe tipin e ndërmjetësit, apo matshmërinë e efektivitetit dhe suksesit të ndërmjetësimit.

Një çështje me interes dhe e debatueshme është ajo e kuptimit të ndërmjetësimit dhe dallimit të tij nga koncepte të ngjashëm me të. Fakti, që përdorimi i ndërmjetësimit është intensifikuar, nuk i ka penguar studiuesit, si: Susskind (1981), Stulberg (1981), Riskin (1997), të vënë re se kuptimi i ndërmjetësimit shoqërohet me shumë paqartësi: çfarë përfaqëson ekzakhtësisht ai, apo çfarë e dallon nga proceset e tjera të zgjidhjes së konflikteve. Shumë shpesh, kuptimi i ndërmjetësimit karakterizohet nga ngatërrimi i nocionit të ndërmjetësimit “si është”, me nocionin e ndërmjetësimit “si duhet të jetë.” Përgjithësisht, studiuesit pajtohen, që ndërmjetësimi përfaqëson një proces⁷⁶, i cili është jo i detyrueshëm, vullnetar, informal⁷⁷, orienton palët drejt njëra-tjetrës jo përmes imponimit, por ndihmës për

⁷³Billikopf, Gregorio (2014) *Party-Directed Mediation: Facilitating dialogue between individuals*, 3th Edition, University of California, pp.58-83

⁷⁴Po aty, pp.58-83

⁷⁵Stulberg, Joseph B. (1981) “The Theory and Practice of Mediation: A Replay to Professor Susskind,” *Vermont Law Review*, Vol. 6, pp. 84-117; Susskind, Lawrence (1981), *Environmental Mediation and the Accountability Problem*, *Vermont Law Review*, Vol. 6, No. 1, pp. 40

⁷⁶Riskin, Leonard L (1997) “*Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed*,” *Harvard Negotiation Law Review*, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 8-19; Stulberg, Joseph B. (1981), (veper, e cit.) pp. 84-117; Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp.2-4.

⁷⁷Stulberg, Joseph B. (1981) “The Theory and Practice of Mediation: A Replay to Professor Susskind,” *Vermont Law Review*, Vol. 6, pp. 84-117; Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) (veper, e cit.), pp.2-4.

të arritur një perceptim të përbashkët dhe modifikim të disponimit të tyre⁷⁸, që drejtohet nga një palë e tretë, neutrale, e paanshme, e pranuar nga të dy palët në konflikt⁷⁹, në të cilin pala e tretë, identifikon problemet e përbashkëta për të dy palët, nuk ka autoritet imponues, nuk imponon por skicon dhe sugjeron zgjidhje për problemet, ndihmon palët të gjejnë zgjidhje të pranueshme nga të dy palët në konflikt⁸⁰ dhe ku procesi dhe veprimet e palës së tretë, karakterizohen nga synime, veprime, përdorimi i strategjive dhe teknikave, lehtësimi i negociatave mes palëve, dhe vlerësim i çështjeve të rëndësishme⁸¹. Por, studiuesit ndajnë mendime të ndryshme përse i përket natyrës dhe qëllimeve të ndërmjetësimit, sepse në jetën reale, qëllimet dhe metodat variojnë kaq shumë, sa që një përgjithësim është thuajse i pamundur⁸².

Studiuesit janë, gjithashtu, të kujdesshëm edhe në dallimin e ndërmjetësimit, qoftë si koncept, qoftë si praktikë, nga alternativat e tjera të zgjidhjes së konfliktit. Ata kanë qartësuar edhe cilët janë elementët, që e bëjnë ndërmjetësimin të dallohet nga praktika të tjera të zgjidhjes së konfliktit. Ndër alternativat që përdoren për zgjidhjen e konflikteve, ndërmjetësimi përfaqëson vetëm njërin prej tyre⁸³. Ajo që dallon jo vetëm ndërmjetësimin

⁷⁸ Fuller, (1971) "Mediation – Its Forms and Functions," *South California Law Review*, Vol. 44, pp. 305-325; Nicolau, G. (1978) *Community Mediator Training Manual for the Neighborhood Justice Center of Kansas City, Missouri*, Institute for Mediation and Conflict Resolution, pp.59-98; Stulberg, Joseph B. (1981) ,(veper, e cit.), pp. 84-117; Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) (veper, e cit.) pp.2-4.

⁷⁹ Stulberg, Joseph B. (1981) (veper, e cit.) pp. 84-117; Riskin, Leonard L (1997) "Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed," *Harvard Negotiation Law Review*, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 8-19; Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) (veper, e cit.) pp.2-4.

⁸⁰ Riskin, Leonard L (1997), (veper, e cit.) pp. 8-19; Stulberg, Joseph B. (1981) ,(veper, e cit.), pp. 84-117; Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) (veper, e cit.), pp.2-4.

⁸¹ Riskin, Leonard L (1997) (veper, e cit.), pp. 17-19.

⁸² Bush, Robert A. B. (1989) "The mediator's role and ethical standards in mediation," *U. Fla. Law Review*, Vol. 41, pp. 253; McEwen, Craig A. (1993) "Competence and quality," *Negotiation Journal*, Vol. 9, p. 317; Salem, Richard A. (1993) "The interim guidelines need a broader perspective," *Negotiation Journal*, Vol. 9, pp. 309; Stulberg, Joseph B. (1994), (veper, e cit.) pp.92-124; Bush, Robert A. B. (1989), (veper, e cit.), pp. 253

⁸³ Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp.2-4; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution", *British Academy of Management*, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.2-4.

nga alternativat e tjera, por edhe vetë alternativat nga njëra tjetra janë dy tipare kryesore: 1) karakteri imponues ose jo i zgjidhjes, dhe 2) karakteri vullnetar apo i detyruar i pjesëmarrjes në proces. Në këtë kuptim, ndryshe nga arbitrazhi apo procesi gjyqësor, që karakterizohen nga fuqia imponuese, ndërmjetësimi bën pjesë, bashkë me negocimin dhe pajtimin, në grupin e atyre alternativave që kanë karakter jo imponues, dhe vihen në veprim vetëm kur ekziston vullneti i palëve për të zgjidhur konfliktin përmes pjesëmarrjes në proces. Dallimi më i përgjithshëm i ndërmjetësit me të gjithë alternativat e tjera është, se ai i anashkalon procedurat tradicionale të ankimit, nuk është i varur në respektimin e proceseve dhe procedurave të vendosura që më parë dhe, gjithashtu, as nuk influencohet, as nuk merr parasysh të gjithë proceset apo marrëveshjet e mëparshme ekzistuese mes palëve, nisur nga logjika se palët në konflikt duhet të jenë të lira të negociojnë rezultatin e procesit dhe mosmarrëveshjes mes tyre⁸⁴. Ndërsa, dallimet më kryesore të ndërmjetësit nga të gjithë alternativat e tjera, pavarësisht, karakterit imponues ose jo të tyre, gjejnë shprehje dhe janë saktësuar nga studiuesit në një numër elementësh specifikë.

Me “Negocimin,” ndërmjetësimi ka të përbashkët faktin, që vihen në lëvizje në sajë të vullnetit të palëve për të kërkuar dhe arritur një zgjidhje dhe iu japin mundësi palëve të kenë kontroll, si mbi procesin, ashtu edhe mbi rezultatin. Ajo që i bën të ndryshëm është fakti që, negociimi zhvillohet pa praninë e një pale të tretë, ndërsa ndërmjetësimi zhvillohet me praninë e një pale të tretë⁸⁵.

Me “Pajtimin,” ndërmjetësimi ka të përbashkët faktin se, të dy proceset kanë një palë të tretë me rol pajtues ose ndërmjetës, që nuk ka autoritet t’u imponojë palëve një marrëveshje, por thjesht lehtëson komunikimin ose ndihmon në përpilimin e marrëveshjes⁸⁶, ku si pajtuesi, ashtu edhe ndërmjetësi, punojnë për identifikimin e çështjeve konfliktuale, ofrojnë një proces relativisht fleksibël, sugjerojnë zgjidhje⁸⁷, takohen me palët veç-e-veç, tentojnë ndërgjegjësimin e palëve për shkaqet e konfliktit, nxisin arritjen e marrëveshjes në mënyrë miqësore, jo-antagoniste, i udhëzojnë palët si të arrijnë një kompromis që t’i kënaqë

⁸⁴ Po aty, pp.9.

⁸⁵ Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998), (veper, e cit.) pp.2-4,

⁸⁶ Po aty, pp.2-4

⁸⁷ Simkin, W. E., (1971) *Mediation and the Dynamics of Collective Bargaining*, Bureau of National Affairs Books, Washington DC, pp. 3-17.

të dy palët dhe, së fundi, në të dy proceset, vetë zgjidhja duhet të ketë miratimin e palëve⁸⁸. Por “pajtimin” dhe “ndërmjetësimin” i dallojnë një numër elementësh. Pajturesit kryejnë edhe rolin e këshilluesit. Si njohës të mirë të fushës ku ata ndërmarrin pajtim, ata iu ofrojnë palëve këshilla për kushtet e marrëveshjes dhe informacion ligjor dhe inkurajojnë aktivisht palët që të merren vesh. Ndërsa ndërmjetësi nuk ka ndonjë rol këshillues, ai thjesht ndihmon palët që të kuptojnë më mirë konfliktin dhe të gjejnë një zgjidhje⁸⁹. Gjithashtu, ndërmjetësimi mund të përdoret në çdo etapë të konfliktit, ndërsa pajtimi vlen vetëm kur konflikti mes palëve gjendet në fazat e para të tij⁹⁰.

Me “Këshillimin,” ndërmjetësimi ka të përbashkët teknikat që përdoren në marrëdhëniet me palët. Por, ai dallon nga këshillimi në rolin që luajnë këshilluesi dhe ndërmjetësi. Në përpjekjet për të arritur një zgjidhje; ndërmjetësi merr parasysh ndjenjat e palëve dhe i eksploron ato në thellësi; fokusohet më shumë në objektivat e palëve për të ardhmen, sesa për ngjarjet e shkuara; e kontrollon procesin, por nuk përpiket ta ndikojë haptazi rezultatin e tij; është neutral, por merret me të dy palët ballë-për-ballë; vetë ndërmjetësimi ka të nevojshëm vullnetin e të dy palëve për zgjidhje dhe merr një apo disa seanca takimi me palët. Këshilluesi, nga ana tjetër, është i interesuar t’i bëjë palët të kuptojnë më mirë sjelljen e tyre; preokupohet për ndjenjat dhe eksperiencat e tyre; eksploron në thellësi origjinën e bindjeve dhe sjelljes së palëve; tenton t’i influencojë palët qëllimisht, drejt një drejtimi ose çështje të caktuar; jo domosdoshmërisht takohet më palët në të njëjtën kohë; mund të tregojë mbështetje aty ku mendon se është gjë e mirë; vetë këshillimi mund të kryhet edhe vetëm me njërën palë, nëse pala tjetër nuk tregon gatishmëri për të marrë pjesë; dhe, së fundi, këshillimi mund të vazhdojë në mënyrë të papërcaktuar në varësi të nevojave dhe progresit të palëve.

Me “Vlerësimin Fillestar Neutral,” (VFN) ndërmjetësimi ka të përbashkët se, të dy proceset kanë një palë të tretë, e cila është neutrale, analizon pikat e forta dhe të dobëta të

⁸⁸ Po aty, pp. 3-17.

⁸⁹ Po aty, pp. 3-17

⁹⁰ Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp.2-4; Gibbons, M. (2007) *Better Dispute Resolution: A Review of Employment Dispute Resolution in Great Britain*, London: Department of Trade and Industry, pp. 29-41.

palëve, zhvillon takime veç-e-veç ose të përbashkëta me palët, si dhe ofron ndihmë dhe udhëheqje në përcaktimin e zgjidhjes. Ajo që i dallon proceset është fakti që, VFN urdhërohet nga gjykata, palët eksplorojnë para zhvillimit të gjyqit meritat e rastit dhe vlerësimi kryhet nga një avokat me eksperiencë⁹¹.

Me “Diplomacinë e Ecejakeve”, ndërmjetësimi ka të përbashkët veprimet e një pale të tretë. Ajo që i dallon proceset është fakti që, ndërmjetësimi bazohet në sqarimin e gjërave ballë-për-ballë, ndërsa, në procesin diplomatik, personi ndërlidhës bën ecejake tek palët, duke përcjellë mesazhe specifike.

Me “Arbitrazhin”, ndërmjetësimi ka të përbashkët pjesëmarrjen e një pale të tretë neutrale, pëlqimin e palëve në konflikt për të qenë pjesë e procesit, dhe mundësinë që iu jepet palëve për të përcaktuar rregullat procedurale⁹². Por, mes tyre ka një ndryshim të rëndësishëm. Zgjidhja që ofron ndërmjetësimi nuk është e detyrueshme për t’u pranuar nga palët. Vetë ndërmjetësimi mund të përdoret në cilëndo fazë të konfliktit⁹³. Në rastin e Arbitrazhit, procesi është më pak formal se një gjyq i vërtetë, por, pala e tretë përbëhet nga arbitra-juristë, zakonisht tre, të cilët zhvillojnë seanca dëgjimore, shqyrtojnë faktet e paraqitura në bazë të standardeve ligjore, janë të autorizuar të caktojnë si do të zgjidhet konflikti dhe marrin, në fund, vendime, të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga palët, të zbatueshme nga gjykata, dhe të paapelueshme nga pala e pakënaqur⁹⁴.

⁹¹ Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp.2-4

⁹² Poaty, pp.2-4; ACAS (2008) *Arbitration Explained*, London: ACAS Publications, www.acas.org.uk; Liebmann, L. (2000) “History and Overview of Mediation in the UK”, in *Mediation in Context*, London: Jessica Kingsley Publishers, pp. 10-11.

⁹³ Gibbons, M. (2007) *Better Dispute Resolution: A Review of Employment Dispute Resolution in Great Britain*, London: Department of Trade and Industry, pp.18-31.

⁹⁴ Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998), (*veper, e cit.*), pp.2-4; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) “*Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution*”, British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.9; Liebmann, L. (2000) “History and Overview of Mediation in the UK”, in *Mediation in Context*, London: Jessica Kingsley Publishers, pp. 10-11.

Me “Procesin Gjyqësor”, ndërmjetësimi ka të përbashkët vetëm faktin që, palët në konflikt kanë këshilluesit e tyre dhe gjykohen nga një palë e tretë, neutrale⁹⁵. Në të gjithë gjërat e tjera, veçanërisht, përsa i përket karakterit të zgjidhjes që i bëhet konfliktit dhe vendimeve që merren, të dy proceset dallohen në mënyrë të rëndësishme. Ndryshe nga ndërmjetësimi, zgjidhja e të cilit nuk është e detyrueshme për palët, në procesin gjyqësor, zgjidhja është e tipit “fitorja e njëres palë përfaqëson humbjen e palës tjetër”, pasi reflekton favorizimin e palës me argumentin më të fortë (The Institute of Arbitrators and Mediators, Australia), përcaktohet nga gjykatësi, është e detyrueshme për palët, dhe është formale⁹⁶.

Një çështje e dytë e debatueshme, që e bën me interes studimin e ndërmjetësimit është ajo e kontekstit të aplikimit të ndërmjetësimit. Debati konsiston në sqarimin e dy çështjeve: 1) nëse ndërmjetësimi mund të aplikohet për zgjidhjen e konflikteve në të gjitha sferat e marrëdhënieve dhe veprimtarisë shoqërore; dhe 2) nëse aplikimi i ndërmjetësimit për zgjidhjen e konfliktit të një sferë specifike marrëdhëniesh gjeneron të njëjtat rezultate dhe efekte, edhe nëse aplikohet në sfera të tjera marrëdhëniesh⁹⁷. Në çështjen e parë, aplikimi i ndërmjetësimit për zgjidhjen e konfliktit mes palëve shihet i mundshëm, jo vetëm në sfera të tilla, si: ato të marrëdhënieve në familje⁹⁸, në sektorin e industrisë⁹⁹, në punë¹⁰⁰, por edhe në

⁹⁵ Simkin, W. E., (1971) *Mediation and the Dynamics of Collective Bargaining*, Bureau of National Affairs Books, Washington DC, pp. 3-17.

⁹⁶ Boulle, Laurence (2005). *Mediation: Principles, Processes, Practice*, Australia, Butterworths, pp.33.

⁹⁷ Riskin, Leonard L (1997) “*Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed*,” Harvard Negotiation Law Review, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 10; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) “*Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution*”, British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.7-8.

⁹⁸ Grillo, Trina (1991) “*The Mediation Alternative: Process Danger for Women*,” Yale Law Journal, Vol. 100, pp. 1545; Rosenberg, Joshua D. (1991) “*In Defense of Mediation*,” Arizona Law Review, Vol. 33, pp. 46; Kelly, J. (2004), “*Family Mediation Research: Is There Empirical Support for the Field?*” Conflict Resolution Quarterly, Vol. 22, No. 1-2, pp. 3-35.

⁹⁹ Delgado, R. (2000) “*Prosecuting Violence: A Colloquy on Race Community and Justice. Goodbye to Hammurabi: Analyzing the Atavistic Appeal of Restorative Justice*”, Stanford Law Review, Vol. 51, pp. 751-756; Delgado, R., Dunn, C., Brown, P. Lee, H. and Hubbert, D. (1985) “*Fairness and Formality: Minimizing the Risk of Prejudice in Alternative Dispute Resolution*”, Wisconsin Law Review, pp. 1359-1404.

¹⁰⁰ Gibbons, M. (2007) *Better Dispute Resolution: A Review of Employment Dispute Resolution in Great Britain*, London: Department of Trade and Industry, pp. 35-67; Dickens, L. (2008), “*Legal Regulation, Institutions and*

sferën e të drejtës penale¹⁰¹, apo të së drejtës kushtetuese¹⁰². Në çështjen e dytë, studiues si Gibbons¹⁰³, Dickens¹⁰⁴ kanë tërhequr vëmendjen ndaj faktit që, përdorimi i ndërmjetësimit për zgjidhje konflikti në sferën e marrëdhënieve në punë mund të sjellë efekte të ndryshme kur aplikohet në marrëdhëniet në familje. Delgado¹⁰⁵, Delgado¹⁰⁶ apo Golten dhe Smith¹⁰⁷, kanë tërhequr vëmendjen për efektet negative të përdorimit të ndërmjetësimit në zgjidhjen e konflikteve në sferën e marrëdhënieve industriale, që gjejnë shprehje në mungesën e llogaridhënies ndaj publikut se si arrijnë palët në marrëveshje dhe për çfarë bien dakord ato. Në kundërshtim me idenë se përdorimi i ndërmjetësimit mund të sjellë pasoja negative, Kelly¹⁰⁸ ka argumentuar se në sferën e marrëdhënieve në familje, përdorimi i ndërmjetësimit jo vetëm nuk ka sjellë efekte negative mbi gratë, por, përkundrazi, ka kontribuar në fuqizimin e statusit të tyre social.

Çështja e tretë e rëndësishme dhe e debatueshme që nxit interesin për studimin dhe analizimin e ndërmjetësimit është ajo e rolit të ndërmjetësimit në procesin e ndërmjetësimit. Brenda debatit mbi rolin e ndërmjetësimit studiuesit kanë debatuar për tre aspekte: 1) çfarë përfaqëson dhe bën ndërmjetësi, si një ndër aktorët kryesorë të procesit të ndërmjetësimit; 2)

Industrial Relations”, *Warwick Papers in Industrial Relations*, No 89, University of Warwick: Industrial Relations Research Unit, pp.6-19.

¹⁰¹ Alschuler, Albert. (1986) “*Mediation with a Mugger: The Shortage of Adjudicative Services and the Need for a Two-Tier Trial System in Civil Cases*,” *Harvard Law Review*, Vol. 99, pp. 1808-1810; Umbret, Mark S (1994) *Victim Meets Offender: The Impact of Restorative Justice and Mediation*, pp.52-74.

¹⁰² Fiss, Owen (1984) “*Against Settlement*,” *Yale Law Journal*, Vol. 93, pp. 1073-1087; Fiss, Owen (1985) “*Out of Eden*,” *Yale Law Journal*, Vol. 94, pp. 1669; McThenia, Andrew W. and Thomas L. Shafer (1985) “*For Reconciliation*,” *Yale Law Journal*, Vol. 94, pp. 1660.

¹⁰³ Gibbons, M. (2007) (*veper, e cit.*), pp. 35-67.

¹⁰⁴ Dickens, L. (2008), “*Legal Regulation, Institutions and Industrial Relations*”, *Warwick Papers in Industrial Relations*, No 89, University of Warwick: Industrial Relations Research Unit, pp.6-19.

¹⁰⁵ Delgado, R., Dunn, C., Brown, P. Lee, H. and Hubbert, D. (1985) (*veper, e cit.*) pp. 1359-1404.

¹⁰⁶ Poaty, pp. 751-756.

¹⁰⁷ Golten, M. and Smith, M. (2007) *Hammers in Search of Nails: Responding to Critics of Collaborative Processes*, pp. 96-132.

¹⁰⁸ Kelly, J. (2004), “*Family Mediation Research: Is There Empirical Support for the Field?*” *Conflict Resolution Quarterly*, Vol. 22, No. 1-2, pp. 3-35.

nëse ndërmjetësi duhet të jetë ose jo neutral; dhe 3) nëse ndërmjetësi duhet apo jo të mbajë përgjegjësi ligjore për rezultatin e procesit.

Në aspektin e parë, ndërmjetësit i atashohen pesë tipare kryesore¹⁰⁹: katalizator në ndërveprimin e palëve, edukues i palëve nga pikëpamja e propozimeve ose refuzimeve të kërkesave të tyre, përkthyes, që i përcjell gjërat tek palët me një gjuhë të kuptueshme, informues, që ndihmon palët me informacion divers, kontrollues i situatave problematike, dhe pragmatist, që nuk mbetet rob i një zgjidhjeje, por eksploron disa rrugë në përputhje me faktet reale. Sipas Sulberg¹¹⁰ dhe Brown, Cervenak, dhe Fairman¹¹¹, detyrat e ndërmjetësit përfshijnë përcaktimin e kuadrit të diskutimeve të pozicioneve dhe kriterëve të vlerësimit, shqyrtimin dhe identifikimin e çështjeve, shqetësimeve, interesave, dhe zgjidhjeve të palëve, strukturimin dhe lehtësimin e komunikimit efektiv, përcjelljen e mesazheve palëve, pengimin e përshkallëzimit të kërkesave nga palët, nxitjen tek palët të frymës bashkëpunuese, problem-zgjidhëse, takimin me palët për të shqyrtuar propozimet, meritat e tyre dhe shtyrjen e tyre drejt zgjidhjes, si dhe shqyrtimin e opsioneve të marrëveshjes apo pasojave të mosmarrëveshjes mes palëve.

Në aspektin e dytë, nëse ndërmjetësi duhet apo jo të jetë neutral, ajo që ka karakterizuar debatin ka qenë mungesa e qartësisë dhe e konsistencës në standardet etike¹¹². Vetë studiuesit ndahen në tre grupe: 1) në ata studiues, kryesisht europianë, që besojnë se ndërmjetësi duhet të jetë neutral¹¹³ 2) në ata studiues, që besojnë se ndërmjetësi nuk duhet të

¹⁰⁹ Stulberg, Joseph B. (1981) "The Theory and Practice of Mediation: A Replay to Professor Susskind," Vermont Law Review, Vol. 6, pp. 92.

¹¹⁰ Po aty, pp. 97-103.

¹¹¹ Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp.2-4.

¹¹² Riskin, Leonard L (1997) "Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed," Harvard Negotiation Law Review, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 9.

¹¹³ Stulberg, Joseph B. (1981) (veper, e cit.) pp.86-87; Alfini, James and Gerald S. Clay (1994) "Should Lawyer-Mediators be Prohibited from Providing legal Advice or Evaluations," Journal of Dispute Resolution Mag., Spring 1994, pp. 8; Bush, Robert A. B. (1989) "The mediator's role and ethical standards in mediation," U. Fla. Law Review, Vol. 41, pp. 253; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution", British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.5.

jetë neutral, por aktiv¹¹⁴ dhe 3) në ata studiues, kryesisht amerikanë, që qëndrojnë në mes të dy opsioneve¹¹⁵. Argumenti në favor të ndërmjetësit aktiv është që ndërmjetësi duhet të jetë aktiv, pasi atij i nevojitet të bëjë vlerësim dhe të realizojë ndërmjetësim efektiv. Pa analizimin e pikave të dobëta dhe të forta të palëve, ndërmjetësimi nuk mund të jetë efektiv¹¹⁶. Argumentet në favor të ndërmjetësit neutral janë më të shumta. Sulberg¹¹⁷ i përmbahet pozicionit që ndërmjetësi, në përgjithësi, duhet të udhëhiqet nga parimet dhe detyrimet e pozicionit si ndërmjetës; se një ndërmjetës neutral mundëson ndërmjetësim efektiv, të bazuar mbi disa parime; dhe se një ndërmjetësi jo-neutral shkon kundër qëllimit dhe objektivave të ndërmjetësimit, sjellja, strategjitë, kontributi i tij bëhen të paparashikueshëm dhe jo-konsistente; mund të sjellë efekte negative të tilla, si: palët mund të mos jenë të përfaqësuara, përfitimet nga marrëveshja mund të mos jenë maksimale, efektet e marrëveshjes së arritur mund të jenë afatgjata dhe vetë zgjidhja mund të jetë problematike, qoftë nga ana e precedentit që vendos, qoftë nga ana e precedentëve, mbi të cilët është bazuar. Argumente të tjera pro një ndërmjetësi neutral theksojnë faktin që, ndërmjetësit-juristë nuk duhet të bëjnë vlerësime apo të ofrojnë këshilla juridike¹¹⁸, apo, faktin që, qëllimi i ndërmjetësit është të lehtësojë arritjen e një marrëveshjeje mes palëve me vullnetin e tyre. Përzierja e rolit të ndërmjetësit me atë të këshilluesit legal e bën situatën problematike. Ndaj, ndërmjetësit duhet të mbajnë gjithmonë parasysh këtë dallim dhe të mos ofrojnë vetë këshilla ligjore, por t'i drejtojnë palët në rast se ata kërkojnë këshilla ligjore tek këshillues ligjorë ose

¹¹⁴ Susskind, Lawrence (1981), *Environmental Mediation and the Accountability Problem*, Vermont Law Review, Vol. 6, No.1, pp.40; Alfini, James and Gerald S. Clay (1994) “*Should Lawyer-Mediators be Prohibited from Providing legal Advice or Evaluations*,” Journal of Dispute Resolution Mag., Spring 1994, pp. 8.

¹¹⁵ Bernard, Sydney E. (1984) “The neutral mediator: Value dilemmas in divorce mediation,” *Mediation Quarterly*, Vol. 4, pp. 61; Honeyman, Christopher (1985) “*Patterns of bias in mediation*,” Journal of Dispute Resolution, pp. 141-149; Forester, John and David Stitzel (1989) “*Beyond neutrality: The possibilities of activist mediation in public sector conflicts*,” Negotiation Journal, Vol. 5, pp. 251-257; Cobb, Sara and Janet Rifkin (1991) “*Practice and paradox: Deconstructing neutrality in mediation*,” Law and Society Inquiry, Vol. 16, pp. 69-70; Poaty, pp.35; Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp.2-4; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) (veper, e cit.), pp.5.

¹¹⁶ Alfini, James and Gerald S. Clay (1994) (veper, e cit.), pp. 8.

¹¹⁷ Stulberg, Joseph B. (1981) “(veper, e cit.), pp. 92.

¹¹⁸ Alfini, James and Gerald S. Clay (1994) (veper, e cit.), pp. 8.

në zgjidhjen e konfliktit përmes alternativave të tjera¹¹⁹. Sipas ACAS¹²⁰, detyra e ndërmjetësit është thjesht të kontrollojë procesin dhe lehtësojë komunikimin, sepse përsa i përket rezultatit të procesit, ai është në dorën dhe kontrollin e palëve¹²¹. Ndërsa argumentet që nuk e shohin rolin e ndërmjetësit, as krejtësisht neutral, as krejtësisht aktiv, kanë për tipar dallues pragmatizmin e tyre. Sipas këtyre studiuesve, neutraliteti i pastër është i paarritshëm, sepse shkalla e neutralitetit përcaktohet proporcionalisht nga tipi i ndërmjetësit¹²². Roli i ndërmjetësit ndryshon shumë dhe varet nga tipi i konfliktit¹²³. Roli aktiv apo pasiv i ndërmjetësit varet, gjithashtu, edhe nga përqasja, të cilën ndërmjetësi zgjedh për të trajtuar konfliktin dhe procesin: nëse përqasja është problem-zgjidhëse, ndërmjetësi luan rol aktiv; por, nëse përqasja është transformuese, ndërmjetësi luan rol pasiv dhe, pothuaj neutral, pasi ndërmjetësi thjesht ofron ndihmë dhe lehtëson komunikimin, ndërsa rregullat e lojës, procesi, mjetet dhe rezultati, të gjitha këto, kontrollohen nga palët¹²⁴.

Edhe në aspektin e tretë, nëse ndërmjetësi duhet apo jo të mbajë përgjegjësi ligjore për rezultatin, studiuesit ndahen në dy grupe: 1) studiuesit që janë në favor¹²⁵, dhe 2) ata që janë kundër¹²⁶. Argumentet e të dy palëve reflektojnë pozicionin e tyre në raport me rolin neutral apo jo-neutral të ndërmjetësit. Nëse ndërmjetësi vendos të mos jetë neutral, atëherë, ai

¹¹⁹ Bush, Robert A. B. (1989) “*The mediator’s role and ethical standards in mediation*,” U. Fla. Law Review, Vol. 41, pp. 253.

¹²⁰ ACAS (2008) *Arbitration Explained*, London: ACAS Publications, www.acas.org.uk.

¹²¹ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) “*Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution*”, British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.5.

¹²² Riskin, Leonard L (1997) “*Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed*,” Harvard Negotiation Law Review, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 47.

¹²³ Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp.2-4.

¹²⁴ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) (*veper, e cit.*), pp.5.

¹²⁵ McCrory, John P (1981) *Environmental Mediation – Another Piece for the Puzzle*, Vermont Law Review, Vol. 6, Issue 49, pp. 64; Susskind, Lawrence (1981), *Environmental Mediation and the Accountability Problem*, Vermont Law Review, Vol. 6, No. 1, pp. 40.

¹²⁶ Stulberg, Joseph B. (1981) “*The Theory and Practice of Mediation: A Replay to Professor Susskind*,” Vermont Law Review, Vol. 6, pp. 92.

duhet të mbajë përgjegjësi¹²⁷. Argumenti kundërshtues është se, nëse ndërmjetësi është neutral, atëherë nuk ka asnjë logjikë dhe arsye që ai të mbajë përgjegjësi për rezultatin e procesit¹²⁸.

Çështja e katërt e debatueshme, për ndërmjetësimin, ka të bëjë me tipin e ndërmjetësimit. Debati në këtë çështje fokusohet në qartësimin e dy gjërave: 1) cilët tipa ndërmjetësimi identifikohen si më kryesorët dhe 2) cilit tip ndërmjetësimi është më i përshtatshëm për aplikim.

Në rastin e parë, tipat e ndërmjetësimit që identifikohen nga studiuesit dallohen nga dy elementë: 1) trajtimi që iu bëhet problemeve karakterizuese të marrëdhënieve dhe konfliktit mes palëve, dhe 2) rolin që luan ndërmjetësi në procesin e ndërmjetësimit. Bazuar në këto dy elementë, studiuesit identifikojnë nëntë tipa kryesorë ndërmjetësimi 1) “me trajtim të gjerë të problemeve”¹²⁹, 2) “me trajtim të ngushtë të problemeve”¹³⁰, 3) “vlerësues”¹³¹, 4) “lehtësues”¹³², 5) “transformues”¹³³, 6) “përshkrues”¹³⁴, 7) “i anshëm”¹³⁵, 8) “me arbitrazh”,

¹²⁷ Susskind, Lawrence (1981), *Environmental Mediation and the Accountability Problem*, Vermont Law Review, Vol. 6, No. 1, pp. 40.

¹²⁸ Stulberg, Joseph B. (1981) (*veper, e cit.*), pp. 92.

¹²⁹ Friedman, Gary J. (1993) *A guide to divorce mediation*, pp.57-79; Riskin, Leonard L (1997) “*Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed*,” Harvard Negotiation Law Review, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 12.

¹³⁰ Feinberg, Kenneth (1989) “*Mediation – A preferred method of dispute resolution*,” Pepperdine Law Review, Vol. 16, S5, S12-S20, pp.9-17; Riskin, Leonard L (1997) (*veper, e cit.*), pp. 12.

¹³¹ Feinberg, Kenneth (1989) (*veper, e cit.*), pp.9-17; Keating, Michael J. Jr. and Margaret L. Shaw (1990) “*Compared to what? Defining terms in court-related ADR programs*,” Negotiation Journal, Vol. 6, pp. 217; Riskin, Leonard L (1997) (*veper, e cit.*), pp. 12.

¹³² Friedman, Gary J. (1993) (*veper, e cit.*), pp.57-79; Dauer, Edward A. (1994) *Manual of dispute resolution: ADR law and practice*, pp. 11-45; Princen, Thomas (1994) “Joseph Elder: *Quiet peacemaking in a Civil War*,” in *When talks works*, pp. 428; Riskin, Leonard L (1997) (*veper, e cit.*), pp. 12; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) “*Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution*”, British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.5.

¹³³ Lang, Michael and Alison Taylor (2000) *The Making of a Mediator: Developing Artistry in Practice*, San Francisco: Jossey Bass, pp. 48-62; Mareschal, P. (2003) “*Solving problems and transforming relationships: The Bifocal Approach to Mediation*”, The American Review of Public Administration, Vol. 33, pp. 423-448; Gaynier, L (2005) “*Transformative Mediation: In Search of a Theory of Practice*”, Conflict Resolution Quarterly, Vol. 22, No. 3, pp. 397-408; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) (*veper, e cit.*) pp.5.

dhe 9) “on-line.” Për sa iu përket këtyre nëntë tipeve, dy gjëra duhen mbajtur parasysh. Gjëja e parë ka të bëjë me tipet e ndërmjetësimit, që dallohen në bazë të trajtimit të problemeve, që karakterizojnë marrëdhënien dhe konfliktin mes palëve. Ndonëse, fakti nëse problemet trajtohen nga një perspektivë e gjerë apo e ngushtë ka vlerën e vet¹³⁶, shumë studiues¹³⁷ nuk i japin rëndësi një dallimi të tillë dhe, për pasojë, thonë se nisur nga trajtimi që i bëhet problemeve nuk mund të flitet për dy tipe, por për një tip të vetëm ndërmjetësimit. Gjëja e dytë ka të bëjë me elementët, në bazë të të cilëve një tip ndërmjetësimi dallohet nga tipat e tjerë. Këtu studiuesit përdorin pesë kritere: 1) natyrën e procesit të ndërmjetësimit, 2) rolin e ndërmjetësit, 3) strategjia në bazë të procesit, 4) teknikat që përdor ndërmjetësi, dhe 5) roli që luajnë palët në konflikt.

Në rastin e dytë, se cili tip është më i përshtatshëm, një pjesë e mirë e debatit konsumon argumentet, nëse ndërmjetësimi vlerësues është më i përshtatshëm se ndërmjetësimi lehtësues¹³⁸, apo, nëse ndërmjetësimi lehtësues është më i përshtatshëm se ndërmjetësimi transformues¹³⁹. Ideja e përgjithshme është se, çdo tip ndërmjetësimi mund të përdoret në çdo tip marrëdhënieje dhe konflikti mes palëve. Megjithatë, në rastin se, cili tip ndërmjetësimi është më i përshtatshëm për aplikim, një numër i madh studiuesish bien dakord për dy gjëra. E para, që disa tipe ndërmjetësimi mund të mos jenë tamam të

¹³⁴ White, Michael (2000) *Narrative Mediation: A New Approach to Conflict Resolution*, pp.5-10; Winslade, John and Gerald Monk (2000) *Narrative Mediation: A New Approach to Conflict Resolution*. San Francisco: Jossey-Bass, pp. 48-62.

¹³⁵ Svensson, Isak (2009). "Who Brings Which Peace? Neutral versus Biased Mediation and Institutional Peace Arrangements in Civil Wars," *The Journal of Conflict Resolution*, Vol. 53, No. 3, pp. 446–469.

¹³⁶ Riskin, Leonard L (1997) (veper, e cit.)pp. 12

¹³⁷ Silbey, Susan S. (1993) *Mediation mythology*, *Negotiation Journal*, Vol. 9, pp. 71-83; Rosenberg, Joshua D. and Jay H. Folberg (1994),(veper, e cit.), pp. 1487-1496; Ralston, Richard H. (1994) "Effective advocacy and mediation", in *ADR for the defense: Alternative dispute resolution*, Defense Research Institute eds, pp.36-59; Sarat, Austin (1994) "Patrick Phear: Control, commitment, and minor miracles in family and divorce mediation, in *When talk works*, Deborah M. Kolb eds., pp. 193-196.

¹³⁸ Waldman, Ellen A (1998) "The Evaluative-Facilitative Debate in Mediation: Applying the Lens of Therapeutic Jurisprudence," *Marquette Law Review*, Vol. 82, pp. 155-170.

¹³⁹ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution", British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.5.

përshtatshëm për disa tipe marrëdhëniesh dhe konfliktesh (Mareschal 2003, fq. 443). E dyta, fakti se cili tip ndërmjetësimi mund të jetë më i përshtatshëm për t'u përdorur, varet nga tre rrethana: 1) tipi i konfliktit, 2) faza e konfliktit, dhe 3) lloji i zgjidhjes që kërkohet¹⁴⁰.

Çështja e pestë dhe e fundit, që e bën studimin e ndërmjetësimit interesant është ajo e efektivitetit dhe suksesit të ndërmjetësimit. Pyetja mbi të cilën ngrihet diskutimi është se, kur mund të konsiderohet ndërmjetësimi i suksesshëm, në ç'mënyrë dhe me ç'kriterë mund të matet sukcesi i tij. Sqarimi i kësaj çështje është jo vetëm i vështirë, por mbetet edhe i hapur për debat, pasi studiues të ndryshëm përdorin tregues të ndryshëm matës¹⁴¹. Përgjithësisht, studiuesit e lidhin suksesin dhe efektivitetin e ndërmjetësimit me pesë tregues.

Një mënyrë matëse është ajo përmes verifikimit të cilësive profesionale të ndërmjetësit¹⁴². Në këtë rast shikohet, nëse ndërmjetësi zotëron katër cilësi: 1) karakter të përshtatshëm, 2) aftësi analitike, 3) aftësi komunikimi, dhe 4) reputacion profesional. Me karakter të përshtatshëm kuptohen cilësitë e të qenit i artikuluar, i durueshëm, jo-paragjykues, dhe fleksibël. Këto cilësi konsiderohen të domosdoshme për atë që kërkon të bëjë ndërmjetësin. Me aftësi analitike kuptohen, aftësia për të analizuar situatën dhe dinamikat në të cilën zhvillohet konflikti. Pa këto aftësi një ndërmjetës nuk do të jetë në gjendje të kuptojë gjërat dhe të veprojë në funksion të zgjidhjes së konfliktit. Me aftësi komunikuese kuptohen, aftësia për të qenë dëgjues efektiv, inteligjent, komunikues i fortë, bindës, me imagjinatë, i mirë-informuar. Pa këto aftësi ndërmjetësi nuk do të jetë në gjendje të merret vesh me palët në konflikt dhe të nxisë ata drejt marrëveshjes. Me reputacion profesional kuptohet të qenurit i besueshëm për palët, me integritet profesional, objektiv, neutral dhe me akses në të gjithë burimet e nevojshme. Nga të gjitha cilësitë e mësipërme, aftësia për të njohur dinamikat e konfliktit dhe shqetësimet e palëve, si dhe të qenurit neutral konsiderohen si dy cilësi kyçe të ndërmjetësit, për një ndërmjetësim të suksesshëm.

¹⁴⁰ Po aty, pp.5; Huang, P. C. (2006). "Court Mediation in China, Past and Present", Modern China, Vol. 32, No. 3, pp. 275-314.

¹⁴¹ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) (*veper, e cit.*), pp.8.

¹⁴² Stulberg, Joseph B. (1981) "The Theory and Practice of Mediation: A Replay to Professor Susskind," Vermont Law Review, Vol. 6, pp. 94-96.

Mënyra e dytë e përcaktimit të efektivitetit dhe suksesit të ndërmjetësimit është ajo, përmes sjelljes dhe qëndrimeve të palëve në konflikt¹⁴³. E përdorur edhe nga një numër i madh praktikuesish të ndërmjetësimit, misionarëve pajtues, apo përkrahësit e drejtësisë restauruese, kjo mënyrë tenton ta masë efektivitetin dhe suksesin e ndërmjetësimit, përmes pozicionimit të palëve në tre etapa të procesit të ndërmjetësimit: 1) para fillimit të procesit, 2) gjatë procesit, dhe 3) pas mbarimit të procesit. Me pozicion të palëve pas fillimit të procesit, nënkuptohet gatishmëria dhe vullneti i palëve për të marrë pjesë në proces, kanë moshën që kërkon ligji, dhe kanë të drejtë dhe aftësi ligjore për të marrë vendime. Me pozicion të palëve gjatë procesit kuptohet rritja e aftësive personale për të qenë aktiv në proces dhe për të marrë vendime, rritjen e reagueshmërisë dhe ndërveprimit konstruktiv me palën tjetër, rritjen e aftësisë për të ekzaminuar në mënyrë kritike dhe kuptuar më mirë situatën dhe mundësitë e vetes, paralelisht me perspektivën dhe mundësitë e palës tjetër, si dhe rritjen e shkallës së vendosmërisë për të prekur në negociata dhe treguar gatishmëri për arritjen e një marrëveshjeje, si dhe për të marrë vetë vendimet që lidhen me marrëveshjen. Me pozicion të palëve pas mbarimit të procesit kuptohet, si ndjehen palët brenda vetes dhe në raport me palën tjetër, cila është shkalla e kënaqësisë së tyre me procesin, dhe cila është shkalla e pajtimit personal të arritur mes palëve.

Mënyra e tretë e përcaktimit të efektivitetit dhe suksesit të ndërmjetësimit është ajo, që bazohet në rezultatin e procesit ndërmjetës¹⁴⁴. Kjo mënyrë përdoret, zakonisht, nga administrata e gjykatave dhe një pjesë e praktikuesve të ndërmjetësimit. Procesi konsiderohet efektiv dhe i suksesshëm kur në përfundim të procesit arrihet një marrëveshje mes palëve dhe rasti hiqet nga lista e rasteve kandidate për proces gjyqësor. Marrëveshjet mes palëve konsiderohen tësuksesshme, pavarësisht, nëse ato janë rezultat i arritjes së një pajtimi të plotë dhe të dyanshëm, që përfshin edhe të kërkuarit falje së sinqertë, apo rezultat i marrëveshjeve transformuese dhe të arritura me vullnetin e dyanshëm të palëve.

¹⁴³ Bush, R. and J. Folger (1994) *The Promise of Mediation: Responding to Conflict through Empowerment and Recognition*, San Francisco: Jossey-Bass, pp.64-79; Noll, Douglas E. (2001) "A Theory of Mediation," *Dispute Resolution Journal*, February, pp.45-49; Boule, Laurence (2005). *Mediation: Principles, Processes, Practice*, Australia, Butterworths, pp.35-64.

¹⁴⁴ Noll, Douglas E. (2001) (*veper, e cit.*), pp.45-49.

Mënyra e katërt dhe e fundit e përcaktimit të efektiviteti dhe suksesit të ndërmjetësimit është ajo, që sheh kushtet e zhvillimit të procesit¹⁴⁵. Sipas kësaj mënyre, me kushte kuptohen: 1) çështjet që kërkojnë trajtim dhe 2) qëndrimi ndaj autoritetit.

Arsyeja e katërt teorike e studimit të ndërmjetësimit ka të bëjë me natyrën diverse të faktorëve që influencojnë procesin e ndërmjetësimit. Ajo që e bën interesante studimin e ndërmjetësimit nuk janë thjesht tre grupet që identifikohen, si faktorë direkt përgjegjës për dinamikën të cilat vëzhgohen në tipin, efektivitetin, dhe suksesin e ndërmjetësimit, por variacioni i faktorëve dhe i natyrës së tyre, brenda secilit grup.

Faktorët influencues mbledhen në tre grupe kryesore: 1) ata që kanë të bëjnë me ndërmjetësin, 2) ata që kanë të bëjnë me palët në konflikt, dhe 3) ata që kanë të bëjnë me konfliktin mes palëve. Të tre këta grupe kanë të përbashkët dimensionin njerëzor. D.m.th. natyra e të gjithë grupeve dhe faktorëve brenda tyre kanë lidhje me sjelljen, psikologjinë, dhe arsyen njerëzore. Por, këto grupe i dallojnë marrëdhëniet që vendosin me njëri-tjetrin dhe rolin që luajnë brenda ndërmjetësimit. P.sh. marrëdhëniet midis grupit të faktorëve, që lidhen me konfliktin, dhe grupit të faktorëve, që lidhet me palët, karakterizohet nga një lidhje njëdrejtimëshe dhe varësie. D.m.th. natyra dhe shkalla e konfliktit ndikon dhe përcakton sjelljen e palëve në konflikt. Ndërsa, marrëdhëniet mes grupit të faktorëve, që lidhen me ndërmjetësin, dhe grupit të faktorëve, që lidhet me palët, karakterizohet nga një lidhje e dyanshme dhe simetrike. D.m.th. si sjellja e palëve në konflikt, ashtu edhe sjellja e ndërmjetësit ndikojnë dyanshëm mbi njëri-tjetrin dhe, kështu, përcaktojnë edhe vetë sjelljen dhe qëndrimet e tyre.

Sipas studiuesve të ndryshëm, grupi i faktorëve që lidhen me ndërmjetësin, përfshin katër faktorë kryesorë: 1) llojin e rolit që luan ndërmjetësi¹⁴⁶, 2) strategjinë që përdor

¹⁴⁵ Lang, Michael and Alison Taylor (2000) *The Making of a Mediator: Developing Artistry in Practice*, San Francisco: Jossey Bass, pp. 10-19; Picard, Cheryl, Peter Bishop, Rena Ramkay, and Neil Sargeant (2004) *The Art and Science of Mediation*, Toronto: Emond Montgomery Ltd, pp.9-16; Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution", British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.8.

¹⁴⁶ Stulberg, Joseph B. (1981) "The Theory and Practice of Mediation: A Replay to Professor Susskind," Vermont Law Review, Vol. 6, pp. 92.; Nelson, Lisa (2012) "What is a Divorce Mediator?" Mediation Blog.

ndërmjetësi¹⁴⁷, 3) përgatitjen profesionale të ndërmjetësit¹⁴⁸, dhe 4) përgjegjësinë ligjore të ndërmjetësit. Këta faktorë kanë lidhje dhe reflektojnë, mënyrën se si e sheh ndërmjetësi procesin e ndërmjetësimit, veprimet konkrete të ndërmjetësit gjatë procesit, njohuritë dhe eksperiencën e ndërmjetësit, si dhe marrëdhëniet e ndërmjetësit me kuadrin ligjor.

Grupi i faktorëve që kanë të bëjnë me palët në konflikt përfshin: 1) llojin e rolit dhe pjesëmarrjes së palëve në proces¹⁴⁹ dhe 2) zgjedhjet që bëjnë palët, para dhe gjatë procesit¹⁵⁰. Këta faktorë kanë lidhje me mënyrën si si palët në konflikt përqasin marrëdhëniet e tyre me ndërmjetësin, perspektiven e tyre për vendin e tyre në proces dhe marrëdhëniet me palën në konflikt, kushtet, kërkesat, dhe interesat e palëve në konflikt, si dhe pritshmëritë e palëve në konflikt, ndaj procesit dhe rezultatit të tij.

Grupi i faktorëve që kanë të bëjnë me konfliktin përfshin: 1) qëllimet prapa konfliktit¹⁵¹, 2) fazën ose shkallën e zhvillimit të konfliktit¹⁵², si dhe 3) tipin e konfliktit¹⁵³. Këta faktorë kanë lidhje me çështje të tilla, si: identiteti i palëve, marrëdhëniet mes palëve, përmbajtja e konfliktit, procesi i konfliktimit, përshkallëzimi i konfliktit, predispozicioni

¹⁴⁷ Menkel-Meadow, Carrie (1984) "Toward another view of legal negotiation: The structure of problem-solving," UCLA Law Review, Vol. 31, p. 754-762; Gifford, Donald G. (1985) "A context-based theory of strategy selection in legal negotiation," Ohio State Law Journal, Vol. 46, pp. 41-49; Fisher, Roger and Scot; Brown (1988) *Getting together*, pp. 26-32; Ury, William (1993), *Getting past*, pp. 4-8; Riskin, Leonard L (1997) "Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed" Harvard Negotiation Law Review, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 12.

¹⁴⁸ Zutter, Deborah (2004) *Preliminary Mediation Practices*, Bond University, Australia: Unpublished Thesis, pp.6-12.

¹⁴⁹ New South Wales the Law Society, *A guide to the rights and Responsibilities of participants*.

¹⁵⁰ Menkel-Meadow, Carrie (1994) "Ex Parte Talks with Neutrals: ADR Hazard," *Alternatives to the High Cost of Litigation*, September 1994, Vol. 1, pp. 23-48; Nolan-Haley, Jacqueline M. (1996) "Court mediation and the search for justice through law," Washington University Law Quarterly, Vol. 74, p. 501; Riskin, Leonard L (1997) (veper, e cit.), pp. 12.

¹⁵¹ Wilmot, William W. and Joyce L. Hocker (1998) *Interpersonal Conflict*, 5th edition, New York: McGraw - Hill, pp. 71-90; Noll, Douglas E. (2001) "A Theory of Mediation," *Dispute Resolution Journal*, February, pp.45-49.

¹⁵² Spillman, Kurt R. and Kati Spillman (1991) "On Enemy Images and Conflict Escalation," *ISSS Journal*, Vol. 27, pp. 57; Noll, Douglas E. (2001) (veper, e cit.), pp.45-49.

¹⁵³ Poaty, pp.45-49.

konfliktual i palëve, dhe kultura e menaxhimit të interesave dhe zgjidhjes së konfliktit nga palët në konflikt.

Deri tani u shtjelluan arsytet teorike, përse ia vlen të studiuarit e ndërmjetësimit. Siç u pa nga diskutimi i tyre, këto arsye ishin vërtet të bollshme, por studimi i ndërmjetësimit ka vlerë edhe për dy arsye praktike.

Arsyeja e parë praktike ka të bëjë me rëndësinë dhe ndikimin që ka ndërmjetësimi, për sistemin gjyqësor, individin e përfshirë në konflikt dhe vetë marrëdhëniet shoqërore. Në të tria rastet, studiuesit i atashojnë ndërmjetësimit, një rol dhe ndikim pozitiv. Mbi sistemin gjyqësor përdorimi i ndërmjetësimit kontribuon në uljen e ngarkesës së gjykatave nga pikëpamja e numrit të rasteve të mundshme për zgjidhje, përmes procesit gjyqësor¹⁵⁴, si dhe në shkurtimin e kohëzgjatjes që kërkon zgjidhja e një konflikti¹⁵⁵. Mbi individin e përfshirë në konflikt përdorimi i ndërmjetësimit kontribuon në arritjen e zgjidhjes në mënyrë efeciente të konflikteve, të cilat mund të jenë komplekse dhe të ngarkuara emocionalisht¹⁵⁶, në uljen e kostos së zgjidhjes së konfliktit¹⁵⁷, në përmirësimin e gjendjen shpirtërore të individëve të përfshirë në konflikt¹⁵⁸, si dhe në gjendjen financiare të individit¹⁵⁹. Mbi marrëdhëniet shoqërore, ndërmjetësimi kontribuon në ruajtjen e marrëdhënieve mes palëve në konflikt

¹⁵⁴ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "*Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution*", British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.2-12.

¹⁵⁵ White, Michael (2000) *Narrative Mediation: A New Approach to Conflict Resolution*, pp.7-25; Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group, pp.8.

¹⁵⁶ Roche, D. (2003) "*Gluttons for Restorative Justice*", Economy and Society, Vol. 32, No. 4, pp. 630-644.

¹⁵⁷ Frank Sander and Stephen Goldberg (1994) "*Fitting the Forum to the Fuss: A User-Friendly Guide to Selecting an ADR Procedure*," *Negotiation Journal*, January 1994, pp. 49-68; Brown, Scott., Christine Cervenak, David Fairman (1998) (*veper, e cit.*), pp.8.

¹⁵⁸ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) (*veper, e cit.*) pp.2-12.

¹⁵⁹ Frank Sander and Stephen Goldberg (1994) "*Fitting the Forum to the Fuss: A User-Friendly Guide to Selecting an ADR Procedure*," *Negotiation Journal*, January 1994, pp. 49-68.

edhe pas përfundimit të procesit dhe zgjidhjes së konfliktit, si dhe në aspektin moral të marrëdhënieve shoqërore¹⁶⁰.

Arsyeja e dytë praktike ka të bëjë me rëndësinë që ka modeli i ndërmjetësimit, për ndërmjetësin dhe palët në konflikt. Në kushtet kur ekzistojnë modele të ndryshme ndërmjetësimi dhe disa prej tyre rezultojnë më efektivë dhe të suksesshëm, sesa disa tipe të tjerë ndërmjetësimi, jo rrallë, si ndërmjetësi, ashtu edhe palët në konflikt përballen me dilemën, cili model ndërmjetësimi është më i përshtatshëm për t'u përdorur në rastin e tyre të konfliktit. Në këtë rast, ndërmjetësit dhe palëve në konflikt së bashku iu duhet të vendosin, cili model është më mirë të aplikohet prej tyre, cili model do të ishte më efektiv për ta. Rëndësia praktike e zgjedhjes së modelit del më e qartë nisur nga fakti se, modelet e ndërmjetësimit të identifikuara nga studiuesit dhe që janë në dispozicion të ndërmjetësit dhe palëve ndryshojnë nga njëri-tjetri në faktin që, secili prej tyre thekson dhe i jep rëndësi e përparësi një seti faktorësh e veprimesh përmbi faktorët apo veprimet e tjera. Studiuesit e ndërmjetësimit iu sugjerojnë praktikuesve të ndërmjetësimit, katër modele kryesore ndërmjetësimi: 1) Modelin "Riskin", 2) Modelin "Kovach-Love", 3) Modelin "Carnevale", dhe 4) Modelin "Noll".

Modeli Riskin i jep rëndësi dy aspekteve të procesit¹⁶¹: 1) trajtimit të ngushtë apo të gjerë të problemeve të konfliktit nga ndërmjetësi, dhe 2) rolin vlerësues apo lehtësues të ndërmjetësit. Për praktikuesin e ndërmjetësimit, ky model ofron katër opsione zgjedhjeje: 1) ndërmjetës lehtësues që i bën trajtim të gjerë problemeve të konfliktit mes palëve; 2) ndërmjetës lehtësues që i bën trajtim të ngushtë problemeve të konfliktit mes palëve, 3) ndërmjetës vlerësues që i bën trajtim të gjerë problemeve të konfliktit mes palëve dhe, 4) ndërmjetës lehtësues që i bën trajtim të ngushtë problemeve të konfliktit mes palëve. Dallimi mes këtyre opsioneve ka të bëjë dhe përcakton strategjinë dhe taktikat, që i sugjerohen ndërmjetësit të aplikojë. Për secilin tip ndërmjetësimi, që sugjeron ky model, praktikuesit të ndërmjetësimit i sugjerohen strategji dhe taktika të ndryshme.

¹⁶⁰ Ridley-Duff, R. J. and A. J. Bennett (2010) "*Mediation: Developing a theoretical framework to understand alternative dispute resolution*", British Academy of Management, University of Sheffield, 14th-16th September, pp.2-12.

¹⁶¹ Riskin, Leonard L (1997) "*Understanding Mediators Orientations, Strategies, and Techniques: A Grid for the Perplexed*" Harvard Negotiation Law Review, Spring 1996, Vol. 1, No. 7, pp. 12.

Modeli Kovach-Love i jep rëndësi tre elementëve të procesit¹⁶²: 1) qëllimit të procesit, nëse ai synon të gjykojë faktet apo të ndërtojë konsensus mes palëve, 2) kontekstit ligjor ose jo-ligjor të procesit, dhe 3) neutralitetit të ndërmjetësit. Për praktikuesin e ndërmjetësimit, ky model ofron dy opsione zgjedhjeje: 1) ndërmjetës neutral që vlerëson faktet; dhe 2) ndërmjetës neutral që lehtëson komunikimin dhe gjetja e gjuhës së përbashkët mes palëve në konflikt. E përbashkëta e strategjive që shoqërojnë këto opsioneve është neutraliteti i ndërmjetësit.

Modeli Carnevale i jep rëndësi tre elementëve të procesit¹⁶³: 1) objektivave të palëve në konflikt, 2) probabilitetit të arritjes së marrëveshjes, dhe 3) strategjisë së ndërmjetësit. Nisur nga objektivat e palëve në konflikt dhe probabilitetit të arritjes së një zgjidhjeje, praktikuesi i ndërmjetësimit ka në dispozicion katër lloje strategjish: 1) strategjinë e kompensimit, 2) strategjinë e ushtrimit të presionit, 3) strategjinë e integritit, dhe 4) strategjinë e të qëndruarit pasiv. Tre strategjitë e para, i sugjerojnë praktikuesit të ndërmjetësimit, një rol aktiv dhe vlerësues të fakteve. Ndërsa, strategjia e katërt i sugjeron praktikuesit të ndërmjetësimit një rol pasiv dhe lënien e fushës së lojës, në dorë të palëve në konflikt.

Modeli Noll, i jep rëndësi dinamikave të konfliktit¹⁶⁴ dhe thekson rëndësinë e katër elementëve: 1) objektivave të konfliktit, 2) shkallës në të cilën gjendet konflikti, 3) stilit të ndërmjetësimit, dhe 4) rezultatit të pritshëm të ndërmjetësimit. Nisur nga roli i rëndësishëm që luajnë këta katër elementë, për praktikuesin e ndërmjetësimit, ky model sugjeron një strategji transformuese që diktohet nga natyra e konfliktit dhe rezultati i mundshëm i tij. Dy janë tiparet kryesore të kësaj strategjie: 1) fleksibiliteti në alternimin e rolit lehtësues me rolin vlerësues të ndërmjetësit; dhe 2) kombinimi i rolit aktiv dhe pasiv të ndërmjetësit.

1.3. Nga ç’ perspektivë e analizon ky studim Ndërmjetësimin?

Ky studim e analizon Ndërmjetësimin, duke kombinuar dy perspektiva: 1) perspektivën e procesit, dhe 2) perspektivën e konfliktit. Nga perspektiva e procesit, ky studim i jep rëndësi zgjedhjeve dhe veprimeve të ndërmjetësit dhe palëve në konflikt. Nga

¹⁶² Noll, Douglas E. (2001) “*A Theory of Mediation*,” *Dispute Resolution Journal*, February, pp.45-49.

¹⁶³ Po aty, pp.45-49.

¹⁶⁴ Po aty, pp.45-49.

perspektiva e konfliktit, ky studim i jep rëndësi objektivave, shkallës, dhe tipit të konfliktit. Nisur nga fakti që brenda kontekstit të ndërmjetësimit, ndërmjetësi, palët në konflikt dhe natyra e konfliktit ndikojnë në veprimet dhe zgjedhjet e aktorëve, si dhe vetë dinamikat e procesit të ndërmjetësimit, ky studim ngrihet mbi tre supozime bazë:

1. Zgjedhjet dhe veprimet e ndërmjetësit dhe palëve në konflikt nuk janë të pavarur nga njëri-tjetri, por reflektojnë besimet dhe konceptet që kanë për ndërmjetësimin, ndërmjetësi dhe palët në konflikt, si dhe marrëdhëniet që vendosin ndërmjetësi dhe palët në konflikt me njëri-tjetrin.
2. Zgjedhjet dhe veprimet e palëve në konflikt reflektojnë motivet, qëllimin, tipin, dhe shkallën e zhvillimit të konfliktit, gjejnë shprehje në marrëdhëniet me procesin dhe ndikojnë mbi dinamikat e të gjithë procesit të ndërmjetësimit.
3. Vetë tipi i ndërmjetësimit është rezultat i zgjedhjeve dhe veprimeve të ndërmjetësit dhe palëve në konflikt, si dhe i qëllimit, shkallës dhe tipit të konfliktit.

Nisur nga këto tre supozime bazë, ky studim e analizon ndërmjetësimin në katër drejtime:

- Cili është tipi i ndërmjetësimit që praktikohet më shumë në Shqipëri
- Sa efektiv është në Shqipëri përdorimi i ndërmjetësimit në zgjidhjen e konflikteve;
- Cilët janë faktorët që ndikojnë, edhe tipin, edhe efektivitetin e ndërmjetësimit në Shqipëri;
- Cilat janë tendencat e praktikimit të ndërmjetësimit në Shqipëri, në zgjidhjen e konflikteve.

1.4. Përse ky studim zgjedh Shqipërinë si rast për analizimin e Ndërmjetësimit?

Dinamikat e ndërmjetësimit që vëzhgohen në Shqipëri, justifikojnë studimin e ndërmjetësimit në kontekstin shqiptar, qoftë për arsye praktike, qoftë për arsye akademike dhe shkencore.

Nisur nga ana praktike, një arsye që justifikon studimin e ndërmjetësimit në rastin e Shqipërisë, është aplikimi i ndërmjetësimit për zgjidhjen e konflikteve vetëm pas viteve 2000. Elezi¹⁶⁵, Semini-Tutulani¹⁶⁶, apo edhe Raporti i International Financial Corporation¹⁶⁷,

¹⁶⁵Elezi, I. (2006). *Ndërmjetësimi në pajtimin e rasteve penale*, Botim i Fondacionit “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” dhe Shërbimit Norvegjez të Ndërmjetësimit, Tiranë, Shqipëri, fq. 12.

flasin për ekzistencën në Shqipëri, të traditës popullore të zgjidhjes së konflikteve me ndërmjetësim, duke shkuar prapa në kohë, deri tek Kanuni i Lekë Dukagjinit. Por kjo traditë është, më së shumti, para-legale në karakterin e vet, ndërsa praktikimi “zyrtar” i ndërmjetësimit si alternativë e zgjidhjes së konfliktit, ashtu siç aplikohet në SHBA apo Evropë, regjistrohet vetëm pas viteve 2000. Të dhënat që ky studim ka mbledhur nga ndërmjetësit, gjykatat dhe palët në konflikt, të cilat kanë përdorur ndërmjetësimin, tregojnë se ndërmjetësimi ka filluar të aplikohet andej nga viti 2009. Bazuar në disa të dhëna, nga 1049 persona për periudhën 1996-1999, të mbledhur nga Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Elezi¹⁶⁸ flet për praktikim të ndërmjetësimit, para viteve 2000. Por, vetë të dhënat ku ai mbështetet nuk tregojnë kështu, pasi 38.4% e të pyeturve e kanë zgjidhur konfliktin me gjyq, 13.8% me vetëgjyqësi, 39.2% me pajtim, ndërsa për 8.6% nuk ka informacion. Nisur nga dallimi që studiuesit bëjnë midis “ndërmjetësimit” dhe “pajtimit”, qoftë si koncepte, qoftë si praktikë rezulton se deri para viteve 2000, nuk mund të flitet për praktikim në Shqipëri të ndërmjetësimit, ashtu siç praktikohet ai në shoqëri të tjera të botës. Kështuqë, fakti i praktikimit të ndërmjetësimit vetëm në këto dhjetë vitet e fundit e bën intrigues sqarimin, përse vërehet kjo gjë në rastin shqiptar.

Arsyeja e dytë praktike, që justifikon studimin e ndërmjetësimit në rastin shqiptar, ka lidhje me dinamikën që vërehen në përdorimin e ndërmjetësimit. Çka vihet re janë katër zhvillime. I pari flet për rritje e numrit të rasteve që përdorin ndërmjetësimin. Që nga 2009, numri i rasteve që kanë kërkuar zgjidhje përmes ndërmjetësimit ka njohur dy herë dyfishim: një herë gjatë periudhës 2009-2013 dhe, hera e dytë, në periudhën 2013-2015. Zhvillimi i dytë flet për zgjerim të sferave të përdorimit të ndërmjetësimit, si alternativë për zgjidhjen e

¹⁶⁶ Semini-Tutulani, M. (2011). *“Parimet bazë të përdorimit të drejtësisë restauruese në çështjet penale. Roli i ndërmjetësit dhe aftësitë e tij”*, botuar tek Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi për të Miturit, redaktorë Marjana Semini, Arta Mandro, Viktor Gumi, dhe Rasim Gjoka, botues West Print, fq. 7-26.

¹⁶⁷ IFC Raport (2010), *Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve Tregtare Npërmjet Ndërmjetësimit: Rasti i Shqipërisë*, Botues International Finance Corporation (IFC), World Bank Group, dhe Qeveria e Holandës, fq.122.

¹⁶⁸ Elezi, I. (2006). *Ndërmjetësimi në pajtimin e rasteve penale*, Botim i Fondacionit “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” dhe Shërbimit Norvegjez të Ndërmjetësimit, Tiranë, Shqipëri, fq. 158.

konfliktit në familje, tregti, çështje civile, çështje penale¹⁶⁹. Zhvillimi i tretë flet për ndryshime të qëndrimit të gjykatave ndaj ndërmjetësimit. Që nga viti 2009, gjykatat kanë rritur numrin e të rasteve që dërgohen për ndërmjetësim¹⁷⁰. Zhvillimi i katërt flet për diversifikim të burimeve që iu rekomandojnë palëve ndërmjetësimin. Përveç gjykatave, ndërmjetësimi rekomandohet nga policia, prokuroria, autoritetet vendore, apo komunitetet¹⁷¹. Këto dinamika nxisin kureshtjen për të shpjeguar, çfarë forcash apo rrethanash qëndrojnë pas këtyre dinamikave pozitive për ndërmjetësimin.

Përveç arsyeve praktike, studimi i ndërmjetësimit në rastin e Shqipërisë, ka vlerë edhe për arsye teorike dhe shkencore. Në këtë rast, studimi mund të ndihmojë në sqarimin se, deri në çfarë pikë dinamikat e ndërmjetësimit në Shqipëri, ngjasojnë me dinamikat e ndërmjetësimit si fenomen, të identifikuara dhe përgjithësuara nga studiuesit e tjerë të ndërmjetësimit. Studimi i ndërmjetësimit, në rastin e Shqipërisë, ka vlerë për tre arsye teorike dhe shkencore.

Një arsye ka të bëjë me parakushtet që përcaktojnë shkallën dhe efektivitetin e përdorimit të ndërmjetësimit. Nisur nga fakti që, studiuesit kanë identifikuar disa parakushte të nevojshme, ku përdorimi i ndërmjetësimit të mundësohet dhe jetë efektiv, konteksti

¹⁶⁹ IFC Raport (2010) *Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve Tregtare Npërmjet Ndërmjetësimit: Rasti i Shqipërisë*, Botues International Finance Corporation (IFC), World Bank Group, dhe Qeveria e Holandës, fq.22-23; Semini-Tutulani, Marjana (2011), *“Parimet bazë të përdorimit të drejtësisë restauruese në çështjet penale. Roli i ndërmjetësit dhe aftësitë e tij”*, botuar tek Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi për të Miturit, redaktorë Marjana Semini, Arta Mandro, Viktor Gumi, dhe Rasim Gjoka, botues West Print, fq. 14-16.

¹⁷⁰ IFC Raport (2010) *Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve Tregtare Npërmjet Ndërmjetësimit: Rasti i Shqipërisë*, Botues International Finance Corporation (IFC), World Bank Group, dhe Qeveria e Holandës, fq.22-23.

¹⁷¹ Elezi, I.(2006). *Ndërmjetësimi në pajtimin e rasteve penale*, Botim i Fondacionit “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” dhe Shërbimit Norvegjez të Ndërmjetësimit, Tiranë, Shqipëri, fq. 224; SAVE THE CHILDREN” Manual (2015a), *Shërbimi i Ndërmjetësimit dhe Drejtësia Restauruese për të Miturit në Konflikt me Ligjin: Për rastet e Referuara nga Policia*, botues “Save the Children,” BE, dhe Fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve,” Tiranë, Shqipëri, pp.22-27; UNICEF Raste Studimore (2011). *Të Miturit në Konflikt me Ligjin dhe Mundësia e Përfshirjes së tyre në Programe Restauruese*, botim I UNICEF, BE, dhe Fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi I Mosmarrëveshjeve,” Tiranë, Shqipëri, fq. 13.

shqiptar tregon disa elementë interesantë. Raporti i IFC¹⁷² nënvizon se, ndonëse përdorimi i ndërmjetësimit në Shqipëri favorizohet nga tradita historiko-kulturore, zhvillimi i kuadrit ligjor dhe nevojës shumë të madhe të njerëzve për zgjidhje të konflikteve të tyre përmes ndërmjetësimit, përdorimi i ndërmjetësimit si alternativë zgjidhjeje konflikti mbetet shumë i pazhvilluar në Shqipëri. Në raport me parakushtet, që studiuesit i cilësojnë si të nevojshme për një ndërmjetësim efektiv dhe të suksesshëm, në Shqipëri, vëzhgohen dinamika të ndryshme. *Së pari*, ka ndryshime në kuadrin ligjor për ndërmjetësimin. Këto ndryshime fillojnë në 11 Mars 1999, me Ligjin 8465, në të cilin artikullohet pranimi i përdorimit të ndërmjetësimit si alternativë për zgjidhjen e konflikteve; vazhdojnë me Ligjin 9090, të 26 Qershorit 2003, Ligjin 10385, të 24 Shkurt 2011, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” dhe plotësohen edhe me Kodet, si ai i Procedurës Civile, Familjes, apo me Vendime të Këshillit të Ministrave, si VKM Nr. 414, 08 Qershor 2011, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve”, apo VKM Nr. 418, 08 Qershor 2011, “Për procedurën e heqjes së licencës së ndërmjetësit”. *Së dyti*, edhe tek njerëzit vëzhgohet një qëndrim tjetër ndaj ndërmjetësimit. Sipas UNICEF¹⁷³, në Shqipëri vëzhgohet edhe një përmirësim i mendimit të njerëzve për ndërmjetësimin. P.sh. nga 336 persona, që kanë qenë palë në 181 konflikte, të cilët kanë përdorur ndërmjetësimin gjatë periudhës Shkurt 2012 - Qershor 2013, dhe janë pyetur për përshtypjet e tyre rreth ndërmjetësimit, 97% e tyre jo vetëm e kanë gjetur ndërmjetësimin efektiv dhe, kështu, janë ndjerë të kënaqur nga rezultati i procesit, por edhe kanë pohuar se ishin të gatshëm që, ose t’ua rekomandonin edhe të tjerëve, ose ta përdornin përsëri vetë në rast konflikti. Së treti, ndryshime vëzhgohen edhe në kriteret profesionale për ndërmjetësimin, specifikisht

¹⁷² IFC Raport (2010) *Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve Tregtare Nëpërmjet Ndërmjetësimit: Rasti i Shqipërisë*, Botues International Finance Corporation (IFC), World Bank Group, dhe Qeveria e Holandës, fq. 22-27.

¹⁷³ UNICEF Raste Studimore (2011). *Të Miturit në Konflikt me Ligjin dhe Mundësia e Përfshirjes së tyre në Programe Restauruese*, botim I UNICEF, BE, dhe Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, Shqipëri, fq. 13; UNICEF Studim (2013) *Drejtësia restaurues dhe ndërmjetësimi viktimë-kundërvajtës në shërbimin e provës*, Botues UNICEF, BE, Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Marrëveshjeve”, Tiranë, Shqipëri, fq. 32.

licencimi¹⁷⁴. Por, paralelisht këtyre ndryshimeve, vihen re edhe probleme me numrin e pakët të ndërmjetësve profesionist dhe të trajnuar¹⁷⁵, ose edhe me vetë cilësinë e trajnimeve të ndërmjetësve. Nisur, pra, nga këto vëzhgime, një analizë nga pikëpamja e dinamikave në parakushtet do të ndihmonte për të kuptuar, nëse rasti i efektivitetit dhe suksesit të ndërmjetësimit në Shqipëri, bart tipare të njëjta apo të ndryshme me tiparet e fenomenit të ndërmjetësimit, në përgjithësi, apo në shoqëri të tjera të botës.

Arsyeja e dytë teorike, që e bën me vlerë studimin e ndërmjetësimit, në rastin e Shqipërisë, ka të bëjë me faktorët që ndikojnë dhe përcaktojnë tipin dhe modelet e ndërmjetësimit në Shqipëri. Edhe këtu pyetja intriguese është, nëse rasti i tipit dhe modelit të ndërmjetësimit që vëzhgohet të preferohen dhe praktikohen në Shqipëri, mund të shpjegohet me të njëjtin set faktorësh, që kanë identifikuar studiuesit, kur kanë trajtuar dinamikat në tipin dhe modelet e ndërmjetësimit, në përgjithësi, apo tipi dhe modeli i ndërmjetësimit që praktikohet në rastin e Shqipërisë, ka lidhje me faktorë të ndryshëm. Në bazë të zhvillimeve të fundit në Shqipëri, ajo që vëzhgohet është se tipi dhe modeli i ndërmjetësimit në Shqipëri, influencohet kryesisht nga dy grupe faktorësh, nga brenda dhe nga jashtë sistemit gjyqësor¹⁷⁶. Grupi i parë përfshin faktorët që janë në favor të përdorimit të ndërmjetësimit, si alternativë për zgjidhjen e konfliktit. Këtu futen gjyqtarët, ndërmjetësit, biznesi, sektori privat, qeveria, apo organizata të shoqërisë civile. Përgjithësisht, qëndrimi në favor të ndërmjetësimit nisët nga mbingarkesa në rastet me të cilat përballen gjykatat. Grupi i dytë përfshin faktorët që janë kundër përdorimit të ndërmjetësimit për zgjidhjen e konfliktit. Ky grup përfshin avokatët, kushtet financiare, mosha e re dhe mungesa e eksperiencës së institucioneve, si dhe mangësitë në kuadrin ligjor. Përgjithësisht, ndikim negativ i këtyre faktorëve lidhet me cenimin e interesave dhe mangësinë e ekspertizës në grupe të caktuara të sistemit të drejtësisë. Sqarimi se, deri në çfarë pikë dinamikat në tipin dhe modelet e ndërmjetësimit në

¹⁷⁴ UNICEF Raste Studimore (2011). *Të Miturit në Konflikt me Ligjin dhe Mundësia e Përfshirjes së tyre në Programe Restauruese*, botim i UNICEF, BE dhe Fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, Shqipëri, fq. 88.

¹⁷⁵ IFC Raport (2010) *Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve Tregtare Nëpërmjet Ndërmjetësimit: Rasti i Shqipërisë*, Botues International Finance Corporation (IFC), World Bank Group, dhe Qeveria e Holandës, fq.27.

¹⁷⁶Po aty, fq.24-27.

Shqipëri, ndajnë të njëjtat tipare me dinamikat e ndërmjetësimit në përgjithësi, apo në vende të tjera, përfaqëson një kontribut teorik dhe shkencor.

Arsyeja e tretë teorike ka të bëjë me vetë studimin dhe njohjen shkencore të ndërmjetësimit dhe rastit të Shqipërisë. Ndonëse, në Shqipëri është rritur numri i botimeve për ndërmjetësimin, informacionet që qarkullojnë, më shumë se studime të mirëfillta shkencore, janë raporte, manuale, udhëzues, programe trajnimi, apo përshkrime situatash të ofruara dhe financuara në më të shumtën e rasteve nga organizata ndërkombëtare, si: BE, USAID, UNICEF, SAVE CHILDREN. Për më tepër, edhe në ato pak raste që pretendojnë të jenë studime shkencore, ajo që vihet re është një mungesë e qartësisë së koncepteve, empirizëm, metodologji problematike e studimit, analizë bazike e të dhënave, historicizëm apo dominim i perspektivave sociologjike, mungesë e komunikimit me studimet bashkëkohore dhe komunitetin shkencor ndërkombëtar, që interesohet dhe merret me ndërmjetësimin. Në Shqipëri mungon një debat i mirëfillt shkencor juridik për ndërmjetësimin¹⁷⁷. Kjo ndodh, qoftë sepse mungojnë studimet e mirëfillta shkencore, qoftë sepse nuk ekziston një komunitet shkencor i konsoliduar, qoftë edhe për shkak të moskomunikimit shkencor me komunitetin shkencor ndërkombëtar të studiuesve në botë. Ky studim tenton të mbushë këtë boshllëk. Ai synon ta ekspozojë ndërmjetësimin në Shqipëri dhe dinamikat e tij, nga një këndvështrim shkencor, esenca e të cilit është përpjekja për të kuptuar dhe dhënë një shpjegim për ato tipare të ndërmjetësimit që vëzhgohen në rastin e Shqipërisë.

1.5. Variabilet e Studimit

A. Variabili i varur

1. Procesi i Ndërmjetësimit

B. Variabilet e pavarur

1. Shërbimi i Ndërmjetësimit (që bëhet nga ndërmjetësit)
2. Mosmarrëveshja e palëve në konflikt (vjen nga palët)
3. Referimi i çështjeve nga gjyqësori

¹⁷⁷Semini-Tutulani, M.(2011). *“Parimet bazë të përdorimit të drejtësisë restauruese në çështjet penale. Roli i ndërmjetësit dhe aftësitë e tij”*, botuar tek Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi për të Miturit, redaktorë Marjana Semini, Arta Mandro, Viktor Gumi, dhe Rasim Gjoka, botues West Print, fq. 5-6.

1.6. Hipotezat e Studimit

I. Hipoteza kryesore

1. Aplikimi dhe efektiviteti i procesit të ndërmjetësimit ndikohet nga roli i ndërmjetësit, qëndrimi i palëve në konflikt dhe ndikimi i parakushteve institucionale dhe profesionale të kuadrit ligjor, gjykatave dhe aftësisë profesionale të ndërmjetësve.

II. Hipotezat sekondare

1. Sa më e standardizuar të jetë infrastruktura ligjore për shërbimin e ndërmjetësimit, kualifikimin dhe aftësitë profesionale të ndërmjetësit, aq më pozitivisht do të ndikojë ajo, në procesin e ndërmjetësimit dhe rritjes së numrit të mosmarrëveshjeve që do t'i nënshtrohen këtij procesi.
2. Sa më e lartë të jetë shkalla e ndërgjegjësimit, të palëve të përfshira në mosmarrëveshje lidhur me shërbimin e ndërmjetësimit, aq më i lartë do të jetë numri i referimeve nga sistemi gjyqësor.
3. Sa më efektiv të jetë kuadri ligjor në lidhje me referimet e mosmarrëveshjeve, që i nënshtrohen procesit të ndërmjetësimit, aq më i lartë do të jetë numri i çështjeve që do të trajtohen në ndërmjetësim.

1.7. Pyetjet qendrore dhe sekondare të studimit

Fakti që ndërmjetësimi në Shqipëri përfaqëson një praktikë shumë të re, me moshë as edhe një dekadë dhe, fakti që përdorimi i ndërmjetësimit për zgjidhjen e konfliktit, ndonëse ka filluar të karakterizohet nga dinamika intensifikuese, përsëri mbetet një praktikë e pakonsoliduar, natyrshëm shpie në ngritjen e tre pyetjeve që janë bazë për këtë studim.

Pyetja qendrore e studimit synon të sqarojë ç'marrëdhënie ekzistojnë mes tipit të ndërmjetësimit që përdoret më shpesh nga ndërmjetësit në Shqipëri, në raport me tipin e konfliktit, rolin e ndërmjetësit dhe palëve në konflikt, dhe sistemit të referimit të konflikteve në ndërmjetësim.

Pyetja qendrore është: Çfarë ndikon dhe përcakton shkallën e përdorimit dhe efektivitetit të procesit të ndërmjetësimit në zgjidhjen e konfliktit mes palëve?

Ky studim ngre, gjithashtu, dhe përpiket t'i japë përgjigje, edhe tre pyetjeve të tjera sekondare. Këto pyetje synojnë të hedhin dritë mbi tre marrëdhënie: 1) mes ndërmjetësimit dhe plotësimit të parakushteve; 2) mes ndërmjetësit dhe palëve në konflikt; dhe 3) mes gjykatës dhe referimit të mosmarrëveshjeve në ndërmjetësim.

Pyetja e parë sekondare është: A është efikas shërbimi i ndërmjetësimit dhe cilët janë faktorët që ndikojnë në këtë efektivitet?

Pyetja e dytë sekondare është: A janë palët të interesuara për shërbimin e ndërmjetësimit në mosmarrëveshjet që ata kanë dhe sa qasen ata me këtë proces?

Pyetja e tretë sekondare është: Sa e predispozuar është gjykata për të referuar mosmarrëveshjet drejt procesit të ndërmjetësimit.

Ky studim pra, ngre pyetje dhe kërkon të shpjegojë procesin e ndërmjetësimit, efikasitetin e tij, shkallën e efektivitetit të ndërmjetësimit, jo vetëm përmes ekzaminimit të rolit të ndërmjetësit, palëve në konflikt dhe natyrës së konfliktit, por, duke përfshirë në analizën e tij, edhe rolin e parakushteve të nevojshme për një ndërmjetësim efektiv, për të parë nëse këto parakushte plotësohen apo jo dhe, nëse merren në konsideratë, deri në çfarë masë ato plotësohen.

1.8. Rastet studimore dhe metoda e studimit

Studimin e ndërmjetësimit në Shqipëri ky punim e bën në gjithë vendin, duke përfshirë 22 gjykatat e rretheve, pa përfshirë gjykatën e krimeve të rënda dhe gjykatat administrative. Pastrimi i të dhënave, u krye në bazë të kriterit të referimit të çështjeve në ndërmjetësim, ku rezultoi se gjykatat e Tiranës, Durrësit, Korçës dhe Gjirokastrës kanë bërë referime. Gjithashtu, këto rrethe gjyqësore janë zgjedhur edhe për këto tre arsye:

Së pari, rrethet gjyqësore Durrës, Korçë dhe Gjirokastrë kanë qenë pjesë e një programi pilot, që ka synuar përfshirjen në gjykata të përdorimit të ndërmjetësimit, për trajtimin e rasteve që kanë bërë kërkesë për proces gjyqësor dhe zgjidhjen e konfliktit mes palëve pa shkuar në gjyq.

Së dyti, këto rrethe gjyqësore karakterizohen nga prezenca dhe veprimtaria e të gjithë aktorëve që kanë lidhje me procesin e ndërmjetësimit dhe që mund të japin informacion për dinamikën e tij: 1) kanë një listë të ndërmjetësve, 2) kanë gjykatës që kanë sugjeruar

ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e konfliktit, dhe 3) kanë të regjistruar edhe të dhënat për palët që kanë pasur konflikt dhe i janë nënshtruar ndërmjetësimit.

Së *treti*, këto rrethe gjyqësore kanë elementë dhe fuqi të mirë përfaqësimi nga pikëpamja e komunitetit të ndërmjetësve, trupës së gjykatësve, si dhe popullsisë. Rrethet Gjyqësore të Tiranës, Durrësit, Korçës dhe Gjirokastrës janë ndër rrethet më të mëdhenj gjyqësorë brenda sistemit gjyqësor shqiptar, nga 22 gjykatat e rretheve që e përbëjnë atë. Bashkë, të katërta këto rrethe gjyqësore, mbulojnë përafërsisht 50% të numrit të gjyqtarëve, 70% të numrit të ndërmjetësve, dhe mbi 50% të popullsisë së Shqipërisë. Përkatësisht, nga 235 gjyqtarë, janë 113 gjyqtarë. Këtu nuk janë përfshirë gjyqtarët e gjykatave administrative, të krimeve të renda, Gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

Këto rrethe gjyqësore, ndonëse nuk përfaqësojnë të gjithë sistemin gjyqësor, mund të ofrojnë një informacion dhe mësim interesante për tipin dhe efektivitetin e ndërmjetësimit, si dhe parakushtet dhe faktorët që ndikojnë mbi të dhe formësojnë përdorimin e ndërmjetësimit si alternativë për zgjidhjen e konfliktit mes dy palëve. Ndaj, në këtë kuptim, ky studim nuk pretendon që konkluzionet e tij të mund të jenë të vërteta dhe përgjithësuese, edhe për raste të tjera të përdorimit të ndërmjetësimit, që mund të kenë ndodhur jashtë këtyre rretheve gjyqësore të përzgjedhura nga ky studim.

Në analizimin e dinamikave të ndërmjetësimit, ky studim e mbledh informacionin nga tre burime kryesore: 1) ndërmjetësit, 2) palët në konflikt, 3) gjyqtarët. Informacioni i mbledhur prej tyre karakterizohet nga dy tipare kryesore. Së *pari*, ai ofron një njohje të situatës rreth ndërmjetësimit në këto elementë kryesorë: 1) numrin e rasteve, 2) trajtimin dhe qëndrimin që mbahet ndaj ndërmjetësimit nga kuadri ligjor, gjykata, dhe njerëzit, 3) strategjinë dhe tipin e ndërmjetësit, 4) rolin e ndërmjetësit dhe palëve në konflikt, si dhe 5) natyrën e konfliktit mes palëve. Tipari i dytë i informacionit të mbledhur është karakteri konfirmues. Për shkak se të tre aktorët, ndërmjetës, gjykatës, dhe palë në konflikt janë pjesë dhe aktorë aktivë të të gjithë procesit të ndërmjetësimit dhe, për shkak se, të tre këtyre aktorëve iu është kërkuar të shprehen për të njëjtin element, saktësia e informacionit të marrë nga secili burim precizohet dhe konfirmohet nga dy burime të tjera. P.sh. saktësia e informacionit të dhënë nga ndërmjetësit, precizohet nga informacioni i mbledhur nga gjykata apo palët në konflikt.

Mbledhja e informacionit është kryer, duke përdorur si instrument një pyetësor prej 30 pyetjesh. Për të qenë të sigurt që informacioni i mbledhur përmes pyetësorit është pikërisht, ai informacion për të cilin është i interesuar ky studim, përpara përdorimit të pyetësorit është kryer kolaudimi i pyetjeve dhe përmirësuar strukturimi i pyetjeve, nga pikëpamja e përmbajtjes dhe e qartësisë së tyre. Pyetësori është kolauduar me një grup prej 100 vetësh dhe precizoni i tij ka rezultuar 95%. Pas përmirësimit të përmbajtjes dhe qartësisë së 5% të pyetjeve, pyetësori është përdorur me gjykatësit, ndërmjetësit, dhe palët në konflikt.

Metoda e analizimit të informacionit të mbledhur nga pyetësorët ka kombinuar dy metoda: 1) metodën statistikore përshkruese dhe 2) metodën e krahasimit. Metoda statistikore jep informacion dhe ndihmon për nxjerrjen e disa konkluzioneve për tipin dhe efektivitetin e ndërmjetësimit, si dhe parakushtet dhe faktorët kryesorë influencues të dinamikave të ndërmjetësimit nga pikëpamja e tipit, efektivitetit, dhe tendencave të tij. Metoda krahasuese jep informacion dhe ndihmon për nxjerrjen e disa konkluzioneve për dallimet që ekzistojnë, në raport me dinamikat e përdorimit të ndërmjetësimit.

1.9. Si është i organizuar studimi

Ky studim është i organizuar në pesë kapituj.

Kapitulli i dytë që pason, ofron një analizë të kuadrit teorik për ndërmjetësimin. *Së pari*, trajton dhe analizon marrëdhëniet mes ndërmjetësimit dhe ndërmjetësit, ndërmjetësimit dhe palëve në konflikt, ndërmjetësit dhe palëve në konflikt. *Së dyti*, trajton dhe analizon tipet dhe modelet e ndërmjetësimit të identifikuara nga studiuesit e ndërmjetësimit, supozimet dhe hipotezat, mbi të cilat ngrihen modelet, argumentet në favor dhe kundër secilit model, si dhe pikat e dobëta dhe të forta të modeleve të ndërmjetësimit. *Së treti*, kapitulli qartëson variabilet e tij të varur dhe të pavarur, treguesit matës të variancës së tyre, dhe hipotezat e studimit. *Së katërti*, kapitulli hedh një vështrim të tipit, modelit, shkallës, efektivitetit të ndërmjetësimit që vëzhgohen në Shqipëri, si dhe të marrëdhënieve të tij me parakushtet që garantojnë suksesin. Analiza këtu ofron një tablo mbi kuadrin ligjor, organizimin, kriteret, dhe standardet profesionale të institucionit të ndërmjetësimit, marrëdhëniet e ndërmjetësimit me gjykatën.

Kapitulli i tretë analizon marrëdhënien ndërmjetësim-ndërmjetës në terrenin konkret të Shqipërisë. Bazuar në të dhënat e mbledhura, ky kapitull diskuton tre elementë. *Së pari*,

nxjerr disa konkluzione për strategjinë që preferojnë ndërmjetësit shqiptarë. *Së dyti*, nxjerr disa konkluzione për tipin e ndërmjetësit, që preferojnë ndërmjetësit shqiptarë. *Së treti*, nxjerr disa konkluzione për modelin e ndërmjetësimit që rezulton, nisur nga marrëdhënia e krijuar dhe vëzhguar në Shqipëri, mes ndërmjetësit dhe ndërmjetësimit. Ky kapitull ofron edhe disa nga argumentet dhe konkluzionet bazë të studimit.

Kapitulli i katërt analizon marrëdhënien ndërmjetës-palë në konflikt, në terrenin konkret të Shqipërisë. Bazuar në të dhënat e mbledhura, ku kapitull diskuton tre elementë. *Së pari*, nxjerr disa konkluzione për qëllimin e palëve prapa konfliktit. *Së dyti*, nxjerr disa konkluzione për shkallën e konfliktit mes palëve, në momentin e dhënies hapësirë prej palëve, të idesë së përdorimit të ndërmjetësimit. *Së treti*, nxjerr disa konkluzione për tipin e konfliktit që karakterizojnë marrëdhëniet mes ndërmjetësit dhe palëve në konflikt. Ky kapitull ofron edhe disa argumente dhe konkluzione për natyrën e konfliktit, në rastet e konflikteve që kanë përdorur ndërmjetësimin në Shqipëri.

Kapitulli i pestë, merr në analizë parimet kryesore mbi të cilat bazohet ndërmjetësimi në Rrepublicën e shqipërisë, duke trajtuar me kujdes bazën ligjore ku ndërmjetësimi mbështetet në ndjekjen e këtyre parimeve. Në këtë kapitull do të vërejmë edhe një pjesë të evolucionit që ligji për ndërmjetësimin ka pësuar duke theksuar përmirësimet e dukshme dhe ato jo të dukshme.

Kapitulli i gjashtë, bën një analizë e të dhënave parësore të grumbulluara me anë të pyetësorëve nga intervistimi i aktorëve që marrin pjesë në procesin e ndërmjetësimit duke bërë një përpunim statistikor të të dhënave të marra nga palët në procesin e ndërmjetësimit. Për të arritur në konkluzione që dalin nga lidhjet statistikore, lidhjet funksionale ndërmjet palëve në konflikt, ndërmjetësit, Gjyqtarët dhe vetë procesit të ndërmjetësimit është përdorur metoda komplekse (SPSS) e përpunimit të të dhënave që kanë dalë nga këto pyetësorë.

Kapitulli i shtatë trajton ndërmjetësimin në eksperiencat e huaja, për të arritur një krahasim spërfaqësor për mënyrën se si funksionon ndërmjetësimi në 11 (njëmbëdhjetë) shtete të bashkimit europian. Ky trajtim bëhet për të trajtuar eksperiencat që kanë ndikuar në zhvillimin e ndërmjetësimit në këto shtete të cilat aplikojnë civil law.

Kapitulli i tetë është kapitulli përmbyllës i studimit, bën tre konkluzione kryesore. *Së pari*, nxjerr disa konkluzione përmbledhëse për marrëdhëniet mes parakushteve dhe ndërmjetësimit. Konkluzionet lidhen me sqarimin e faktit se deri në çfarë pike ekzistenca ose

jo e parakushteve dhe plotësimi i plotë apo i pjesshëm i parakushteve ndikon dhe përcakton dinamikat e ndërmjetësimit në Shqipëri. *Së dyti*, nxjerr disa konkluzione përmbledhëse për marrëdhëniet mes ndërmjetësimit, ndërmjetësit, dhe palëve në konflikt, nga pikëpamja e tipit dhe modelit të ndërmjetësimit dhe mënyrës se si tipi dhe strategjia e ndërmjetësit, si dhe qëllimi, shkalla dhe tipi i konfliktit ndikojnë mbi tipin dhe modelin e ndërmjetësimit, që vëzhgohet në Shqipëri. Konkluzionet lidhen me sqarimin se, cili prej faktorëve të përzgjedhur nga ky studim, brenda modelit të tij analizues, influencon dhe përcakton dinamikat e ndërmjetësimit. *Së treti* dhe së fundit, nxjerr disa konkluzione për dinamikat e ndërmjetësimit në rrethet gjyqësore të Tiranës, Durrësit, Korçës dhe Gjirokastrës. Konkluzionet bazohen në krahasimin e dinamikave mes këtyre tre rretheve dhe synojnë të sqarojnë, nëse tiparet e dinamikave, tipit, modelit, efektivitetit, dhe tendencave të ndërmjetësimit, që vëzhgohen në këto rrethe, janë të ngjashme apo të ndryshme.

KAPITULLI II: ZANAFILLA, KUPTIMI, ROLI DHE ZHVILLIMI I INSTITUTIT TË NDËRMJETËSIMIT NE SHQIPERI

1. Përkufizimi dhe natyra e institutit të ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi mund të përkufizohet si një proces, ku bihet dakord për caktimin e një pale të tretë për të ndihmuar dy ose më shumë palë të zgjidhin konfliktin me anë të një marrëveshjeje, pa iu nënshtruar një procesi gjyqësor. Ky proces bazohet në disa parime kryesore etike që profesioni i ndërmjetësit duhet të ketë parasysh. Pavarësisht se si mund të referohet një konflikt në një proces ndërmjetësimi, ndërmjetësi duhet të ruajë me fanatizëm kufijtë e kompetencës, që ligji i lejon në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, të respektojë zgjedhjen e lirë të palëve për ndërmjetësin që do të asistojë ata, t'i njoftojë për avantazhet dhe disavantazhet e këtij procesi, të ushtrojë profesionin i pavarur dhe i paanshëm, të bëjë të qarta të gjitha kushtet dhe detyrimet e palëve, si dhe të ushtrojë të gjitha kompetencat që i njeh ligji me ndershmëri dhe në konfidencialitet të plotë.¹⁷⁸

Gjatë gjithë procesit, Ndërmjetësi duhet të veprojë dhe të demonstrojë hapur se po vepron me paanshmëri ndaj palëve dhe duhet të jetë i përkushtuar t'u shërbejë të gjitha palëve në mënyrë të barabartë, përse i përket procesit të ndërmjetësimit. Këtë ai e tregon, duke vendosur rregulla korrekte dhe barabarta për të gjitha palët pjesëmarrëse në proces, duke iu kushtuar atyre kohë të njëjtë për të dhënë shpjegimet e tyre, duke i lënë ata të lirë për të përcaktuar mënyrën se si do të ndahen shpenzimet e tyre dhe mënyrën se si do të arrihet zgjidhja përfundimtare¹⁷⁹.

Nëse do t'i referohemi kuptimit të fjalës Ndërmjetës, dhe do të marrim në analizë ekzistencën e kësaj fjale, do të shohim se daton shumë herët. Në greqishten e vjetër ndërmjetësit ndaheshin gjuhësisht në emërtimin *mesita*espër ndërmjetësin mashkull dhe *mesiti*spër ndërmjetësuesen. Në latinishten e vjetër ndërmjetësit thërriteshin *mediator* dhe ndërmjetëset *mediatrix*. Pra siç e shikojmë fjala Ndërmjetës nuk është një fjalë e re, por ka ekzistuar shumë shekuj më parë. Të katra këto fjalë, kanë në thelb personin që është në

¹⁷⁸Ligji 9090 dt. 26.06.2003 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”; Ligji 8465 dt. 11.03.1999, “Për Ndërmjetësimin për Zgjidhjen me Pajtim të Mosmarrëveshjeve”; Ligji 10385 24.02.2011 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

¹⁷⁹Kodi Etik Evropian i Ndërmjetësve; Kodi Etik Australian i Ndërmjetësve

mes¹⁸⁰ të dy apo më shumë personave të tjerë, personin ndërlidhës. Në gjuhën frënge, fjala ndërmjetës nëse përkthehet e germëzuar ka kuptimin paqeprurës, “*apaiseur*” (paix –paqe), gjithashtu, kjo fjalë nënkupton edhe fjalën “pajtues”. Nga sa vërejmë me sipër, mund të themi me siguri se arti i ndërmjetësimit ka ekzistuar, individët me mendësinë e ndërmjetësit kanë ekzistuar dhe ka pasur individë të formuar për të vepruar si ndërmjetës, duke e bërë këtë gjë krejt natyrshëm.

Nëse i referohemi fjalorit të gjuhës shqipe, “*ndërmjetës është ai që hynë në mes të dy palëve për të arritur një marrëveshje, për të bërë një punë etj.: ai që ndërhyrë për të bërë një fejesë, lajmës. P.sh. ndërmjetësoj për të arritur një marrëveshje a për të zgjidhur diçka në dobi të një tjetri. Ndërmjetësim për paqe, ndërmjetësoj për t’i pajtuar*”¹⁸¹.

2. Historiku i krijimit dhe zhvillimit të institutit të ndërmjetësimit në Shqipëri

Ndërmjetësimi në Shqipëri nuk ka një periudhë të caktuar se kur ka lindur. Unë mendoj se ndërmjetësimi ka lindur bashkë me njeriun dhe nevojën e tij për të. Ai është një instinkt njerëzor mbijetese dhe si i tillë nuk mund të datohet. Për sa kohë problemet janë dhe kanë qenë pjesë e jetës tonë, për aq kohë edhe ndërmjetësimi ekziston si një mjet i përdorur në zgjidhjen e këtyre problemeve. Madje, mendoj se aftësimi në këtë fushë vjen pikërisht nga ekzistenca e ndërlikimeve të këtyre problemeve.

Referuar historikut të ndërmjetësimit në Shqipëri, vërejmë se e gjejmë në të drejtën zakonore shqiptare e, veçanërisht, në Kanunet, si pjesë e rëndësishme e tyre.

Ndërmjetësimi tek e drejta zakonore shqiptare është pjesë e një sistemi juridik të pashkruar. Ky sistem i pashkruar i përcakton ndërmjetësit të drejta dhe detyrime, të cilat janë të sanksionuara sipas kësaj të drejte. Konfliktet dhe problemet shoqërore, kanuni i rregullonte me anë të figurave të tilla si pleqësia (me karakter gjyqi); dorëzanët e gjakut (besëtari), pajtimi, ku si ndërmjetës ka qenë edhe ai që ka hyrë “*për me da fjalët e kqia*”¹⁸², pastaj prifti, si ndërmjetës në emër të “*Famullis, n’emër të flamurit*”. Kjo traditë e ndërmjetësimit ka mbetur aktuale deri në ditët e sotme. Padyshim, sot nuk bëhet ndërmjetësimi krejt sipas kësaj të drejte zakonore. Tani si ndërmjetës veprojnë persona, të

¹⁸⁰ Joseph Duss-von Werdt, (2008) *Einführung in die Mediation*, Heidelberg, fq. 10-14.

¹⁸¹ ASHSH (2002), *Fjalor i shqipësisë së sotshme*, Instituti i gjuhësisë dhe i letrësisë, Tiranë, fq.833-834.

cilët vijnë nga shtresa të ndryshme dhe pa dallim gjinie, gjë që tregon se ky nuk është më veprim i rezervuar apo i preferuar për disa njerëz të caktuar, edhe pse ende ka njerëz që e ushtrojnë ndërmjetësimin konform rregullave tradicionale. Ndërmjetësimi si i tillë ka qenë përherë prezent në shoqërinë shqiptare. Sot ky ndërmjetësimi ka mbetur aktual, edhe për shkak të mosbesimit përballë sistemit gjyqësor, prezencës së korrupsionit në gjykatë, por, edhe për shkak se, paraqitja në gjykatë e një konflikti ka mundësi të nxisë urrejtje edhe më të mëdha mes palëve, apo edhe fakti se shpesh vendimet e gjykatave, në aspektin juridik, edhe pse kanë dhënë vendimin sipas ligjit, kanë nxitur edhe më shumë konfliktin.

Referuar historikut të ndërmjetësimit në Shqipëri, vërejmë se atë e gjejmë edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Ndërmjetësi në Kanun zë një pjesë shumë të rëndësishme në marrëdhënien njerëzore ¹⁸³.

Përveç sa më sipër, në Kanunin e Lekë Dukagjinit është një kapitull i tërë, i cili angazhohet vetëm me kompetencat e ndërmjetësit. Po të shohim në përmbajtjen e këtyre dispozitave kanunore, do të vërejmë se, në fakt, ndërmjetësi ka qenë një person fuqiplotë, hera-herës një hallkë e detyrueshme edhe nga ana formale, të gjitha kompetencat e tij janë të rregulluara deri në detaj. Ai merr një mbrojtje të veçantë për tagrat qëi ngarkohen, është një person që ka më shume të drejta se të tjerët. Pra, në një lloj mënyrë shohim se ndërmjetësi, sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, është një person që është mbi palët, por, duke u kushtëzuar vetëm në bërjen të mundur të dialogut ¹⁸⁴.

3. Ndërmjetësimi dhe ndërmjetësi, sipas kuadrit ligjor shqiptar

Sot, është bërë e mundur që baza ligjore, e cila ka ekzistuar edhe më parë, ¹⁸⁵ të rishihet në përshtatje me kohën, legjislacionin e BE dhe me praktikën ndërkombëtare, për të arritur që, ndërmjetësimi të zbatohet si zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës familjare, civile, tregtare, të punës, si edhe në fushën penale, për çështje që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues ose me ankim të të dëmtuarit dhe, në ato raste, kur vetë ligji e lejon një gjë të tillë.

¹⁸³ Kanuni i Lekë Dukagjinit.

¹⁸⁴ Po Aty.

¹⁸⁵ Ligji 10385, datë 24.2.2011, "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve".

Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, edhe pse nuk ka pasur një shkallë të tillë institucionalizimi, nuk mund të quhet krejt i ri për shoqërinë shqiptare. Në të drejtën e zbatuar në vendin tonë, qoftë në atë zakonore, fetare apo pozitive, gjejmë modele e shembuj të shumtë tradicional të zbatimit të metodave pajtuese e ndërmjetësuese. Kështu mund të përmendim rolin e veçantë që kanë luajtur pleqtë dhe gjyqi i pleqve, por edhe kuvendi (i cili gjykonte në raste të veçanta), të cilët, para se të gjykonin çështjen e paraqitur bënin të gjitha përpjekjet për pajtim. Këturol të këtyre institucioneve zakonore e ka huazuar, herë pas here, edhe e drejta shtetërore deri në ditët tona. “Gjykatat” e fshatit dhe të lagjes, të njohura edhe si gjykata shoqërore të krijuara qysh më 1968,¹⁸⁶ e madje, të njohura si hallka përbërëse të sistemit gjyqësor, ndonëse, nisur nga masa e dënimit gjykonin çështje të një rëndësie të vogël, me të marrë kërkesën duhet të bënin të gjitha përpjekjet për pajtim të palëve në konflikt¹⁸⁷.

Ligji 10385, dt. 24.02.2011, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” ka pasuar ligjin 9090, dt. 26.06.2003 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, i cili ka ardhur pas ligjit 8465, dt. 11.03.1999, “Për Ndërmjetësimin për Zgjidhjen me Pajtim të Mosmarrëveshjeve”;

Pajtimi është një term, i cili është përdorur shpesh për të treguar një marrëveshje për pozitën e shumicës, që mund të vijë nga një dëshirë për t’u “përshtatur” ose për t’u pëlqyer (normative), apo, për shkak të dëshirës për të qenë i saktë (informative), ose thjesht në përputhje me një rol a pozitë shoqërore (identifikimi)¹⁸⁸. Pra, është një lloj i ndikimit social që përfshin ndryshime në besim apo sjellje, në mënyrë që të përshtatemi në një grup. Ky ndikim është i vërtetë (duke përfshirë praninë fizike të të tjerëve) ose i imagjinuar (përfshirë presionin e normat sociale / pritjet), që mund të vijë si pasojë e një presioni ndaj një individi apo grupi individësh¹⁸⁹.

Në vendin tonë, pajtimi është i përkthyer si shuarje e konfliktit, madje zakoni edhe e ka detajuar atë, duke e plotësuar me procedura të caktuara. Kjo, në momente të caktuara

¹⁸⁶ Direkti nr.4426 dt.23.09.1968, "Mbi gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve".

¹⁸⁷ Ligji Nr.4406, datë 24.6.1968, "Mbi organizimin gjyqësor të Republikës Popullore të Shqipërisë".

¹⁸⁸ <http://www.simplypsychology.org/conformity.html>; dt.05.12.2015.

¹⁸⁹ <http://www.oxforddictionaries.com/definition/learner/conformity>.

të historisë sonë është dokumentuar edhe në rregullat zakonore shqiptare¹⁹⁰. Nga vetë natyra që ka historiku i fjalës “Pajtim” për Shqipërinë, është një proces, i cili jo vetëm që nuk është i ligjëruar, por është i trysnuar.

Ky ligj ka për objekt, ekzistencën e kësaj alternative në zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe, njëkohësisht, përcaktimin e disa rregullave bazë për funksionimin e këtij profesioni në mënyrë të organizuar.

Në prill të vitit 2002, një “*green paper*” e Komisionit të Evropës, për zgjidhjet alternative të konfliktit (ADR) në fushën e së drejtës civile dhe tregtare, përshkroi ADR si “një politikë prioritet”. Në këtë “*Green Paper*” u konsiderua se qasja në drejtësi, e sanksionuar në nenin 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, u përball me tre Probleme: 1-vëllimi i mosmarrëveshjeve të ardhura pranë gjykatave, 2- gjatësia e kohës që merr procedura, dhe 3- kostot e larta, që shpesh herë bëheshin shkak për të mos kërkuar një të drejtë në gjykatë. ADR paraqitet si një çelës zgjidhje, duke plotësuar dhe jo duke konkurruar me procedurat gjyqësore, por duke paraqitur disa përparësi si me poshtë:

- përshtatshmëria për disa mosmarrëveshje të caktuara,
- i jep përparësi harmonisë shoqërore, duke qenë se palët angazhohen në një proces afrimi e komunikimi dhe jo konfrontimi,
- qasja konsensuale rrit mundësinë që Marrëdhëniet të durojnë,
- fleksibiliteti procedural, dhe
- reduktimi i jashtëzakonshëm i shpenzimeve¹⁹¹.

3.1. Kuadri ligjor për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Shqipëri

Eksperienca e parë me një ligj të posaçëm të ndërmjetësimit përkon me Ligjin Nr.8465, datë 11.03.1999, “*Për ndërmjetësimin për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve*” i cili, në fakt, nuk parashikonte ndërmjetësimin si alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tregtare. Ky ligj është shfuqizuar nga ligji Nr.9090, datë 26.06.2003, “*Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve*”, në të cilin është përfshirë ndërmjetësimi si alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tregtare.

¹⁹⁰Kanuni i Lekë Dukagjinit “*NYE I NJIQINDETRIDHETEPESËT*” §.895, §.939, §.965,.

¹⁹¹GREEN PAPER,(2002),on alternative dispute resolution in civil and commercial law, presented by the Commission, Brussels.

Ligji i parë është ligji 8465, dt. 11.03.1999, “Për Ndërmjetësimin për Zgjidhjen me Pajtim të Mosmarrëveshjeve”. Sipas këtij ligji, ndërmjetësimi ishte një veprimtari, e cila organizohej nga organizata joqeveritare¹⁹² (jo fitim-prurësve sot), të cilat kishin të drejtë ta ushtronin këtë veprimtari, pasi të jepej aprovimi i Ministrit të Drejtësisë dhe, më pas, ato regjistronin ndërmjetësit e tyre në gjykatë¹⁹³. Këto organizata joqeveritare kishin të drejtë të përcaktonin se kush do të ushtronte apo jo, këtë profesion, në bazë të disa kriterëve ligjore e subjektive¹⁹⁴. Sipas këtij ligji, marrëveshja e ndërmjetësimit, nuk kishte fuqinë një titulli ekzekutiv, ajo ishte një marrëveshje, e cila kishte për mendimin tim, qëllimin për shuarjen e konfliktit, duke mos i kushtuar rëndësi të madhe formës së saj¹⁹⁵. Shpenzimet e palëve në një proces ndërmjetësimi, sipas ligjit 8465, dt. 11.03.1999, “Për Ndërmjetësimin për Zgjidhjen me Pajtim të Mosmarrëveshjeve” ishin shpenzime, të cilat mbuloreshin nga buxheti i shtetit, dhe për mendimin tim, kjo është një nga arsyet përse nuk pati iniciativa mjaftueshmërisht të mëdha për ta bërë ndërmjetësimin pjesë të sistemit tonë të drejtësisë.

Ligji i dytë, me të cilin u tentua të bëhej i mundur implementimi i Ndërmjetësimit ishte ligji 9090, dt. 26.06.2003, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” Sipas këtij ligji, në nenin 4 paragrafi 4 parashikohet se: *“Ndërmjetësuesit, që e ushtrojnë këtë veprimtari si profesion, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të shpërblehen për punën, si dhe për shpenzimet e kryera në procedurën e ndërmjetësimit, sipas marrëveshjes për ndërmjetësim, të nënshkruar me palët”*¹⁹⁶. Pra, vërejmë se risia e ligjit për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, të vitit 2003, është se shteti ka hequr dorë nga mbulimi i shpenzimeve të procedurave të ndërmjetësimit. Ai e ka kthyer në një farë mënyre, tanimë, këtë profesion, në një profesion të lirë, i cili nuk ka më asnjë varësi nga shteti sa i përket anës ekonomike. Në këtë ligj përcaktohet se marrëveshja e ndërmjetësimit ka vlerën e titullit ekzekutiv, kjo del nga përmbajtja e nenit 14 të ligjit, i cili parashikon se : *“Nëse palët bien dakord për zgjidhjen e pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre dhe, së bashku me ndërmjetësuesit ose grupin e ndërmjetësuesve, nënshkruajnë*

¹⁹²Neni 8 i ligjit 8465, dt. 11.03.1999, “Për Ndërmjetësimin për Zgjidhjen me Pajtim të Mosmarrëveshjeve”

¹⁹³Po Aty. Neni 9.

¹⁹⁴Po Aty. Neni 15 dhe 16.

¹⁹⁵Neni 18 i ligjit 8465, dt. 11.03.1999, “Për Ndërmjetësimin për Zgjidhjen me Pajtim të Mosmarrëveshjeve”

¹⁹⁶Neni 4 i ligjit 9090, dt. 26.06.2003, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

*marrëveshjen përkatëse, në kuptim dhe zbatim të kushteve, rasteve dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj, kjo marrëveshje është e detyrueshme dhe e ekzekutueshme në të njëjtën shkallë me vendimet e arbitrazhit*¹⁹⁷, si dhe neni 16/2 “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, ku parashikohen detyrime në të holla, dorëzim sendesh ose kryerja e shërbimeve të vlerësueshme e të dokumentuara me shkrim, mund të kundërshtohet brenda 10 ditëve nga palët, pjesëmarrësit e tjerë në proces, personat e interesuar ose organi përkatës. Në të kundërt aktmarrëveshja përbën titull ekzekutiv në mbështetje të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe ngarkohet Zyra e Përmbarimit për ekzekutimin e tij”. Pra, duke barasvleftësuar marrëveshjen e ndërmjetësimit me vendimin e arbitrazhit, i është dhënë kësaj marrëveshjeje, fuqia e titullit ekzekutiv. Njëkohësisht, palëve u është njohur një afat 10 ditor, për të kundërshtuar këtë zgjidhje, pavarësisht faktit se janë vetë pjesëmarrës në të. Zgjidhja, sipas këtij ligji, shihet si zgjidhje e konfliktit, por edhe si kursim i kohës, njëkohësisht. Dalim në këtë konkluzion, edhe duke vërejtur nenin 16 të tij, i cili parashikon se: “1. Gjykata ose arbitrazhi nuk fillon ose pezullon vazhdimin e procedurave përkatëse, në rast se palët në një mosmarrëveshje, subjekt gjykimi, kanë rënë dakord paraprakisht, që të përdorin ndërmjetësimin për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje dhe, shprehimisht, kanë marrë përsipër që brenda një afati të caktuar ose deri në vërtetimin e një rrethane të caktuar, të mos kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga gjykata ose arbitrazhi.”. Në këtë mënyrë, me ligjin e ri për ndërmjetësimin, ky profesion filloi dhe po merrte formën për të cilën ai në të vërtetë ishte krijuar, të zgjidhë konflikte e të rregullojë marrëdhënie, të kursejë kohë dhe të kursejë para.

Ligji i tretë për ndërmjetësimin është ligji 10385, 24.02.2011, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, ligj, i cili është edhe sot në fuqi. Me anë të këtij ligji, u perfeksionua edhe më tepër ndërmjetësimi në Republikën e Shqipërisë. Në këtë ligj u vazhdua me frymën e ligjit të mëparshëm. Marrëveshjes së ndërmjetësit iu dha fuqia e plotë e titullit ekzekutiv, duke mos e kushtëzuar atë me afatin 10 ditor, në momentin që marrëveshja merr formën e titullit ekzekutiv apo duke mos e krahasuar atë me arbitrazhin. Kjo marrëveshje përbën titull ekzekutiv qysh në momentin e nënshkrimit të saj. Palët menjëherë janë të detyruara ta zbatojnë atë vullnetarisht, në të kundërt për

¹⁹⁷Neni 14, 16/2, 16/4 i ligji 9090, dt. 26.06.2003, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

këtë marrëveshje kërkohet lëshimi i urdhrat të ekzekutimit. Në këtë ligj, parimet mbi të cilat funksionon Ndërmjetësimi u konsoliduan dhe formëzimi i këtij profesioni u rregullua menjëherë edhe me dy Vendime të Këshillit të Ministrave, të cilët rregulluan mënyrën se si do të funksiononte një nga organet kryesore, që është “Komisioni i Licencimit”, si do të licencoheshin ndërmjetësit dhe për cilat arsye do t’u hiqej atyre licenca. Kësaj here, në ligjin për ndërmjetësimin parashikohet një mënyrë e organizimit, sipas strukturave të ngritura në formën e “Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve”. Në këtë strukturë bien në sy, dy organe kryesore, që janë: Mbledhja e përgjithshme dhe Kryesia.

Zgjidhja e konflikteve alternative, në përgjithësi, dhe ndërmjetësimi, në veçanti, kanë qenë në radarin e autoriteteve të BE-së, për një numër vitesh. Plani i Veprimit të Vjenës bëri në një farë mënyre thirrje, për "mundësinë e hartimit të modeleve për zgjidhjen jashtë-gjyqësore të mosmarrëveshjeve”, veçanërisht, me përmbajtje familjare. Në këtë kuptim, mundësia e ndërmjetësimit, si një mjet për zgjidhjen e konflikteve familjare, duhet të merret në konsideratë. Ky fokusim i ngushtë i ndërmjetësimit në mosmarrëveshjet familjare, ka ardhur duke u zgjeruar, për të mbuluar edhe një pjesë të mirë të mosmarrëveshjeve civile dhe tregtare.

Nevojat bazë për krijimin e këtij ligji kanë ardhur pas miratimit të Direktivës 2008/52/EC, 21maj 2011, të Këshillit dhe Parlamentit Evropian, “Për aspekte të caktuara të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare”. Kjo direktivë, pasi hyri në fuqi më 13 qershor 2008, duhet të ishte e zbatueshme nga të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian, si edhe nga ata që u bënë pjesë e saj. Direktiva kishte për qëllim "lehtësimin dhe promovimin e qasjes në zgjidhjen miqësore apo alternative të mosmarrëveshjeve, duke inkurajuar përdorimin e ndërmjetësimit dhe duke siguruar një marrëdhënie të ekuilibruar, ndërmjet ndërmjetësimit dhe procesit gjyqësor¹⁹⁸.

Direktiva, në fakt, nuk bën fjalë vetëm për ndërmjetësim vullnetar, por neni 5 (2) e bën të qartë, se “Direktiva” nuk paragjykon legjislacionet e shteteve të ndryshme, të bëjnë të detyrueshëm ndërmjetësimin apo t’i nxisin palët ose t’i nënshtrojnë ato, ndaj sanksioneve në rast të mospërdorimit të ADR. Puna që po bëhet në Komitetin Evropian në këtë drejtim, padyshim, përfshin dimensione ndërkombëtare, pasi ajo përfshin edhe ato

¹⁹⁸ Steven Friel, Christian Toms, Brown Rudnick LLP, *The European Mediation Directive—Legal and Political Support for Alternative Dispute Resolution in Europe paper*, Bloomberg Law Reports pp.1.

shtete që konsiderojnë veten si subjekte potenciale për t'u bërë një ditë Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian. Program i ADR është, gjithashtu, në axhendën e një numri organizatash ndërqeveritare¹⁹⁹. Nisur nga sa më sipër, shteti shqiptar mori nismën për të bërë, për herë të tretë, ligjin për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve dhe e aprovoi atë, me ligjin 10385, dt.24.02.2011.

3.2.Karakteri i ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”

Nëse do të marrim në analizë, ligjin 10385, dt.24.02.2011, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” për të përcaktuar karakterin e tij, do të vërejmë se dispozitat e këtij ligji janë dispozita, të cilat rregullojnë marrëdhënie që kanë karakter privat dhe marrëdhënie, të cilat kanë karakter publik. Në këtë konkluzion dalim, pasi ligji për ndërmjetësimin, siç kemi thënë më sipër, mund të ndihmojë si në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, ashtu edhe atyre penale, sipas përcaktimeve dhe ndalesave të ligjit, duke u kufizuar vetëm në ato konflikte, për të cilat ligjvënësi nuk kërkon detyrimisht një zgjidhje gjyqësore²⁰⁰. Në ligjin për ndërmjetësimin, në nenin 19/2/a është shprehimisht e përcaktuar se “a) është e nevojshme për shkaqe të cenimit të interesave themelorë të shtetit dhe/apo interesit publik;”.

Ndërsa, në nenin 24/2 është përcaktuar se “2. Gjykata, përveç rasteve të parashikuara në Kodin Civil për pavlefshmërinë e veprimeve juridike, mund ta konstatojë marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim të pavlefshme edhe kur arrin në përfundimin se ajo nuk respekton rendin publik në Republikën e Shqipërisë”. Pra vërejmë se interesi publik është një parim, i cili nuk mund të superohet nga ky ligj, sikurse nga çdo dispozitë e ligjeve të tjera. Por, mendoj se arsyeja përse në dispozita të këtij ligji është përcaktuar shprehimisht një gjë e tillë, është parimi i efikasitetit që ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i japë normave të këtij ligji. Në nenin 19 ka parashikuar kufizimin e konfidencialitetit, për shkak të ruajtjes së këtij parimi dhe në nenin 24 ka parashikuar një element të ri të kushteve të pavlefshmërisë së veprimit juridik. Megjithatë, konkluzioni në të cilin dalim nga ky përshkrim i mësipërm është se ligjvënësi, në thelb, si në çdo ligj tjetër ka pasur

¹⁹⁹ Po aty, pp.3.

²⁰⁰Neni 2 pika 6 iligjit 10385 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” ‘6. Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim’.

parasysh parimin e garantimit të rendit publik, si një detyrë e marr që në mandatimin e tij²⁰¹.

Për të arritur në konkluzionin, nëse në thelb, ligji për ndërmjetësimin i shërben më shumë të drejtës publike apo asaj private, duhet të marrim në analizë dispozitat e këtij ligji për të përcaktuar funksionin e tyre. Vetëm në këtë mënyrë do të arrijmë në një konkluzion të vërtetë përse i përket karakterit të fushës së të drejtës, që përfaqëson ligji për ndërmjetësimin.

Nëse do të vërejmë me vëmendje, ligji 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” është një ligj, i cili në përmbajtje të tij ka disa lloj dispozitash. Dispozita të cilat kanë funksione të ndryshme, dispozita me funksion material, dispozita me funksion procedural dhe dispozita me funksion referues. Le t’i marrim në analizë secilën prej tyre.

Me dispozita materiale do të kuptojmë të gjitha ato dispozita, të cilat rregullojnë marrëdhënie apo një veprim juridik faktik, pra të përcaktuar. Këtë, ligji material e bën duke treguar faktin dhe mënyrën se si e rregullon këtë fakt, duke ngarkuar subjektin e posaçëm të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar, ndonjëherë, duke përcaktuar edhe anën formale të këtij veprimi. Dispozita materiale përbëhet nga “Vëllimi” – pjesa që tregon faktet dhe rrethanat, të cilat i nënshtrohen rregullimit të dispozitës përkatëse, ndërsa pjesa “rregulluese” është ajo pjesë, e cila tregon se, nëse ekzistojnë rrethana apo fakte të përcaktuara në pjesën e vëllimit, çfarë detyrimi përcakton ligji për këtë situatë faktike. Në këtë mënyrë, ajo urdhëron kryerjen e një veprimi të caktuar. Materialiteti është një term ligjor që mund të ketë kuptime të ndryshme, në varësi të kontekstit. Kur flasim për fakte, termi zakonisht do të thotë një fakt që është “i rëndësishëm” për çështjen ose çështje konkrete. Nëse do të marrim një shembull konkret: *“Me përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi njofton me shkrim, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, gjykatën ose arbitrazhin, me qëllim fillimin e procedurave të pezulluara për efekt të*

²⁰¹ Rregullorja e Kuvendit të Republikës, “Betohem me nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën si deputet i popullit në Kuvend. Do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve, do të mbroj lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, do të respektoj dhe do të mbroj të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe do të përpiqem me të gjitha fuqitë e mia për përparimin e Atdheut dhe mirëqenien e popullit tim.” neni 4/2 Betimi i deputetëve.

ndërmjetësimit”. Shikojmë në këtë dispozitë, se fakti që rregullohet është çka duhet të ndodhë pas përfundimit të procedurës së ndërmjetësimit. Dhe, nëse Ndërmjetësi konstaton se procedura e ndërmjetësimit ka përfunduar, me një marrëveshje apo jo ndërmjet palëve, ai ngarkohet me detyrim ligjor për të kryer një veprim të caktuar në një formë të caktuar, që në rastin konkret është të njoftojë me shkrim, organin që ia ka referuar çështjen, në rastin konkret, Gjykatën e juridiksionit normal apo atë të arbitrazhit.

Me dispozita procedurale do të kuptojmë të gjitha ato dispozita të përfshira në legjislacionin në fuqi, që rregullojnë fushën e ndërmjetësit në Republikën e Shqipërisë, të cilat caktojnë rregullat me anë të të cilave përcaktohet mënyra e veprimit si dhe ndërmarrja e veprimeve nga ana e Ndërmjetësve, palëve pjesëmarrëse në proces dhe organeve shtetërore, në rastin e zbatimit të dispozitave për raste konkrete, p.sh.: gjatë vendosjes mbi referimin e një çështjeje në ndërmjetësim apo gjatë ligjërimit të një marrëveshjeje etj. Aplikimi i dispozitave procedurale në fushën e ndërmjetësimit nënkupton një tërësi rregullash, me të cilat rregullohet procedimi (veprimi) i të gjithë operatorëve të ndërmjetësimit²⁰².

Megjithëse kemi folur pak më sipër për lirshmërinë e procesit të ndërmjetësimit dhe ekzistencën e tij si një proces, i cili karakterizohet nga mungesa e procedurave, duhet të theksojmë se kur flasim për dispozita procedurale nuk duhet të kuptojmë dispozita, të cilat rregullojnë procedurën e ndërmjetësimit gjatë procesit të ndërmjetësimit. Dispozitat procedurale në ligjin për ndërmjetësimin janë ato dispozita, të cilat rregullojnë veprimet e operatorëve të procesit të ndërmjetësimit, me përjashtim të palëve në konflikt, për t'i ardhur në funksion, pikërisht qëllimit kryesor të ligjit, ekzistencën e një procesi pa procedura për palët në konflikt. Pra, me anë të këtyre dispozitave, përcaktohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e atyre, që në fakt bëjnë lehtësimin e procesit.

Dispozitat Referuese, në rastin e ligjit për ndërmjetësimin, do t'i gjejmë në disa raste. P.sh. në rastet e parashikuara në dispozitat që bëjnë fjalë për çështjet, të cilat mund të zgjidhen me anë të ndërmjetësimit. Në nenin 13 të ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” përcaktohen procedurat për ndërmjetësimin në procesin civil. Në këtë dispozitë parashikohet se: “1. Gjykata, në përputhje me nenet 4, 25, 158/a,

²⁰² Me operatorë të ndërmjetësimit do të kuptojmë të gjithë subjektet që janë apo mund të jenë të përfshirë në çdo hallkë të procesit të ndërmjetësimit.

158/b dhe 297 të Kodit të Procedurës Civile, fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, parashikuar në nenin 2 pika 2 të këtij ligji dhe, kur palët bien dakord, pezullon gjykimin duke u caktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes. 2. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë rifillimin e gjykimit.”²⁰³. Pra, shohim se ligji për Ndërmjetësimin, në rastin konkret, referon në këto dispozita për të përcaktuar, se cilat janë veprimet që duhet të kryejë gjykata në rastin e referimit të çështjes civile për ndërmjetësim.

Ndërsa në nenin 14 parashikon procedurat për ndërmjetësim në procesin penal, duke urdhëruar “1. Gjykata, në përputhje me nenet 333 dhe 338 të Kodit të Procedurës Penale, fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, parashikuar në nenin 2 pika 3 të këtij ligji, duke iu caktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes”²⁰⁴”.

Në këtë dispozitë, gjithashtu, ligji referon në dy dispozita: e para është, duke përcaktuar ligjërimin e vendimit të referimit të çështjes për ndërmjetësim, në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të cilat përcaktojnë veprimet përgatitore dhe ato të pajtimit, ndërsa, referimi i dytë na çon në një dispozitë, e cila përsëri është referuese. Kjo, pasi neni 2 pika 3 e ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” përcakton se cilat mosmarrëveshje, që përbëjnë vepër penale, mund të zgjidhen me ndërmjetësim, çka janë veprat penale të parashikuara nga neni 59 (i dëmtuari akuzues) e neni 284(veprat penale që ndiqen mbi ankim) të Kodit të Procedurës Penale.

Ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshje me anë të një personi të tretë asnjans (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes, e cila nuk bie në kundërshtim me ligjin. Ndërmjetësimi, në thelb, është negociim që përfshinë një palë të tretë, e cila është njohur me procedurën efektive të negociimit dhe mund të ndihmojë personat në konflikt, që të koordinojnë aktivitet e tyre dhe të jenë më efektiv në marrëveshjet e tyre²⁰⁵. Me qëllimin e vlerësimit të plotë të ndërmjetësimin, si metodë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, është e nevojshme të kuptohet qartë karakteri publik apo privat i ligjit,

²⁰³Neni 13 i ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

²⁰⁴Po aty, neni 14.

²⁰⁵ Manual trajnimi, Maj 2014, *Ligji për ndërmjetësimin*, USAID ,fq. 9.

“Për Ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”. Deri tani nuk kemi një qasje të qartë dhe të pranuar nga të gjithë, në lidhje me karakterin privat apo publik të këtij ligji.

Për të analizuar karakterin publik apo privat, të ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, më parë duhet të bëjmë dallimin midis të drejtës publike dhe të drejtës private. Ndarja e së drejtës, në të drejtë publike dhe në të drejtë private, është bërë për herë të parë nga juristi romak Domicius Ulpian (170-228), i cili në të drejtën publike përfshinte normat që mbronin interesat e shtetit, kurse në të drejtën private përfshiheshin normat që mbronin interesat e personave privatë²⁰⁶. Jurisprudenca e mëvonshme e ka pranuar gjerësisht ndarjen në të drejtë publike dhe private. E drejta publike mund të përkufizohet si tërësia e normave juridike, që kanë të bëjnë me statusin (pozitën) e shtetit dhe të qeveritarëve, si dhe e normave që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet qeveritarëve dhe shtetasve. Norma publike janë norma të përgjithshme, që i drejtohen një numri të pacaktuar personash dhe që formulohen në bazë të një interesi publik. Ato janë norma me një forcë detyruese ndaj shtetasve, të cilëve nuk u kërkohet pëlqimi për zbatimin e tyre, ndryshe nga normat private të cilat pjesërisht janë lejuese.

Zakonisht, subjektet e së drejtës mendojnë se mënyra më e mirë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tyre është përmes procedurës formale gjyqësore. Shteti, nëpërmjet përdorimit të forcës së tij, vë në dispozicion gjykatat, të cilat aplikojnë procedurat e përcaktuara me ligj për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve. Në këtë aspekt, del qartë karakteri publik që kanë gjykatat. Gjithashtu, ligji “Për ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” merr karakterin publik në momentin, kur, ky ligj miratohet dhe hynë në fuqi nga institucionet shtetërore, por, veprimtaria që ai kryen është private. Ndryshe nga gjykatat, të cilat organizohen dhe administrohen nga shteti, ligji 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” organizohen dhe administrohen nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit. Neni 7 pika 1 e ligjit 10385, përcakton se: “*Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit është person juridik, që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti*”. Ndërsa, në nenin 1 pika 2 të ligjit 10385, përcaktohet se: “*Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve është veprimtari e pavarur, që ushtrohet në përputhje me këtë ligj dhe nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë*”²⁰⁷.

²⁰⁶ Luan Omari, (2007) “*Parime dhe institucione të së drejtës publike*”, Botim i trembëdhjetë, Tiranë, fq 3.

²⁰⁷ Neni 1 pika 2 e ligjit “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

Vërejmë që në dukje, këto 2 dispozita kanë një përplasje ndërmjet tyre, por, në fakt, po t'i analizojmë ato me vëmendje do të kuptojmë dallimin. Parashikimi i nenit 1 pika 2 është një parashikim i cili, rregullon funksionin përfundimtar të ndërmjetësimit, funksion që i shërben zgjidhjes së mosmarrëveshjes, ku ligji ka vërejtur me vend se nuk mund të jetë një funksion i pa kontrolluar. Në vijimësi të kësaj dispozite, kanë dalë edhe VKM.414, për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, si dhe VKM. 418, për Procedurën e heqjes së licencës së ndërmjetësve. Në këto dy Vendime të Këshillit të Ministrave, përcaktohet qartë roli i shtetit, duke përcaktuar një shumicë të përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, në Komisionin e Licencimit të Ndërmjetësve. Në këtë mënyrë, mund të themi se, ndërmjetësimi është një profesion i lirë, i organizuar në mënyrë të pavarur nga shteti, por duke pasur parasysh funksionin ngushtësisht publik që ka (zgjidhja e mosmarrëveshjeve), ndërmjetësimi e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, në mënyrë të pavarur, duke respektuar rregullat e parashikuara në ligj dhe në statutin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve²⁰⁸. Ky parashikim, në fakt, është një garanci shtesë për të gjitha subjektet e së drejtës, që e aplikojnë ndërmjetësimin si një zgjidhje alternative.

Ligji 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” ka karakter ngushtësisht privat, sepse në këtë ligj veprojnë normat private lejuese, që do të thotë se janë palët në konflikt të cilat zgjedhin, nëse duan ta zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre nëpërmjet një ndërmjetësi apo jo. Në këtë ligj nuk kemi të bëjmë me forcën shtrënguese të shtetit, por me një veprimtari të lirë, të cilën palët mund ta ushtrojnë ose jo, kjo varet nga vullneti i lirë i palëve, nëse duan ta zgjidhin konfliktin midis tyre me ndërmjetës apo t'i nënshtrohen procedurave formale gjyqësore. Në nenin 2 pika 1 parashikohet se: *“Ndërmjetësimi , sipas këtij ligji, zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara nga pikat 2 dhe 3 të këtij neni, në çdo kohë që palët në konflikt, më vullnetin e tyre të lirë, kërkojnë dhe pranojnë ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes...”*, në këtë paragraf shprehet qartë se ndërmjetësimi nuk është një detyrim ligjor, por është një zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve midis palëve për të ulur koston ekonomike ose zgjidhjen e mosmarrëveshjes në një kohë relativisht të shkurtër.

²⁰⁸Po aty, neni 8.

Ndërmjetësi e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë të paanshme, me ndershmëri dhe profesionalizëm, duke përdorur të gjitha mjetet e ligjshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Qëllimi kryesor i ndërmjetësit është pajtimi i palëve dhe arritja e një marrëveshje të caktuar, të pranuar nga të dyja palët. Pozicioni i tij është i një personi të tretë, neutral dhe i paanshëm. Natyrisht që është dhe gjyqtari, por ky i fundit është i detyruar të aplikojë normën juridike, shprehje e arritjes së një ekuilibri politik, ndërsa ndërmjetësi thirret mbi të gjitha për të arritur një rezultat praktik, pa asnjë garanci ndaj palëve të interesuara, të ndryshme nga deontologjia e tij profesionale²⁰⁹.

Ligji 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, parashikon në nenin 15 pika 1, se: *“Palët, në përputhje me këtë ligj, janë të lira të vendosin rregullat dhe mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit”*, duke i lënë hapësirë palëve të vendosin në lidhje me normat juridike, të cilat do të ndiqen gjatë procesit të ndërmjetësimit. Kjo thekson karakterin privat të ligjit, pasi normat e së drejtës në këtë proces janë plotësuese dhe jo të detyrueshme për t’u zbatuar, ndryshe nga normat publike, të cilat kanë detyrimin ligjor për t’u zbatuar me përpikëri. Subjektet private mund t’i anashkalojnë normat juridike për zgjidhjen e konfliktit, vetëm kur marrëveshja e arritur nuk bie në kundërshtim me ligjin.

Karakterin privat i ligjit vërehet dhe në nenin 9 pika 1, ku shprehet se: *“Ndërmjetësit, që e ushtrojnë këtë veprimtari si profesion, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të shpërblehen për punën, si dhe për shpenzimet e kryera në procedurën e ndërmjetësimit, sipas marrëveshjes për ndërmjetësim, të nënshkruar me palët”*. Shërbimi që ndërmjetësit ofrojnë është një marrëveshje private midis ndërmjetësit dhe palëve, duke mos ndërhyrë në asnjë çast shteti. Ky shpërblim është si meritë e punës që kryen ndërmjetësi, shuma e të cilës vendoset me një marrëveshje të përbashkët nga palët dhe ndërmjetësi. Ndryshe do të ndodhte, nëse kjo dispozitë do të kishte karakter publik. Shpërblimi i ndërmjetësit për punën e kryer nuk do të vendosej me marrëveshje, por do të ishte një detyrim ligjor i përcaktuar rreptësisht nga shteti.

²⁰⁹Çerekja, B. (2013). “Ndërmjetësimi në veprat penale të të miturve”, Disertacion. Për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor i Shkencave”.

Si përfundim, duke marrë në analizë të gjitha sa thamë më sipër, arrijmë në konkluzionin se duhet të bëjmë një ndarje sa i përket funksionit të ligjit dhe karakterit të tij. Në rastin konkret, në ligjin për ndërmjetësimin, kemi të bëjmë me një ligj, i cili ka funksion publik, dhe këtë e parashikon vetë objekti i ligjit, që është “zgjidhja e mosmarrëveshjeve”, gjithashtu, mbrojtja që ka parashikuar ligji në nenin 1 pika 2 të tij, si dhe në VKM-të e dala në zbatim të tij, duke garantuar subjektet e së drejtës që do të aplikojnë këtë ligj, se për asnjë qëllim, aplikuesit e këtij ligji (Ndërmjetësit) nuk do të devijojnë nga ky qëllim. Ndërsa nga ana tjetër, konfliktet që ligji për ndërmjetësimin zgjidh, janë konflikte me karakter tërësisht privat, dhe ky ligj ka lindur pikërisht për t’i shërbyer këtij qëllimi.

Rrjedhimisht, ligji 10385/2011, Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret për t’u kualifikuar si një ligj me karakter tërësisht privat, duke plotësuar, gjithashtu, të gjitha kushtet dhe kriteret që ligjbërja ka parasysh kur zhvillon ligje të reja, që është funksioni publik i ligjit.

3.2.1. Licencimi i ndërmjetësit

Në kreun e dytë të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011²¹⁰, na rezulton se ndërmjetësi e ushtron veprimtarinë e tij si person fizik ose juridik, nëpërmjet zyrës ose qendrës së tij dhe këtë e bën, pasi është licencuar dhe regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve. Gjë e cila realizohet me anë të KLN-së, i cili ngrihet pranë Ministrisë së Drejtësisë. Komision, i cili funksionon si organ kolegjal vendimmarrës, pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe përbëhet nga pesë anëtarë (dy përfaqësues të DKN-s dhe tre përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë), të zgjedhur për një afat trevjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë²¹¹.

Me VKM nr.414, datë 8.6.2011, subjekti i cili dëshiron të pajiset me licencë për ushtrimin e funksionit të ndërmjetësit, paraqet kërkesën pranë komisionit, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në këtë VKM²¹².

²¹⁰ Kreu II-Licencimi dhe ushtrimi i veprimtarisë.

²¹¹ VKM Nr.414, datë 8.6.2011, “Vendimi për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Komisionit të licencimit të ndërmjetësimit të ndërmjetësve”.

²¹² VKM nr.414, datë 8.6.2011, kapitulli III - “Kushtet dhe dokumentacioni për pajisjen me licencë”.

Regjistri i Ndërmjetësve përmban informacionet e duhura mbi subjektin, i cili ushtron ndërmjetësimin si profesion dhe që është kusht për licencim. Në rastin e personave fizikë, ai duhet të përmbajë identitetin, vendbanimin, numrin e licencës, datën e fillimit të veprimtarisë së ndërmjetësit dhe adresën e vendit ku zhvillohet veprimtaria e ndërmjetësit; ndërsa në rastin e personave juridikë emërtimin, llojin dhe selinë e shoqërisë, emrin/emrat e administratorëve dhe emrat e ndërmjetësve të punësuar në shoqëri.

3.2.2. Heqja e licencës së ndërmjetësit

Ashtu siç janë përcaktuar kriteret, që një subjekt duhet të përmbushë për të ushtruar profesionin e ndërmjetësit, kemi edhe rastet dhe procedurën e heqjes së licencës së ndërmjetësit. Këtë e gjejmë në VKM nr.418, datë 8.6.2011, i cili përcakton se ndërmjetësit i hiqet licenca dhe bëhet çregjistrimi i tij nga regjistri, në rastet kur: ai e kërkon vetë një gjë të tillë, humbet apo i kufizohet zotësia për të vepruar, dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje, vërtetohet shkelja e dispozitave urdhëruese dhe ndaluese të ligjit nr. 10385, për shkelje të rënda të normave të Kodit të Etikës, si dhe në çdo rast tjetër, kur parashikohet shprehimisht në ligj²¹³.

Kjo procedurë e heqjes së licencës, e cila fillon me kërkesën e subjektit të interesuar ose kryesisht nga KLN, duhet bërë brenda gjashtë muajve nga kryerja e shkeljes, por jo më vonë se tre vjet. Kur procedimi për heqjen e licencës fillon me kërkesë të subjektit të interesuar, kërkesa duhet paraqitur pranë sekretarit të Komisionit dhe duhet të jetë e hartuar me shkrim dhe të përmbajë identifikimin e ndërmjetësit, veprimet konkrete si dhe duhen bashkangjitur aktet e tjera të cilat janë të nevojshme²¹⁴.

Ndërkohë që ka filluar procedimi i heqjes së licencës, ndërmjetësi ka të drejtë që të informohet rreth arsyeve të shkeljes që pretendohen, mund të formulojë pretendimet dhe kërkesat, të njihet me materialin e procedimit, si dhe të depozitojë prova të mjaftueshme, mund të asistohet nga një avokat ose një koleg, jo më vonë se dy javë, mund të kërkojë dhe të paraqesë të gjitha faktet që disponon, në mbrojtje të tij²¹⁵.

²¹³ Pika 1, VKM nr.418, datë 08.06.2011, "Vendim për procedurën e heqjes së licencës së ndërmjetësit".

²¹⁴ Po aty, Pika 2.

²¹⁵ Po aty, Pika 3.

Komisioni, në rast se vërtetohet një prej rasteve të parashikuara në piken nr. 1 të VKM-së, për procedurën e heqjes së licencës së ndërmjetësit, vendos heqjen e saj. Vendim i cili, duhet të përmbajë organin që e ka marrë këtë vendim, identifikimin dhe të dhënat e licencës së atij, të cilit i hiqet licenca (ndërmjetësit), shkeljet faktike, bazën ligjore, rrethanat e çështjes siç janë konstatuar gjatë procedimit, përfundimet e nxjerra nga Komisioni, arsyet dhe provat mbi të cilat mbështetet vendimi, si dhe të drejtën e ankimit, afatin për paraqitjen e tij dhe organi përgjegjës për zgjidhjen e tij. Kundër këtij vendimi të Komisionit, kërkuesit kanë të drejtën që të paraqesin ankim pranë Ministrit të Drejtësisë dhe kundër vendimit të këtij të fundit mund të bëhet ankim në gjykatë²¹⁶.

Pas heqjes së licencës së ushtrimit të profesionit, Komisioni i paraqet strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, për administrimin e Regjistrit të Ndërmjetësve, vendimin për heqjen e licencës, me qëllim bërjen e shënimit përkatës në regjistrë, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, i cili mbahet nga Qendra Kombëtare e Licencimit²¹⁷.

4. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve dhe Dhoma e Ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi është një profesion i lirë dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, i cili është një institucion publik i pavarur, përbën organin e tij drejtues. Dhoma e Ndërmjetësve ka përgjegjësinë e miratimit të rregullave që udhëheqin shërbimin e ndërmjetësimit, si dhe të Kodit të Etikës së Ndërmjetësve. Gjithashtu, ajo ushtron funksione mbikëqyrës, siguron trajnimin e ndërmjetësve dhe informimin e publikut.²¹⁸

Në nenin 7 të ligjit 10385, për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve parashikohet:

DKN-ja është një person juridik, e cila e ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti, dhe organet drejtuese të saj janë mbledhja e përgjithshme e ndërmjetësve dhe kryesia, ka për kompetencë rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit, miraton aktet që rregullojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit, si profesion, si

²¹⁶ Ku paraqitja dhe shqyrtimi i tyre bëhen sipas rregullave dhe afateve të parashikuara në ligjin për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

²¹⁷ Pika 7, VKM nr.418, datë 08.06.2011, "Vendimi për procedurën e heqjes së licencës së ndërmjetësit".

²¹⁸ Ligji Nr. 10385, datë 24.2.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".

*dhe Kodin e Etikës së Ndërmjetësit, miraton statutin e saj, ku përcaktohen edhe rregullat e hollësishme për mënyrën e organizimit e të funksionimit të DKN-së, merr masat për themelimin e dhomave vendore të ndërmjetësit, përcakton rregullat për tarifën e shpërblimit, për punën e ndërmjetësit dhe shpenzimet e kryera, si rezultat i veprimtarisë së ndërmjetësit, harton dhe siguron pjesëmarrjen në program trajnimi të ndërmjetësve, përcakton në statut detyrat dhe funksionet e organeve drejtuese të saj, kujdeset për informimin e nevojshëm të publikut për veprimtarinë e ndërmjetësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe për mundësitë e kontaktimit të ndërmjetësve*²¹⁹.

Për realizimin e veprimtarisë së saj dhe në kuadër të cilësisë dhe efektivitetit të procesit të ndërmjetësit, DKN-ja mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Shërbimin e Provës, Shkollën e Magjistraturës, OJF dhe organe të tjera të sistemit të drejtësisë, gjithashtu, një numër minimal i ndërmjetësuesve mund të formojnë një dhomë ndërmjetësimi²²⁰, ku çdo dhomë ndërmjetësimi, ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur, duke respektuar rregullat e parashikuara në ligj dhe në statutin e vendimet e tjera, të miratuara nga DKN-ja.

Dispozita e sipërcituar bën përcaktimet bazë, në të cilat, institucioni që organizon ndërmjetësit, pra, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve funksionon, ushtron kompetencat dhe/apo funksionet e saj, si dhe mënyra e organizimit të brendshëm dhe të jashtëm të këtij institucioni. Referuar përcaktimeve ligjore, organet që përfaqësojnë në marrëdhënie me të tretë Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve janë Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve dhe Kryesia e saj²²¹.

Por, siç shihet, në këtë dispozitë nuk përcaktohet qartë se cila është ndarja e saktë e kompetencave ndërmjet Kryesisë dhe Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve. Kjo gjë është zgjidhur në statutin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

Nëse vërejmë nëpikën 3/c të nenit 7 përcaktohet se: Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve 3/c: *“miraton statutin e saj, ku përcaktohen edhe rregullat e hollësishme për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve”*; Në

²¹⁹Po aty, Neni 7.

²²⁰Numri minimal duhet caktuar në statutin e dhomës Kombëtare të Ndërmjetësit .

²²¹ Neni 7, pika 2, i ligjit nr. 10385 , *“Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”*, *“Organet drejtuese të saj janë mbledhja e përgjithshme e ndërmjetësve dhe kryesia ”*.

referim të kësaj dispozite, dhoma kombëtare e ndërmjetësve, më dt.07.07.2013, ka aprovuar statutin e saj të parë. Në këtë statut bëhen edhe përcaktimet e përmendura më sipër, sa i përket ndarjes së të gjithave kompetencave të përcaktuara në nenin 7, të ligjit 10385/2011, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, madje, duke përcaktuar një organizim akoma më të detajuar, përcaktim, i cili ka çuar në shtimin e disa organeve administrative të Dhomës, që ligji nuk i parashikon.

Në nenin 7 të statudit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve është parashikuar se:

Organet e DhKN-së janë:

- a) *Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve;*
- b) *Kryesia;*
- c) *Kryetari.*

Siç shohim pra, në këtë dispozitë statutore është shtuar mbi parashikimet ligjore, edhe organi i “Kryetarit”. Do të shohim më poshtë, se është edhe një organ tjetër statutor që është “Sekretari i Përgjithshëm” parashikuar në nenin 20 të Statutit.

Të marrim me radhë organet që përfaqësojnë Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, duke analizuar funksionet e gjithsecilit, si dhe përputhshmërinë e funksioneve të tyre me përcaktimet ligjore.

4.1. Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve.

Në Nenet 8, 9, 10 dhe 11 të statudit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve parashikohen të gjitha funksionet dhe kompetencat e “*Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve*”. Në nenin 8 parashikohet shprehimisht, se “*Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve është organi më i lartë vendimmarrës i DhKN-së. Ajo përbëhet nga tërësia e anëtarëve të DhKN-së*”. Nisur nga ky parashikim, siç do të analizojmë edhe më poshtë, nuk ka se si të funksionojë ndryshe. Normalisht që njëri nga dy organet e parashikuara në ligjin 10385/2011, Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, duhet të ketë epërsi mbi tjetrin. Dalim në konkluzionin se Mbledhja e Përgjithshme ka epërsi edhe për faktin, se mbledhja e përgjithshme e ndërmjetësve nuk është një organ me anëtarë të zgjedhur për ta drejtuar atë. Ajo është e përbërë nga tërësia e ndërmjetësve. Për të qenë ndërmjetës, ligji parashikon në nenin 4 se: “*1. Ndërmjetësi e ushtron veprimtarinë, si person fizik ose juridik, nëpërmjet zyrës a qendrës së tij, pas licencimit dhe regjistrimit të*

tij në Regjistrin e Ndërmjetësve, sipas këtij ligji”. Pra kushte kryesore për të qenë anëtar i Dhomës Kombëtare janë dy. Së pari, të jetë licencuar pranë Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, dhe së dyti të jetë regjistruar në regjistrin e ndërmjetësve. Shohim se i vetmi organ, në fakt, ekzistent, përpara se të bëhej mbledhja e parë e përgjithshme e ndërmjetësve, ishte “Mbledhja e Përgjithshme” ose tërësia e ndërmjetësve. Rrjedhimisht, ky organ mban stafetën e organit më të lartë vendimmarrës, për sa kohë ai është organi i parë që ka ekzistuar, është i pavarur nga çdo organ tjetër i Dhomës, si dhe është organi që miraton fillimisht dhe ndryshon statutin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

Kompetencat e Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve, sipas nenit 9 të Statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve janë :

Neni 9- Kompetencat e Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve

- a. Miraton Statutin, Rregulloren dhe Kodin e Etikës të DhKN-së si dhe akte të tjera të saj;*
- b. Miraton politikat kryesore të veprimtarisë së DhKN-së;*
- c. Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Kryesisë dhe Kryetarin e DhKN-së;*
- d. Miraton të gjitha aktet e krijimit, organizimin dhe funksionimin e Dhomave Vendore të Ndërmjetësimit;*
- e. Shqyrton dhe miraton pasqyrat financiare, buxhetin dhe raportin vjetor të veprimtarisë së DhKN-së;*
- f. Miraton tarifën e anëtarësimit në DhKN; si dhe*
- g. Çdo kompetencë tjetër të parashikuar në akte të tjera ligjore, nënligjore dhe në Statut²²².*

Sa i përket pikës së parë, “*Miraton Statutin, Rregulloren dhe Kodin e Etikës të DhKN-së, si dhe akte të tjera të saj*”, Statuti i Dhomës Kombëtare është miratuar për herë të parë nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve e dt.07.07.2013, ku sëbashku me të është miratuar rregullorja e përkohshme e votimit, që kishte efekt vetëm për mbledhjen e asaj dite. Sa i përket Kodit të Etikës, Mbledhja e Përgjithshme nuk ka miratuar akoma një të tillë, por duhet të kemi parasysh se në referim të direktivës CELEX-32008L0052, pika

²²²Neni 9 i Statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve

17²²³, kjo direktivë këshillon të gjitha shtetet anëtare të saj, t'i referohen kësaj direktive, si dhe ta bëjnë atë publike për të interesuarit.

Referuar pikës b: “*Miraton politikat kryesore të veprimtarisë së DhKN-së*”; kemi parasysh se çdo veprimtari, e cila përbën veprimtari të politikave të ndërmjetësve, është veprimtari, e cila ndikon drejtpërdrejt në ushtrimin e veprimtarisë së zakonshme të ndërmjetësve. Rrjedhimisht, ky parashikim ka pasur si objektiv kryesor, garantimin e ushtrimit të profesionit të Ndërmjetësit në mënyrën e parashikuar nga ligji.

Në pikën c të kësaj dispozite parashikohet se: “*Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Kryesisë dhe Kryetarin e DhKN-së*”; Si organi më i lartë vendimmarrës, garantues i parimeve dhe garancive ligjore, që ligji parashikon për ndërmjetësit, Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve, zgjedh organin që e qeveris dhe e përfaqëson atë, si dhe, gjithashtu, ka të drejtën t'i tërheqë vërejtje, deri në shkarkimin e saj.

Mbledhja e Përgjithshme, si organi që shpreh vullnetin e të gjithë ndërmjetësve në Republikën e Shqipërisë, ka parashikuar në pikën d, se Mbledhja e Përgjithshme “*Miraton të gjitha aktet e krijimit, organizimin dhe funksionimin e Dhomave Vendore të Ndërmjetësimit*”; Kjo vjen edhe si rrjedhojë logjike e pikës b) të kësaj dispozite statutore, pasi miratimi i krijimit, organizimit dhe funksionimit të Dhomave Vendore të Ndërmjetësimit, përbën ushtrimin e vullnetit të drejtpërdrejtë për të bërë politikat kryesore të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve në Republikën e Shqipërisë.

Parashikimi i pikës e të kësaj dispozite, është ushtrimi drejtpërdrejtë i kompetencave të Mbledhjes së Përgjithshme mbi administrimin e të ardhurave të Dhomës Kombëtare. Në këtë dispozitë, parashikohet se: e) “*Shqyrton dhe miraton pasqyrat financiare, buxhetin dhe raportin vjetor të veprimtarisë të DhKN-së*”; pra shohim se duke bërë një përcaktim të tillë, statuti njeh dhe aprovon përcaktimin e ligjit, duke i dhënë

²²³Direktiva CELEX-32008L0052-En whereas 17” *Member States should define such mechanisms, which may include having recourse to market-based solutions, and should not be required to provide any funding in that respect. The mechanisms should aim at preserving the flexibility of the mediation process and the autonomy of the parties, and at ensuring that mediation is conducted in an effective, impartial and competent way. Mediators should be made aware of the existence of the European Code of Conduct for Mediators which should also be made available to the general public on the Internet*”.

epërsi funksioneve dhe kompetencave të Mbledhjes së Përgjithshme në raport me Kryesinë.

Në pikën f e g të kësaj dispozite parashikohet se: *f); Miraton tarifat e anëtarësimit në DhKN; si dhe g) Çdo kompetencë tjetër të parashikuar në akte të tjera ligjore, nënligjore dhe në Statut.* Duke qenë se tarifa e anëtarësimit është diçka që lidhet ngushtë me mundësinë e ushtrimit të profesionit, Statuti i ka njohur të drejtën organit më të lartë vendimmarrës për të përcaktuar një gjë të tillë. Në këtë mënyrë, garantohet parimi i lirisë së ushtrimit të këtij profesioni, pa qenë e mundur të kufizohet nga vendime të njëanshme, por, njëkohësisht, duke garantuar mbarëvajtjen e veprimtarisë profesionale të ndërmjetësve, me parashikimin e pikës g të kësaj dispozite.

4.1.1. Funksionimi i Mbledhjes së Përgjithshme

Siç do të shohim më poshtë, në nenin 10 të statutit, është parashikuar mënyra se si funksionon Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve.

Në nenin 10/1 të Statutit parashikohet se: *“Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve mbledhet të paktën një herë në vit”.* Një parashikim i tillë, është pasur parasysh nga grupi i punës që krijoi Statutin e Dhomës Kombëtare, për mos të krijuar ngërç në funksionimin e dhomës.

Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve, për të organizuar mbledhjet e saj në mënyrë të ligjshme, duhet të thirret nga Kryetari, ose 1/3 e anëtarëve të kryesisë, ose 1/4 e anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme. Në këtë dispozitë është thënë shprehimisht: *“Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve mbledhet me kërkesë të Kryetarit, 1/3-ës së anëtarëve të Kryesisë ose 1/4 së anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve. Thirrësi i Mbledhjes propozon rendin e ditës”.* Kur themi 1/4 e anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme, duhet të kemi parasysh që është 1/4 e të gjithë anëtarëve me të drejtë vote.

Më pas në këtë dispozitë statutore, parashikohet se: *“Çdo propozim për të shtuar çështje në rend dite duhet të miratohet nga të paktën 1/3-a e anëtarëve të pranishëm”.* Ky parashikim ka pasur parasysh se çështjet që diskutohen në rend dite, janë çështje të cilat prezumohet se ka një interes të ligjshëm, në rast se ky diskutim kërkohet nga më shumë se 1/3 e anëtarëve të pranishëm. Kjo shumice kaq e ulët, nuk vlen për aprovimin e këtyre

çështjeve më pas, pasi siç parashikohet në nenin 11/1 të Statutit, duhet 50%+1 vota për aprovimin e vendimeve të Mbledhjes së Përgjithshme²²⁴.

Në nenin 10/4 parashikohet se: *“Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithëanëtarëve të saj. Nëse nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm, Kryesia e Dhomës vendos brenda 30 ditëve për datën e mbledhjes së ardhshme”*. Ligji ka parashikuar se prania e më shumë se gjysmës së Ndërmjetësve me të drejta të plota, duhet të jenë të pranishëm në mënyrë që vendimet e mbledhjes të jenë të vlefshme, dhe arsyeja e logjika është e thjeshtë, përfaqësim i denjë për një vendim gjithëpërfshirës.

Gjithashtu parashikimi i detyrimit të kryesisë për mbledhjen e ardhshme, brenda një afati prej 30 ditësh është në përputhje me ligjin. Pavarësisht se mbledhjen mund ta ketë thirrur kryetari, apo 1/3 e kryesisë, apo ¼ e ndërmjetësve, kryesia është organi më përfaqësues i të gjithë ndërmjetësve, i zgjedhur në formën e qeverisë.

Në nenin 10/5 parashikohet se: *“Mbledhjet drejtohen nga Kryetari i DhKN-së ose në mungesë të tij nga një personi i caktuar nga Kryesia”*. Një përcaktimi i tillë, ka qëllim organizimin e funksionimit në mënyrë sa më të qetë dhe të organizuar të mbledhjeve të përgjithshme, duke evituar çdo papërshtatshmëri dhe konfuzion, në organizimin e tyre.

Në nenin 10/6 parashikohet se: *“Rendi i ditës dhe materialet shpjeguese duhet t’u njoftohen të gjithë anëtarëve, të paktën 30 ditë para datës kur do të zhvillohet mbledhja. Ky njoftim, përfshirë edhe materialet e mbledhjes bëhet në një formë të përshtatshme me postë, letër rekomande, fax, e-mail”*. Ky parashikim, në fakt, ka parasysh se rëndësia e vendimeve që merren në Mbledhjen e Përgjithshme duhet t’i përgjigjet mundësisë së konsultimit të ndërmjetësve me materialet, kohë përpara mbledhjes. Në këtë mënyrë vendimi i tyre do të jetë i menduar mirë²²⁵.

Nëse shkojmë me tej, në nenin 11 do të shohim se jo të gjitha vendimet që merren në Mbledhjen e Përgjithshme të Ndërmjetësve, merren me të njëjtën shumicë votash.

Në paragrafin e parë të kësaj dispozite është parashikuar se: *“Vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve konsiderohen të vlefshme kur votojnë pro të paktën 50%+1 e anëtarëve të pranishëm”*. Kjo është ajo që ndodh me çdo vendimmarrje në Mbledhjen e

²²⁴Neni 11 i Statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve

²²⁵Po Aty. Neni 10.

Përgjithshme, nëse nuk është parashikuar ndryshe në një dispozite të saj, siç do të shohim më poshtë.

Në paragrafin e dytë të nenit 11 të statutit parashikohet se: *“Çdo anëtar gëzon të drejtën e një vote sipas parashikimeve të këtij Statuti”*. Është e qartë që asnjë anëtar i Dhomës nuk është i privilegjuar në ushtrimin e të drejtës së votës së tij. Ky parim mbështetet mbi barazinë e anëtarëve dhe të drejtave të tyre, në këtë bashkim vullnetesh të lejuar nga ligji.

Më pas do të shikojmë se mënyra si bëhet votimi është e tillë që lejon një votim transparent. Kjo për shkak edhe të parimeve ku profesioni i ndërmjetësit duhet të mbështetet, një prej të cilave është ai i transparencës. Duke mos u kufizuar në votimet e hapura, statuti parashikon se në raste të përcaktuara ose me vullnetin e ndërmjetësve të pranishëm, bëhen edhe votime të fshehta. Në paragrafin e tretë të nenit 11 të statutit, parashikohet se: *“Votimet merren me votim të hapur, me ngritje dore nga secili anëtar. Me kërkesë të 1/3-ësë anëtarëve të pranishëm mund të procedohet edhe me votim të fshehtë. Vendimet, që përmbajnë vlerësime mbi sjelljet apo cilësitë e një individi, merren me votim të fshehtë”*. Gjithashtu, shprehimisht është e diktuar që në rast se diskutohet mbi sjelljet apo cilësitë e një individi, atëherë detyrimisht do të bëhet votim i fshehtë, për të garantuar mos lindjen e një konflikti nga ky proces.

Votimi me një shumicë të cilësuar, parashikohet në rastin e votimit të Statutit, Rregullores dhe Kodit të Etikës. Ky votim është parashikuar i tillë, në raport me rëndësinë që vendime të kësaj natyre kanë për mbarëvajtjen apo edhe vetë ekzistencën e këtij institucioni. Në nenin 11 paragrafi 4 të statutit, parashikohet se: *“Vendimet për miratimin dhe ndryshimin e Statutit, Rregullores së DhKN-së dhe Kodit të Etikës janë të vlefshme kur votojnë pro të paktën 2/3-at e të gjithë anëtarëve të pranishëm”*²²⁶. Kjo dispozitë parashikon që me 2/3 e anëtarëve të pranishëm mund të arrihet në vendime, të cilat miratojnë apo ndryshojnë statutin, rregulloren dhe kodin e etikës, duke inkurajuar njëkohësisht një pjesëmarrje maksimale të palëve, megjithëse do të quhej i vlefshëm një votim për sa më sipër edhe me 2/3 e 1/2 të të gjithë anëtarëve. Kjo pasi qëllimi është gjithëpërfshirja, por, njëkohësisht evitimi i një situate bllokuese e këtij procesi.

²²⁶Neni 11 i Statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve

Parashikimi i radhës është munduar të bëjë një kufizim të atyre ndërmjetësve të licencuar, që mund të marrin pjesë në votim në Mbledhjen e Përgjithshme të Ndërmjetësve, duke parashikuar në nenin 11 pika 5, se: “*Të drejtën e votimit dhe pjesëmarrjes në mbledhje e ka vetëm anëtari i DhKN-së*”. Ky parashikim nuk ka asnjë kuptim, nëse nuk marrim të analizojmë dispozitën e radhës, e cila bën parashikimin se kush mund të quhet anëtar i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

4.2. Anëtarët e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve

Në nenin 12 të statutit të Dhomës Kombëtare parashikohet se:

1. Anëtar i DhKN-së është çdo ndërmjetës i licencuar nga Ministria e Drejtësisë dhe i regjistruar në regjistrin e ndërmjetësve, pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe pagan kuotizacionin vjetor përkatës.
2. Çdo anëtar i DhKN-së ushtron të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, Statuti i DhKN-së, Kodi i Etikës dhe Rregulloret, në përputhje me parimet e barazisë, paanshmërisë dhe etikës.
3. Çdo person juridik ose fizik, ofrues i shërbimit të ndërmjetësimit, është i detyruar të jetë anëtar i DhKN-së dhe ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Sa më sipër arrijmë në konkluzionin se anëtar i Dhomës është çdo subjekt i licencuar, person fizik apo juridik. Lind pyetja: si e ushtron personi juridik funksionin e tij, në zbatim të objektit të veprimtarisë së ndërmjetësimit?

Për t’i dhënë një përgjigje të saktë kësaj pyetje, duhet të marrim në analizë objektin e veprimtarisë së ndërmjetësimit, kushtet për të qenë ndërmjetës, licencimin e ndërmjetësimit.

Cilat janë përcaktimet për të qenë ndërmjetës për personat fizik dhe personat juridik?

Për personat fizik është e përcaktuar qartë në nenin 5 (mosha mbi 25 vjeç, arsimi i lartë në nivelin *bachelor*, kualifikimi në fushën e ndërmjetësimit, të mos jetë i dënuar²²⁷), po për personat juridik cili mund të jetë përcaktimi? A mund të kërkojmë të njëjtat kritere për personat juridik, apo do t’i referohemi rregullave të përgjithshme për personat juridik

²²⁷Neni 5 i ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhje e Mosmarrëveshjeve”.

në Republikën e Shqipërisë? Rrjedhimisht, dalim në konkluzionin se personat juridik nuk mund t'i nënshtrohen kushteve të parashikuara nga neni 5, por do t'i referohen kushteve të përgjithshme të parashikuara nga ligji për kushtet për përcaktimin e personave juridik. Në këto kushte, dalim në konkluzionin se kushtet e përcaktuara në nenin 5 të ligjit 10385, janë kushtet që duhet të plotësojë çdo ndërmjetës për të ushtruar profesionin. Në rastet e personit juridik, këto kushte duhet t'i plotësojë personi, i cili ushtron profesionin e ndërmjetësit pranë personit juridik. Në këtë konkluzion dalim edhe nga analiza e nenit 10, të ligjit 10385, Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, ku parashikohen detyrat e ndërmjetësit. Nga përmbajtja e kësaj dispozite dalim në konkluzionin se profesionin e ndërmjetësit nuk mund ta ushtrojë asnjë tjetër përveç personave fizik, pra një individ konkret. Do të ishte e pa mundur të perceptojmë lidhjen e karakteristikave të tilla si ndershmëri, respekt i rregullave të etikës profesionale dhe perceptimin e një zgjidhje të drejtë nga ana e një personi juridik. Nëse do t'i referohemi edhe nenit 1 të ligjit 10385/2011, Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, do të shohim se përcaktohet qartë karakteristika e ndërmjetësit, ku parashikohet se: *“Ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjans (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin”*. Rrjedhimisht dalim në konkluzionin, se personi juridik nuk është gjë tjetër veçse ai që ne perceptojmë në konceptin klasik si një entitet i së drejtës, i cili ushtron kompetencat e tij brenda kufijve të objektit të tij. Në këto kushte, nëse një person juridik do të kishte në objektin e tij ndërmjetësimin sipas ligjit 10385/2011, atëherë do të duhej të kishte pranë tij ndërmjetës të licencuar sipas ligjit, në mënyrë që personi juridik të ushtronte funksionet sipas objektit të tij.

Përfundimisht, ndërmjetës, anëtarë me të drejta të plota për të marrë pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme të Ndërmjetësve, janë të gjithë ata ndërmjetës të licencuar pranë Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve, të cilët e ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas ligjit, si person fizik apo pranë një personi juridik, që është i regjistruar në regjistrin e ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe paguan kuotizacionin vjetor përkatës.

4.3. Kryesia si një organ ligjor i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

Kryesia është një organkolegjal dhe vendimmarrës me funksion ekzekutiv, i cili përbëhet nga 7 anëtarë të zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve²²⁸. Anëtarët duhet të jenë anëtarë aktiv, ku sipas statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, në nenin 12²²⁹, janë të lirë të kandidojnë për Anëtarë të Kryesisë çdo ndërmjetës aktiv²³⁰ dhe anëtarë të kryesisë do të zgjidhen kandidatët më të votuar nga lista e pretendentëve.

Sipas nenit 14/a të Statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, kryesia është organi që siguron zbatimin e vendimeve të organeve të DhKN-së. Por si e bën kryesia një gjë të tillë? Kryesia si një organ ligjor, është një organ i cili në hierarkinë e organeve të Dhomës, vjen menjëherë pas Mbledhjes së Përgjithshme. Rrjedhimisht, Kryesia është organi ku Kryetari dhe Sekretari i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, si dy organe Statutore që merren me administrimin dhe ekzekutimin e detyrave të marra nga vendimet e dala në Mbledhjen e Përgjithshme, paraqesin periodikisht punën e bërë prej tyre.

Detyrat kryesore të Kryesisë janë të dalim me propozime, që kanë të bëjnë me politikat kryesore të veprimtarisë së DhKN-së, amendimet mbi aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe me përgatitjen e propozimeve të projekt-vendimeve dhe çdo akt që i paraqitet për miratim Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve. Kështu, është Kryesia ajo që projekton veprimtarinë e DhKN-së. Këtë gjë Kryesia e bën vetë apo duke krijuar komisione për kryerjen e detyrave specifike me karakter të përhershëm ose të përkohshëm dhe me rol rekomandues ose propozues.

²²⁸ Neni 13 i Statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve; “Kryesia është organ kolegjial, vendimmarrës dhe ekzekutiv, që përbëhet nga 7 anëtarë të zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve. Anëtarë të Kryesisë zgjidhen anëtarët më të votuar nga lista e kandidatëve”.

²²⁹ Po Aty. Neni 12; 1) Anëtar i DhKN-së është çdo ndërmjetës i licencuar nga ministria e Drejtësisë dhe i regjistruar në regjistrin e ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë, dhe paguan kuotizacionin vjetor përkatës. 2) Çdo anëtar i DhKN-së ushtron të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, Statuti i DhKN-së, Kodi i Etikës dhe Rregulloret, në përputhje me parimet e barazisë, paanshmërisë dhe etikës. 3) Çdo person juridik ose fizik, ofrues i shërbimit të ndërmjetësimit, është i detyruar të jetë anëtar i DHKN-se dhe ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Shqipërisë.

²³⁰ Ndërmjetës aktiv do të klasifikohet çdo ndërmjetës i licencuar, i cili sipas legjislacionit në fuqi, ka të drejtën të ushtrijë profesionin e ndërmjetësit, si person fizik apo pranë një personi juridik.

Ajo miraton strukturën administrative mbështetëse të Dhomës dhe funksionet e tyre, duke mundësuar administratën e Dhomës të jetë e aftë të administrojë dhe të bëjë të mundur ushtrimin e funksioneve të organeve të DhKN-së, të bëjë të mundur dokumentimin e veprimtarisë, si dhe të mundësojë mbajtjen e korrespondencës së nevojshme për të mundësuar ekzekutimin e vendimeve të marra nga organet e DhKN-së.

Kryesia miraton programet e trajnimit dhe formimit profesional të ndërmjetësve, miraton logon dhe vulën e Dhomës, emëron apo shkarkon përfaqësuesit e Dhomës pranë Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve. Ajo paraqet opinione, krijon komisione për kryerjen e detyrave specifike, me karakter të përhershëm ose të përkohshëm, dhe me rol rekomandues ose propozuesi, dhe propozon tarifat e shërbimit të ndërmjetësimit dhe kuotizacionit vjetor.

Kryesia përgatit rregulloret e funksionimit të strukturave të Dhomës Kombëtare dhe Dhomave Vendore, ajo cakton rregullat për kontrollin dhe administrimin e aseteve të DhKN-së; si dhe miraton ekspertin/tët kontabël për auditimin e llogarive vjetore dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të DhKN, duke hartuar pasqyrat financiare, buxhetin, raportin vjetor të punës dhe të aktiviteteve, që i paraqitet Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve.

Kryesia, gjithashtu, përbën një hallkë garantuese për pavarësinë dhe lirinë e ushtrimit të profesionit të ndërmjetësve, pasi, në rastet e procedimeve për heqjen e licencës së ndërmjetësit, i paraqet Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve opinionin, në lidhje me këtë gjë²³¹.

4.3.1. Funksionimi i Kryesisë së DhKN

Për të kryer detyrat e saj, **Kryesia e DhKN**, mbledhet të paktën 4 herë në vit. Ajo është e detyruar të mbledhet kurdoherë, nëse thirret mbledhja nga Kryetari i DhKN-së apo 1/3 e anëtarëve të saj. Kusht që Mbledhja e Kryesisë të jetë e vlefshme është që të marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve të saj, por vendimet merren vetëm kur votojnë pro të paktën 50% + 1 e të gjithë anëtarëve të kryesisë.

Në çdo rast, Kryesia është e detyruar të ftojë në mbledhje, çdo subjekt të interesuar ose që ka lidhje me çështjen që shqyrtohet, për të garantuar të drejtën e një procesi të

²³¹Neni 14 i Statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

rregullt ligjor. Në këtë mënyrë, në rastet kur p.sh.: propozohet heqja e licencës së një ndërmjetësi, ajo të ketë parasysh një pasqyrë reale të të vërtetës dhe të çdo të dhëne, me anë të të cilave do të përgatisë opinionin (neni 14 i statutit) përpara Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve.

Në çdo rast, anëtarët e kryesisë, njoftohen të paktën 15 ditë përpara datës së caktuar për mbledhje, në një formë të përshtatshme sipas legjislacionit shqiptar, përfshirë formën elektronike në faqen e internetit dhe/ose adresat e depozituara në Regjistrin e DhKN-së. Në mbledhje diskutohen çështjet rend dite të njoftuara, si dhe çdo çështje tjetër e propozuar nga 1/3 e anëtarëve të pranishëm. Kryetari i DhKN-së ka të drejtë të përfshijë në rendin e ditës edhe çështje të tjera, që nuk janë kërkuar nga thirrësi i mbledhjes, vetëm pasi të ketë njoftuar minimalisht 5 ditë para anëtarët. Për këtë mbahet procesverbal nga sekretari dhe nënshkruhet prej tij dhe Kryetarit, por regjistrimi i diskutimeve mund të realizohet edhe përmes aparaturave elektronike²³².

Anëtar i kryesisë, siç kemi thënë edhe me sipër, ka të drejtë të zgjidhet çdo anëtar i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, me të drejtë rizgjedhje vetëm njëherë radhazi me mandat 4-vjeçar.

Çdo anëtar i kryesisë që kryen shkelje, sipas ligjit 10385, datë 24.02.2011, dispozitave të këtij statuti, rregullores së punës, Kodit të Etikës, vendimeve të asamblesë, si dhe mungon 3 herë radhazi pa arsye në mbledhjet e njoftuara të kryesisë, bëhet subjekt i një mocioni mosbesimi. Ky mocion mosbesimi duhet të nënshkruhet nga më shumë se 1/2 e anëtarëve të kryesisë, ose 1/3 e anëtarëve të DhKN-së. Shkarkimi vendoset nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve me 50 % +1 të votave të anëtarëve të pranishëm.

4.3.2. Kryetari i DhKN

Kryetari i DhKN-së është përfaqësuesi ligjor i DhKN-së, i cili drejton mbledhjet e Kryesisë, lidh dhe nënshkruan marrëveshjet dhe aktet në emër të DhKN-së, si dhe kryen çdo funksion dhe kompetencë që buron nga Statuti, vendimet ose rrethanat e detyrës, që e lejojnë dhe që nuk cenon kompetencat e organeve të tjera të DhKN-së²³³.

²³² Po aty, neni 15.

²³³ Neni 18 i Statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

Për shkelje të rënda të ligjit, Statutit, Kodit të Etikës, vendimeve të Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve, kryerjen e veprimeve që vijnë në kundërshtim me qëllimet e DhKN-së, ndaj Kryetarit mund të paraqitet mocion mosbesimi nga më shumë se 1/2 e anëtarëve të Kryesisë ose 1/3 e anëtarëve të DhKN. Shkarkimi vendoset nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve me 50% +1 të votave të anëtarëve të pranishëm.

Votimi për Kryetarin dhe anëtarët e Kryesisë bëhet në njëjtën kohë me dy fletë të veçanta votimi. Votat për kryetarin numërohen të parat. Rregulla të detajuara për procedurën e votimit për Kryetarin dhe anëtarët e Kryesisë përcaktohen në Rregulloren e votimit.

4.3.3. Sekretari i DhKN-së

Sekretari përzgjidhet nga Kryesia, përmes një procesi konkurrimi. Ai nuk është i detyrueshëm të jetë anëtar i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve. Sekretari i ushtron kompetencat e tij, duke njoftuar dhe raportuar periodikisht organet drejtuese për veprimtarinë e DhKN-së, duke përditësuar Regjistrin e anëtarësisë dhe rregullshmërinë e derdhjes së kuotizacioneve nga anëtarët, duke ndjekur zbatimin e vendimeve të Kryesisë dhe të Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve, duke administruar procesverbalet, arkivin, dokumentacionin dhe korrespondencën e DhKN. Sekretari i DhKN-së, gjithashtu, siguron përditësimin e informacioneve dhe vendimeve të Asamblesë në faqen zyrtare të DhKN, ndjek rregullshmërinë e njoftimeve, siguron dërgimin apo publikimin e materialeve për mbledhjet, mban korrespondencën me DhKN, qendrat dhe ndërmjetësit, mbledh, përpunon, përditëson dhe publikon statistikën e DhKN, si dhe ushtron çdo kompetencë tjetër të dhënë nga Statuti ose vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve dhe Kryesisë.

KAPITULII III: ROLI I NDËRMJETËSIT, PALËT NË KONFLIKT DHE PROCEDURA E NDËRMJETËSIMIT

1. Arsytet përse të ndërmjetësosh

Në jetën tonë të përditshme mund të na ketë ndodhur shpesh herë të përballemi me situata konfliktuale të thjeshta apo të ndërlikuar, dhe të kemi luajtur një rol në zgjidhjen e tyre. Këtë e kemi bërë edhe si qytetarë të thjeshtë, këtë e bëjmë më mirë duke qenë ndërmjetës ose duke u drejtuar dhe adresuar të tjerët tek ndërmjetësi²³⁴, i cili mundëson arritjen e një marrëveshjeje miqësore mes palëve në konflikt, në pajtim me kërkesat ligjore për paanshmëri, konfidencialitet dhe transparencë, sepse kjo zgjidhje përbën një mekanizëm më të shpejtë, më pak të kushtueshëm dhe më transparent²³⁵.

Ndërmjetësimi përveç zgjidhjes konsensuale të konfliktit, i ndihmon palët të arrijnë zgjidhje funksionale, të cilat të jenë në të mirë të interesit të tyre të përbashkët, të reduktojë konfliktualitetin, të përmirësojë komunikimin, si dhe të nxisë ndarjen e drejtë dhe racionale të përgjegjësisve aktuale dhe të perspektivës, me një rezultat të pranueshëm dhe të pëlqyeshëm nga palët në konflikt, një rezultat *"fitore-fitore"*²³⁶.

2. Kushtet për të qenë ndërmjetës

Ligjet për ndërmjetësimin, në Shqipëri, kanë pasur kritere të ndryshme për të ushtruar profesionin e ndërmjetësit. Ligji nr.10385, parashikon kushtet që duhet të plotësojë një person për të ushtruar profesionin si ndërmjetës. Me këtë ligj, shtetasi shqiptar ose i huaj, që dëshiron të ushtrojë profesionin e ndërmjetësit, duhet të përmbushë njëkohësisht këto kushte: të ketë kryer programe të studimeve të ciklit të parë, të ketë mbushur moshën 25 vjeç, të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen me dashje të veprave penale, të ketë përfunduar programin e trajnimit dhe të formimit profesional të ndërmjetësve, të

²³⁴Mandro A.(2006). *Alternativat e Zgjidhjes Jashtëgjyqësisht të Mosmarrëveshjeve: Ndërmjetësimi dhe Avantazhet e Tij*. USAID, fq.35.

²³⁵ Mosmarrëveshja zgjidhet shumë më shpejt se çdo rrugë tjetër, është ekonomike, çështja mbahet nën kontroll, palët edukohen me situatën reale dhe ligjore, eksplorojnë në mënyrë informale opsione zgjidhjeje, Organizohen shumë negociata gjatë një procesi, mbron dhe ruan vazhdimësinë e marrëdhënies.

²³⁶ Avantazhet e tij. USAID. fq.40.

miratuar nga DhKN-ja, si dhe të jetë i licencuar dhe i regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve²³⁷.

Ndërmjetësit që e ushtrojnë këtë veprimtari si profesion, kanë të drejtë të shpërblehen për punën dhe për shpenzimet e kryera, sipas marrëveshjes për ndërmjetësim të nënshkruar me palët, si dhe duhet të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin profesional²³⁸.

Personi i licencuar nuk ofron këshillim ligjor, dhe nuk ka përgjegjësi, nëse ndërmjet palëve për zgjidhjen e konfliktit me ndërmjetësim nuk arrihet marrëveshje, si dhe në ato raste kur arrijnë në marrëveshje, ai nuk mban përgjegjësi për moszbatimin e kësaj marrëveshjeje. Në mbyllje të procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi njofton gjykatën prokurorin ose arbitrazhin me qëllim fillimin e procedurave të pezulluara për efekt të ndërmjetësimit.

3. Profili i ndërmjetësit

Ndërmjetësi nuk është një palë e tretë gjykuese, nuk ofron këshilla dhe teknika ligjore, e as nuk vendos mosmarrëveshjen në bazë dhe as për meritat e secilës palë, si rrjedhojë, ndërmjetësi nuk mund të garantojë arritjen e një marrëveshjeje, por ka një detyrim metodologjike dhe jo rezultati. Ka një funksion udhëheqës në procedurë, duke identifikuar pikat që formojnë të ashtuquajturën "harta e konfliktit"²³⁹, lehtëson komunikimin dhe negocimin mes palëve, aplikon teknikat e tij të procedurës së zgjidhjes, inkurajon pjesëmarrjen e palëve në mënyrë të drejtë dhe lejon që secili prej tyre të shprehet lirshëm, në mbrojtje të interesave të tyre, pa cenuar ato të tjerëve. Gjithçka e realizueshme, vetëm nëse krijohet një klimë respekti reciprok dhe një urë-lidhjeje komunikimi efektiv ndërmjet palëve dhe mes tyre e ndërmjetësit.

Angazhimi i ndërmjetësit konsiston në një ndërveprim të vazhdueshëm me palët, që nga momenti i parë i ndërhyrjes së tij e deri në përfundim të procedurës. Objektivi i tij kryesor është që të ndihmojë palët për t'u përballur me konfliktin nga një perspektivë tjetër,

²³⁷Ligji Nr. 10385, date 24.2.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përfaqësuar me Direktivën 2008/52/EC "Mbi disa aspekte të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare ", me nr. CELEX 3200810052.

²³⁸Ligji aktual parashikon edhe shmangien e konfliktit në interes të personit që kryen rolin e ndërmjetësit.

²³⁹ Kjo fazë na ndihmon për të vlerësuar, së cilat prej nevojave dhe shqetësimeve janë më të rëndësishme, në mënyrë që t'u japim përparësi gjatë negocimit.

përmes analizës së komponentëve të tij të ndryshme. Teknikat që ndërmjetësi duhet t'u referohet mund të grupohen në tri kategori²⁴⁰:

Teknikat procedurale, që kanë të bëjnë me çështje të tilla, si: përcaktimi i axhendës për trajtimin e çështjeve²⁴¹, përcaktimi i mënyrës më të përshtatshme për ndërmjetësim²⁴², përcaktimi i kohës së seancave individuale dhe të përbashkëta. Ndërmjetësi duhet t'i shpjegojë palëve që nga momenti i parë se nuk do të marrë asnjë vendim, në lidhje me mënyrën me të cilën do të zgjidhet mosmarrëveshja dhe se i takon atij të përcaktojë dhe të kujdeset për aspektet procedurale dhe rregullat²⁴³.

Teknikat komunikuese, i përmbahen procedurave të hartuara për të mbajtur kanalet e komunikimit të hapura, duke i ndihmuar palët në sqarimin e çështjeve dhe t'i lejojë që të mund të dëgjojnë njëri-tjetrin për të kuptuar interesat e tyre, duke siguruar në të njëjtën kohë, një hapësirë në të cilën, secili ka të drejtë të shpreh ndjenjat e tij, të gjenerojë empati dhe të krijoj klimën e besimit të nevojshëm për negociata bashkëpunuese.

Teknikat e konsiderueshme, kanë të bëjnë me qartësimin e çështjeve dhe të interesave të palëve mbi bazën e kriterëve objektive, për t'i ndihmuar në gjenerimin e alternativave të ndryshme, bazë mbi të cilën do të strukturohet marrëveshja. Për këtë motiv, kompetencat e kërkuara nga ndërmjetësi janë të përfaqësuar nga njohjet teorike dhe aftësitë ose kapaciteti²⁴⁴.

4. Objektivi i ndërmjetësimit dhe procedura e organizimit të ndërmjetësit

Në këtë pikë është më se e arsyeshme të shtrohet pyetja: Qëllimi kryesor i ndërmjetësit konsiston në arritjen e një marrëveshjeje?

Një pyetje me të vërtetë shumë e rëndësishme, si për hartimin e procedurës për vlerësimin e ndërmjetësit, ashtu edhe të programit të ndërmjetësimit. Roli kryesor i të tretit të paanshëm është t'i nxisë palët të arrijnë në një diskutim konstruktiv, mbi komponentët e ndryshëm të mosmarrëveshjes, duke krijuar kushte optimale për trajtimin e konfliktit nga një

²⁴⁰ADR Center (2011). *Guida Alla Procedura Di Mediazione*.tq. 10.

²⁴¹ Identifikimi i prioritetit të interesave dhe strategjitë

²⁴² P.sh. të fillohet me një seance fillestare të përbashkët apo me seanca individuale me secilën palë etj.

²⁴³ Kohët, ndërprerjet dhe strukturën e ndërmjetësimit.

²⁴⁴ Bush R.&Folger J.(1994). *The Promise of Mediation: Responding to Conflict through Empowerment and Recognition*. San Francisco.JosseyBass.

këndvështrim tjetër. Në qoftë se në përfundim të kësaj, palët arrijnë një marrëveshje, rezultati me siguri do të jetë ai me optimali, por në çdo rast, para se të marrin pjesë në proces, si ndërmjetësi ashtu edhe palët, duhet të jenë plotësisht të vetëdijshëm për mundësinë që mund t'i japin fund edhe pa marrëveshje.

Shumë ndërmjetësime, edhe pse përfundojnë pa marrëveshje arrijnë të hapin dritare të reja, nëpërmjet të cilave, palët rinisin dialogun, kjo sepse ndërhyrja e palës së tretë neutrale favorizon një kuptim më të mirë të aspekteve të vërteta të mosmarrëveshjes. Përpjekja për ndërmjetësim përbën një angazhim të mënyrave dhe nuk mund të garantojë rezultate të veçanta, prandaj, parametrat e vlerësimit duhet të përqendrohen në mënyrën se si është kryer procedura. Ndërmjetësi duhet t'i shpjegojë palëve që në fillim qëllimin e ndërmjetësimit në mënyrë të qartë, sepse në qoftë se nuk e bëjnë, palët mund të konsiderojnë se qëllimi i vetëm i ndërmjetësimit është ai që të arrijnë një marrëveshje, ndoshta edhe me frikën që mund t'i serviret një zgjidhje e padobishme për ta. Ndërmjetësi duhet të jetë në gjendje që të përshtatë çdo herë skemën dhe procedurën pajtuese, me veçantinë e mosmarrëveshjes dhe llojin e konfliktit, duke planifikuar që nga fillimi dhe gjatë gjithë ecurisë së ndërmjetësimit, veprimin më të përshtatshëm për menaxhimin e situatave konkrete²⁴⁵.

Përveç teknikave dhe metodave të përdorura, ndërmjetësimi sjell një mënyrë të ndryshme të të menduarit, një përjasje krijuese që lejon pjesëmarrjen aktive të palëve në bashkëndërtimin e zgjidhjes. Ky sistem i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sjell me vete një respekt të thellë për njerëzit, bazuar në etikën, ndaj së cilës duhet të frymëzohen veprimet e ndërmjetësit dhe avokatëve që ndihmojnë palët²⁴⁶.

5. Kuptimi i rolit të Palëve në Konflikt

5.1. Çështja e kuptimit dhe përkufizimit të Konfliktit dhe Palëve në Konflikt

Po t'i referohemi fjalorit të drejtësisë, me fjalën “konflikt” do të kuptojmë: *“Mosmarrëveshje e thellë ndërmjet dy njerëzve a dy palëve; pasojë e tensioneve si në planin e brendshëm, ashtu dhe në planin e jashtëm të jetës politike dhe shoqërore, të bashkësive*

²⁴⁵ Bazuar mbi Pikën 1 të Kodit Etik Europian për Ndërmjetësit.

²⁴⁶ Acland, Floyer A. (1993). *Comoutilizar la mediation para resolver conflicts en la s organizaciones*. Ed.Paidós. Barcelona.

nacionale dhe shtetërore”²⁴⁷. Ndërsa, me fjalën “Mosmarrëveshje” do të kuptojmë “*mungesë marrëveshje, mospajtim a mospërputhje mendimesh, pikëpamjesh, qëllimesh, veprimesh etj., ndërmjet dy a më shumë njerëzve, palëve etj.; përçarje, grindje. Kuptimi jo i plotë, jo ashtu siç duhet ose i gabuar i diçkaje që thotë a që parashtron një tjetër, keqkuptim. Term teknik që do të thotë mosmarrëveshje rreth një çështje të së drejtës ose një fakti, konflikti i qëndrimeve juridike ose të interesave midis palëve*”²⁴⁸. Megjithëse, këto dy fjalë ngjajnë me sinonime të njëra-tjetrës, shohim se ato njëherazi plotësojnë njëra-tjetrën.

Sipas Prof. Dr. Ismet Elezit, shkencat sociologjike dhe kriminologjike, bazohen në konceptin se konflikti, ashtu si kriminaliteti, është në fenomen social. Bazuar në këtë koncept, një metodë e caktuar mund të përdoret për ta studiuar atë, për të kuptuar se ç’ndodh me të, strukturën dhe dinamikën, shkaqet dhe rrethanat që favorizojnë konfliktin dhe mosmarrëveshjen, duke studiuar personalitetin e palëve në konflikt, si dhe duke gjetur metoda të përshtatshme si alternativa të pranueshme nga palët, në zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve²⁴⁹.

Sipas Prof. Dr. Arta Mandro, konflikti mund të përkufizohet si një situatë faktike, në të cilën elemente që duken të papajtueshme ushtrojnë forcë në drejtime të kundërta ose divergjente. Këto forca divergjente krijojnë tension, por jo domosdoshmërisht armiqësi ose luftë. Fjala “konflikt”, jo domosdoshmërisht do të thotë betejë. Konflikti mund të jetë i heshtur dhe i pashprehur, sikurse mund të jetë i shprehur në mënyrë të dukshme ose të fortë. Konflikt do të thotë që palët janë në opozitë. Pra, konflikti është fakti, diçka që ndodh dhe që nuk perceptohet njësoj nga të dyja palët. Është e kuptueshme se perceptimi varet nga shumë faktorë. Të tillë janë makro-mjedisi dhe mikro-mjedisi, në të cilët njeriu është lindur, rritur, edukuar si dhe stereotipi dhe paragjykime të caktuara të formuara nga përvoja e jetës vetjake ose e jetës së të tjerëve, të tillë si: prindërit, motrat, vëllezërit, të afërmit, madje, ndonjëherë edhe ata që duken si pa ndikim, në një moment të caktuar, mund të kenë dhënë ndikimin e tyre në një deformim të caktuar. Kjo varet nga toleranca, nga të pranuarit ose jo të fajësisë, nga ndjenja e tërheqjes dhe e shmangies, nga pushteti që dëshiron të vendosësh mbi të tjerët,

²⁴⁷ Fjalor i Drejtësisë 2011, isbn:978-9928-4084-0-2, fq. 348.

²⁴⁸ Po aty, fq. 471-472.

²⁴⁹ Elezi. I. (2006). *Mediation in Penal Case Reconciliation*, fq. 94-102.

nga interesi i çastit, nga dëshira për t'u treguar si më i forti e fitimtari etj. Arsyet dhe shkaqet e qëndrimeve të caktuara janë të pafundme²⁵⁰.

Konflikt, gjithashtu, mund të konsiderohet përballja e dy dëshirave të kundërta, që shfaqen dhe duken jetësore për personat të cilëve iu përkasin. Kështu, mund të themi se konflikti lind nga ndjenja e humbjes, humbja e një të kaluar që nuk ekziston më dhe një dëshirë për të zëvendësuar rregullin, që tashmë është shndërruar në kaos. Kalimi nga rregulli në kaos provokon atë që mund ta përkufizojmë si konflikt²⁵¹.

Konfliktet dhe mosmarrëveshjet mes njerëzve janë një pjesë integrale e jetës sonë të përditshme. Ato mund të jenë të çdo lloji, duke nisur nga konfliktet sociale, komerciale, mosmarrëveshjet familjare, deri në konfliktet midis shteteve. Ashtu si rriten llojet dhe natyra e mosmarrëveshjeve me zhvillimin ekonomik dhe kulturor të çdo shoqërie, rriten dhe marrin një rëndësi të veçantë edhe mekanizmat që kanë të bëjnë me to. Përkrah këtyre zhvillimeve, mënyrat alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve janë duke u zhvilluar gjithnjë e më shumë dhe po marrin një rëndësi të veçantë, duke u zhvilluar edhe me ligje të veçanta²⁵².

Automatizimi i jetës ka të mirat e tij, por sjell edhe veçimin e individit dhe izolimin e tij në një jetë më pak sociale. Shpesh nuk njohim fqinjët që kemi pranë shtëpisë, nuk e përshëndesim njëri-tjetrin në ashensor ose shohim persona në rrugë, autobus, metro e të tjera, duke dëgjuar muzikë me kufjet në vesh dhe nuk i shikojnë fare njerëzit rreth tyre. Për këto arsye, shoqëria e sotme ka rritur distancat dhe mosbesimin e individit nga grupi, nga shoqëria, nga familja. Si e tillë, kjo mënyrë jetese nuk ofron të njëjtat rrugë “miqësore” të komunikimit dhe të ndërtimit të raporteve midis njerëzve dhe, aq më pak, nuk ofron rrugët “miqësore” për zgjidhjen e konflikteve, të cilat ndesheshim në traditën historike. Dashuria është ndjenja që shëron gjithçka. “Dashuria mësohet” - thotë Leo Buskaglia dhe kjo nuk duhet harruar. Dashuria është çelësi i zgjidhjes së konflikteve. Prirja e drejtësisë dhe e politikave sociale në rang ndërkombëtar është se, gjithmonë e me shpesh, po i kthen sytë nga tradita e shkuar për zgjidhjen e konflikteve me natyrë sociale dhe juridike, sepse e ndjen që

²⁵⁰ Mandro, A. (2006). *Ndërmjetësimi i konflikteve në grup-moshat Shkollore*, Manual për mësuesit, 7-17

²⁵¹ Çerekja, B. (2013). Disertacion, “*Ndërmjetësimi në veprat penale të të miturve*”.

²⁵² Bushati, E. & Spaho, E. (2013). *Mediation: A concept that has to do not just with the justice system*. *Academicus: International Scientific Journal*, 7, 54-61.

rrotull mjedisit ku jetojmë e punojmë, po shtohet ndjenja e pasigurisë dhe e pakënaqësisë. Në këto kushte, alternativa ndërmjetësuese po forcohet, duke sjellë me vete edhe fuqizimin e ndjenjës së stabilitetit dhe harmonisë në shoqëri. Me anë të zgjidhjes miqësore të konflikteve, minimizohen pasojat e veprimeve keqdashëse e të paligjshme. Nga njëra anë, restaurohen individët e përfshirë në këto konflikte dhe, nga ana tjetër, restaurohet e gjithë shoqëria dhe mënyra e jetesës dhe e mbijetesës së saj²⁵³.

Origjina e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve në mes të individëve dhe shoqërive është e vjetër, po aq sa edhe vetë njerëzimi dhe ekzistenca e komunikimit mes tyre. Forma, llojet, palët dhe natyra e konfliktit kanë evoluuar në varësi të rrethanave të ndryshme, historike/ shoqërore/ ekonomike/ politike/ teknologjike dhe ushtarake. Po ashtu, edhe evoluimi i mënyrës së përfshirjes së palëve në zgjidhjen e konflikteve dhe ndryshimi i metodave apo perfeksionimi i tyre janë si rrjedhojë e kushteve të lartpërmendura. Historikisht, ndër shkaqet kryesore të lindjes së konflikteve në botë janë ato: ekonomike/ territoriale/ etnike/ fetare/ ideologjike/ shkelja e të drejtave të njeriut etj. Shumica nga këto shkaqe në një fazë të zhvillimit të shoqërive kanë qenë burim krizash, qoftë si të vetme, qoftë më shumë se një, duke përcaktuar kështu, kuantitetin dhe kualitetin si të nivelit të konfliktit, ashtu edhe të mundësive për zgjidhjen e konflikteve²⁵⁴.

5.2. Çështja e debatit rreth rolit të Konfliktit dhe Palëve në konflikt

Në fakt, në Shqipëri nuk është bërë ndonjë studim, i cili të ketë studiuar natyrën e konfliktit, kështu që nuk mund të paraqesim dallime në vlerësimin mes studiuesve rreth natyrës së konfliktit në Shqipëri, por nëse bëjmë një analizim të fazave të zhvillimit të konfliktit, rolin e palëve të përfshira në konflikt, metodave etj., do të shikojmë që konflikti në Shqipëri nuk ka arsye përse të ketë një kuptim të ndryshëm nga vendet e tjera. Konflikti është një situatë mosdakordësie, ku palët e vlerësojnë situatën dhe argumentet e ballafaquara ndërmjet tyre, në favor të pretendimeve të tyre.

Çështjet më të ndjeshme që kanë të bëjnë me konfliktin dhe palët në konflikt, në kontekstin social dhe juridik të Shqipërisë, kanë të bëjnë me mënyrën e sjelljes ndaj konfliktit të aktorëve që mund të ndikojnë në transformimin e tyre. Në këtë kontekst, dëshiroj të shikoj

²⁵³ Semini, M. (2011). *Drejtësia Restauruese dhe Ndërmjetësimi për të Miturit*; fq.4-18.

²⁵⁴ Zejnullahi, V. (2013). *Zgjidhja paqësore e konflikteve*, Universiteti i Tiranës, fq. 4-6.

konfliktin në trajtën e mënyrës se si ai orientohet. Orientimi i konfliktit në hallkat, të cilat tentojnë ta shuajnë atë, është shumë e rëndësishme.

Çfarë do të konsiderojmë zgjidhje të konfliktit është një tjetër çështje, që vlen të trajtohet, pasi, zgjidhja mund të bëhet në shumë mënyra. Zgjidhja njëkohësisht është një çështje perceptimi. Jo të gjithë do të ishim dakord me çdo zgjidhje, ashtu sikundër nga ky pohim deduktojmë konkluzionin se zgjidhja nuk është domosdoshmërisht e njëjtë për të gjithë, në situata të caktuara. Por, megjithatë, kjo është e pranueshme. Në të kundërt nuk do të ekzistonte konflikti, por do mjaftonte dakordësia e njëjtë e palëve për çdo problem.

Subjektet, të cilat trajtojnë zgjidhjet e konflikteve e trajtojnë konfliktin në pikëpamje të ndryshme dhe me qëllime të ndryshme. Ndryshe e shikon konfliktin gjyqtari, ndryshe e shikon prokurori apo oficeri i policisë, ndryshe e shikon pala në një proces përpara gjyqtarit/Prokurorit/Oficerit të Policisë, ndryshe e shikon Ndërmjetësi. Mënyra se si ne e shikojmë konfliktin na dikton edhe mënyrën se si do ta trajtojmë konfliktin. Në fund të fundit, të gjithë aktorët apo subjektet të cilët trajtojnë konfliktin, që nga hallka më e dobët e deri të hallka më e fortë, kanë një qëllim: të zgjidhin konfliktin. Një detaj shumë i vogël, që nuk mbahet parasysh është, se zgjidhja më e mirë e një konflikti vjen kur konflikti njëkohësisht është shuar, përveç se është zgjidhur.

5.3. Çështja e aspekteve të sjelljes konfliktuale

Në teorinë e disponueshmërisë të varur nga kostot do të shohim se palët mund të tërhiqen me njëri-tjetrin, në mënyrë që të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre, sjellja e tyre do të jetë efikase, pavarësisht nga rregulli themelor i së drejtës. Kjo nënkupton që, sa herë kostot e transaksionit janë të ulëta, njerëzit hezitojnë më pak të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale dhe, në këto raste, zbatohen rregullat e përcaktuara në kontratë. Në anën tjetër, sa herë që kostot e marrëdhënies janë të larta, njerëzit nuk do të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale, por do të zbatohen rregullat e përcaktuara në ligj, për rregullimin e marrëdhënies ndërmjet tyre²⁵⁵.

²⁵⁵Coase, Ronald H. (1960). 'The Problem of Social Cost', 3 *Journal of Law and Economics*, 1-44.

Në botën e vërtetë, standardet ligjore janë shpesh të pasigurta²⁵⁶. Faktorët që çojnë në pasiguri të palëve janë, mes të tjerash, gabime të gjykatave në përcaktimin e nivelit të duhur të kujdesit dhe drejtësisë, gabime të gjykatave në vlerësimin e angazhimit të palëve, dhe pamundësitë e gjykatave për të kontrolluar dhe kujdesur në mënyrën e duhur, për çështjet që ato trajtojnë²⁵⁷.

Megjithatë, për çdo arsye që mund të ndodhë, kur palët vendosin t'i nënshtrohen një procesi negociate, apo një mënyre alternative për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet tyre, ky konflikt fillon dhe pëson ndryshimet e para.

Palët në konflikt dallohen në dy modele kryesore të sjelljes së tyre, i pari është modeli këmbëngulës, që përcaktohet si një përpjekje personi për të kënaqur shqetësimet e tij ose të saj, dhe modeli i dytë është kooperativiteti ose bashkëpunimi, përcaktuar si një përpjekje për të kënaqur shqetësimet e personit tjetër²⁵⁸.

Duhet të kemi parasysh se në të dyja rastet, palët mund të jenë këmbëngulëse ose jo dhe bashkëpunuese ose jo. Rasti ku personi është këmbëngulës karakterizohet nga ndjenja e garimit apo të qenit në çdo kohë në gjendje gare me të tjerët. Në rastin, ku pala është bashkëpunuese ajo karakterizohet nga dëshira për të akomoduar apo ndihmuar. Nëse do të ndanim një diagonale ndërmjet tyre, atëherë do të gjendeshim në tre situata, në situatën ku palët mënjanojnë njëri-tjetrin, në situatën ku palët mund të gjejnë kompromisin, apo në situatën ku ata arrijnë bashkëpunimin.

²⁵⁶Craswell, R & Calfee, John E. (1986), 'Deterrence and Uncertain Legal Standards', 2 Journal of Law, Economics, and Organization, pp. 279-303.

²⁵⁷Craswell, R & Calfee, John E. (1984), 'Some Effects of Uncertainty on Compliance with Legal Standards', 70 Virginia Law Review, pp. 965-1003.

²⁵⁸Thomas L. Ruble & Richard A. Cosier, (1980). *An exercise in conflict-handling behavior*, Experiential Learning Enters the Eighties, Volume 7, pp.199-201.




Figura 1; Taksonomia e trajtimit dy-dimensional të konfliktit²⁵⁹

Në një konflikt, qëllimi, shkalla, dhe tipi i konfliktit përfaqësojnë tre dimensione sjelljesh konfliktuale. Diskutimi i këtyre tre aspekteve, që përfaqësojnë së bashku dimensionin e konfliktit në procesin e ndërmjetësimit është, pothuajse, i pamundur të bëhet, duke i ndarë ato. Qëllimi i konfliktit nuk është që të na ndihmojë për të na sjellë më afër, edhe pse kjo mund të jetë rezultat i mundshëm. Konflikti ekziston për të bërë ndarjen dhe dallimet e vetes nga tjetri.

Nuk është e mjaftueshme të dimë se konfliktet e pazgjidhshme shpesh janë shkatërruese, ne kemi nevojë të dimë përse. Gjithashtu, kemi nevojë të kuptojmë në mënyrë të detajuar motivet që detyrojnë palët, pasi këto do të përcaktojnë se çfarë mund dhe nuk mund të bëhet për të korrigjuar problemet dhe për të rritur konstruktivitetin e përballjes së pashmangshme.

²⁵⁹ Kenneth W. Thomas May (1992) "Conflict and conflict management; Reflections and update; Journal of organizational behavior, Volume 13, Issue 3, Special Issue: Conflicts and negotiation in organizations; Historical and Contemporary Perspectives, 256-274

Fusha e zgjidhjes së konflikteve është rritur në mënyrë të shpejtë dhe, kompleksiteti dhe ndryshueshmëria e konflikteve shkatërruese është aq e madhe, saqë asnjë person ose organizatë nuk ka një kuptim të duhur të të gjitha problemeve të konflikteve apo metodave të zgjidhjes së tyre. Të kuptuarit e problematikave të konfliktit dhe krijimi i një zgjidhje efektive, kërkon përpjekje për mbledhjen e një numri të madh të dhënash nga njerëzit, ku secili duhet të kontribuojë për të zgjidhur një pjesë ose dy të enigmës.

Dallimet mes qëllimit, shkallës, dhe tipit të konfliktit janë esenca e të kuptuarit të problematikave konfliktuale, dhe një analizë e këtyre elementeve do të na ndihmojë të arrijmë t'i japim një kuptim këtyre problematikave.

6. Procedura e Ndërmjetësimit

6.1. Ku bazohet procedura e ndërmjetësimit

Procedura e ndërmjetësimit konsiston në një sekuencë fazash që ndërmjetësi organizon për të arritur objektivat specifike, të cilat synojnë lehtësimin e komunikimit dhe negocimit mes palëve. Fazat zhvillohen përmes seancave të ashtuquajtura "të përbashkëta", në të cilat janë të pranishëm ndërmjetësi dhe palët e përfshira, ose brenda seancave private (caucuses- grupeve)²⁶⁰, në të cilat janë të pranishëm ndërmjetësi dhe një palë e vetme. Mund të thuhet, se edhe pse ndërmjetësimi i përket rendit negociues, si metodë joformale e zgjidhjes së konflikteve, ka një strukturë, në të cilën mund të identifikohen faza të dallueshme me karakteristika të veçanta, në varësi të objektivave që duhen arritur. Të pranosh ekzistencën e një strukture nuk do të thotë se ndërmjetësi nuk mund të përsërisë ose të ndryshojë rendin e disa fazave: në çdo rast do të jenë rrethana të veçanta (niveli i zhvillimit të konfliktit, koha në të cilën ndërhyjnë ndërmjetësi, strategjitë negociuese që përdoren, kompleksiteti i çështjeve) për përcaktimin e kohëzgjatjes, përsëritjen dhe radhën e fazave të ndryshme të ndërmjetësimit. Megjithatë, struktura e ndërmjetësimit duhet të garantojë gjithmonë pjesëmarrjen e palëve dhe aftësinë e secilit për t'u shprehur lirshëm dhe të mbrojë interesat e tij, pa cenuar ato të të tjerëve, duke krijuar një klimë respekti dhe promovimi të një komunikimi efektiv nga ana e ndërmjetësit.

²⁶⁰ Caucuses - Takim i veçantë, konfidencial midis ndërmjetësit dhe njëres palë. Informacioni që i jepet ndërmjetësit gjatë kazusit, në përgjithësi, është sekret, përveç rastit kur pala autorizon ndërmjetësin t'ia komunikojë atë palës tjetër.

Seanca e pajtimit zhvillohet në seancën e parë²⁶¹. Për këtë seancë duhet të urdhërohet prania personale e të dyja palëve. Gjykata duhet të diskutojë gjendjen, por dhe të bëjë pyetje e vërejtje. Palët duhet ta paraqesin konfliktin, sipas pikëpamjes së tyre, për këtë arsye duhet t'u jepet mundësia dhe të dëgjohen personalisht, e mbi këtë bazë gjykata duhet t'u bëjë palëve një propozim të argumentuar për pajtim ose të propozojë një ndërmjetësim. Kjo në aspektin që t'i inkurajojë palët të provojnë ndërmjetësimin e konfliktit me anë të një zyre ndërmjetësimi ose ndërmjetësi. Nëse palët bien dakord me këtë propozim, gjykata mund të urdhërojë pezullimin e çështjes për aq kohë sa vazhdojnë përpjekjet për ndërmjetësim²⁶².

Procedura për ndërmjetësim fillon pas datës së paraqitjes së ftesës për ndërmjetësim nga të paktën njëra nga palët në konflikt, sipas këtij ligji, ose nga data e referimit të çështjes nga gjykata për zgjidhjen e saj me ndërmjetësim. Ftesa për ndërmjetësim mund t'i drejtohet ndërmjetësit, pavarësisht, nëse palët kanë rënë dakord paraprakisht, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim. Nëse një palë në mosmarrëveshje i kërkon një pale tjetër ndjekjen e procedurave të ndërmjetësimit, sipas këtij ligji, dhe kjo e fundit nuk i përgjigjet kësaj kërkesë brenda tridhjetë ditëve nga data në të cilën është dërguar ftesa ose brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesë, pala kërkuese mund ta vlerësojë këtë si mospranim të ftesës për të ndërmjetësuar. Ftesa për ndërmjetësim e paraqitur nga një palë në mosmarrëveshje nuk e pengon këtë palë që të nis fillimin e një procesi gjyqësor apo arbitrazhi në lidhje me këtë mosmarrëveshje, për shkak të kalimit të afateve të paraqitjes së padisë. Palët zgjedhin vullnetarisht një ose më shumë ndërmjetës prej Regjistrisë të Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në procedurën e ndërmjetësimit me një ndërmjetës, palët bien dakord për të caktuar nga lista e ndërmjetësve të licencuar, një ose dy ndërmjetës, dhe kjo, në varësi të mosmarrëveshjes që trajtohet.

Përpara fillimit të procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi është i detyruar që të informojë palët për qëllimet dhe parimet e përgjithshme, rolin e ndërmjetësit dhe të palëve në proces, shpenzimet e procesit të ndërmjetësimit dhe efektet e marrëveshjes së ndërmjetësimit. Sipas ligjit, palët dhe ndërmjetësi nënshkruajnë bashkërisht marrëveshjen për realizimin e procesit të ndërmjetësimit. Ai parashikon rastet, kur përfundon një procedurë ndërmjetësimi, nënshkrimi i aktmarrëveshjes dhe detyrimet e palëve. Në rastin, kur është zgjidhur çështja me

²⁶¹ D.m.th. në seancën fillestare - ose në rastin e procedurës paraprake shkresore - në seancën kryesore.

²⁶² Voka, J. (2004). *Mundësitë e ndërmjetësimit gjyqësor*. Jeta Juridike nr.4. Tiranë. fq.38.

anë të ndërmjetësimit, organet gjyqësore ose të prokurorisë vendosin, sipas rastit, miratimin e zgjidhjes me pajtim të çështjes civile ose pushimin e çështjes penale apo mosfillimin e procedimit penal, përveç rasteve kur arrihet në përfundimin se vërehet pavlefshmëri²⁶³.

6.2. Sa ndërmjetës mund të marrin pjesë në një proces ndërmjetësimi.

Në raport me kompleksitetin e mosmarrëveshjes, si dhe vullnetin e palëve, palët që do të pranojnë të hyjnë në një proces ndërmjetësimi janë të lirë të zgjedhin një ose më shumë ndërmjetës për të asistuar dhe lehtësuar në komunikimin ndërmjet tyre²⁶⁴. Direktiva CELEX-32008L0052-En, nuk ka një përcaktim të saktë se sa ndërmjetës duhet të asistojnë në një proces ndërmjetësimi. Në këtë direktivë përcaktohet, se palët marrin pjesë në një proces vullnetar të asistuar “nga një palë e tretë”²⁶⁵, duke u mjaftuar me cilësitë e domosdoshme që janë paanësia dhe profesionalizmi. Ndërmjetësimi është një aktivitet i specializuar. Përmes qasjes profesionale, ndërmjetësit dhe ekipet e tyre²⁶⁶ duhet të sigurojnë hermetizëm të informacionit për palët në konflikt dhe të rrënojnë konfidencialitetin në proces, me besimin se një zgjidhje paqësore është e arritshme. Pra, ndërmjetësimi, edhe nëse i referohemi Guidës për ndërmjetësim efektiv, publikuar nga Kombet e Bashkuara, në shtator 2012, do të vërejmë se ndërmjetësimi bëhet nga një ndërmjetës apo nga një grup ndërmjetësish, siç parashikohet edhe në ligjin 10385, “për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

Pavarësisht se, sipas ligjit për ndërmjetësimin, këtë profesion e ushtrojnë si personat fizik ashtu edhe personat juridik, duhet të kemi parasysh që kjo ndarje bëhet për shkak të përcaktimit që ligji bën për subjektet e së drejtës, që kanë të drejtë të japin shërbime sipas përcaktimeve ligjore në Republikën e Shqipërisë. Theksojmë se ndërmjetësi në çdo rast duhet të karakterizohet nga dy cilësi të veçanta, që janë profesionalizmi dhe paanësia, cilësi të cilat

²⁶³ Për më tepër flitet në Kapitullin IV, 4.5 - Pavlefshmëria e ndërmjetësimit, fq.40.

²⁶⁴ Neni 15/2 i Ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, Neni 15, **‘Liria e palëve për rregullat dhe mënyrën e ndërmjetësimit’** ; Palët zgjedhin vullnetarisht një ose më shumë ndërmjetës prej Regjistratit të Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë.

²⁶⁵ Direktiva CELEX-32008L0052-En ; neni 1(b) ‘Mediator’ means any third person who is asked to conduct a mediation in an effective, impartial and competent way, regardless of the denomination or profession of that third person in the Member State concerned and of the way in which the third person has been appointed or requested to conduct the mediation”.

²⁶⁶ Ban Ki-moon Secretary-General United Nations, (2012). “Guidance for Effective Mediation”.

mund t'i kenë vetëm frymorët dhe, mënyra se si organizohen ata për të dhënë shërbimin e ndërmjetësimit nuk ka të bëjë me këto kërkesa të ligjit. Pra shohim se, kemi të bëjmë me një proces, i cili bazohet fort në parimet e tij, siç është edhe parimi i fleksibilitetit. Janë palët ato që vendosin në raport me nevojat e tyre, nëse do të autorizojnë një apo më shumë ndërmjetës për t'i shërbyer dhe asistuar atyre në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

6.3. Procedura që duhet të ndjekë gjykata kur referon për ndërmjetësim në procesin civil

“Gjykata, në përputhje me nenet 4, 25, 158/a, 158/b dhe 297 të Kodit të Procedurës Civile, fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, parashikuar në nenin 2 pika 2 të këtij ligji dhe kur palët bien dakord pezullon gjykimin, duke u caktuar palëve një afat në përputhje e me natyrën e mosmarrëveshjes”²⁶⁷.

Referuar sa më sipër, do të marrim në analizë mënyrën se si do të procedojë gjykata në rastet e paraqitura përpara saj, të cilat përmbajnë konflikte që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës dhe familjare²⁶⁸.

Nëse vërejmë me kujdes, ftesa e gjykatës është i vetmi detyrim që gjykata ka kundrejt këtij procesi. Diskutimi që ngrihet është nëse ky detyrim aplikohet apo nëse bie ndesh me një detyrim tjetër ligjor. Po t'i referohemi nenit 4 të Kodit të Procedurës Civile, ku na referon dispozita nr. 13 e ligjit “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, do të shohim se diskutimi që kemi bërë më sipër, ku Direktiva e 2008, për Ndërmjetësimin parashikon procedurën e ndërmjetësimit si një procedurë, që vjen në përputhje me parimet e një procesi të rregullt ligjor, vjen në përputhje me kërkesat e këtyre dispozitave. Mënyrat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sipas Komisionit Europian, konsiderohen të gjitha ato mekanizma që gjenden për të mbushur boshllëkun e procedurave gjyqësore kombëtare. Kjo bëhet për të siguruar një qasje sa më të mirë në drejtësi, si dhe për të garantuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian. Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve, në të vërtetë, konsiderohet si më e përshtatshme,

²⁶⁷Neni 13, Procedura për ndërmjetësim në procesin civil; ligji 10385 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

²⁶⁸Neni 2/2; ligji 10385 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

sepse ajo lejon palët që, duke u bazuar në parimin e një dialogu, të përballen me njëra-tjetrën dhe, përfundimisht, të vendosin vetë nëse dëshirojnë apo jo, t'i nënshtrohen një procesi gjyqësor²⁶⁹.

Në nenin 4 të Kodit të Procedurës sonë Civile parashikohet, se “*Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme*”. Ndërsa në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashikohet, se “*...b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes*”. Në këtë kuptim, ndërmjetësimi është një lehtësi e përshtatshme, e cila duhet gjithashtu të ketë kohën e nevojshme në dispozicion të palës.

Në nenin 25 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet, se “*Pajtimi i palëve është detyrë e gjykatës që të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje*”. Nëse do të vërejmë me kujdes përcaktimin që kjo dispozitë i ka bërë rëndësisë së pajtimit ndërmjet palëve, do të kuptojmë se edhe instituti i ndërmjetësimit për të njëjtën arsye ka lindur. Rrjedhimisht, kjo dispozitë është një nga dispozitat bazë të burimit të ligjit për ndërmjetësimin. Nëse i referohemi ligjit për ndërmjetësimin do të shohim se pajtimi i parashikuar në nenin 25 të Kodit të Procedurës Civile, është parashikuar në nenin 1 të tij. Në këtë dispozitë parashikohet se “*....2. Ndërmjetësimi për zgjidhjen **me pajtim** të mosmarrëveshjeve është veprimtari e pavarur, që ushtrohet në përputhje me këtë ligj dhe nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë*”²⁷⁰.

Pra, këtë mënyrë të zgjidhjes së mosmarrëveshjes (zgjidhja me pajtim), e ka veshur edhe me një garanci për palët, duke garantuar që ky proces do të jetë nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, si organi më i specializuar në këtë drejtim. Kjo analogji bëhet për të gjitha proceset e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në fakt.

Duke filluar që nga sistemi Gjyqësor, i cili ka një mbikëqyrje nga inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, po ashtu edhe sistemi Akuzator (prokuroria). Duke vazhduar në këtë frymë edhe me procesin e ndërmjetësimit, zgjidhja e mosmarrëveshjeve me këtë mënyrë alternative, merr një garanci të mjaftueshme dhe korrekte për funksionin që ajo kryen.

²⁶⁹ Marzocco, A.Maria & Nino M, (2011). *Directive commentary*, pp. 109-110.

²⁷⁰ Neni 1/2, Ligji 10385 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

Në vazhdim të parimit të funksionimit në mënyrë të kontrolluar dhe të garantuar edhe nga aparaturat shtetërore, në nenin 158/a të Kodit të Procedurës Civile, është parashikuar momenti procedural, kur kryhet përpjekja e pajtimit. Në këtë dispozitë parashikohet se në seancën përgatitore, seancë e cila shërben për të caktuar natyrën e mosmarrëveshjeve dhe për të përcaktuar të gjitha palët e interesuara, gjykata pasi dëgjon shpjegimet e nevojshme, “*me vendim, kryen këto veprime: ... Vendos për pezullimin e gjykimit, kur janë rastet e përcaktuara nga neni 297 i këtij Kodi*²⁷¹”. Në këtë kuptim, një nga arsyet që gjyqtari mund të vendosë pezullimin për një afat të caktuar, si të arsyeshëm nga ana e tij, është edhe mundësia e arritjes së një kompromisi, apo një zgjidhjeje me anë të pajtimit.

Po të marrim në analizë nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, që vjen më pas, ku parashikohet se: “*Veprimet e pajtimit (Shtuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 40) Gjyqtari, gjatë veprimeve përgatitore, bën të gjitha përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen me pajtim, kur e lejon natyra e çështjes*”. Shohim, që kjo dispozitë ka karakter urdhërues, për këtë arsye ajo vjen si një detyrim procedural për gjyqtarin, i cili detyrimisht e aplikon atë. Referuar sa kemi parashtruar më sipër, kjo pjesë e Kodit të Procedurës Civile, është rregulluar me dispozitat procedurale që përmban ligji për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Rrjedhimisht, nëse nuk aplikohet dhënia e mundësisë për ndërmjetësim, sipas këtij detyrimi ligjor që ka gjykata, atëherë nuk do të mund të themi se janë bërë të gjitha përpjekjet. Madje, në këtë dispozitë, gjykata duhet të shohë përtej mundësisë së ndërmjetësimit. Ajo përveç përpjekjes që vjen si detyrim ligjor për të pajtuar palët me anë të ndërmjetësimit, mund edhe të tentojë vetë për të bërë diçka të tillë, nëse shikon se ndërmjetësi i ka bërë përpjekjet, por akoma ekziston një mundësi. Megjithatë, përgatitja e ndërmjetësit në fushën e ndërmjetësimit, duke u kualifikuar me një orientim të qartë aftësimi në këtë drejtim, do të ishte më efektive. Për këtë arsye, edhe ligjvënësi, ka parashikuar krijimin dhe formëzimin e këtij instituti të ri të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

“*Për këtë qëllim, kur është rasti, urdhëron edhe paraqitjen e vetë palëve*”. Më tej në këtë dispozitë shohim që pajtimin, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ligjvënësi i jep një rëndësi të posaçme, duke arritur deri në detyrimin e palëve në rastet që gjykata e sheh të arsyeshme. Përmbajtja e këtij urdhërimi, në fakt, ka efekt për seancën e pajtimit që mund të kryejë gjykata, duke ushtruar vetë kompetencat e personit të ndërmjetëm, që lehtëson

²⁷¹ Neni 158/a, i Kodit të Procedurës Civile.

zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ky veprim, nëse shihet i arsyeshëm, mund të kryhet pasi është tentuar që të ftohen palët në ndërmjetësim pranë ndërmjetësit. Dalim në këtë konkluzion pasi, vetë procesi i ndërmjetësimit është një proces vullnetar nga përmbajtja e tij. Nëse do të detyronim palët për të kryer një veprim të tillë, atëherë i gjithë ky proces vullnetar do ta humbte kuptimin e tij. Atëherë lind pyetja: përse ligjvënësi ka lejuar që gjyqtari të urdhërojë paraqitjen e palëve përpara tij? Së pari, duhet të kemi parasysh se shpesh përkatësit ku kryen këto veprime, është një seancë në të cilën gjyqtari kryen edhe veprime të tjera përveç veprimit të pajtimit. Në këtë seancë, gjyqtari përkatit çështjen për në seancë gjyqësore. Kështu atij i duhet të marrë çdo informacion të nevojshëm, ose të bëjë përpjekjet për të marrë çdo informacion të nevojshëm. Në këtë kuptim, njëkohësisht, gjyqtari duhet të sigurohet që e ka ezauruar plotësisht detyrimin për të provuar çdo mundësi pajtimi mes palëve.

“Përpjekjet për pajtim mund të përsëriten në çdo fazë të hetimit gjyqësor”. Shikojmë se ligjvënësi detyron gjykatën t’i japë një rëndësi të veçantë procedurës së pajtimit. Në thelb Kodi i Procedurave Civile, ka të njëjtin objekt me ligjin e ndërmjetësimit. Të dyja këto ligje si objekt kanë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Kodi i Procedurave e bën këtë nëpërmjet forcës shtrënguese të gjykatës, ndërsa ligji për ndërmjetësimin, ia lë palëve në dorë zgjidhjen e konfliktit. Megjithatë, rregullimin e marrëdhënies, procedura e ndjekur në gjykatë e ka më të vështirë se procedura e ndërmjetësimit. Mendoj se në përmbajtje të sa parashtruam më sipër, është mishëruar qëllimi final dhe kryesor i ligjvënësit, ai i bërjes së të gjitha përpjekjeve për rregullimin e marrëdhënieve, dhe lënien si opsion final, atë të zgjidhjes së mosmarrëveshjes me anë të forcës së vendimit gjyqësor.

“Kur arrihet pajtimi pa filluar seanca gjyqësore, mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga palët. Gjyqtari me vendim miraton pajtimin. Kur pajtimi arrihet në seancë gjyqësore, kushtet e marrëveshjes pasqyrohen në procesverbalin gjyqësor”. Shohim pra, se në të njëjtën frymë me ligjin për ndërmjetësimin, funksionon edhe marrëveshja e arritur pranë gjykatës. Palët mund të arrijnë të pajtohen me propozim të gjyqtarit, pranë gjyqtarit, duke e kthyer marrëveshjen e tyre në një titull ekzekutiv me miratimin e saj, me një vendimi gjyqësor, por, duke mos u ndaluar sipas kësaj dispozite që i njëjti veprim të kryhet, edhe kur arrihet zgjidhja dhe pajtimi me anë të marrëveshjes së ndërmjetësimit.

Gjykata jep vendim për miratimin e tij, por në çdo rast ai nuk duhet të jetë në kundërshtim me ligjin. Parashikimi në çdo rast i ligjvënësit, konfirmon qëllimin kryesor që

është rregullimi i marrëdhënies, dhe tentimi, duke bërë çdo përpjekje për të arritur këtë qëllim. Ndalea e vetme ligjore, është ndalesa klasike, që marrëveshja të mos vijë në kundërshtim me ligjin. Një parashikim i tillë është i drejtë. Madje, duhet të kemi parasysh parashikimin që ligji i ndërmjetësimit ka për një situatë të tillë. Ai madje, siç kemi parashikuar më lart, parashikon se edhe në këto raste, për sa kohë veprimet nuk ngarkojnë palët me përgjegjësi përpara ligjit, palët janë të lira t'i pranojnë ato dhe t'i përligjin me vullnetin e tyre, në format e duhura ligjore.

“Kundër vendimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim ose mospranimin e pajtimit mund të bëhet ankim i veçantë”. Parim klasik ky, i cili ligjëron të drejtën e palëve për një proces të rregullt ligjor, të cilët kanë të drejtë që pretendimet e tyre të dëgjohen në shkallën më të lartë gjyqësore, dhe e drejta e tyre e ankimit nuk mund të refuzohet.

Për të bërë të mundur që palët të provojnë mundësinë për të zgjidhur konfliktin që ekziston midis tyre, me anë të ndërmjetësimit, ligjvënësi ka parashikuar procedurën e pezullimit të gjykimit. Në rastet kur palët bien dakord të provojnë zgjidhjen e konfliktit që ekziston ndërmjet tyre, nëpërmjet ndërmjetësimit, referuar nenit 297/b, gjykata vendos pezullimin e procedurës gjyqësore deri në ezaurimin e kësaj mundësie. Në këtë dispozitë parashikohet se: *“Gjykata vendos pezullimin e vendimit kur: b) kërkohet nga të dyja palët”*. Rasti, në të cilin parashikohet pranimi i procesit të ndërmjetësimit, sipas dispozitës 13 të ligjit 10385, *“Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”*, parashikon se pranimi i palëve për të provuar ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre, detyrimisht barasvlerësohet më kërkesën e palëve për të pezulluar procesin gjyqësor, ku ata janë duke marrë pjesë. Në këtë mënyrë, gjykata bazuar në këtë dispozitë referuese, në rast se shikon që ekziston mundësia për një zgjidhje paqësore të konfliktit, vendos pezullimin e gjykimit, duke i dhënë një afat të caktuar palëve për këtë qëllim dhe dërgimin e çështjes për të ndjekur procesin e ndërmjetësimit. Njëkohësisht, ky mjet procedural, i cili parashikon pezullimin e gjykimit në rast se palët pranojnë të provojnë procedurën e ndërmjetësimit, është një mjet procedural, i cili përbën një garanci edhe për afatet procedurale.

Në rastet e pezullimit të gjykimit, pezullohen edhe afatet e parashkrimit të së drejtës. Kjo, në fakt, për mendimin tim është një mangësi e ligjit 10385, *“Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”*. Ligji për ndërmjetësimin, duhet të parashikojë pezullimin e

afateve të parashkrimit si mase sugjestionuese për palët, që ata të shtyhen për të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimit deri në momentin e fundit.

6.4. Procedura për ndërmjetësim në procesin penal

Të trajtojmë çështjet dhe argumentet, të cilat bëjnë përcaktimin e momentit kur duhet të gjejë aplikim ligji për ndërmjetësimin në procesin penal. Në këtë këndvështrim duhet të vërejmë me kujdes problemet që lidhen me qasjen apo kundërshtitë në raport me drejtësinë restauruese dhe qëllimit të së drejtës penale. Bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi, neni 24 i K.Pr.P. dhe neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, arrijmë në konkluzionin se nuk mund të analizojmë pa pasur parasysh qëllimin e drejtësisë penale, qëllim i cili mbështetet në parimin e detyrueshmërisë së ushtrimit të ndjekjes penalenga organi i Prokurorisë.

Dispozita e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale nuk i heq të drejtën prokurorisë të nisë procedimin penal ndaj autorit të veprës penale, ajo thjesht i krijon mundësinë të dëmtuarit akuzues të nisë procedimin. Kushtetuta i ka njohur si rregull prokurorisë, fillimin e procedimit penal por, në rastet kur i dëmtuari ka prova dhe fakte të mjaftueshme, mund të hapë çështje penale për vepra që nuk kanë rrezikshmëri shoqërore të madhe dhe për të cilat prokuroria nuk është e mendimit se duhet filluar hetimi²⁷².

Gjithashtu, duhet theksuar fakti se gjatë procesit të ndërmjetësimit në fushën penale, pavarësisht se jemi midis dy pozicioneve të kundërta, që tërheqin drejt vetes rezultatet dhe qëllimet e këtij Ndërmjetësimi, pika fillestare është vepra penale e kryer²⁷³.

Do të shohim se në anën e drejtësisë restauruese²⁷⁴, nga vetë kuptimi i fjalës, orientohemi drejt kënaqjes së nevojave të viktimës dhe të shkelësit; ndërsa në procesin penal rezulton një karakter i tipit korrektues/ rehabilitues. I pari: i orientuar drejt kërkimit të një zgjidhje të pranueshme e të arsyeshme, ndërmjet palëve në konflikt; i dyti, për të orientuar

²⁷²Vendimi nr. 3, datë 06.02.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

²⁷³Çerekja B. (2013). *Ndërmjetësimi në veprat penale të të miturve*, Disertacion, fq. 32-35.

²⁷⁴Drejtësia restauruese është një qasje në drejtësi që fokusohet në nevojat e viktimave dhe shkelësve, si dhe komunitetin e përfshirë, në vend të Parimeve të ligjore abstrakte për të ndëshkuar kundërvajtësit., https://en.wikipedia.org/wiki/Restorative_justice. 07.01.2016.

pozitivisht procesin e rehabilitimit dhe të zhvillimit të një shoqërie të “shëruar” nga kriminaliteti.

Përveç kësaj, ndërmjetësimi siguron ndihmë për kundërvajtësit në mënyrë që të shmangen veprave në të ardhmen. Kjo teori të drejtësisë konsideron krimin dhe keqbërjen të jetë një vepër penale kundër një individi ose komunitet, në vend që ta konsiderojë atë një vepër penale kundër Shtetit²⁷⁵.

Ndërsa disa studime të vjetra kanë treguar rezultate të përziera, që prej vitit 2013, studimet që kanë krahasuar normën e recidivizmit, kanë treguar rezultate më definitive dhe në favor të Drejtësisë Restauruese^{276 277}.

Drejtësia restauruese është përdorur kryesisht për viktimën, Në mënyrë të veçantë me një lloj të ndërmjetësimit dhe/ose shpërblimi nga kundërvajtësit. Drejtësia restauruese është e bazuar në sjelljen së bashku, të viktimës, shkelësit, dhe komunitetit. Në këtë proces të gjithë kanë pjesë të barabarta në riparimin e marrëdhënieve të shkatërruara nga krimi. Në përgjithësi, shkelësi është përgjegjës për viktimën, për veprimin kriminal dhe përgjegjës ndaj komunitetit. Premisa themelore e drejtësisë restauruese thotë se të tre janë të përgjegjshëm për njëri-tjetrin.

Duhet të kemi parasysh se shpërblimi i përmendur në paragrafin e mësipërm duhet të jetë në raport të drejtë me dëmin dhe pasojën kriminale. Ai nuk mund të ketë formën e blerjes së drejtësisë. Në këtë mënyrë nuk do të arrinim në atë që është qëllimi i ligjit, por do të bënim të kundërtën e saj.

Nisur nga këto qëllime, le të marrin në analize e të vërejmë si është e organizuar Procedura Penale për të orientuar në procesin e ndërmjetësimit.

Në nenin 14, të ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” është e parashikuar se: “Gjykata, në përputhje me nenet 333 dhe 338 të Kodit të Procedurës Penale, fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes, objekt gjykimi, parashikuar në nenin 2 pika 3 të këtij ligji, duke iu caktuar palëve një afat në

²⁷⁵Price, M. (2000). “Personalizing Crime”. Dispute Resolution Magazine 7 (1). pp. 8–11.

²⁷⁶Hayes H. (2005). *Assessing Reoffending in Restorative Justice Conferences*. 38(1). Australian and New Zealand Journal of Criminology. pp. 77.

²⁷⁷Braithwaite J. (1999). *Restorative Justice: assessing optimistic and pessimistic accounts*, in Michael Tonry ed, *Crime and Justice: A Review of Research* Volume 2.

*përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes.*²⁷⁸. Nëse vërejmë me vëmendje këto dy dispozita, neni 333 dhe neni 338 i Kodit të Procedurës Penale janë dispozita të cilat përshkruajnë veprimet përgatitore të gjykatës. Në nenin 333 është parashikuar se: *“Caktimi i seancës”*1. *Brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i kërkesës së prokurorit ose të dëmtuarit akuzues, kryetari i trupit gjykues, i ngarkuar për gjykimin e çështjes cakton datën e seancës gjyqësore.* 2. *Data e seancës i njoftohet prokurorit, të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit, palëve private dhe përfaqësuesve të tyre të paktën dhjetë ditë para datës së caktuar për gjykim*²⁷⁹.

Procedura jonë penale është e organizuar në mënyrë të tillë, ku pajtimi nuk është një kryefjalë në përmbajtjen e saj. E vetmja dispozitë, e cila disponon këtë fjalë është dispozita nr.338 e Kodit të Procedurës Penale, dispozitë e cila parashikon: *“Përprjekja për pajtim”*; 1. *Në rastin e veprave që ndiqen me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, gjykata thërret të dëmtuarin dhe atë kundër të cilit është bërë kërkesa për gjykim dhe u propozon zgjidhjen e çështjes me pajtim. Në qoftë se i dëmtuari e tërheq kërkesën dhe ai që akuzohet e pranon tërheqjen, gjykata vendos pushimin e çështjes. Në të kundërtën ajo cakton datën e seancës dhe u bën të njohur atyre se mund të ndihmohen nga mbrojtës*”. Pra shikojmë së parashikimi për përprjeke të pajtimit, vlen vetëm për ato vepra, të cilat ndiqen nga i dëmtuari akuzues. Këto vepra i kemi përshkruar pak më sipër, në analizën që i kemi bërë veprave të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë, në përmbajtje të saj përcakton se gjyqtari është i detyruar të thërrasë palët përpara saj dhe t’iu propozojë atyre zgjidhjen e çështjes me pajtim. Vetëm pasi të thërrasë palët në seancë pajtimi apo pasi të kalojë çështjen në seancë gjyqësore, gjykata, mund të vendosë pushimin e çështjes për shkak të pavlefshmërisë së kërkesës së paraqitur nga i dëmtuari akuzues²⁸⁰.

Vërejmë se përcaktimi në këtë dispozitë i procedurës së pajtimit si një procedurë detyruese, nuk vjen aspak në kundërshtim me parimin kushtetues, që të drejtën e procedimit penal e ka vetëm prokurori. Një ndryshim tjetër midis procesit të filluar mbi një akuzë publike dhe atij të bazuar mbi akuzën private, pra nga i dëmtuari akuzues, është se ky i fundit mund të përfundojë edhe me marrëveshje, kur i dëmtuari pranon të marrë një dëmshpërblim moral ose material nga i pandehuri, duke tërhequr kështu akuzën në çdo fazë të procesit.

²⁷⁸ Neni 14 i ligjit 10385, *Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve*.

²⁷⁹ Neni 333, i Kodit të Procedurës Penale, *“Caktimi i séances”*.

²⁸⁰ Vendimin nr. 840, Date 02.10.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë; fq. 3, 4, 5.

Madje, neni 338 i Kodit të Procedurës Penale parashikon edhe një procedurë pajtimi midis palëve, në rastet e veprave penale që ndiqen me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, e cila është e detyrueshme. Nëse kjo përpjekje dështon, atëherë mund të ngrihet akuza private. Kjo bëhet me qëllim që gjykata të mos ngarkohet me shqyrtimin e çështjeve, të cilat nuk mbartin në vetvete ndonjë rrezikshmëri të lartë dhe palët mund t'i kursejnë vetes një proces, i cili mund të përfundojë edhe me pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes²⁸¹.

Në referim të këtyre përcaktimeve, parashikimi i veprave penale për të cilat duhet vetëi dëmtuari akuzues të vlerësojë, të fillojë apo jo hetimi gjyqësor, konsiderohet si një zgjidhje e mirë. Në këtë mënyrë i dëmtuari është më aktiv dhe më i lirë në vlerësimet dhe disponimet e tij gjatë procesit penal. Ai, sipas analizës së kësaj dispozite, ndjek çështjennë mënyrë të pavarur, në të gjitha shkallët e gjyqësorit²⁸².

Gjithashtu, qëllimi i ligjvënësive, është t'i krijojë mundësitë e duhura individit, që ai të çmojë në mënyrë të pandikuar shkallën e cenimit të interesave të tij dhe veprimet që duhet të kryejë, për mbrojtjen juridike penale ose civile të tij. Ligji procedural penal, megjithatë, edhe në këto raste, kujdeset për mos të shmangur pjesëmarrjen e prokurorit në gjykimin e këtyre çështjeve. Prokurori, në gjykimin e të pandehurit, merr pjesë dhe sipas rastit, kërkon dënimin ose pafajësinë e tij²⁸³.

Sa i përket veprave, të cilat ndiqen mbi ankim, sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale, momenti kur duhet të propozohet aplikimi i ndërmjetësimit nuk përcaktohet nga Kodi i Procedurës Penale, por nga Ligji për ndërmjetësimin. Në fakt, që në projektin të këtij ligji, ka qenë planifikuar, që për këto vepra të tentohej ndërmjetësimi që në organin e prokurorisë. Pjesëmarrësit në krijimin e ligjit 10385, në projektligjin e propozuar në parlament, kishin propozuar që, prokurori, përpara se të dërgohej çështja për gjykim, duhet të ftonte palët në seancë ndërmjetësimi²⁸⁴. Një gjë e tillë nuk u bë e mundur, e megjithatë, procedura e përcaktuar e lejon mundësimin e ndërmjetësimit në çdo fazë të procedimit. Një gjë e tillë

²⁸¹Vendimi nr. 3, datë 06.02.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

²⁸²*Privatklage – private complaint* siç quhet ndryshe, është e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale gjermane që në vitin 1877 neni 374 - [394](#). fq. 141.

²⁸³Neni 59/2 I Kodit të Procedurës Penale, 2. *“Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij”*.

²⁸⁴Republika e Shqipërisë, Kuvendi, Komisioni *“Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike Dhe Të Drejtat E Njeriut”*, Procesverbal Datë 17.01.2011, Ora 09:00.

parashikohet në nenin 286 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: “1. Tërheqja e ankimit bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit me deklaratë të paraqitur në organin që procedon. 2. Tërheqja e ankimit mund të bëhet në çdo fazë të procedimit, gjersa vendimi i gjykatës nuk ka marrë formën e prerë. 3. Shpenzimet e procedimit janë në ngarkim të atij që tërheq ankimin, përveçse, kur në aktin e tërheqjes është parashikuar, me marrëveshje, që ato të jenë tërësisht ose pjesërisht në ngarkim të atij kundër të cilit është bërë ankimi”²⁸⁵. Shohim që në parashikimet e bëra në këtë dispozitë, ligjvënësi është munduar që t’i japë sa më shumë mundësi dhe liri veprimi palëve për të arritur në marrëveshje. Në paragrafin e parë shikojmë se kjo dispozitë e parashikon këtë të drejtë si një të drejtë të delegueshme. Pavarësisht se veprat e parashikuara nga neni 284 i Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi i parashikon ato si vepra të lehta dhe me karakter ngushtësisht personal, duke lënë në diskrecionin e palëve, edhe të drejtën e ndjekjes penale, vërejmë se bëhen të gjitha përpjekjet për të lehtësuar rregullimin e marrëdhënies ndërmjet palëve të konfliktuara. Në këtë frymë të ligjit, ligjvënësi mjaftohet me shprehjen e vullnetit të palës së dëmtuar për të kryer një veprim të tillë, siç e parashikon paragrafi i parë i nenit 284 i Kodit të Procedurës Penale, vullnetin për të hequr dorë nga ankimi, dhe nuk i jep një rëndësi të veçantë procedurës dhe mënyrës se si paraqitet ky vullnet. Madje për të lehtësuar kryerjen e një veprimi të tillë, lejon kryerjen e tij nga përfaqësuesi ligjor. Një gjë të tillë e plotëson edhe përmbajtja e ligjit për ndërmjetësimin.

Nëse vërejmë me vëmendje, në nenin 15 të ligjit për ndërmjetësimin, parashikohet “Liria e palëve për rregullat dhe mënyrën e ndërmjetësimit”. Në këtë dispozitë, ligji vazhdon me frymën e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, për të arritur qëllimin e parashikuar në to. Madje, në dispozitat e ligjit për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, theksohet më tepër akoma dhe në mënyrë të shprehur, qëllimi i ligjvënësit për të rregulluar marrëdhënien ndërmjet subjekteve të përfshira në këto vepra penale, të parashikuara nga neni 284 i Kodit të Procedurës Penale. Më tej në këtë dispozitë, vërehet liria e palëve për të vendosur rregulla në mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit. Në paragrafin e parë parashikohet se “Palët, në përputhje me këtë ligj, janë të lira të vendosin rregullat dhe mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit”. Ky parashikim vjen gjithashtu, në përputhje me parashikimin e nenit 284, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë parashikon të drejtën e palëve për të vendosur me marrëveshje ndërmjet tyre se si

²⁸⁵Neni 286 i Kodit të Procedurës penale, Heqja dorë nga e drejta e ankimit.

do të ndahen shpenzimet e bëra gjatë këtij procedimi nga palët. Kjo gjë është përcaktuar si një nga detyrat e ndërmjetësit edhe në nenin 17²⁸⁶ të ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, por, gjithashtu mund të jetë edhe një nga objektet e konfliktit përpara Ndërmjetësit²⁸⁷.

Pasi vlera tashmë e diskutuar në rastin konkret është thjesht një detyrim, i cili mund të përcaktohet ndërmjet palëve, se cili do ta marrë përsipër apo si do të ndahet.

Palët janë të lira sipas nenit 286 të Kodit të Procedurës Penale, që në çdo moment deri sa vendimi të marrë formë të prerë, të heqin dorë nga e drejta e ndjekjes penale²⁸⁸. Ky parashikim i Kodit të Procedurës Penale, lejon palët, që në çdo fazë dhe shkallë të procedimit e gjykimit, të mund të heqin dorë nga ankimi i tyre. Në këtë mënyrë, efektet e një vendimi gjyqësor, që në fakt, për konflikte të tilla me karakter kaq ngushtësisht personal, ku edhe ligjvënësi i ka parashikuar këto si akuza private dhe jo si shkelje që kanë një impakt dhe rëndësi aq të lartë sa të konsiderohen cenim i rendit juridik, nuk do të arrijnë të kenë efektin agresiv që ligji parashikon. Nëse palët do të arrijnë të zgjidhin një marrëdhënie të tillë ndërmjet tyre, atëherë efekti agresiv i vendimit gjyqësor nuk do të cenonte më tej marrëdhënien ndërmjet palëve, por edhe impakti i drejtësisë që do të realizohej do të ishte restaurues, si në pasoja, ashtu edhe në marrëdhënien njerëzore.

Nëse arrihet që palët të bien dakord, për të zgjidhur një çështje penale me ndërmjetësim dhe plotësohen kushte e përshkruara më sipër, sa i përket heqjes dorë nga ankimi, atëherë do të gjendemi përpara aplikimit të nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon mosfillimin e procedimit, në këtë dispozitë parashikohet se: “*Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur:*

²⁸⁶ Neni 17 i ligjit 10385 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, Zhvillimi i ndërmjetësit, 1. “Përpara fillimit të procedurës së ndërmjetësit, ndërmjetësi është i detyruar që të informojë palët për qëllimet dhe parimet e përgjithshme, rolin e ndërmjetësit dhe të palëve në proces, shpenzimet e procesit të ndërmjetësit dhe efektet e marrëveshjes së ndërmjetësit”.

²⁸⁷ Neni 2/2 I ligji 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”; Fusha e Zbatimit; “Ndërmjetësimi zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës dhe familjare”.

²⁸⁸ Neni 286/2 i Kodit të Procedurës Penale; 2. “Tërheqja e ankimit mund të bëhet në çdo fazë të procedimit, gjersa vendimi i gjykatës nuk ka marrë formën e prerë”.

c) mungon ankimi i të dëmtuarit ose ai e tërheq ankimin;

e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.”²⁸⁹

Pra, nëse ankimi tërhiqet si rrjedhojë e çdo arsyeje, procedimi nuk mund të fillojë. Interpretuar kjo dispozitë në harmoni me sa kemi parashtruar më sipër, nëse aplikohet ndërmjetësimi, atëherë palët do të arrijnë që në çdo faze dhe shkallë të gjykimit ta pushojnë atë. Në këtë mënyrë, ata do të përcaktojnë vetë se cila do të jetë zgjidhja më e drejtë për ta.

Ata janë të lirë të vendosin që ndërmjet tyre do të aplikohet konflikti, i cili do të shuhet vetëm duke rregulluar pasojat civile apo edhe mund të mos parashikojnë asnjë gjë, e mund të mjaftohen me një shtrëngim dore për të shuar konfliktin ndërmjet tyre.

Në nenin 330/4, “Detyrimi i ankuesit me shpenzimet dhe dëmet” të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “4. Shpenzimet dhe dëmet caktohen nga prokurori. Kundër vendimit të tij mund të bëjnë ankim në gjykatë, i dëmtuari, i pandehuri dhe i padituri civil”. Vërejmë se titullar i përcaktimit të vlerës së dëmit, sipas kësaj dispozite është Prokurori, por, duhet të kemi parasysh se kjo dispozitë është ajo që aplikohet, nëse është bërë ankimi dhe ky ankim është apo do të gjykohet. Në këtë rast prokurori që merr pjesë në këtë procedim, përveç detyrave të tjera procedurale, bën edhe vlerësimin e dëmit. Në rastin kur palët e zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me ndërmjetësim, atëherë titullar i kësaj të drejte s’ka se të jetë Prokuroria, pasi ajo nuk merr fare pjesë në këtë procedim. Rrjedhimisht, duke u referuar në analogjinë e përcaktimeve për akuzën private, kjo e drejtë i përket atij që ka të drejtën ekskluzive të akuzës private, që është pala e dëmtuar. Gjithsesi, duhet pasur parasysh që të jemi të kujdesshëm në administrimin e këtyre vlerave, pasi do të cenonim rëndë qëllimin që ligji për ndërmjetësimin projekton. Përcaktimi i një vlere, e cila do të jetë në përputhje me realitetin dhe dëmin e shkaktuar nuk duhet të tejkalojë kufijtë, pasi nëse e bën këtë ajo do të konsiderohej një drejtësi e blerë.

Në nenin 14/2, të ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” parashikohet se “*Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë rifillimin e gjykimit*”. Ky përcaktim, në fakt, vjen në përputhje me frymën e ligjit për Ndërmjetësim në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, pasi, siç shikojmë gjatë gjithë përmbajtjes së tij, në thelb qëndron fryma e ligjërimit të vullnetit të palëve si pjesë e drejtësisë absolute

²⁸⁹Neni 290/c/e i Kodit të procedurës Penale, “*Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit*”.

që ata kërkojnë. Nëse vullneti i tyre përcakton që drejtësia do të pranohet e vendosur nga gjykata, atëherë thelbi i ligjit për ndërmjetësimin nuk na lejon të dalim kundër tij.

Fakti qëndron shumë thjeshtë, në raport me këto dy zgjidhje që ligji njih. Në të dyja rastet biem dakord, që ligji i ka dhënë një zgjidhje mosmarrëveshjes të lindur nga veprat penale parashikuar nga nenet 59 e 284 të Kodit të Procedurës Penale, si në rastin e zgjidhjes në gjykatë, ashtu edhe në rastin e zgjidhjes me ndërmjetësim. Efektet nuk mund të jenë të njëjta kur, në njërin rast, vendos një palë e tretë se çfarë do të ndodhë me konfliktin në fjalë, dhe në rastin tjetër palët vendosin vetë²⁹⁰. Në rastin e zgjidhjes gjyqësore kemi një person të dënuar, i cili mund të shkojë në burg a të paguaje një gjobë, apo çdo lloj dënimit alternativ, që ai merr në një formë të detyruar, në zgjidhjen me ndërmjetësim në rastin më të keq, palët ndahen duke shtrënguar dorën njëri-tjetrit. Pra, shikojmë se jemi përpara një alternative zgjedhjeje, që në pamje të parë na ngjan me një situatë ideale, por, në fakt, duhet të kuptojmë më në thelb se çfarë ndodh me psikologjinë e konfliktit.

E nevojshme është që konsumatori i këtyre dy shërbimeve, atë të vënë në dispozicion nga ligji me anë të gjykatës, dhe atë të vënë në dispozicion me anë të ndërmjetësimit, të edukohet në pranimin e ndërmjetësimit si një rrugë me të njëjtin efektivitet për të marrë drejtësi. Pra, rrënjët e problemit tregojnë se pjesa më e madhe e palëve në konflikt, me këmbëngulje kërkojnë “DREJTËSI”- dhe në çdo kohë që mendojmë drejtësi, e lidhim këtë koncept me gjykatën dhe gjyqtarin. Kështu, mendoj se ne vetë projektojmë veten si “viktima”²⁹¹ të sistemit të drejtësisë. Palët i kanë rrënjësuar thellë lidhjet e konceptit të drejtësisë me gjyqtarin dhe gjykatën. Kjo, shpesh bën që pritshmëritë e tyre për procesin gjyqësor të jenë tërësisht jo reale. Palët kanë dëshirë madje të dëgjohen në gjykatë, dhe kjo për ta është e vetmja rrugë për ta marrë drejtësinë të plotë. Në këtë logjikë, të kthesh palët nga procesi gjyqësor në atë të ndërmjetësimit, për ta mund të jetë një sfidë e frikshme. Ndërmjetësimi ndoshta mund të mos aftësohet asnjëherë në nivel të tillë sa të konkurrojë gjykatën. Ky proces nuk mund të ofrojë nivelin e hakmarrjes, që palët kanë nevojë të ndjejnë, as nivelin e poshtërimit publik për kundërshtarin e tyre, që e ofron vendimi gjyqësor, as

²⁹⁰Paul Randolph leksion dt. 06.05.2015 Sarandë; Albania.

²⁹¹Në kuptimin e mendimit të kushtëzuar vetëm në këtë drejtim.

vlerat e mëdha të lekëve që ata parashikojnë të përfitojnë nga procesi gjyqësor²⁹². Në këtë mënyrë, nëse nuk ka asnjë angazhim serioz nga operatorët e drejtësisë, nuk do të mundemi të shijojmë asnjëherë të mirat e ndërmjetësimit.

6.5. Disa tipologji ndërmjetësimi

Përkufizimet e ndërmjetësimit, të përdorura nga autorë të ndryshëm, pasqyrojnë, në përgjithësi, shkallën e tyre të aderimit të modeleve të ndryshme teorike, kështu që është e nevojshme të japim një shqyrtim të shkurtër të modeleve të ndërmjetësimit të njohura ndërkombëtarisht.

a). Modeli i bazuar mbi negocimin (Shkolla e Harvard-it), i cili ndryshe nga dy të tjerët e ka origjinën e tij në zhvillimin e një modeli negociimi të realizuar nga një grup (HNP – Harvard Negotiation Project) i themeluar nga Roger Fisher, më 1980, i njohur zyrtarisht nga Universiteti i Harvardit,²⁹³ dhe pastaj i aplikuar në ndërmjetësimin e asistuar apo atë të udhëzuar.²⁹⁴

Ky model negociimi i ilustruar nga Roger Fisher dhe William Ury, në librin "*Getting to yes*" (1981), propozon zhvillimin në katër faza kryesore,²⁹⁵ të cilat, më vonë u bënë shtatë,²⁹⁶ një metodë negociimi që ka si objektiv themelor realizimin e marrëveshjeve në gjendje të kënaqë interesat e të gjitha palëve të përfshira.

b). Modeli transformues i Bush dhe Folger, i cili përfaqëson një evoluim të modelit të Harvardit, krijuar me qëllim për të formuar tek palët ndërgjegjshmërinë në kapacitetin e tyre

²⁹² Randolph, P. (2011). "*The Mediation Conundrum*" - why mediation needs a makeover or a nudge from Government. New Law Journal. pp.18-22.

²⁹³ Nga projekti HNP mori nismën në vazhdim. (1983). *Program on Negotiation Managing (PON)*, një konsorcium universitar, i lidhur me Harvard Law School, që përfshin një seri fakultetesh dhe institutesh në zonën e Bostonit dhe ofron kurse, aktivitete kërkimore dhe këshilla profesionale për zhvillimin e teorisë dhe praktikës së negociatave në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

²⁹⁴ Folberg J. & Taylor A. (1984). *Mediation-A Comprehensive Guide to Resolving Conflicts without Litigation*, San Francisco.; Jossey– Baas & Publishers,(1991) *Community Mediation : A Handbook For Practitioners And Researchers*, Guilford Publications.

²⁹⁵ Të ndash njerëzit nga problem, të përqendrohesh tek interesat dhe jo tek pozicionimi, të krijosh mundësitë për avantazh të ndërsjellët dhe të përdorësh kriteret objektive.

²⁹⁶ Interesa, legjitimitet, marrëdhënie, alternativa dhe alternativa më e mirë për akt-marrëveshje e negociuar, opsione, angazhime dhe komunikime.

për ndryshim. Në librin "*The promise of mediation*", Bush dhe Folger thonë se: "*premtimi i vetëm që mund të bëjë ndërmjetësimi është ai që të mundësojë një transformim real dhe aktiv të marrëdhënieve midis njerëzve*"²⁹⁷. Autorët identifikuan të shtatë hapat që ndërmjetësit duhet të zhvillojnë gjatë procesit transformues,²⁹⁸ duke parashtruar se rendi i treguar nuk përfaqëson një praktikë transformuese ideale, por mundëson ndërtimin e një perspektive të ndryshme për rolin e ndërmjetësit. Në vizionin transformues, konfliktet përjetohen si një mundësi për të ndryshuar marrëdhëniet, duke promovuar "vlerësimet" dhe "njohjen" e protagonistëve të tyre, ku këto të fundit lejojnë rritjen morale të njerëzve.

c). *Modeli qarkor-narrativ krijuar nga Sara Cobb*, nis nga koncepti, sipas të cilit eksperiencia dhe realiteti shoqëror organizohen nëpërmjet narrativitetit (*storytelling*), dhe pranon që konfliktet janë prodhim i koherencës midis historive që i sjellin. Modeli narrativë është si bashkëndërtimi i një historie të përbashkët, në të cilin ndërmjetësi ka një rol kyç, për shkak se ai ndërhyr në marrëdhëniet midis palëve. Për këtë arsye, reflektimi i parë që shkakton modeli ka të bëjë me neutralitetin e ndërmjetësit. Struktura e procesit të ndërmjetësimit, qarkor-narrativ, përbëhet nga një takim paraprak dhe nga katër faza të tjera²⁹⁹.

6.6. Mbyllja e ndërmjetësimit

Akti finalizues i një procesi ndërmjetësimi është arritja e marrëveshjes së pajtimit midis palëve të konfliktuara. Duke u mbështetur në ligjin për ndërmjetësimin, aktmarrëveshja përmban detyrimet dhe kushtet, që palët i venë njëra-tjetrës, mënyrën dhe afatin e përmbushjes së tyre, nënshkrimin e palëve dhe atë të ndërmjetësit. Ajo lidhet ndërmjet palëve me shkrim, me përjashtim të rasteve kur nuk është e domosdoshme për vetë natyrën e mosmarrëveshjes. Çdo konflikt që zgjidhet me pajtim, përfundon me sukses, atëherë kur palët pranojnë kushtet e njëra-tjetrës dhe hartojnë një aktmarrëveshje pajtimi. Në përmbajtje të saj duhet të jepen identitetet e palëve të konfliktuara, data dhe vendi i ndërmjetësimit, lloji i konfliktit dhe natyra e tij, pretendimet e palëve për shkaqet e konfliktit dhe rrugëzgjidhjet

²⁹⁷Bush R. & Folger J. (1994). *The Promise of Mediation : Responding to Conflict through Empowerment and Recognition*. San Francisco. Jossey Bass.

²⁹⁸Për shkak se një praktikë transformuese ideale kërkon shumë komponentë të tjerë.

²⁹⁹ Takimi i përbashkët, takimi privat, takimi i brendshëm dhe takimi i fundit i përbashkët

ose kushtet, që ato i vënë njëra-tjetrës për të dalë nga konflikti, zgjidhja e arritur dhe nënshkrimet e palëve dhe i ndërmjetësit.³⁰⁰

Aktmarrëveshja, në të shumtën e rasteve, lidhet me shkrim, përveç rasteve kur ndërmjetësi dhe palët vlerësojnë se ajo mund të lidhet me gojë,³⁰¹ nisur nga natyra e mosmarrëveshjes, si dhe kur ligji nuk e ndalon një gjë të tillë.

Në konfliktet me natyrë pasurore, në përgjithësi, që lidhen me dëmshpërblimet dhe kompensimet në të holla, aktmarrëveshja bëhet me shkresë. Aktmarrëveshja shkresore duhet të ketë të shprehura qartë të gjitha kushtet që palët i vënë njëra-tjetrës dhe mund të parashikojë edhe afate për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që palët i kanë vënë njëra-tjetrës. Në këto raste ndërmjetësi, pasi të skadojë afati, duhet të verifikojë edhe fatin e realizimit të saj.

Sipas ligjit të ndërmjetësit, aktmarrëveshja hartohet në tri kopje, një për secilën palë dhe një kopje depozitohet tek subjekti ndërmjetës, i cili është i detyruar të ruajë dhe të administrojë aktmarrëveshjen dhe dokumentacionin në lidhje me të³⁰². Në këtë ligj jepen disa rregulla të anës formale, të cilat janë të rëndësishme për provueshmërinë e realizimit të procesit të ndërmjetësit dhe për evidentimin e rasteve të zgjidhura nga ana e organizatës joqeveritare. Formalizmi i mësipërm ka rëndësinë e tij, sepse mbajtja, depozitimi dhe skedimi i çdo marrëveshje të arritur, midis të konfliktuarve, ka vlerën e provës për procese të ardhshme. Depozitimi dhe ruajtja e kopjes së aktmarrëveshjes dhe e dokumentacionit të paraqitur nga palët, është një nga detyrimet e subjektit që organizon shërbimin e ndërmjetësit, në mënyrë që të ruhet fshehtësia e të dhënave që kanë dalë gjatë ndërmjetësimin. Materialet e grumbulluara gjatë ndërmjetësit nuk mund të dalin jashtë

³⁰⁰Neni 22, pika 2, Ligji nr. 10385, datë 24.2.2011, "*Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve*".

³⁰¹Kur bazë e konflikteve janë fyerja, shpifja, rrahja, plagosja, trafikimi, vrasja, etj., pra kryesisht për konfliktet penale, ose ne konflikte familjare jopasurore, kur familjaret janë grindur për një konflikt social, aktmarrëveshja e bëre nga palët para ndërmjetësit, është gojore, dhe konsiston në kërkimin e faljes, kryerjen e vizitave të ndërsjella në shtëpi dhe organizimin, e festave familjare, pagimin e shpenzimeve të mjekimit të të dëmtuarit, vizitë në spital të të dëmtuarit, (për rastet e plagosjeve të lehta, heqjen dorë nga ndjekja penale nga ana e palës së dëmtuar, e të tjera. Mund të ndodhë që palët të zgjedhin edhe elemente nga tradita për zgjidhjet gojore të konflikteve, si për shembull, konflikti zgjidhet me anë të bërjes së besës, dhënies së besës e të tjera.

³⁰²Neni 22, pika 4, Ligji Nr. 10385, datë 24.2.2011, "*Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve*".

ambienteve ku i depoziton organizata, përveç rasteve kur palët janë të interesuara dhe e kërkojnë vetë një gjë të tillë.

6.7. Njohja ligjore e ndërmjetësimit

Nga praktika e rasteve të zgjidhur me ndërmjetësim nga Fondacioni *"Për zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve"*, është konstatuar se aktmarrëveshja e nënshkruar nga palët nuk është shkelur më pas nga ana e tyre, pra rastet e ndërmjetësuara na rezultojnë të suksesshme. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që ndërmjetësimi është absolutisht i suksesshëm. Në rastet kur çështja referohet për ndërmjetësim nga gjykata, ndërmjetësi, në përfundim të procedurës së ndërmjetësimit, ose në afatin e përcaktuar prej tyre, njofton gjykatën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes³⁰³. Nëse aktmarrëveshja është arritur me konsensus dhe vullnet të lirë nga palët, ajo përbën titull ekzekutiv për palët dhe për gjykatën. Por gjykata, nëse palët e kundërshtojnë aktmarrëveshjen, nuk është e detyruar të vendosë sipas saj³⁰⁴.

Dhe në ato raste kur çështja zgjidhet me anë të ndërmjetësimit, organet gjyqësore vendosin, sipas rastit, miratimin e zgjidhjes me pajtim të çështjes civile ose pushimin e çështjes penale apo mos fillimin e procedimit penal, përveç rasteve kur arrihet në përfundimin se vërehet pavlefshmëri. Gjithashtu, ligji aktual për ndërmjetësimin parashikon, nëse marrëveshja është arritur me konsensus dhe vullnet të lirë nga palët, ajo përbën titull ekzekutiv.

6.8. Pavlefshmëria e ndërmjetësimit

Aktmarrëveshja është me të vërtetë një akt i rëndësishëm, që përcakton fatin e konfliktit dhe fatin e marrëdhënieve midis palëve, sepse një aktmarrëveshje e shkelur, ose përpilimi i një aktmarrëveshje të pavlefshme mund të sjellë pasoja më të rënda, sesa ato të shkaktuara para ndërmjetësimit. Për këtë arsye ligji për ndërmjetësimin ka parashikuar edhe

³⁰³ Neni 23, pika 1, ligji 10385, datë 24.02.2011 *"Për ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve"*.

³⁰⁴ Gjykata ose prokuroria mund ta konsiderojnë të pavlefshme marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim, kur arrijnë në përfundimin se nuk pasqyron vullnetin e palëve në konflikt, kur janë cenuar rëndë të drejtat dhe interesat e tyre ose kur zhdëmtimi është haptazi në shpërpjesëtim me dëmin e shkaktuar.

rastet ligjore kur aktmarrëveshja e arritur midis palëve me ndihmën e ndërmjetësit mund të shpallet e pavlefshme.

Kështu që, gjykata ose prokuroria mund ta konsiderojnë të pavlefshme marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim, kur arrijnë në përfundimin se ajo nuk pasqyron vullnetin e lirë të palëve në konflikt, kur janë cenuar rëndë të drejtat dhe interesat e tyre, ose kur zhdëmtimi është haptazi në disproporcion me dëmin e shkaktuar. Ligji për ndërmjetësimin, në nenin 24 te tij, na jep edhe rastet kur aktmarrëveshja është e pavlefshme dhe mund të shpallet si e tillë nga gjykata³⁰⁵. Por, megjithatë, nuk i pengon palët në konflikt që të realizojnë marrëveshjen e arritur, duke ushtruar të drejtat, që gëzojnë në ligje të tjera.

³⁰⁵ Këto raste janë kur: realizohen nga persona që nuk janë ndërmjetës të licencuar dhe të regjistruar sipas këtij – ligjin mosmarrëveshja, sipas ligjit, duhet zgjidhur vetëm në rrugë gjyqësore;" përmban detyrimin të vlerësueshme në të holla dhe nuk formulohet me shkrim; përmban detyrime për subjekte që nuk kanë marrë pjesë në ndërmjetësim; ka simulim dhe, për konfliktin real, ka shkaqe pavlefshmërie. (Neni 24/1, Ligji Nr. 10385, datë 24.2.2011, "*Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve* ").

KAPITULLI IV: APLIKIMI I NDËRMJETËSIMIT NË FUSHA TË NDRYSHME TË SË DREJTËS

1. Hyrje

Nga fundi i shek.XX, doli në pah nevoja për një alternativë të re zgjidhjeje konfliktesh, në mënyrë që të ishte ndryshe nga proceset gjyqësore mbi mosmarrëveshjet, alternativë, e cila nuk duhej të ishte e kufizuar nga ndonjë juridiksion i veçantë apo nga ndonjë degë e veçantë e së drejtës, por që të prekte çdo fushë ligjore dhe të përhapej në çdo sistem juridik.

Zgjidhja e çështjeve civile, tregtare, penale, familjare etj., me marrëveshje është e njohur si formë në praktikë dhe legjislacionin vendor e ndërkombëtar në fuqi, që ndryshe njihet si zgjidhje jashtë gjyqësore. Zgjidhja e këtyre çështjeve me marrëveshje nënkupton arritjen e një kompromisi në mes palëve në konflikt, nga një palë e tretë neutrale e përcaktuar nga vetë ata, ku nga praktika dhe doktrina juridike rezultojnë disa tipologji të zgjidhjeve të çështjeve me marrëveshje, si: negocimi, pajtimi, arbitrazhi dhe ndërmjetësimi³⁰⁶.

Arsyet që politika e konsensusit po hedh hapa të mëdha, tregon se për të shoqëria ka një kërkesë të fortë dhe të gjithanshme, një ritëm të shpejtë konform me rritjen e numrit të konflikteve. Kjo Lëvizje dhe përkrahje e zgjidhjes konsensuale është quajtur si drejtësia e komunitetit, drejtësia restauruese apo edhe drejtësia formale. Lëvizja ndërmjetësuese e ditëve tona ka mbështetjen e burimeve të ndryshme tradicionale, ideologjike, tashmë, edhe ligjore.

Zgjidhja gjyqësore, e cila konsiderohej si e vetmja formë e mundshme e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, i ka lënë vendin rregullave të reja, të cilat janë, gjithashtu, ligjore. Kjo erdhi si pasojë e dobësisë së shtetit në zbatimin e ligjit, rritjen e korrupsionit në organet e drejtësisë dhe humbjen e besimit në to, aktet e vetëgjyqësisë etj., dhe ndërmjetësimi paraqet disa avantazhe në raport me procedurat e tjera, si proces i shpejtë, konfidencial, avantazh për të mbajtur nën kontroll kostot dhe lëshimet reciproke, premisa që palët të vazhdojnë marrëdhëniet në të ardhmen, karakteri i detyrueshëm i aktmarrëveshjes. Palët konsiderohen dhe emërtohen "palë në proces" dhe jo me termat paditës, i paditur, keqbërës, dëmtues, i

³⁰⁶ Keka, D. (2005). *Zgjidhja e çështjeve me marrëveshje*. Tribuna Juridike Nr.57. fq. 103-104.

pandehur, të cilat krijojnë gjendje të rëndë psikologjike për palët dhe përkatësi të fajit edhe pa ekzistuar ai³⁰⁷.

2. Tematikat rreth të cilave mund të ndërmjetësohen

Gama e çështjeve që mund të ndërmjetësohen është e gjerë. Ndërmjetësimi, zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, familjare, të punës dhe ato penale. Në këto të fundit është fjala për çështjet që shqyrtohen nga gjykata, me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit³⁰⁸.

Ndërmjetësimi i çështjeve familjare ka për qëllim të shmang procedimin përpara autoriteteve gjyqësore, (të cilat përgjithësisht ndikojnë mbi fëmijët)³⁰⁹ dhe mund të zgjidhen mosmarrëveshje familjare të tilla si: ato midis bashkëshortëve dhe bashkëjetuesve, midis anëtarëve të tjerë të familjes, ato që burojnë nga detyrimi për ushqim etj. Alternativa e ndërmjetësimit paraqet shumë interes edhe në konfliktet civile dhe është shtrirë në çështjet tregtare, për këtë ligji i ri e parashikon ndërmjetësimin si një alternative për zgjidhjen e konflikteve jo vetëm dhe thjesht të natyrës personale, por edhe pasurore dhe në ndryshim nga ligji i mëparshëm, ligji i ri rendit edhe fushën tregtare, në këtë mënyrë këto çështje nuk janë vetëm ekskluzivitet i arbitrazhit si alternative jashtëgjyqësore³¹⁰.

3. Fushat e aplikimit të ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara nga ligji 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, në çdo kohë që palët janë në konflikt. Me vullnetin e tyre të lirë, palët kërkojnë dhe pranojnë ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kjo gjë mund të ndodhë, edhe nëse mosmarrëveshja është paraqitur përpara organit të përcaktuar nga ligji për zgjidhjen e saj, qv mund të jetë një organ i administratës shtetërore apo private, por, edhe përpara gjykatës. Palët në çdo rast, mund t’i drejtohen ndërmjetësit, edhe nëse mosmarrëveshja është bërë konflikt gjyqësor.

³⁰⁷Marrë nga: <http://www.cdr.al/files/Prezantim%20A.%20Beqiraj.pdf>(parë më 26.10.2011).

³⁰⁸Neni 2, pika 3, Ligji Nr. 10385, datë 24.02.2011 “ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

⁴⁹Neni 13 i Konventës Europiane Për të Drejtat e Fëmijëve.

³¹⁰Konferenca Vjetore (2008). *Zgjidhjet Alternative të Mosmarrëveshjeve* - RSHSL. fq. 11.

3.1. Ndërmjetësimi në Çështjet Civile dhe Tregtare

Ndërmjetësimi civil & tregtar shmanë përballjen me gjykatën dhe është një proces privat, ku palët në konflikt përpiqen të gjejnë një zgjidhje të kënaqshme ndaj nevojave dhe interesave të tyre, të ndihmuar nga një ndërmjetës, i paanshëm dhe i pranuar nga të gjitha palët, i cili synon pajtimin e palëve dhe pranimin e marrëveshjes, pa penguar marrëdhëniet e tyre të ardhshme (e përshtatshme në marrëdhëniet tregtare), ku roli ekonomik luan një rol kyç.

Në pajtim nuk ekzistojnë skema të bazuara në arsye ose gabim, por kërkohet e jo vetëm, nëpërmjet koncesioneve, për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme³¹¹.

Me reformën e drejtësisë, legjislatori ka bërë disa raste të detyrueshme për ndërmjetësim, përpara ngritjeve të padive të zakonshme në gjykatë, duke mos i vendosur palët përballë një rezultati të pakënaqshëm, dhe ku mund ta kontrollojnë këtë të fundit nëpërmjet përgatitjes profesionale të ndërmjetësve.

Qëllimi i ligjvënësit, në ligjin nr. 10385, për ndërmjetësimin, është që të shkarkojë gjykatat civile nga një mbingarkesë e çështjeve të këtij lloji me anë të procesit të ndërmjetësimit të sigurojë një zgjidhje të shpejtë, fleksibilitet të procedimit, konfidencialitet, kursim dhe transparencë të tarifave, stimulime fiskale, profesionalizëm dhe seriozitet të agjencive dhe të ndërmjetësve.

Ndërmjetësimi ka qenë edhe përpara se ligji ta bënte të detyrueshëm për rastet që përfshinin çështje të caktuara, por, në vendin tonë nuk ka pasur sukses të madh për shkak të një njohjeje të dobët të institucionit nga ana e palëve ndërgjyqëse, dhe nga mungesa e besimit, që i linte në dorë një pale tjetër, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Zgjidhja, nëse nuk gjendet nga vetë palët, i kërkohet një pale të tretë që mund të jetë gjykatësi, nëse çështja zgjidhet vetëm në këtë rrugë (ligjore), një gjykatës që duke vendosur i detyron palët ta respektojnë. Gjyqtari nuk mund të zgjidhet nga palët dhe nuk mund t'ia refuzojnë vendimin e dhënë, kështu, të shumtën e rasteve, marrëdhëniet e palëve mbeten të kompromentuar.

Ligjvënësi me reformën e ndërmjetësimit ka vendosur një palë të tretë, të paanshme dhe pa ndonjë fuqi vendimmarrëse dhe gjykuese, me detyrën që t'i vërë palët përballë njëra-tjetrës dhe do të jenë vetë ato, që do të gjejnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre

³¹¹ Nuk shikohet e shkuara, por nisemi nga e tashmja për një të ardhme.

(ndërmjetësimi lehtësues), ose ai do të propozojë një marrëveshje (ndërmjetësimi vlerësues), padyshim, që njëra zgjidhje ose tjetra duhet të ketë pëlqimin e të dyja palëve që të jetë efektive dhe detyruese.

Ndërmjetësimi civil dhe tregtar është frymëzuar nga vendet anglo-saksone dhe, në veçanti, nga Shtetet e Bashkuara, ku kjo teknikë ka pasur sukses të konsiderueshëm dhe është integruar plotësisht në kontekst tregtar të evoluar e që njihet me emrit *bussinessoriented-biznes i orientuar*.

Referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe një selektimi të llojeve të padi, duke bërë një ndarje se cilat padi mund t'i nënshtrohen ndërmjetësimit dhe për cilat padi ligji përcakton një zgjidhje gjyqësore të detyrueshme, arrijmë të përcaktojmë, se cilat konflikte (padi) mund t'i nënshtrohen ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes që i ka çuar palët në këtë konflikt. Këto padi i ndajmë në:

Padi pronësie, Padi Uzufrukti (Neni 232-260), Padi Servituti (Neni 261-295), Padi Kërkim Sendi (Neni 296-303), Padi Posedimore (Neni 304-315), Padi Trashëgimie (Neni 316-418), Padi Shkaktim Dëmi (Neni 608-654), Padi Begatim Pa Shkak (Neni 655-658), Padi të Kontratave të Shitjes (Neni 705-756), Padi Kontrate Shkëmbimi (Neni 757-760), Padi Kontrate Dhurimi (Neni 761-771), Padi Kontrate Furnizimi (Neni 772-783), Padi Kontrate Entifeoze (Neni 784-800), Padi Kontrate Qiraje (Neni 801-849), Padi Kontrate Sipërmarrje (Neni 850-876), Padi Kontrate Transport (Neni 877-900), Padi Kontrate Huapërdorje (Neni 901-912), Padi Kontrate të Përdorjes (Neni 913-934), Padi Kontrate Komisioni (Neni 935-944), Padi Kontrate Spedicioni (Neni 945-949), Padi Kontrate Agjencie (Neni 950-961), Padi për Kalim Pasurie (962-972), Padi Kontrate Ndërmjetësimi (Neni 973-981), Padi Kontrate Depozite (Neni 982-1012), Padi Kontrate Llogari-Rrjedhëse (Neni 149-231), Padi Kontrate Bankare (Neni 1024-1049), Padi Kontrate Huaje (Neni 1050-1055), Padi Kontrate Franchising (Neni 1056-1064), Padi Kontrate Rente Jetësore (Neni 1065-1073), Padi Kontrate Shoq. Thjeshtë (Neni 1074-1112), Padi Kontrate Sigurimi (Neni 1113-1161), Padi të tjera Kontraktuale (kontratat atipike), Padi Kundërshtim Veprimi Përmbarimor, Padi për Marrëdhënie Pune, Padi Pagim i pa detyruar (Neni 653-654), Padi gjerimi i punëve të tjetrit (Neni 648-652), Padi Pjesëtim Sendi (Neni 207), Padi për Kalim Pasurie, Padi për Kthim Shume, Padi Shlyerje Dëmi të Administratorit (Neni 53), Padi për Reklamimin e Dividendëve (Neni 70), Padi të Tjera, Padi për Përgjegjësi të Kesh. Mbikëqyrës (Neni 194),

Padi për Tejkalim Kompetencash Administrative (Neni 50), Padi për Mbrojtjen e Pronës Intelektuale (Neni 103), si dhe çdo mosmarrëveshje tjetër, që lind ndërmjet subjekteve të kësaj fushe me çdo subjekt të së drejtës, mosmarrëveshje të cilat nuk kërkojnë detyrimisht zgjidhje gjyqësore³¹².

Të gjitha paditë me karakter pasuror, me objekt padie deri në 500 mijë lekë, si dhe për paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese³¹³ e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit³¹⁴.

Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, por pa u kufizuar vetëm në to, gjykata ose organi përkatës shtetëror ka detyrimin ligjor të ftojë palët në ndërmjetësim, por jo duke i detyruar ato. Ky detyrim për mendimin tim është një detyrim, i cili në mosmarrëveshjet administrative ka vlerën e një hallke të barasvlershme me atë të ezaurimit të ankimit administrativ, mungesa e të cilit nxjerr detyrimisht jashtë juridiksioni, gjykimin në gjykatën administrative. Ndërsa në gjykimet në shkallë të parë, ka vlerën e një shkelje procedurale, të njëjtë me moszhvillimin e seancës së pajtimit në procesin e zgjidhjes së martesës, mungesa e së cilës përbën një cenim të rëndë të parimit të një gjykimi e hetimi të drejtë e të gjithanshëm dhe një procesi të rregullt ligjor³¹⁵.

3.2. Ndërmjetësimi në çështje familjare

Ky ndërmjetësim aplikohet kryesisht në çështjet e pajtimit, në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i Kodit të Familjes³¹⁶. Në të gjitha çështjet familjare,

³¹² Neni 2/ 6; ligji 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”; Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim.

³¹³ Neni 302; Ligji Nr.7850, Datë 29.7.1994, Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, “Padia mohuese”.

Pronari ka të drejtë të kërkojë nga cildo që e cenon në pronësinë e tij, por pa u zhveshur nga posedimi, të pushojë cenimin dhe të mos përsërisë këtë në të ardhmen, dhe, kur është rasti të shpërblejë dëmet që mund t'i ketë shkaktuar.

Neni 314 Pushimi i cenimit të posedimit; Neni 312; Ligji Nr.7850, Datë 29.7.1994, Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë; “***Personi, që cenohet në posedimin e një sendi, mund të kërkojë brenda gjashtë muajve, pushimin e cenimit të posedimit dhe mos përsëritjen e tij në të ardhmen***”.

³¹⁵ Neni 131/f Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, të Kuvendit Popullor; “***gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave***”.

³¹⁶ Përpjekjet për pajtim; Neni 134 i ligjit Nr.9062, datë 8.5.2003 “KODI I FAMILJES”.

kur ndërthuren interesat e të miturve³¹⁷, Padi Pension Ushqimor, Padi Pjesëtimi Pasurie Bashkëshortore, si dhe çdo mosmarrëveshje tjetër që lind ndërmjet pjesëtareve të familjes, mosmarrëveshje të cilat nuk kërkojnë detyrimisht zgjidhje gjyqësore³¹⁸. Ndërmjetësimi familjar është një mënyrë zgjidhjeje e konflikteve familjare pa shkuar në gjykatë, si p.sh. një ndarje ose divorc, ku gjatë procesit të ndërmjetësimit çiftet ndihmohen të shohin alternativa e ndryshme, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre. Tashmë, ndërmjetësimi familjar po përdoret edhe për të zgjidhur llojet e tjera të problemeve familjare, si: mosmarrëveshjet mes fëmijës dhe prindit, mosmarrëveshjet për kujdesin për të moshuarit apo të afërmit e sëmurë, kontaktet mes gjyshërve dhe nipërve dhe mungesa e strehimit e shkaktuar nga konfliktet familjare.

Gjatë këtij procesi ndërmjetësimi, palët shpjegojnë shqetësimet dhe nevojat që kanë në prani të një mediatori familjar të kualifikuar të paanshëm dhe, ndryshe nga një avokat, i cili punon vetëm për njërën palë, ai nuk mban anën e askujt, por i ndihmon ata. Ndonjëherë, ndërmjetësi mund edhe të sugjerojë një mënyrë për zgjidhjen e konfliktit, kjo gjithmonë për t'i ndihmuar palët të arrijnë një marrëveshje të pranueshme për të dy, por kurrë nuk i thotë palëve së çfarë duhet të bëjnë nga fillimi deri në fund.

3.2.1. Lindja dhe përhapja e ndërmjetësimit familjar

Qendra e parë e ndërmjetësimit familjar lindi në Atlanta (1974), nga iniciativa e një psikologu dhe avokati amerikan J. Coogler më 1975, gjithmonë me iniciativën e tij, u krijua *FamilyMediationAssociation*", e cila u ofronte një shërbim ndërmjetësimi çifteve, të cilët ishin në prag ndarjeje apo divorci³¹⁹.

Me 1978, Howard Living aktivizon "*Toronto Conciliation Project*" në Toronto dhe John Haynes (më 1982) krijon "*Academy of Family Mediators*" në SHBA. Që këtëj, praktika e ndërmjetësimit familjar përhapet në fillim të viteve '80, edhe në Evropë. Në Angli shoqata e

³¹⁷ Neni 2/ 4/a; ligji 10385 "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve".

³¹⁸ Neni 2/ 6; ligji 10385 "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve"; "**Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim**".

³¹⁹ Corsi M., Sirignano C. (1999). *La mediazione Familiare. Problemi, prospettive, esperienze*. Vxta e Pensiero, Milano, fq.30.

parë "Family Mediators Association" lind me 1988, dhe "Family Law Act"³²⁰ i përket vitit 1996. Franca, më 1996, bëhet protagoniste e një reforme të rëndësishme të *Nouveau Code de Procedure Civil*,³²¹ e cili parashikon që gjyqtari mund të caktojë një palë të tretë, që ka për detyrë të dëgjojë të dyja palët në proces me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të dyanshme. Më 2004, ndërmjetësimi familjar shndërrohet në një aktivitet komplementar të atij të gjyqtarit.³²²

Paralelisht me eksperiencën franceze, më 1987, krijohet në Milano, Shoqata *GeAfGenitoriAncora*, me qëllim përhapjen e praktikës së ndërmjetësimit familjar. Dhe, pavarësisht indiferencës së konsiderueshme të ligjvënësit dhe organeve të tjera gjyqësore, lindin pak në të gjithë Italinë, qendra eksperimentale të ndërmjetësimit familjar, të cilat pasuan me shkollat e para të formimit profesional të ndërmjetësve të ardhshëm familjar.

3.2.2. Rëndësia e rolit të ndërmjetësit për zgjidhjen e konflikteve familjare

Gjithnjë e më shpesh gjendemi përballë krizash familjare, ku niveli i konfliktit tanimë është bërë me të vërtetë shqetësues dhe ka marrë, plotësisht, vendin e ndërveprimeve "normale" familjare, duke e bërë procesin ligjor të gjatë, të dhembshur dhe të kushtueshëm. Konflikt, i cili shndërrohet në një vrimë të zezë, që thith të gjithë aspektin e hapësirës familjare, shpresat, zakonet, afektet, identitetin familjar dhe shpesh, identitetin individual, duke lënë një vakum të madh, me plot zemërim, zhgënjim dhe vuajtje, duke krijuar një gjendje konfuzionale të vështirë për ta kontrolluar, nëse nuk zëvendësohet me diçka tjetër.

Kjo diçka, shpesh është dëshira për hakmarrje, e cila shprehet në kundërshtime, me qëllimin e eliminimit të kundërshtarit e që nuk lejon komunikimin civil midis bashkëshortëve të destinuar për t'u bërë "ish". Për të trajtuar një situatë të tillë, gjen zbatim ndërmjetësimi familjar, ku ndërhyrja e ndërmjetësit, i cili larg nga të qenit një këshilltar ligjor apo një trapist për çiftin, i ndihmon bashkëshortët, që të riorganizojnë në mënyrë konstruktive raportet e

³²⁰Ligji, i cili njeh rëndësinë e ndërhyrjes së ndërmjetësimit familjar, aq sa sanksionon detyrimin për të gjitha konfliktet që kanë të bëjnë me çështje familjare, të cilat mbërrijnë në gjykatë, të paktën një takim ndërmjetësimi. *Family Law Act*: 04.07.1996. Marrë nga:

<http://www.legislation.gov.uk/ukpga/1996/27/contents>, parë më 10.3.2012.

³²¹Dekreti nr. 92-652 i datës 22.02.1996. Marrë nga:

http://www.lexinter.net/NCPC/titre_vi_bis_la_mediation.html, parë më 10.3.2012.

³²²Legge n° 439 del 26 maggio 2004. Ligji francez mbi divorcin, Marrë nga:

http://www.notardilizia.it/oflicina/Voci/2008/1/29/divorzio_alia, parë më 10.3.2012.

tyre të tashme, por mbi të gjitha ato të ardhme. Ndërmjetësimi familjar është ajo hapësirë, në të cilën palët mund të gjejnë fillin e problemit dhe të rregullojnë atë çfarë koha i ka prishur, ajo hapësirë ku palët mund ta dëgjojnë njëri-tjetrin. Të humanizosh "armikun". Të vuash së bashku. Burri dhe gruaja. Prindërit. Të marrin në dorë jetën e tyre dhe të vendosin, jo vetëm, por të mbështetur dhe ndihmuar nga një person, i cili nuk vendos për ta, por i ndihmon për të kuptuar vetë së çfarë është më mirë për veten e tyre, duke i ndihmuar që të menaxhojnë zemërimin, zhgënjimin dhe të gjitha ato emocionet njerëzore, që i bëjnë njerëzit të verbër dhe të shurdhër ndaj nevojave reale, personale.

Të ndryshme janë teknikat dhe mënyrat e ndërhyrjes së ndërmjetësve, të përshtatura sipas ndjeshmërisë të secilit ndërmjetës dhe sipas nevojave të çështjes konkrete. Sesionet e ndërmjetësimit realizohen me praninë e të dy bashkëshortëve në një hapësirë, ku edhe pse i nënshtrohen rregullave të caktuara, rezulton të jetë vendi, ku asnjë nuk duhet të ketë frikë dhe të ndjehet i lirë për të shprehur jo vetëm mendimet, por edhe frikërat dhe dëshirat, që me ndihmën e ndërmjetësit propozohen në një mënyrë me të vërtetë të kuptueshme, nga njëri tek tjetri. Përmes pyetjeve të synuara, ndërmjetësi mund të përqendrojë frikën dhe ankthet e bashkëshortëve, gatishmëritë e tyre për t'u ndihmuar, mbi të gjitha, për të komunikuar midis tyre, e në vazhdim të fillojnë të angazhojnë përpjekjet për të vlerësuar vlefshmërinë e marrëveshjeve të pjesshme, që seancë pas seance merren nga bashkëshortët, ku janë palët (çiftet) ato, të cilat vendosin dhe jo ndërmjetësi (gabimisht mendojnë disa), i cili, në fakt, limitohet në krijimin e kushteve për të gjetur pika të përbashkëta. Përdorimi i mjeteve objektive³²³ për t'i dhënë një mundësi çifteve në vëzhgimin e situatës me sy tjetër, atë çfarë ndodh apo atë që duan, atë së çfarë kanë vendosur apo atë që kanë qenë, por mbi të gjitha, për të parë rezultatet që hap pas hapi arrijnë.

Të pranosh ndërmjetësim familjar, do të thotë të lejostransformimin e një situatë konfliktuale stresi, emocionale dhe financiare, në një situatë bashkëpunimi të vërtetë, me të gjitha përfitimet pasuese. Nuk duhet harruar se njerëzit të cilët ndahen, kanë ndarë shumë midis tyre (kjo në aspektin e kohës dhe ndjenjave), ku ndërmjetësimi i lejon ata të marrin në konsideratë kohën e kaluar si një kohë e mbaruar, por e këndshme për t'u kujtuar dhe jo të kundërtën. Natyrisht, nuk ka efekte anësore për të drejtuar qasjen ndaj procesit gjyqësor, është e pamohueshme që, përballë disa situatave të caktuara, ndërmjetësimi nuk është i

³²³Si, për shembull, një tabelë me fleta të lëvizshme.

rekomanduar, megjithatë, në aspektin e kostos, në një nivel emocional, ndërmjetësimi mbetet zgjidhja me ekonomike. Por duhet qartësuar se kjo nuk do të thotë që është e përjashtuar prania e avokatëve gjatë ndërmjetësimit, përkundrazi, asistenca ligjore është e rekomanduar, pasi njerëzit duhet të gjejnë më shumë siguri, duke u këshilluar në lidhje me marrëveshjet e arritura, siguri në mbrojtjen e të drejtave të tyre ose për paraqitjen e veprimit të ndarjes, për miratimin e marrëveshjeve në fund të procesit.

3.3. Ndërmjetësimi në çështjet administrative;

Të gjitha ato çështje, të cilat janë të përfshira në nenin 7, të ligjit 49/2012, “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*”, të cilat janë:

1. Mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;
2. Mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik;
3. Mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike; si dhe çdo mosmarrëveshje tjetër, që lind ndërmjet organeve të administratës publike dhe këtyre të fundit me çdo subjekt të së drejtës, mosmarrëveshje të cilat nuk kërkojnë detyrimisht zgjidhje gjyqësore³²⁴.

3.4. Ndërmjetësimi në çështjet Penale

Debatet si rrjedhojë e një krimi, që mund të përballeshin dhe të zgjidheshin nga ata që ishin të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë, domethënë viktimat dhe autori i veprës penale, janë shfaqur në Europë, në fillim të viteve shtatëdhjetë. Ky diskutim ka ndodhurnë të njëjtën kohë kur u bënë provat e para me ndërmjetësimin viktimë -i akuzuar, në SHBA dhe Kanada, në mesin e viteve '70. Disa nga nismëtarët e parë amerikanë-verior u influencuan nga puna shkencore e disa dijetarëve evropianë, si Nils Christie (1977), Herman Bianchi (1964) dhe Peter Noil (1962).³²⁵

³²⁴ Neni 2/ 6; ligji 10385, “*Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve*”; Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim.

³²⁵ Revistë juridike shkencore (2008). *Justitia Nr.1*. Botim i Fakultetit Justicia. Prill, fq.62.

Në legjislacionin tonë penal, disa janë ato vepra penale, të cilat mund të zgjidhen jashtë gjyqësorit. Në praktikën gjyqësore është vërtetuar se shumica e këtyre çështjeve është zgjidhur me pajtim. Për rastet e fyerjes, shpifjes, dhunimit të banesës, dëmtimit të shëndetit, shumica e çështjeve pushohen për shkak të pajtimit të palëve në konflikt.

Është rasti të theksojmë këtu se, legjislacioni shqiptar për ndërmjetësim në çështjet penale, në Nenin 2, të ligjit nr. 10385, për ndërmjetësimin, parashikon përdorimin e ndërmjetësimit në çështje të caktuara penale, respektivisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale (më tej K.Pr.Penale). Sidoqoftë, K.Pr.Penale nuk specifikon kushtet për transferimin e çështjeve penale për t'u trajtuar përmes modeleve të drejtësisë restauruese. Kështu, gjithnjë sipas K.Pr.Penale, gjyqtari, prokurori, apo oficeri i policisë gjyqësore nuk mund të transferojë çështje për ndërmjetësim dhe kodi nuk përmban dispozita që të mund të bëjnë të mundur devijimin e procedimit penal dhe përdorimin e drejtësisë restauruese, në raste kur mund të jetë më e dobishme përdorimi i kësaj të fundit sesa ndalimi, hetimi, apo gjykimi i një të mituri.

Devijimi rekomandohet dhe në shumë instrumente ndërkombëtare për të miturit, në të cilat vendi ynë është palë³²⁶.

Ndërmjetësimi në fushën e konflikteve penale është më i vështirë, sepse ato shkaktojnë një dhimbje të madhe tek viktimat, por shpesh, edhe tek vetë i akuzuari, i cili mund të ndjehet i penduar për sjelljen kriminale që ka kryer³²⁷.

Një rol të rëndësishëm në zbatimin e ndërmjetësimit në konfliktet penale është luajtur nga sistemi gjyqësor shqiptar. Legjislacioni në këtë fushë, i njeh gjykatës të drejtën dhe detyrimin për të ndërmarrë veprime në zgjidhjen e çështjeve, që parashikohen nga ligji, përmes ndërmjetësimit dhe pajtimit. Prandaj, gjykata mund ta bëjë këtë për rastet penale, të cilat nuk mund të procedohen, nëse nuk ka një akuzë kundër autorit të veprës penale. Duke iu referuar nenit 59, të K.Pr. Penale, një kategori e çështjeve penale, të tilla si dëmtime të tjera me dashje, plagosje e rëndë nga pakujdesia, plagosje e lehtë nga pakujdesia, dhunimi i banesës, pikërisht, hyrja ose qëndrimi në banesën e tjetrit pa pëlqimin e tij, fyerja me motive

³²⁶Gjoka R. (2009). *Ndërmjetësimi midis viktimës-autorit të veprës penale*, Manual për punonjësin e shërbimit të provës. OSCE. Tirane. fq.53.

³²⁷Tutulani-Semini M.(2006). *Korniza Ligjore e Procesit të Ndërmjetësimit: Aktmarrëveshja e ndërmjetësimit*. USAID.fq.46.

racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik, shpifja, ndërhyrje të padrejta në jetën private, përhapja e sekreteve vetjake, mosdhënia e mjeteve për jetesë, marrja e padrejtë e fëmijës, botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet, riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit dhe shkelja e paprekshmërisë së banesës, viktimë ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit³²⁸.

Dhe sipas K.Pr.Penale, në rastet e përmendura më lart, gjykata fton viktimën dhe të akuzuarin e u propozon atyre, që ta zgjidhin çështjen përmes ndërmjetësimit. Nëse viktimë pranon të tërheqë padinë, dhe i akuzuari e pranon këtë, gjykata vendos mbylljen e çështjes dhe palët i adresohen ndërmjetësimit.

Neni 284 i K.Pr.Penale përcakton edhe rastet e veprave penale, për të cilat procedimet penale janë iniciuar nga zyra e prokurorisë ose policisë gjyqësore, mbi ankimin e bërë nga i dëmtuari tek prokurori ose në policinë gjyqësore, ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, kërkon që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale. Gjithashtu, i njihet e drejta që viktimë mund të tërheqë ankesën në çdo fazë të procedurës penale. Raste të tilla janë: plagosje të lehta nga pakujdesia, vrasje nga pakujdesia, shpifjet dhe fyerjet për shkak të detyrës etj.³²⁹

Nuk duhet lënë këtu pa përmendur ndërmjetësimin viktimë-autor i veprave penale për të miturit, ku qëllimi kryesor është zbatimi i metodave alternative të ndërmjetësimit, në çështjet penale me të mitur, qoftë në rolin e viktimës apo të autorit të veprës penale dhe që ka për objektiv kryesor sigurimin e ndërmjetësimit për të miturit dukeshmangur procedimin penal dhe duke zgjidhur rastin, sipas rregullave të ndërmjetësimit, me mirëkuptim nga palët e përfshira.³³⁰

³²⁸Pikërisht, veprat penale të parashikuara nga nenet 90,91, 92, 112 paragrafi i parë, 119,119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148,149 dhe 254 të Kodit Penal.

³²⁹Veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243,264,275 dhe 318 të Kodit Penal.

³³⁰ Gjoka, R. (2009). *Ndërmjetësimi midis viktimës-autorit të veprës penale*, Manual për punonjësin e shërbimit të provës. OSCE. Tirane. fq.49-50.

Të gjitha mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale³³¹, si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon, mund të zbatohet procedura e Ndërmjetësimit për të zgjidhur këtë mosmarrëveshje. Ato mosmarrëveshje që mund të zgjidhen me ndërmjetësim në fushën e së drejtës penale i ndajmë në vepra penale dhe Kundërvajtje penale.

3.4.1. Veprat Penale që mund të zgjidhen me ndërmjetësim

Veprat penale që mund të zgjidhen me ndërmjetësim janë vepra, të cilave iu varion maksimumi i dënimit nga 3 vjet deri në 10 vjet burgim. Një pjesë e mirë e këtyre veprave penale janë vepra, të cilat ndiqen mbi ankim, sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet: *“1. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243, 264, 275 dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit”*. Ndërsa një prej këtyre veprave është e parashikuar si vepër, e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Disa nga këto dispozita parashikojnë dënime maksimale, që arrijnë në kufijtë e kundërvajtjeve penale, ndërsa disa të tjera parashikojnë dënime që arrijnë deri në 10 vite burgim.

Ato janë:

“Shkelja e paprekshmërisë së banesës”, parashikuar nga neni 254 i Kodit Penal si një vepër penale, e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër, ndëshkimin e personit, i cili *“hyn në banesë, pa pëlqimin e personit që banon në të, prej punonjësit të ngarkuar me një funksion shtetëror apo në shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, veç rasteve kur lejohet nga ligji, e bën me dënimin me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”*.

“Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura” parashikuar nga neni 102/1 i Kodit Penal si një vepër penale, e cila ndiqet mbi ankim, sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon se *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tregjer në dhjetë vjet”*.

³³¹ Veprat që ndiqen mbi Ankimin; veprat që ndiqen nga i dëmtuari akuzues; Ligji nr.7905, datë 21.3.1995 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë

“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 105 i Kodit Penal si një vepër penale, e cila ndiqet mbi ankim, sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë ose të detyrës, dënohet me burgim gjer në tre vjet”*.

Ankim Neni 106

Vepra penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”, parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal si një vepër penale, e cila ndiqet mbi ankim, sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit, dënohet me burgim gjer në shtatë vjet”*.

Vepra penale “Goditje ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore”, parashikuar nga neni 243 i Kodit Penal si një vepër penale, e cila ndiqet mbi ankim, sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Goditjet ose vepra të tjera dhune që i bëhen pjesëtarit të familjes së një personi, që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, për të penguar në kryerjen e detyrës apo të shërbimit ose për shkak të kësaj veprimtarie, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”*.

Kundërvajtjet penale, të cilat mund të zgjidhen me ndërmjetësim janë të tilla që iu varion maksimumi i dënimit të tyre, deri në 2 vjet burgim. Një pjesë e mirë e këtyre kundërvajtjeve penale janë kundërvajtje, të cilat ndiqen mbi ankim, sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet: *“1. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243, 264, 275 dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit”*. Ndërsa pjesa tjetër e tyre janë parashikuar si kundërvajtje, të cilat ndiqen nga i dëmtuari akuzues, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë dispozitë parashikohet se: *“Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit”*. Këto vepra penale janë vepra, të

cilat kanë një masë të vogël dënimi si ndëshkim dhe janë të parashikuara si vepra, të cilat kanë një ndjeshmëri që lidhet ngushtësisht me të dëmtuarin. Është diskrecioni i tij të vendosë, nëse dëshiron që shkelësi të ndëshkohet apo jo nga ligji.

Këto kundërvajtje janë:

Kundërvajtja penale “Dëmtime të tjera me dashje”,parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon se *“Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë”*.

“Po kjo vepër, kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj”.

Kundërvajtja penale“Plagosja e rëndë nga pakujdesia”,parashikuar nga neni 91 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Plagosja e rëndë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit”*.

kundërvajtja penale “Plagosja e lehtë nga pakujdesia”,parashikuar nga neni 92 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 tëKodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Plagosja e lehtë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë”*.

kundërvajtja penale “Dhunimi i banesës”,parashikuar nga neni 112/1 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Hyrja ose qëndrimi në banesën e tjetrit pa pëlqimin e tij përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj”*.

Kundërvajtja penale “Fyerja”,parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë*.

Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë”.

Kundërvajtja penale “Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik”,parashikuar nga neni 119/b i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se

“Fyerja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”.

Kundërvajtja penale “Shpifja”,parashikuar nga neni 120 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë.*

Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë”.

Kundërvajtja penale “Ndërhyrje të padrejta në jetën private”,parashikuar nga neni 121 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi, regjistrimi ose transmetimi i fjalëve, fiksimi, regjistrimi ose transmetimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim apo publikimi i këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.*

Kundërvajtja penale “Përhapja e sekreteve vetjake”,parashikuar nga neni 122 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Përhapja e një sekreti që i përket jetës private të një personi nga ai që e siguron atë për shkak të detyrës ose të profesionit, kur detyrohet të mos e përhapë pa qenë i autorizuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit;*

Po kjo vepër, e kryer me qëllim fitimi ose për të dëmtuar një person tjetër, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

Kundërvajtja penale “Mosdhënia e mjeteve për jetesë”,parashikuar nga neni 125 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Mosdhënia e mjeteve të nevojshme për jetesën e fëmijëve, të prindërve ose të bashkëshortit, nga personi që në zbatim të një vendimi gjyqësor detyrohet ta japë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit”*.

Kundërvajtja penale “Marrja e padrejtë e fëmijës”,parashikuar nga neni 127 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon se *“Marrja e padrejtë e fëmijës, duke e larguar prej personit që ushtron autoritetin prindëror ose që i është besuar për rritje dhe edukim, si dhe mosdorëzimi i fëmijës prindit tjetër në zbatim të vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj”*.

Kundërvajtja penale “Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet”,parashikuar nga neni 148 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Botimi ose përdorimi tërësisht apo pjesërisht me emrin e vet i një vepre letrare, muzikore, artistike ose shkencore, që i përket një tjetri, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”*.

Kundërvajtja penale “Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit”,parashikuar nga neni 149 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht i veprës letrare, muzikore, artistike ose shkencore që i përket një tjetri, ose përdorimi i tyre pa pëlqim të autorit, kur kanë shkelur të drejtat vetjake e pasurore të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”*.

Kundërvajtja penale “Fyerja e gjyqtarit”,parashikuar nga neni 318 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga i dëmtuari akuzues,sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Fyerja e gjyqtarit apo anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit ose anëtarit të arbitrazhit, për shkak të veprimtarisë së tyre në një çështje, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj”*.

Kundërvajtja penale “Plagosja e lehtë me dashje”,parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga organi i akuzues me ankimimin e të dëmtuarit,sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”*.

Kundërvajtja penale “Shtrëngimi apo pengimi për të bashkëjetuar ose për të lidhur apo zgjidhur martesë”,parashikuar nga neni 130 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga organi i akuzës me ankimimin e të dëmtuarit,sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Shtrëngimi apo pengimi për të filluar ose vazhduar bashkëjetesën, ose shtrëngimi për të lidhur apo zgjidhur martesën, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj;*

“Kërkesa e qëllimshme ndaj një të rrituri ose fëmije për të shkuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim detyrimin e tij për të lidhur martesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj”.

Kundërvajtja penale “Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë”,parashikuar nga neni 264i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga organi i akuzës me ankimimin e të dëmtuarit,sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Detyrimi i punonjësit që kundër vullnetit të marrë apo të mos marrë pjesë në grevë ose krijimi i pengesave dhe vështirësive për të vazhduar punën kur punonjësi dëshiron të punojë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj”*.

Kundërvajtja penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”,parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal si një Kundërvajtje penale,e cila ndiqet nga organi i akuzës me ankimimin e të dëmtuarit,sipas nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo vepër parashikon, se *“Thirrjet telefonike keqdashëse që bëhen me qëllim për të prishur qetësinë e tjetrit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit”*.

Kur kemi parasysh veprat penale të parashikuara nga neni 59 dhe 283 i Kodit të Procedurës Penale, duhet të kuptojmë kuptimin që ligjvënësi ka dashur t’i japë këtyre veprave. Në rastin e veprave të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, vërejmë se ligjvënësi i ka dhënë të drejtën palës së dëmtuar të ngrejë privatisht një akuzë ndaj personit që ai mendon se ka kryer një vepër penale në dëm të tij (akuza private). Ndërsa,

në nenin 284 të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi është mjaftuar me kërkesën e të dëmtuarit, duke marrë përsipër provueshmërinë e kësaj veprë. Në të dyja rastet, ligjvënësi lë në dorën e të dëmtuarit vullnetin e ndjekjes penale. Madje, në dispozitat pasardhëse parashikon se është e drejta e të dëmtuarit në të dyja rastet, që nëse ai dëshiron, mund të heqë dorë në çdo kohë nga ndjekja penale e shkelësit. Për arsye të caktuara, ligjvënësi ka parë të arsyeshme, që për veprat e parashikuara nga neni 284 i Kodit të Procedurës Penale, të investohet prokuroria për hetimin, provueshmërinë dhe ndjekjen penale të tyre, ndërsa, për ato të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, hetimin, provueshmërinë e veprës dhe të drejtën për të kërkuar ndjekjen penalisht të shkelësit, ia ka ngarkuar personit të dëmtuar. Por, në të dyja palët e dëmtuara kanë të drejtë që të vendosin ato vetë, nëse kanë dëshirë ta ndjekin shkelësin e këtyre veprave apo kundërvajtjeve penale apo jo. Nëse do marrim në analizë përmbajtjen e veprave të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, dotë shohim se arsyeja përse ligjvënësi i ka njohur të drejtën të dëmtuarit të ngrejë akuzën, bëhet më e thjeshtë për t'u kuptuar. Veprat e parashikuara nga kjo dispozitë, janë të gjitha vepra, të cilat kanë të bëjnë me pasoja që mund të konsiderohen të lehta, por mbi të gjitha arsye ngushtësisht personale. Në këto kushte, kur kemi të bëjmë me vepra me karakter ngushtësisht personal, ku pasojat kanë të bëjnë më shumë me marrëdhënien mes individëve se me objektin e legjislacionit penal, që është ruajtja e rendit publik, ligjvënësi i ka lënë në diskrecion palëve të investohen për të ndjekur e provuar një fakt të tillë penal. Ndërsa për veprat dhe kundërvajtjet e parashikuara nga neni 284, ligjvënësi ka lehtësuar palën e dëmtuar vetëm me një nga detyrat e saj, pjesën e hetimit. Në të dyja rastet, vullneti për ndjekjen penale të shkelësit i ngelet palës së dëmtuar.

Kështu shikojmë se rregullimi i marrëdhënies ndërmjet palëve të konfliktuara, për ligjvënësin, në veprat e parashikuara nga neni 59 e 284 të Kodit të Procedurës Penale, janë arsye të mjaftueshme për të konsideruar rehabilitimin e shkelësit në rastet konkrete. Në këtë kuptim, ligji për ndërmjetësimin, është ligji që ka përafrimin më të madh me qëllimin e rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës. Njëkohësisht rëndësia që merr ky ligj vjen duke rregulluar dy pasoja të mundshme:

Së pari, palët i shuajnë të gjitha konfliktet e mundshme me njëri-tjetrin, dhe konflikti i mëparshëm nuk bëhet shkak për thellim të konfliktit dhe përshkallëzim të tij në agravim të marrëdhënies. Kjo do të sillte pasojë, ndoshta, edhe më të rëndë, duke arritur deri në pikën,

ku palët mund të kryejnë vepra akoma më të rënda, si pasojë e mosmarrëveshjeve të lindura nga konflikti i parë.

Sw dyti, pala e cila ka kryer një shkelje do të ishte akoma më e disponueshme për të rregulluar marrëdhënien, pasi, zgjidhja e këtij konflikti me anë të ndërmjetësimit, do të thotë që në rekordet kriminale të shkelësit, nuk do të pasqyrohet një vepër penale e kryer. Kjo do të shërbente për shumë arsye. Shkelësi nuk do të quhej i dënuar dhe ai do të ishte i lirë të ushtronte të drejta e tij si një person pa precedent penal. Në këto të drejta do të përmendim të drejta të tilla si, ushtrimi i një profesioni të caktuar etj.

Në rastin e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur procedimi penal ka nisur, gjykata detyrimsht fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve të parashikuara më sipër. Ky parashikim është bërë në ligjin për ndërmjetësimin dhe vjen si një detyrim për ligjzbatuesit. Për sa kohë, ky parashikim në ligjin 10385, për Ndërmjetësimin nuk vjen në kundërshtim me urdhërimet e ligjeve bazë, atëherë është një parashikim që është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga gjykata. Këtu hyn në zbatim edhe teoria e doktrinës, që vjen pas shprehjes latine "*Lex specialis, derogat lex generalis*", e cila në teorinë juridike dhe praktike, është një doktrinë në lidhje me interpretimin e ligjeve dhe mund të aplikohet si në dispozitat e brendshme, ashtu edhe ato që përmbajnë elementin e huaj. Doktrina konstaton se kur dy ligje rregullojnë të njëjtën situatë faktike, ligji që rregullon një çështje të caktuar (*lex specialis*) prevalon mbi një ligj, i cili rregullon vetëm çështje të përgjithshme (*lex generalis*). Gjendja, zakonisht koklavitet, kur legjislacioni i përgjithshëm lind pas ligjit të veçantë dhe ky rregullon të njëjtën situatë ndryshe. Megjithatë, në këtë situatë, doktrina "*lex posterior derogat legi priori*" mund të zbatohet edhe - ligji i ri prevalon mbi ligjin e vjetër. Pra, në këtë rast, supozohet se ligjvënësi e ka bërë me qëllim një veprim të tillë, duke planifikuar për të ndryshuar legjislacionin e mëparshëm. Ekziston edhe një pikëpamje tjetër, që parashikon se konfliktet e normave duhet të shmangen nëpërmjet një interpretim sistematik. Sipas këtij parimi, interpretimi sistematik mbështetet në një krahasim dhe interpretim të dispozitave, të cilave u konstatohet përqasja me dispozita të tjera, të ligjeve të tjera apo atij ligji, si dhe me sistemin e përgjithshëm juridik, duke pasur parasysh se çdo dispozitë pasqyron një pjesë të sistemit si tërësi dhe duhet të ketë harmoni në përmbajtje dhe vlerë me disa akte të tjera apo

me grupe dispozitash në këtë sistem juridik³³². Ky parim vlen edhe për ndërtimin e një ligjit të vetëm, që përmban të dy dispozitat, dispozitat e veçanta dhe ato të përgjithshme³³³.

Ky fakt përforcohet nga parashikimi “*Për çështjet, që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, në veprimtarinë e ndërmjetësimit, për aq sa është e mundur, zbatohen dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë parasysh natyrën ligjore të çështjes*”³³⁴. Në këtë dispozitë, shprehimisht parashikohet se procedurat për këto vepra penale duhet detyrimisht të rregullohen nga ligji për ndërmjetësimin fillimisht. Nëse në këtë ligj ato nuk gjejnë rregullim të plotë, atëherë ato rregullohen nga dispozitat e tjera të së drejtës, që rregullojnë këto marrëdhënie.

Ligji për ndërmjetësimin shkon edhe më tej, duke i dhënë këtij ligji një dimension akoma më të gjerë. Parimi i të drejtës për të aplikuar marrëveshjen e ndërmjetësimit përtej kufijve, duke u mjaftuar që një palë të ketë vendbanimin në Shqipëri, e ka origjinën në të drejtat dhe detyrimet që Direktiva 2008/52/EC, i njeh Shqipërisë si një shtet aderues. Referuar nenit 1/2, Objektivat dhe fushëveprimi i kësaj direktive, përcaktohet se kjo Direktivë do të zbatohet, në kontekstet ndërkufitare, në çështje civile dhe çështje tregtare, përveç sa i përket të drejtave dhe detyrimeve, të cilat nuk janë në dispozicion të palëve sipas ligjit të aplikueshëm³³⁵.

Sipas Komisionit Europian, mënyrat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërkufitare konsiderohen ato mekanizma, të cilat gjenden për të mbushur boshllëkun e procedurave gjyqësore kombëtare, për të siguruar qasje më të mirë në drejtësi, si dhe për të garantuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian. Në të vërtetë, këto zgjidhje konsiderohen si më të përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sepse ato lejojnë palët që të përballen me njëra-tjetrën, duke u bazuar në parimin e një dialogu që do t’iu lejojë atyre, përfundimisht, të vendosin nëse dëshirojnë apo jo ti nënshtrohen një procesi gjyqësor³³⁶.

³³² Petroviq, B.(2006)., E Drejta Penale, Sarajevë / Prishtinë, fq. 23-24.

³³³ https://en.wikipedia.org/wiki/Lex_specialis; dt.05.01.2016.

³³⁴ Neni 2/7; ligji 10385 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

³³⁵ Directive 2008/52/EC; article 1.

³³⁶ Marzocco, A Maria & Nino M, (2011). *Directive commentary*, pp. 109-110.

KAPITULLI V: PARIMET QË PALËT DUHET TË NDJEKIN NË NJË PROCES NDERMJETËSIMI NË KENDVËSHTIMIN E KODIT ETIK EUROPIAN DHE LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

1. Kodi Etik European për Ndërmjetësit

Ky Kod Etik për ndërmjetësit³³⁷ parashtrohet një sërë parimesh, ku çdo ndërmjetës, spontanisht mund të aderojë nën përgjegjësinë e tij. Kodi mund të zbatohet për të gjitha llojet e ndërmjetësit, në çështjet civile dhe tregtare. Gjithashtu, edhe organizatat që ofrojnë shërbime ndërmjetësimi mund të bëjnë një angazhim të tillë, duke i kërkuar ndërmjetësve që veprojnë brenda fushës së tyre, të veprojnë në përputhje me këtë kod. Ata (organizata) mund të japin informacione mbi masat (të tilla si, vlerësimin e trajnimit dhe monitorimin) e marra për të favorizuar respektimin e kodit nga çdo ndërmjetës.

Respektimi i Kodit të Etikës nuk ndikon në zbatimin e legjislacionit kombëtar ose rregullat që rregullojnë profesionet individuale. Organizatat që ofrojnë shërbime ndërmjetësimi mund të hartojnë kode edhe më të detajuara, të përshtatura për kontekstin e tyre specifik ose llojet e shërbimeve të ndërmjetësit që ato ofrojnë, si dhe për fusha ndërmjetësimi të veçanta, të tilla si: ndërmjetësimi familjar apo ajo që ka të bëjë me konsumatorin³³⁸.

1.1. Kompetenca, emërimi, tarifat dhe promovimi i shërbimeve të ndërmjetësve.

Në pikën 1 të Kodit Etik European për Ndërmjetësit, vërejmë se janë të përcaktuar katër pika esenciale që kanë të bëjnë me kompetencën, emërimin, pagesën dhe promovimin e shërbimit të ndërmjetësit, ku, përsa i përket kompetencës, ndërmjetësi duhet të jetë kompetent dhe ta njohë mirë procesin e ndërmjetësit³³⁹.

Ndërmjetësi duhet të konsultohet me palët, për datat në të cilat ndërmjetësimi do të zhvillohet dhe përpara se të pranojë detyrën, atij i kërkohet të vetëvlerësohet, nëse ka aftësitë

³³⁷ Marrë nga: http://ec.europa.eu/civiljustice/aclr/adr_ec_code_conduct_it.pdf (parë me 12.03.2012).

³³⁸ Codice Europeo Di Condotta Per Mediatori, fq.1.

³³⁹ Faktorët relevant përfshijnë një trajnim të përshtatshëm dhe të përditshëm të vazhdueshëm të institutit të tyre dhe praktikë në aftësitë e ndërmjetësit, duke pasur parasysh standardet përkatëse dhe sistemet e aderimit të profesionit.

e duhura për të ndërmjetësuar rastin që i paraqitet si dhe, përse i përket kësaj, t'i japë informacionet e duhura palëve.

Gjithashtu, në këtë kod përmendet edhe shpërblimi i ndërmjetësit, kur nuk është i parashikuar, ai duhet t'i paraqesë palëve mënyrën e tij të pagesës dhe nuk duhet të pranojë, të ndërmjetësojë përpara se honorari i tij të aprovohet nga palët e interesuara. Si edhe i jep ndërmjetësuesit të drejtën për të promovuar aktivitetin e tij, por me kushtin që të jetë në një mënyrë profesionale, i vërtetë dhe dinjitoz.

1.2. Pavarësia, paanshmëria dhe konfidencialiteti

*Pavarësi, paanshmëri dhe konfidencialiteti, janë tre parimet që Kodi Etik European për ndërmjetësit i ka kushtuar një vëmendje adekuate. Pikërisht, përse i përket pavarësisë, në të thuhet se: "Nëse ekzistojnë rrethana që mund (ose mund të duken) të ndikojnë në pavarësinë e ndërmjetësit apo të krijojnë konflikt interesi, ndërmjetësuesi duhet të informojë palët përpara se të veprojë apo të vazhdojë punën e tij"*³⁴⁰.

Pra, çdo marrëdhënie personale ose profesionale me një nga palët, çdo interes i tipit ekonomik apo i një lloji tjetër, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, që mund të influencojë në rezultatin e ndërmjetësimit, fakti që ndërmjetësi, apo një anëtar i shoqatës së tij, të ketë vepruar ndryshe nga ai i rolit të ndërmjetësit për një apo më shumë palë, do të konsiderohet si shkelje të parimit të pavarësisë dhe mund të çojnë në pavlefshmërinë e aktmarrëveshjes apo të influencojnë në rezultatin e tij. Dhe detyrimi për të informuar palët, duhet të jetë gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurës së ndërmjetësimit.

Koncepti i paanshmërisë së ndërmjetësit është thelbësor për procesin e ndërmjetësimit. Ndërmjetësi duhet të ndërmjetësojë vetëm ato çështje, ku ai ndihet i paanshëm dhe i drejtë. Në qoftë se ndërmjetësi nuk është në gjendje ta zhvillojë procesin në mënyrë të paanshme, ai është i detyruar të tërhiqet. Kjo në kuptimin që ndërmjetësi në çdo kohë duhet të veprojë në lidhje me palët në mënyrë të paanshme, duke u përpjekur të paraqitet si i tillë, dhe duhet t'i asistojë në mënyrë të barabartë, të gjitha palët në një proces ndërmjetësimi³⁴¹.

³⁴⁰ Codice Europeo Di Condotta Per Mediatori. "2-Indipendenza ed imparzialità/2.1 -Indipendenza ". fq.3.

³⁴¹ Emmond P. Zaka T. Zaka, Kosta&Tashko.(2007). *Njohje me zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve*. RISTALINA-KH. Fq.281.

Përsa i përket parimit të konfidencialitetit³⁴², ndërmjetësi duhet të ruajë të gjithë informacionin mbi ndërmjetësimin ose në lidhje me të, përfshirë faktin që ndërmjetësimi është duke u kryer ose ka përfunduar, me përjashtim të rasteve kur kjo kërkohet me ligj ose për arsye të rendit publik. Pra, çdo informacion që i është dhënë ndërmjetësit nga njëra palë nuk duhet t'i zbulohet palës tjetër pa konsensusin e palës ose nëse kërkohet me ligj.

1.3. Marrëveshja, procesi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Ky nen i Kodit Etik është i ndarë në disa nëntituj si procesi, korrektësia e procesit dhe fundi i procesit, ku në mënyrë të hollësishme dhe në lidhje me legjislacionin aktual në fuqi është folur në Kapitullin IV (Procedura e Ndërmjetësimit), por, nuk duhet lënë pa theksuar rëndësia që ky kod i kushton palëve, duke kujtuar dhe detyruar ndërmjetësin në lidhje me nevojat që kanë palët dhe rëndësinë e mënyrës së trajtimit të çështjeve konkrete, të cilat ndryshojnë nga njëra-tjetra. Dhe pikërisht, ndërmjetësi duhet të udhëheqë procesin në mënyrë të përshtatshme, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, duke përfshirë zhbalancimet e mundshme në marrëdhëniet e "pushtetit", çdo kërkesë të palëve dhe dispozitat e veçanta, dhe jo më pak, nevojën për një zgjidhje sa më të shpejtë konfliktit. Palët mund të bien dakord me ndërmjetësin, për mënyrën se si do të zhvillohet ndërmjetësimi, gjithmonë në lidhje me rregullat përkatëse.

2. Parimet kryesore të Ndërmjetësimit sipas legjislacionit shqiptar

Ndërmjetësimi është një nga metodat më efektive të menaxhimit, parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve. Për të qenë efektiv, një proces ndërmjetësimi kërkon më shumë se thjeshtë emërimin e një individi të profilit të lartë për të vepruar si një palë e tretë. Kundërshtarët duhet të binden për të marrë pjesë në ndërmjetësim, për tarifat që ky proces ka, si dhe për ndërmjetësin që do të lehtësojë zgjidhjen e konfliktit midis tyre. Si përfundim, ndërmjetësi ka si qëllim arritjen e një zgjidhje efektive dhe të qëndrueshme³⁴³. Për të arritur në këtë synim, duhet të kemi parasysh parimet mbi të cilat mbështetet ndërmjetësimi.

Referuar nenit 3 të ligjit 10385, për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve ato janë:

³⁴² Po aty, pika 4.fq.4

³⁴³ Ban-Ki-Moon, "Guidance for Effective Mediation", pp.1.

1. *Ndërmjetësimi bazohet në parimin e barazisë së palëve, konfidencialitetit të të dhënave, si dhe në respektimin e fleksibilitetit e të transparencës së procedurave dhe të vullnetit të palëve në proces.*
2. *Ndërmjetësi, në ushtrimin e funksionit të tij, siguron zgjidhjen e çështjes me efikasitet, drejtësi dhe paanshmëri, si dhe në mënyrë profesionale e pa paragjykime ndaj palëve apo çështjes, objekt ndërmjetësimi.*
3. *Ndërmjetësimi është vullnetar dhe palët në mosmarrëveshje janë të lira:*
 - a) *të zgjedhin ndërmjetësimin, si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në këtë ligj;*
 - b) *të përcaktojnë kushtet, procedurën, si dhe afatet për aq sa ato janë të lejueshme;*
 - c) *të heqin dorë, në çdo kohë, nga zgjidhja e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.*
4. *Ndërmjetësi nuk ka përgjegjësi, nëse ndërmjet palëve për zgjidhjen e konfliktit me ndërmjetësim nuk arrihet marrëveshje, ose nëse marrëveshja është arritur, por nuk zbatohet nga palët.*
5. *Në rastin kur palët arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet tyre, ndërmjetësi nuk ka përgjegjësi për moszbatimin e kësaj marrëveshjeje.³⁴⁴*

Për të arritur në një ndërmjetësim të suksesshëm, ndërmjetësi duhet të vlerësojë një numër të dhënash, të cilat përbëjnë çelësin dhe themelin e problemit për të cilin palët kanë konsideruar në një përpjekje për ndërmjetësim. Këto të dhëna, të cilat ndërmjetësi duhet të vlerësojë dhe përfaqësojë janë; gatishmëria e palëve për t'u ulur në ndërmjetësim; pëlqimi i tyre ndaj ndërmjetësit që do t'i asistojë; paanshmëria që ndërmjetësi paraqet; përfshirja e çdo të interesuari në proces; interesat e palëve; kornizat normative e ligjore; koherencën e argumenteve të palëve, koordinimin e përpjekjeve për ndërmjetësim; dhe, përpjekje për marrëveshjen, e cila nuk do të jetë burim konflikti.

Gjatë këtij procesi, sfidat e mundshme dhe dilemat me të cilat përballet ndërmjetësi janë të shumta, por ai duhet të jetë i aftë t'i përballojë ato. Një nga sfidat e Ndërmjetësit është se çdo situatë duhet të trajtohet ndryshe, dhe në fund të fundit, vullneti i palëve në konflikt është faktori përcaktues për sukses.³⁴⁵ Megjithatë, vëmendja e kujdesshme e këtyre elementeve mund të rrisë perspektivat për një proces të suksesshëm, të minimizojë

³⁴⁴Neni 3 i ligjit 10385 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

³⁴⁵Ban-Ki-Moon, “Guidance for Effective Mediation”, pp.3.

potencialet e ndërmjetësi për gabime dhe të ndihmojë të gjenerojë një mjedis më të favorshëm për ndërmjetësim.

Ne, të gjithë negociojmë në një pikë në jetën tonë, ndonjëherë jemi më efektiv se kundërshtari, ndonjëherë dështojmë. Jemi një specie që mbijetojmë dhe lulëzojmë, kryesisht, për shkak të kësaj aftësie. Ajo që mund të themi është se të gjitha mënyrat e menaxhimit të konflikteve apo proceset negociative, pavarësisht se janë fleksibël, efikase, ekonomike, janë po aq të ndjeshme për njeriun. Në historinë e hershme njerëzore, ndërmjetësi kryesisht ka ekzistuar brenda dhe në mes të afërmeve, fiseve, dhe komuniteteve. Megjithatë, pavarësisht nga nevoja që njerëzimi ka për mbijetesë, negocimi mbetet në mendjet e shumicës së njerëzve. Në shekujt e fundit veçanërisht, nevojat njerëzore janë bërë më komplekse e më të thella se kurrë, në të gjitha aspektet, qofshin ato shoqërore, politike, teknologjike apo ekonomike.

Sjelljet prej negociatori dhe i gjithë ky proces kanë për qëllim të përshkruajnë shumëllojshmërinë e mënyrave të komunikimit, që në rastin e ndërmjetësimit shtrihen përtej çdo natyre të negociatave. Komunikimi që ndërmjetësi përdor përfshin çdo mënyrë të shprehjes apo veprimit, qoftë formale apo informale, që shërben për të menaxhuar, minimizuar, ose zgjidhur çështjet apo mosmarrëveshjet, që lindin në mes të njerëzve. Më e zakonshme e këtyre proceseve është negociata e drejtpërdrejte midis dhe nëpërmjet palëve kryesore të përfshira në një polemikë, apo ndërmjetësimin kur procesi i negociatave është ndihmuar nga një palë e tretë. Shumë njerëz dhe praktikuesit shohin negocimin dhe ndërmjetësimin si procese të veçanta dhe të ndara, por strategjitë, teknikat dhe aftësitë janë në thelb të njëjta për të dy; vetëm forma është e ndryshme.

Negociata te improvizuara joformale ose ndërmjetësime mund të bëhet në mënyrë të heshtur, ose përmes gjesteve, ose përmes mosmiratimit, ose nga takimet e organizuara formalisht të përbashkëta apo të ndara. Në çdo familje apo në punë, miqtë, anëtarët e familjes, bashkë-punëtorët, kolegët, apo drejtuesit, si alternative e negociatorit, shërbejnë si ndërmjetës *de facto*, apo janë pjesëmarrës në një ndërmjetësim³⁴⁶.

Në organizata apo agjenci të mëdha, në praktika të huaja, roli i drejtuesve apo përfaqësuesve është që të përdorin teknika mediative për të menaxhuar streset e brendshme organizative dhe mosmarrëveshjet që lindin nga ato. Megjithatë, ndryshe nga një gjyqtar apo

³⁴⁶Lax, David A., & Sebenius, James K. (1986). *Menaxheri si negociator*, free press.

arbitër, të cilët kanë autoritetin për të imponuar një rezultat ose përcaktim në një polemikë, ose nga ligji ose nga kontrata, negociatorët dhe ndërmjetësit nuk kanë asnjë fuqi ose autoritet të tillë, edhe pse ndonjëherë proceset e arbitrazhit, proceset e negocimit dhe të ndërmjetësimit janë të bashkuara apo mbivendosen me njëra-tjetrën³⁴⁷.

Procesi i ndërmjetësimit është unik dhe krejtësisht vullnetar. Prezenca e ndërmjetësit kërkon detyrimisht pëlqimin e palës tjetër. Proceset e negocimit përdoren në çdo rast kur ka mosmarrëveshje, duke përfshirë: ndërmjetësin në sistemet arsimore, çështje civile, tregtare, pune, penale, transaksionet e biznesit, në politikë, formulimin e politikave publike dhe legjislacionit, kontestet juridike, çështjet gjeopolitike midis popujve, çështjet mjedisore dhe shkencore, mjekësore e kërkimore. Kur shikojmë që rregullat, ligjet, rregulloret dhe politikat e formalizuara nuk mund apo nuk shërbejnë në mënyrë efektive për të zgjidhur kundërshtitë ose çështje që kërkojnë tolerance më të madhe apo fleksibilitet, ndërmjetësimi është mjeti kryesor, me të cilin njerëzit mund të arrijnë një nivel të lartë të komoditetit të zgjedhjes së mënyrës së zgjidhjes së një konflikti, për të jetuar dhe punuar me mirë së bashku.

Kapaciteti për *ndjeshmëri* dhe *aftësinë për të komunikuar* janë komponentët thelbësorë të një ndërmjetësi, ato nuk janë një zëvendësim për negociata efektive. Sjelljet negociatore të ndërmjetësit janë deri në limitin që të çon në një marrëveshje të realizueshme mes njerëzve, shpesh herë në rrethana, ku ndjeshmëria dhe komunikimi janë vetëm mes të pranishme. Sjellja negociatore është muskuli dhe kocka, që konverton instinktin e brendshëm që njeriu përdor për mbijetesë në njohjen e faktit që bashkëpunimi dhe bashkërendimi janë të nevojshme, në realitet, pavarësisht nga marrëdhëniet ku ata janë përfshirë.

Referuar sa me sipër, shohim se në këtë dispozitë, përfshihen si parimet e procesit të ndërmjetësimit, ashtu edhe parimet që palët dhe ndërmjetësi duhet të ndjekin. Logjikisht nuk ka se si të jetë ndryshe pasi, këto parime nuk mund të shihen të ndara nga njëra-tjetra. Janë palët ato që bëjnë procesin dhe është procesi ai që bën palët sëbashku. Të marrim secilin element për të parë se si ai qëndron në raport me palët në proces dhe me procesin në vetvete.

2.1 Parimi i Barazisë

Ndërmjetësi duhet të jetë i kujdesshëm që t'i trajtojë palët në mënyrë të barabartë. Kjo vërehet nga sjellja që ndërmjetësi ka, me secilin prej tyre. Madje, çdokush do të ndihej i

³⁴⁷Brown, H. & Marriott, A. (2011). "ADR Principles and Practice", 3rd ed.

diferencuar edhe nëse jemi me një shok, dhe takojmë një person të tretë. Nëse ai do t'ia shtrëngonte shokut dorën pak më gjatë apo do ta pyesë atë pak më shumë rreth shëndetit e familjes së tij, ndërsa juve do t'iu jepte një përshëndetje të shkurtër e të thjeshtë, duke mos u interesuar për shëndetin apo familjen tuaj. Do të ndjehej menjëherë ndryshimi i sjelljes së tij kundrejt secilit prej nesh. Imagjinoni, nëse kjo situatë do të ndodhte në një situatë të konfliktuar, pikërisht nga personi tek i cili ju shpresoni të gjeni një zgjidhje. Ndërmjetësi duhet të bëjë kujdes për mënyrën se si i trajton palët, duke u kujdesur deri në detajin më të vogël, për të paraqitur dhe për të dhënë ndjesinë e barazisë. Ai duhet:

- të shpenzojë të njëjtën kohë me secilën nga palët, në këtë mënyrë pala tjetër nuk do të shpenzonte kohë, duke menduar “çfarë do të jenë duke biseduar aq gjatë ata”;
- të dëgjojë me të njëjtën ndjeshmëri ata, për të mos bërë asnjërin prej tyre të ndihet i mbështetur apo i refuzuar;
- të mos marrë asnjëherë anë, duke i dhënë të drejtë njërit apo tjetrit, duke mos mbajtur anë dhe duke u përpjekur të paraqesë paanshmëri ndaj palëve;
- Ai duhet të angazhohet për t'i shërbyer të gjitha palëve në mënyrë të barabartë, në lidhje me Procesin e Ndërmjetësimit³⁴⁸. Në kodin Evropian të Sjelljes për ndërmjetësit, kjo gjë është e parashikuar në mënyrë të shprehur.

Në standardet shembull të sjelljes për Ndërmjetësit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, parashikohet se, edhe kur palët vetë bien dakord që do të paguajnë tarifa të ndryshme, pra njëra palë më shumë e njëra më pak, ndërmjetësi i ndalohet ta reklamojë këtë fakt³⁴⁹.

2.2 Parimi i Konfidencialitetit

Një varg çështjesh mund të ndikojnë, që palët në konflikt të japin pëlqimin për ndërmjetësim. Integriteti i procesit të ndërmjetësimit, siguria dhe konfidencialiteti janë elementë të rëndësishëm që ndikojnë në dhënien e pëlqimit të palëve për të marrë pjesë së bashku, në procesin e ndërmjetësimit³⁵⁰. Në nenin 19 dhe 20 të ligjit 10385, Për

³⁴⁸ Kodi Evropian i Sjelljes për ndërmjetësit; 2.2. Impartiality.

³⁴⁹ Model Standards Of Conduct For Mediators Standard VIII. Fees And Other Charges B. 2.

³⁵⁰ Ban-Ki- Moon, (2012) “*Guidance for Effective Mediation*”, pp.8.

Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve parashikohet: *Neni 19 - Konfidencialiteti*³⁵¹

1. *Përveçse, kur palët kanë rënë dakord ndryshe, tërësia e të dhënave dhe e rrethanave për procedurat e ndërmjetësit duhet të mbeten konfidenciale.*
2. *Pavarësisht nga rregulli i ruajtjes së konfidencialitetit, bëhen publike të dhënat dhe përmbajtja e marrëveshjes së arritur në rastet kur:*
 - a) *është e nevojshme për shkaqe të cenimit të interesave themelorë të shtetit dhe/apo interesit publik;*
 - b) *është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e dhunës fizike apo psikologjike ndaj çdo personi, veçanërisht, ndaj fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara;*
 - c) *është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e keqtrajtimit, të dhunës fizike apo psikike të personave me aftësi të kufizuara;*
 - d) *nëpërmjet bërjes publike të të dhënave dhe/apo marrëveshjes së ndërmjetësit sigurohet zbatimi i kësaj marrëveshjeje.*

Referuar sa më sipër, vërejmë edhe se ligji i ka dhënë një status të veçantë procesit në përgjithësi. Fillimisht vërejmë se kufizimi kryesor është i përcaktuar nga liria e vullnetit të palëve në konflikt. Vërejmë edhe elementin e dytë, i cili e lidh mundësinë e nxjerrjes së të dhënave vetëm me përmbajtjen e marrëveshjes, kur kjo e fundit ka të dhëna, të cilat vijnë ndesh me interesa të larta të shtetit, interesin publik, interesin e të miturit apo personave me aftësi të kufizuara, si dhe me interesin e zbatueshmërisë së vetë marrëveshjes.

Ky parim, në vazhdim të tij, ndiqet dhe rregullohet nga detyrimet, që parashikon neni 20 i ligjit 10385, Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, ku parashikohet se:

*Neni 20 - Mospërdorimi i të dhënave*³⁵²

1. *Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, një palë që merr pjesë në procedurën e ndërmjetësit ose një person i tretë, përfshirë dhe ndërmjetësin, nuk mund të kërkojnë ose të përdorin në një proces gjyqësor, arbitrazhi a në ndonjë procedurë tjetër të ngjashme, prova ose dëshmi, pavarësisht nga forma e tyre, si më poshtë:*

³⁵¹ Neni 19 i ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

³⁵² Po Aty. Neni 20.

- a) ftesën e një pale për të marrë pjesë në një procedurë ndërmjetësimi ose veprimin me të cilin njëra nga palët ka shprehur vullnetin për të marrë pjesë në procedurën e ndërmjetësimit;
 - b) mendimet e shprehura ose sugjerimet e bëra nga njëra palë, gjatë ndërmjetësimit ose nga ndërmjetësi për zgjidhjen e mundshme të mosmarrëveshjes;
 - c) deklaratat ose pohimet e bëra nga njëra palë, gjatë zhvillimit të procedurës së ndërmjetësimit;
 - d) propozimet e bëra nga ndërmjetësi;
 - e) faktin që njëra nga palët në procedurën e ndërmjetësimit ka shprehur vullnetin për të pranuar propozimin e bërë nga ndërmjetësi ose zgjidhjen e mosmarrëveshjes;
 - f) një dokument të përgatitur vetëm për qëllim të procedurës së ndërmjetësimit.
2. Rregullat e parashikuara, në pikën 1 të këtij neni, zbatohen nga gjykata, arbitrazhi dhe në procedura të tjera të ngjashme, pavarësisht, nëse këto organe e shqyrtojnë një mosmarrëveshje që ka qenë ose është në procedurën e ndërmjetësimit.

Nisur nga përmbajtja e kësaj dispozite vërejmë se vetëm kur palët kanë rënë dakord, një palë që merr pjesë në procedurën e ndërmjetësimit ose një person i tretë, përfshirë dhe ndërmjetësin, mund të kërkojë ose të përdorë në një proces gjyqësor, arbitrazhi a në ndonjë procedurë tjetër të ngjashëm, prova ose dëshmi të krijuara apo të dala në një proces ndërmjetësimi. Asnjë nga thëniet e palëve, procesverbalet e takimeve, mendimet, propozimet apo sugjerimet e ndërmjetësve, nuk merret si provë në një proces gjyqësor, arbitrazhi apo çdo proces të ngjashëm me to.

Kjo dispozite procedurale në përmbajtje, përbën garancinë që palët në proces të shprehen qartë dhe të shpalosin të gjitha pretendimet e tyre pa u kufizuar. Gjithashtu, vërejmë se në këtë dispozitë parashikohet, përveç garancisë që palët kanë në drejtim të njëri-tjetrit, edhe detyrimin me të cilin ngarkohet ndërmjetësi për të ruajtur këtë në konfidencialitet. Ndërmjetësi është i detyruar që përmbajtjen e marrëveshjes mos t'ia vërë në dispozicion asnjë pale tjetër, përveç palëve në proces³⁵³. Duhet theksuar se ndërmjetësimi ka për qëllim të zhvillohet duke respektuar konfidencialitetin, përveç, nëse palët pajtohen ndryshe³⁵⁴. Ky

³⁵³ Kodi Evropian i Sjelljes për ndërmjetësit.

³⁵⁴ The European Mediation Directive 2008/52 / EC “Legal and Political Support for Alternative Dispute Resolution in Europe”, Confidentiality.

detyrim, sa pamë më sipër, vjen nga ligji për ndërmjetësimin, statuti dhe aktet nënligjore të dala për zbatim të tij, por duhet të kemi parasysh se Shteti shqiptar, për krijimin e ligjit për ndërmjetësimin, është bazuar në Direktivën 2008/52 / EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 21 maj 2008, mbi disa aspekte të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare. Në këtë Direktivë parimi i konfidencialitetit është shprehimisht i përcaktuar si një nga parimet themelore të ndërmjetësimit ku parashikohet se:

(16)³⁵⁵- *Për të siguruar besimin e nevojshëm të ndërsjellë në lidhje me konfidencialitetin, me fuqi në kufizim dhe aplikim sipas periudhave, si dhe njohjen dhe ekzekutimin e marrëveshjeve që rezultojnë nga ndërmjetësimi, Shtetet Anëtare duhet të inkurajojnë, me çdo mjet që ata i konsiderojnë të përshtatshme, trajnimin e ndërmjetësve dhe futjen e mekanizmave për të siguruar kontrollin e cilësisë efektive në lidhje me ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit.*

(23)³⁵⁶- *Konfidencialiteti në procesin e ndërmjetësimit është i rëndësishëm prandaj kjo Direktivë duhet të sigurojë një shkallë minimale të përputhshmërisë së rregullave procedurale civile me qëllim mbrojtjen e konfidencialitetit të ndërmjetësimit, në çdo procedurë pasuese civile dhe tregtare gjyqësore ose të arbitrazhit.*

Neni 7-Fshehtësia e ndërmjetësimit

1. *Duke pasur parasysh se ndërmjetësimi ka për qëllim që të zhvillohet në një mënyrë që respekton fshehtësinë, përveç, nëse palët pajtohen ndryshe, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që, as ndërmjetësuesi, as ata që janë përfshirë në administrimin e procesit të ndërmjetësimit nuk do të detyrohen të dëshmojnë në procedurat civile komerciale gjyqësore apo arbitrazhi në lidhje me informacionet që dalin nga ose në lidhje me procesin e ndërmjetësimit, përveç:*

- (a) *kur kjo është e nevojshme për gjykime ku mbizotëron interesi më i lartë rendit publik të Shtetit Anëtar në fjalë, në mënyrë të veçantë, kur kërkohet për të siguruar mbrojtjen e interesave më të mira të fëmijëve, ose për të parandaluar dëme të integritetit fizik ose psikologjik të një personi; ose*

³⁵⁵ DIRECTIVE 2008/52/EC Of The European Parliament And Of The Council.

of 21 May 2008; Whereas: (16).

³⁵⁵ Po aty; Whereas: (23).

³⁵⁶ Po aty.

(b) kur zbulimi i përmbajtjes së marrëveshjes së rezultuar nga ndërmjetësimi është i nevojshëm në mënyrë që të zbatohet ose zbatohet kjo marrëveshje.

2. Asgjë në paragrafin 1 nuk i pengon Shtetet Anëtare të miratojnë masa strikte për të mbrojtur konfidencialitetin e ndërmjetësimit³⁵⁷.

Pra shohim se konfidencialiteti është një parim i konsoliduar mirë dhe vjen edhe si një detyrim nga Direktiva 2008/52/EC “Për Ndërmjetësimin” nga parlamenti europian.

Lind pyetja: po ndërmjet palëve në ndërmjetësim, a ekziston parimi i konfidencialitetit? Në fakt kjo është një pyetje që e merr përgjigjen tek teknikat e ndërmjetësimit. Por, si pyetje me vend që është, përgjigja është po. Ndërmjetësi është i detyruar të shpalosë vetëm atë informacion, për të cilin, më parë ka marrë nga palët aprovimin e tyre për t’ia shpalosur palës tjetër. Në këtë mënyrë, Ndërmjetësi nuk ndikon në lirinë e vendimmarrjes së palëve. Njëkohësisht nuk rrezikon të përçojë një informacion në mënyrën e paduhur.

2.3 Parimi i fleksibilitetit të procedurës

Procesi i ndërmjetësimit është një proces joformal, që do të thotë se ai nuk është i udhëhequr nga rregullat, provat dhe formalitetet e procedurës. Por, njëkohësisht nuk është një proces i improvizuar apo i rastësishëm. Procesi i ndërmjetësimit në vetvete është i strukturuar dhe formalizuar, sipas nevojave dhe kushteve të palëve pjesëmarrëse në të³⁵⁸. Për shembull, vendi ku mbahet ndërmjetësimi, ora që vendoset për t’u takuar me ndërmjetësin, rregullat e njoftimit, mënyra e organizimit të takimeve (të përbashkëta apo të ndara), mënyra e përcaktimit të personit të tretë (ndërmjetësit) që do të luajnë rolin e lehtësuesit, janë krejtësisht rregulla të cilat përcaktohen nga vete palët³⁵⁹. Palët janë të lira të vendosin të takohen në një kafene, në zyrë apo të bëjnë një shëtitje në park. Ata mund të takohen gjatë ditëve të javës apo në fundjave, ditën apo natën. Mund të njoftohen nëpërmjet telefonit, postes, e-mailit, personalisht apo në çdo mënyrë të mundshme. Fleksibiliteti në procesin e ndërmjetësimit është i tillë, që të vijë në ndihmë të çdo shtate, e cila mund të bëjë të mundur

³⁵⁷ Po aty; (article 7)

³⁵⁸ KUMAR, S. (2010) , “mediation training manual India); pp. 16

³⁵⁹ Neni 3 pika 3/b i ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”; të përcaktojnë kushtet, procedurën, si dhe afatet për aq sa ato janë të lejueshme.

përshtatjen e nevojave të palëve në çdo çështje. Palët e konfliktuara shpesh, mundohen të gjejnë të gjitha arsyet e mundshme për mos t'u përballur me kundërshtarin e tyre, dhe një nga mënyrat që procesi i ndërmjetësimit t'i vijë në funksion kësaj situate është krijimi i një procedure fleksibël. Në këtë mënyrë, nëse arsyeja për mos të takuar ndërmjetësin është “më është prishur makina”, atëherë ndërmjetësin nuk e ndalon asgjë të shkojë e ta ezaurojë takimin në kafenenë poshtë shtëpisë së palës. Pra, fleksibiliteti i procesit të ndërmjetësimit është një parim shumë efikas.

Njëkohësisht, do të kemi parasysh se parimi i fleksibilitetit ndihmon edhe në krijimin e një atmosfere miqësore, çka synon vazhdimisht procesi ndërmjetësimit. Në ndërmjetësim nuk do të kemi asnjëherë një situate të tillë si në gjykatë. Hija e gjykatës me rregulla procedurale deri në detajin e veshjes së gjyqtarit, sekretarit gjyqësor, detyrimi për t'u ngritur të gjithë në këmbë kur hyn gjyqtari, mënyra e pozicionimit të gjyqtarit në krye të dhomës në një vend më të ngritur e të ndarë nga të tjerët, ekzistenca e oficerëve të policisë në sallë etj., është shumë e rëndë. Në ndërmjetësim, jemi përpara një situate, e cila nuk ngjason aspak me këtë panoramë. Palët në ndërmjetësim janë të gjithë të barabartë, ata i vendosin vetë rregullat nëse duan rregulla dhe janë të lirë në çdo veprim të tyre.

2.4 Parimi i transparencës së procedurave

Transparenca është një kërkesë e domosdoshme për të gjetur rrugën për marrëveshjen më të mirë. Në procesin e ndërmjetësimit, transparencat e procedurave është shumë e rëndësishme. Palët duhet të paraqesin qartë interesat e tyre për të gjitha palët e tjera në proces, dhe në të njëjtën kohë, të kuptojnë interesat e palëve të tjera në mënyrë që të parashikojnë e të kuptojnë veprimet e tyre. Transparenca e tillë mund të arrihet duke kërkuar informacion të detajuar në mënyrë simetrike, pra, duke marrë nga të dyja palët një sasi dhe një cilësi të caktuar informacioni.

Me fjalë të tjera, të gjitha palët e përfshira në ndërmjetësim duhet të jenë të vetëdijshme për të gjitha përfitimet, humbjet, dhe çdo veprim të njëri-tjetrit, deri në pikën e vendimit të tyre. Në nenin 15 të ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” parashikohet: *Neni 15 - Liria e palëve për rregullat dhe mënyrën e ndërmjetësimit:*

1. *Palët, në përputhje me këtë ligj, janë të lira të vendosin rregullat dhe mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit.*
2. *Palët zgjedhin vullnetarisht një ose më shumë ndërmjetës prej Regjistrisë të Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë.*

Pra palët vendosin të lira për rregullat dhe mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit, si dhe për përzgjedhjen e ndërmjetësit që do të lehtësojë, sipas ligjit, procesin e ndërmjetësimit, në të cilin ata me dëshirë janë duke marrë pjesë.

Transparenca dhe bashkëpunimi në ndërmjetësim varet vetëm nga ndërmjetësit dhe palët. Nga natyra, çdo ndërmjetësim fillon me informacionin e panevojshëm. Të dyja palët përpiqen të fshehin informacionin e favorshëm për ta dhe tregohen dorëlëshuar me informacionet e pafavorshme. Me bashkëpunimin e palëve, një ndërmjetës i aftë mund të drejtojë procesin drejt një rruge transparente ku palët kuptojnë interesat e njëri-tjetrit.

Në mënyrë që të arrihet një zgjidhje reciprokisht e kënaqshme, ndërmjetësi duhet të stimulojë besimin, që, në fund të fundit, do të rezultojë në ndarjen e informacionit të nevojshëm për ndërmjetësin. Nëse ndërmjetësi është i suksesshëm në ndërtimin e besimit, duke garantuar njëkohësisht transparencën e procesit, palët në fund do të arrijnë në përfundimin, se rezultati më i mirë i mundshëm është të gjejnë një zgjidhje për konfliktin, në mënyrë që të adresojnë dhe zgjidhin interesat e të gjitha palëve³⁶⁰. Të qenit transparent e palëve me ndërmjetësin, nuk do të thotë domosdoshmërisht që ndërmjetësi të shpallë çdo informacion që merr nga njëra palë tek pala tjetër. Kjo pasi do të cenonte rëndë procesin. Ndërmjetësi mund të ndihmojë këtë hallkë të procesit, duke i marrë leje palëve për informacionin që do të depërtojë tek pala tjetër. Në këtë mënyrë, edhe parimi i konfidencialitetit të palës me ndërmjetësin nuk do të thyhet, por ajo që është më e rëndësishme, është se palët do të ndihen më komode dhe më në kontroll të të gjithë procesit.

2.5. Parimi i efikasitetit

Infrastruktura joadekuate takohet me sfidën e ekspozuar, si dhe paaftësinë e sistemit për të trajtuar volumin e madh të çështjeve gjyqësore në mënyrë efikase dhe efektive. Në vend të pritjes në radhë për vite, duke kaluar në proceset gjyqësore, të cilat zgjasin në kohë,

³⁶⁰Maia, A. <http://kluwermediationblog.com/2012/10/25/transparency-is-a-necessary-requirement-to-find-the-way-for-the-best-agreement/> dt.26.12.2015.

ndërmjetësimi shihet si një hallkë për të shmangur sistemet gjyqësore ose për të filluar përdorimin e mjeteve ekstra-gjyqësore. Ligji për ndërmjetësimin nuk parashikon asnjë kufizim përsa i përket shpejtësisë së zgjidhjes së konfliktit. Në këtë mënyrë, palët janë të lira të zgjidhin konfliktin e tyre, sipas nevojave që ata kanë. Një konflikt me ndërmjetësim mund të zgjidhet brenda një ore apo një viti, duke bërë palët të vetmit zotërues të procesit. Palët në proces të ndërmjetësimit nuk kanë nevojë të shpalosin prova apo t'i kenë ato në një formë të caktuar. Pengesat e vetme për të arritur në një marrëveshje ndërmjetësimi janë ato të parashikuara në nenin 24 të ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”. Në këtë dispozitë parashikohet se:

*Neni 24 - Pavlefshmëria e ndërmjetësimit*³⁶¹

1. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, në kuptim të këtij ligji, është e pavlefshme kur:

a) realizohet nga persona që nuk janë ndërmjetës të licencuar dhe të regjistruar, sipas këtij ligji;

Ky përcaktim në këtë dispozitë kufizon çdo person, i cili nuk është i aftë sipas ligjit të kryejë një procedure ndërmjetësimi. Një ndalesë e tillë është jo vetëm e drejtë, por në fakt ajo përbën edhe një garanci për palët që paraqiten përpara ndërmjetësit, se ata të jenë të garantuar që problem i tyre do të trajtohet nga një profesionist i fushës së ndërmjetësimit dhe që arritja në këtë ndërmjetësim do të jetë e mundur të aplikohet për nevojat e tyre.

b) mosmarrëveshja, sipas ligjit, duhet zgjidhur vetëm në rrugë gjyqësore;

Ky përcaktim, në këtë dispozitë përcakton se efikasiteti i ndërmjetësimit është një parim tejet i rëndësishëm. I gjithë qëllimi i ndërmjetësimit, në fakt, është aplikimi i një zgjidhje efikase. Nëse kjo zgjidhje do të binte ndesh me ligjin, atëherë efikasiteti i ndërmjetësimit nuk do të kishte asnjë vlerë në aplikimin e kësaj zgjidhjeje të arritur. Janë disa marrëdhënie që ligji i ka parashikuar si marrëdhënie, të cilat kanë një rëndësi të veçantë, p.sh.: zgjidhja e martesës është një nga këto raste, marrëdhëniet ku interesi më i lartë i familjes është në diskutim. Por, në të njëjtën kohë, pasojat që vijnë nga zgjidhja e martesës, janë marrëdhënie, të cilat palët janë të lira t'i zgjidhin me ndërmjetësim. Nëse do të shikojmë edhe DIREKTIVËN 2008/52/EC të Komisionit të Bashkimit European, që është burimi

³⁶¹Neni 24 i ligjit nr. 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

kryesor i ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, në nenin 7 të tij do të vërehet se për këto interesa ka kufizim edhe të parimit të konfidencialitetit.

c) përmban detyrime të vlerësueshme në të holla dhe nuk formulohet me shkrim;

Duke u referuar në sa më sipër, do të kuptojmë se procesi nuk është efektiv, nëse nuk është transparent. Të mos qenit transparent nga ligjvënësi është parashikuar si një pengesë për të qenë efikas. Pra, në marrëveshjen përfundimtare, nëse ekziston një detyrim i vlerësueshëm në të holla, ai duhet patjetër të vendoset i qartë në marrëveshje, në këtë mënyrë për këtë detyrim nuk do të ketë hamendësime dhe efikasiteti i aplikimit të Marrëveshjes së arritur do të jetë më i lartë.

ç) përmban detyrime për subjekte që nuk kanë marrë pjesë në ndërmjetësim;

Absolutisht që një marrëveshje ndërmjetësimi nuk mund të jetë efikase, nëse në të bihet dakord që të ngarkohet me detyrime një person, i cili nuk është fare pjesëmarrës në këtë marrëveshje. Kjo marrëveshje nuk mund të jetë efikase, fillimisht, sepse nuk mund legjitimohemi për të drejtat dhe detyrimet e të tjerëve, nëse nuk jemi të autorizuar për një gjë të tillë. Së dyti, në nenin 22 të ligjit 10385, parashikohet se “*palët bien dakord për zgjidhjen e pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre, së bashku me ndërmjetësit*”, pra, mosmarrëveshja është ndërmjet palëve që nënshkruajnë marrëveshjen dhe jo për dikë tjetër, që ndoshta nuk është fare në dijeni të këtij procesi, sado i vërtetë të jetë pohimi në aktmarrëveshje.

d) ka simulim dhe, për konfliktin real, ka shkaqe pavlefshmërie.

Në Kodin Civil përcaktohen shkaqet e pavlefshmërisë së akteve, në nenin 92³⁶² të tij. Parashikohen efektet e pavlefshmërisë së akteve, ku përcaktohet se: “*Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike*”, pra aktet që janë absolutisht të pa vlefshme, janë akte që nuk sjellin pasoja. Ato nuk mund të bëhen asnjëherë të vlefshme, me anë të një veprimi tjetër juridik. Si rrjedhojë nuk mund të jenë efikase, për sa kohë nuk prodhojnë pasoja juridike.

2. Gjykata, përveç rasteve të parashikuara në Kodin Civil për pavlefshmërinë e veprimeve juridike, mund ta konstatojë marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim të pavlefshme edhe kur arrin në përfundimin se ajo nuk respekton rendin publik në Republikën e Shqipërisë.

³⁶² Neni 92 i Kodit Civil, “Veprime juridike të pavlefshme”.

3. Pavlefshmëria e marrëveshjes së ndërmjetësimit, sipas këtij ligji, nuk i pengon palët në konflikt të realizojnë marrëveshjen e arritur, duke ushtruar të drejtat që gëzojnë me ligje të tjera.

Duke pasur parasysh që janë palët ato që kanë të drejtën të kërkojnë apo konstatojnë shkaqet dhe pavlefshmërinë e një veprimi të caktuar, ligji për ndërmjetësimin ia njeh drejtpërdrejt palëve këtë të drejtë. Ai shkon më tej, duke i inkurajuar në një farë mënyre palët që, nëse dëshira e tyre është një zgjidhje e caktuar, sipas vullnetit të tyre, ata s'duhet të pengohen nga ky ndalim i ligjit. Por, duhet të gjejnë një mënyrë të përshtatshme për ta bërë efikase atë çka ata mendojnë dhe e pranojnë si të drejtë.

Pra do të vërejmë se efikasiteti i marrëveshjes së ndërmjetësimit kufizohet vetëm nga përcaktimet e kësaj dispozite dhe në këtë dispozitë, në paragrafin e fundit të saj, palët inkurajohen që të vënë në efeciencë, atë çka ata e mendojnë dhe pranojnë si të drejtë.

2.6. Parimi i drejtësisë

Në procesin e ndërmjetësimit, parimi i drejtësisë është më pak kompleks nga ç'duket. Drejtësia në ndërmjetësim është ajo që pranohet dhe që perceptohet si e tillë nga palët në konflikt. Kërkesa e vetme që ligji ka për marrëveshjen e ndërmjetësimit është që ajo të mos bjerë në kundërshtim me ligjin. Kënaqësia apo mjaftueshmëria është natyrisht subjektive. Kështu, e drejta për gjykim të drejtë apo qasja me këtë drejtësi mund të jetë e parëndësishme për një pjesë, që konsideron se ushqimi, strehimi, dhe kujdesi elementar shëndetësor janë me të rëndësishme. Sipas mendimit tim, me qasje në drejtësi, si penale dhe civile, mund të kuptojmë një tjetër të drejtë themelore. Ajo duhet të bazohet në reformimin e mendimit duke zvogëluar varësinë nga metodat tradicionale gjyqësore.

Një deduksion i thjeshtë nga sa më sipër, mendoj se tregon që shumica e individëve veprojnë dhe marrin vendime bazuar në atë që ata besojnë, në varësi të mjedisit dhe informacionit në dispozicion të tyre. Si rezultat i kësaj, konfliktet mund të ndodhin midis atyre që mbajnë perspektiva të ndryshme, të verbuar nga të kuptuarit e fakteve të njohura për ta. Nga ana tjetër, kjo hap derën për ndërmjetësim dhe mundëson një mjet për të hyrë në

drejtësi dhe për të përmirësuar potencialin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, sipas nevojave të secilit në mosmarrëveshje³⁶³.

Thënë ndryshe, parimi i drejtësisë në ndërmjetësim është një parim, i cili është i ndryshëm me drejtësinë klasike të dhënë nga gjykata, arbitrazhi apo çdo proces tjetër i ngjashëm me to. Drejtësia në procesin e Ndërmjetësimit, në një mënyrë përngjasin më shumë me kuptimin e drejtësisë në një vetëgjyqësi. Kjo me ndryshimin, i cili përcakton disa korniza të kësaj “vetëgjyqësie” dhe lejon palët që të vendosin vetë se ç’është e drejtë, brenda këtyre kornizave.

2.7. Parimi i vullnetit të lirë në pjesëmarrje

Palët në procesin e ndërmjetësimit janë të lira të zgjedhin ndërmjetësin që do të asistojë në lehtësimin e mosmarrëveshjes ndërmjet tyre, ato me vullnet të lirë kërkojnë dhe zbatojnë ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre³⁶⁴.

“ 1. Ndërmjetësimi, sipas këtij ligji, zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara nga pikat 2 dhe 3 të këtij neni, në çdo kohë që palët në konflikt, me vullnetin e tyre të lirë, kërkojnë dhe pranojnë ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pavarësisht, nëse mosmarrëveshja është paraqitur përpara organit të përcaktuar nga ligji për zgjidhjen e saj. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në ato raste kur gjykata, apo organi përkatës shtetëror, pas vënies në lëvizje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, orientojnë palët drejt ndërmjetësimit, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni”.

Në këtë dispozitë vërejmë se në të gjitha rastet, janë palët ato që vendosin me vullnetin e tyre të lirë për të marrë pjesë në një proces ndërmjetësimi. Kjo gjë ndodh vetëm në rastet kur palët e kërkojnë dhe e pranojnë ndërmjetësimin si alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Sipas pikës 4 të po kësaj dispozite, ligji parashikon rastet kur gjykata ka detyrimin për të ftuar palët në ndërmjetësim. Gjithsesi, edhe në rastin konkret parashikon detyrimin e Gjykatës të ftojë palët në një proces ndërmjetësimi, pa pasur asnjë tagër nga ana e gjykatës, që t’i detyrojë palët, nëse ata e refuzojnë këtë ftesë³⁶⁵. Palët janë të lira të

³⁶³ Murray, C. <http://kluwermediationblog.com/2015/12/17/civil-justice-1906-2016-time-for-an-update/> dt. 26. 12 .2015.

³⁶⁴ Neni 2/2 te ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

³⁶⁵ Po Aty Neni 2/4.

vendosin vetë, nëse do të marrin pjesë në proces apo nëse do të pranojnë një zgjidhje të caktuar në këtë proces.

2.8 . Parimi i paanshmërisë

Ndërmjetësit duhet të kryejnë procesin, duke mos mbajtur anë për asnjë nga palët dhe duhet të bëjë kujdes të veçantë për t'u siguruar, që të gjitha palët të kenë mundësi të barabartë për t'u dëgjuar, për t'u përfshirë në këtë proces, si dhe të kenë mundësi të kërkojnë dhe marrin këshillë juridike, para finalizimit të marrëveshjes³⁶⁶. Në nenin 11 të ligjit 10385, për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, parashikohet:

*Konflikti i interesit*³⁶⁷

1. *Ndërmjetësi siguron që ndërmjetet tij dhe palëve në një procedurë ndërmjetësimi nuk ekziston asnjë konflikt interesash. Kur ka dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij, ndërmjetësi heq dorë nga procedurat e ndërmjetësimit.*
2. *Konsiderohet se ka konflikt interesash, kur:*
 - a) *ndërmjetësi ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të apo të afërmit e tij, në çështjen për të cilën kërkohet ndërmjetësimi;*
 - b) *ndërmjetësi është kujdestar apo përfaqësues i njëres prej palëve;*
 - c) *ndërmjetësi vetë, bashkëshortja ose të afërmit e tij, deri në shkallën e dytë, janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie ose huaje me njërin prej palëve;*
 - d) *ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti interesi.*
3. *Kur një personi i ofrohet mundësia për t'u zgjedhur si ndërmjetës, ai duhet të deklarojë, si dhe të vërë në dijeni palët për çdo rrethanë që mund të dëmtojë ose të shkaktojë dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij në lidhje me rastin që ndërmjetësohet.*
4. *Ndërmjetësi, duke filluar nga koha e caktimit në këtë detyrë dhe gjatë kohës së procedurës së ndërmjetësimit, duhet t'u deklarojë pa vonesë palëve, çdo*

³⁶⁶ IMI Code Of Professional Conduct: Mediation Process. 3.2.2.

³⁶⁷ Neni 11 i ligjit 10385, "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve".

rrethanë që mund të përbëjë cenim ose dyshim në paanshmërinë dhe pavarësinë e tij.

Ndërmjetësit duhet të kryejë hetime të arsyeshme për të përcaktuar nëse ndonjë interes, konflikt interesash ose paragjykim i mundshëm mund të ekzistojë. Ata duhet të kenë detyrë të vazhdueshme interesimin për ekzistencën e një gjendje konflikti të interesave apo paragjykimi të një situatë të tillë të mundshme. Në çdo rast çdo situatë bëhet e dukshme gjatë procesit të ndërmjetësimit dhe lihet në dorë të palëve, nëse ata preferojnë të vazhdojnë procesin në kushte të një paragjykimi për konflikt interesi me atë ndërmjetës apo të zgjedhin dikë tjetër.³⁶⁸

Paanshmëria, pra, nënkupton se procesi i zgjidhjes së konflikteve nuk është i plotë derisa të gjithë personat e përfshirë në konflikt adresojnë interesat e tyre dhe marrin kujdesin e njëjtë nga ndërmjetësi³⁶⁹.

2.9. Parimi i profesionalizmit

Parimi i profesionalizmit lidhet drejtpërdrejtë me cilësinë e ndërmjetësimit. Ligji 10385, për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, me nenin 5 të tij ka parashikuar:

Neni 5³⁷⁰ - Kushtet për ndërmjetës

Shtetasi shqiptar ose i huaj, që ushtron profesionin e ndërmjetësit, duhet të përmbushë njëkohësisht këto kushte:

- a) të ketë kryer programe të studimeve të ciklit të parë, sipas përcaktimeve të legjislacionit për arsimin e lartë;*
- b) të ketë mbushur moshën 25 vjeç;*
- c) të mos jetë dënuar për kryerjen me dashje të veprave penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;*
- d) të ketë përfunduar programin e trajnimit dhe të formimit profesional të ndërmjetësve, të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve;*

³⁶⁸ IMI Code Of Professional Conduct: *Mediation Process*; 2.3.1.

³⁶⁹ Hooley, S. & Schmucker, E. (2009). “*Contrasting Definitions and Practices*”. Conflict Transformation.

³⁷⁰ Neni 5 i ligjit 10385, “*Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve*”.

e) të jetë i licencuar dhe i regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve.

Sa vërejmë me sipër, kushtet e parashikuara nga pika a, deri ne pikën ç, janë kushte të cilat lidhen drejtpërdrejt me cilësitë e personit që do ndërmjetësojë. Kjo dispozite nuk përjashton shtetasit e huaj të ndërmjetësojnë, për sa kohë ata plotësojnë kushtet e cilësisë që duhet të përfaqësojë Ndërmjetësi. Ligji 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” në nenin 9 pika 2 parashikon se Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve përgatit, të paktën një herë në vit, një program trajnimi të detyrueshëm për të gjithë ndërmjetësit e sapo regjistruar pranë Regjistrin të Ndërmjetësve, si dhe mundëson e kujdeset për trajnimin në vazhdimësi të ndërmjetësve, i cili nuk duhet të jetë më pak se 20 ditë në vit³⁷¹. Në statutin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, neni 14 pika f, parashikohet se Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve miraton programet e trajnimit dhe formimit profesional të ndërmjetësve³⁷². Në nenin 2 të ligjit 10385, për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve parashikohet se Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve është veprimtari e pavarur, që ushtrohet në përputhje me këtë ligj dhe nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë³⁷³. Pra vërejmë se figura e një ndërmjetësi, i cili të jetë një profesionist, i aftë për të marrë përsipër tagrin e lehtësuesit të një mosmarrëveshje, trajtohet me seriozitetin e duhur. Nevojën e një ndërmjetësi profesionist e trajton ligji për ndërmjetësimin, statuti i Dhomës Kombëtare si dhe kemi të bëjmë me një profesion, i cili në këtë drejtim është i varur dhe i kontrolluar nga 2 institucione, Dhoma Kombëtare dhe drejtpërdrejtë nga Ministria e Drejtësisë.

2.11. Parimi i zgjidhjes pa paragjykime

Paragjykimi është vlerësimi i një situate, duke formuar një opinion para se të vihem në dijeni të të gjitha fakteve relevante të një çështjeje. Parimi i zgjidhjes pa paragjykime të konfliktit ka të bëjë me paragjykimin që ndërmjetësi mund të ndërtojë gjatë një procesi të caktuar. Është njerëzore që në një moment të caktuar, pavetëdija jonë të marrë një pozicionim të caktuar në një situate konfliktuale. Paragjykimi është një tjetër burim potencial i njëanshmërisë. Ai mund të lidhet me mendimin mbi një person apo institucion, mendim i

³⁷¹ Po Aty Neni 9/2.

³⁷² Neni 14/f i Statutit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

³⁷³ Neni 2 i ligjit 10385, “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

cili krijohet shpesh vetëm nga rrethanat e paraqitura nga njëra palë apo të dyja ato. Kjo gjë mund të ndikojnë në pavarësinë e ndërmjetësit, neutralitetin apo paanshmërinë, ose në mënyrë të arsyeshme për të krijuar një pamje të njëanshme apo të paragjykuar, duke mos e ndihmuar procesin, por duke u bërë pengese për të.

KAPITULLI VI: ANALIZË E TË DHËNAVE PARËSORE TË GRUMBULLUARA ME ANË TË PYETËSORËVE NGA INTERVISTIMI I AKTORËVE QË MARRIN PJESË NË PROCESIN E NDËRMJETËSIMIT

1. Përpunimi statistikor

Studimi ngre disa pyetje studimore sekondare: (i)“A janë palët të interesuara për shërbimin e ndërmjetësisimit në mosmarrëveshjet që ata kanë dhe sa qasen ata me këtë proces?”; (ii)“A është efikas shërbimi i ndërmjetësisimit dhe cilët janë faktorët që ndikojnë në këtë efektivitet?”; (iii)“Sa e predispozuar është gjykata për të referuar mosmarrëveshjet drtejt procesit të ndërmjetësisimit?”.

Për t’u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve kemi përdorur metodat statistikore të tipit shkak-pasojë, të cilat janë analizuar duke përdorur të dhëna parësore të grumbulluara nga intervistimi me anë të pyetësorëve ³⁷⁴të hartuar për secilin nga aktorët që marrin pjesë në procesin e ndërmjetësisimit për zgjidhjen e konflikteve: (i) Palët në konflikt; (ii) Ndërmjetësit dhe (iii) Gjyqtarët.

Pyetësorët përmbajnë rreth 30 pyetje secili dhe janë hartuar në mënyrë të tillë që përgjigjet e tyre të shërbejnë si burim informacioni për studimin statistikor por edhe për të marrë një informacion të përgjithshëm mbi fenomenin që studiojmë.

Në këtë mënyrë, përgjigjet e pyetësorëve përmbajnë të dhëna të cilat do të shërbejnë për të nxjerrë konkluzione duke përdorur metoda të statistikës inferenciale (vendimore) dhe statistikës deskriptive (përshkruese).

Pyetjet e pyetësorëve përfaqësojnë faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë dhe i japin përgjigje pyetjeve të mësipërme studimore. Këta faktorë i trajtojmë si variabla të pavarur në studimin statistikor dhe në pjesën dërrmuese vlerat e tyre janë matur me anë të nivelit të perceptimit individual të të intervistuarit duke përdorur shkallët e Likertit.

Si variabla të varura të studimit janë marrë pyetjet që lidhen drejtpërdrejtë me atë cka duam të vlerësojmë dhe studiojmë në këtë punim.

Për t’i dhënë përgjigje sa më të saktë pyetjes kryesore studimore nëpërmjet pyetjeve sekondare lidhur me realitetin e gjykatave shqiptare, për cdo pyetje sekondare kemi ndërtuar hipotezat statistikore respective.

³⁷⁴ Shiko Apendiks fq.265.

Verifikimin e hipotezave e kemi bërë duke përdorur metodën e regresionit logjistik të shumëfishtë. Përdorimin e kësaj metode e kemi zgjedhur për faktin se të dhënat e grumbulluara janë të tipit ordinale. Gjithashtu, të dhënat e përdorura për variablat e varur i kemi kthyer në rezultate dichotomus (dyvlerëshe).

Lidhjet shkak-pasojë të cilat kemi përdorur në studimin tonë janë një model i përgjithshëm i analizave që përdor statistika inferenciale. Ato klasifikohen në dy grupe kryesor: (i) lidhjet statistikore (korrelacionet) midis variablave të pavarur dhe (ii) lidhjet funksionale (ekuacionet regressive) midis variablit të varur dhe variablave të pavarur.

Lidhjet statistikore synojnë të përcaktojnë marrdhëniet korrelative midis variablave të pavarur si dhe lidhjet që mbartin efektin e multikolinearitetit midis variablave, duke mundësuar përzgjedhjen e atyre variablave të cilat kanë ndikimin më të mirë dhe më efektiv mbi variablin e varur.

Lidhjet funksionale janë kryesisht lidhjet matematikore që ekzistojnë midis variablit të varur dhe variablave të pavarur.

Ato shprehen me anë të ekuacioneve matematike me ndihmën e koeficientëve të vlerësuar statistikisht. Si rrjedhim, pjesë e analizës së lidhjeve funksionale është identifikimi i shkallës së përcaktueshmërisë së modelit dhe niveli i besueshmërisë së modelit të ndërtuar, në kuptimin se sa përfaqësues është ky model për realitetin e përfaqësuar nga mostra e zgjedhur.

Në çështjet ne vijim kemi bërë analizën e lidhjeve të tipit shkak-pasojë duke trajtuar një për një të treja pyetjet sekondare. Analiza shoqërohet shoqërohet gjithashtu edhe me studimin e disa prej faktorëve me anë të statistikës deskriptive.

2. Palët dhe procesi i ndërmjetësimit

A janë palët të interesuara për shërbimin e ndërmjetësimit në mosmarrëveshjet që ata kanë dhe sa qasen ata me këtë proces?

Në studimet e fenomeneve të ndryshme me metodat e statistikës inferenciale, pyetjet studimore i kthejmë në hipoteza statistikore me qëllim verifikimin e qëndrueshmërisë së tyre me anë të krahasimit dhe interpretimit të koeficientëve të lidhjes funksionale. Përgjigjen për pyetjen kërkimore: “A janë palët të interesuara për shërbimin e ndërmjetësimit në

mosmarrëveshjet që ata kanë dhe sa qasen ata me këtë proces?” do ta zbulojmë me anë të verifikimit të hipotezës statistikore zero (hipoteza null): H_0 : “Palët janë të interesuara për shërbimin e ndërmjetësimit në zgjidhjen e konflikteve të tyre”, versus (v.s.=përkundërt) hipotezën alternative H_a : ” Palët janë të interesuara për shërbimin e ndërmjetësimit në zgjidhjen e konflikteve të tyre”.

Për të verifikuar hipotezën H_0 janë përdorur të dhënat e grumbulluara me anë të pyetësorit : PYETËSOR-për palët në konflikt³⁷⁵. këto të dhëna janë rezultat i përgjigjeve të pyetjeve të pyetësorit të cilat maten me anë të shkallës së perceptimit individual të palëve që janë përzgjedhur të intervistohen dhe që përfaqësojnë gjithë popullimin e palëve që kanë marrë pjesë në një proces të zgjidhjes së konfliktit me anë të ndërmjetësimit.

Në shumë raste, interesimi për një fenomen apo vecori të caktuar në të cilën një person ndjehet i përfshirë, kënaqësia dhe pozitiviteti ndaj këtij fenomeni vlerësohet me nivelin e rekomandimit që ky person i bën këtij fenomeni apo procesi tek persona të tjerë të cilët janë të interesuar për procesin në fjalë.

Për këtë arsye, si variabël të varur kemi marrë variablin dichotomus PP_19 (Tabela 1) i cili përfaqëson pyetjen P19: *A do ta rekomandonit ndërmjetësimin si një alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?* .

Si variabla të pavarur për verifikimin e hipotezës H_0 janë marrë variablat e tjerë të paraqitur në Tabelën 1. Për të bërë një analizë më të hollësishme dhe më të përshtatshme për interpretimin e rezultateve të përpunimit statistikorë, variablat e pavarur i kemi ndarë në tre grupe në varësi të asaj se çfarë ata përfaqësojnë. Kështu, (i) PP_7; PP_10 dhe PP_11 janë variabla të pavarur që shprehin nivelin e kënaqësisë së suksesit në realizimin e procesit; (ii) PP_1 dhe PP_6 shprehin nivelin e të kuptuarit të procesit; (iii) PP_8; PP_9_1; PP_9_2 dhe PP_12 shprehin nivelin e kënaqësisë për faktorët teknik të procesit të ndërmjetësimit.

³⁷⁵ Shiko Apendiks. fq.265

Tabela 1: Variablat e varur dhe të pavarur

Variabli	Pyetja që përfaqëson variabli	Lloji i variablit	Vlerat e variabl
PP_19	A do ta rekomandonit ndërmjetësimin si një alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?	Dichotomus	0-1
PP_1	Cila është shkalla më e lartë e arsimit tuaj?	Ordinale	1-4
PP_6	A morët informacion të mjaftueshëm para se të fillonit procesin e ndërmjetësimit?	Dichotomus	0;1
PP_7	A e përfunduat me sukses procesin e ndërmjetësimit, përmes firmosjes së marrëveshjes?	Dichotomus	0;1
PP_8	Sa ishte kohëzgjatja e procesit të ndërmjetësimit?	Ordinale	0-4
PP_9_1	Në rastin e konfliktit tënd, cili ka qënë mesatarisht numri i séancav ndërmjetësuese që ke bërë deri në arritjen e marrëveshjes? (Séance të perbashkëta)	Ordinale	0-3
PP_9_2	Në rastin e konfliktit tënd, cili ka qënë mesatarisht numri i séancav ndërmjetësuese që ke bërë deri në arritjen e marrëveshjes? (Seanca të vecanta)	Ordinale	0-3
PP_10	A ka sjellë ndërmjetësimi pajtimin e plotë me palën tjetër apo shuarjen e plotë të konfliktit?	Ordinale	-1;0;1
PP_11	Si komunikoni aktualisht me palën tjetër?	Ordinale	1-5
PP_12	A ka qënë i përshtatshëm për ju vendi ku është bërë ndërmjetësimi	Dichotomus	0;1

Burimi: Autori

Ndarja në tre grupe e variablave të pavarur na ka mundësuar që mbas përpunimit statistikor dhe interpretimit të rezultateve të tij, të mund të konkludojmë se cilët nga grupet e mësipërme të variablave ushtron një ndikim më të madh dhe më të rëndësishëm mbi nivelin e interesimit të palëve për t'u përfshirë në procesin e ndërmjetësimit.

Për përpunimin statistikor të të dhënave kemi përdorur software-in SPSS Versioni 21, Output-et e të cilit na kanë mundësuar për një interpretim shumë të mirë të rezultateve.

2.1. Lidhjet statistikore

Sikurse kemi përmëndur më sipër, lidhjet statistikore, i kemi analizuar duke përdorur korrelacionet midis variablave të pavarur. Këto marrdhënie realizohen me anë të korrelacioneve bivariate midis variablave të vlerësuar nga koeficientët e korrelacionit të Pearson-it (PCC) dhe nga niveli statistikor i signifkancës (domethenies statistikore) (*p*).

Tabela 2:Korrelacionet bivariate për variablat e pavarur (Studimi i Palëve në konflikt)

Correlations									
	PP_1	PP_6	PP_7	PP_8	PP_9_1	PP_9_2	PP_10	PP_11	PP_12
Pearson PP_1 Correlation Sig. (2-tailed)	1								
Pearson PP_6 Correlation Sig. (2-tailed)	. ^a	. ^a							
Pearson PP_7 Correlation Sig. (2-tailed)	-.004 .914	. ^a	1						
Pearson PP_8 Correlation Sig. (2-tailed)	-.002 .964	. ^a	-.078* .049	1					
Pearson PP_9_1 Correlation Sig. (2-tailed)	.028 .489	. ^a	.016 .693	-.017 .672	1				
Pearson PP_9_2 Correlation Sig. (2-tailed)	.057 .150	. ^a	-.052 .191	-.037 .347	-.153** .000	1			
Pearson PP_10 Correlation Sig. (2-tailed)	.090* .023	. ^a	.078* .047	.042 .289	-.051 .197	-.027 .500	1		
Pearson PP_11 Correlation Sig. (2-tailed)	-.101* .011	. ^a	.101* .010	-.114** .004	-.080* .043	.077* .050	-.009 .816	1	
Pearson PP_12 Correlation Sig. (2-tailed)	. ^a	. ^a	. ^a	. ^a	. ^a	. ^a	. ^a	. ^a	. ^a
*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed). **. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed). a. Cannot be computed because at least one of the variables is constant.									

Burimi: SPSS. V. 21 (Correlations-Bivariate)

Nga një vrojtim i shpejtë i Tabelës 2 vihet re se dy nga variablat (PP_6 dhe PP_12) nuk paraqesin elemente korrelativ me të gjithë variablat e tjerë të pavarur për faktin se përgjigjet e të gjithë të intervistuarëve kanë qenë të njëjta gjë që reflekton një vlerë të njëjtë të variablit. Duke parë përgjigjen e një pyetësi të cfarëdoshëm (të gjithë të tjerët kanë përgjigje të njëjtë me të) vihet re se Pyetjes 6 të gjithë i janë përgjigjur pozitivishtë, pra *cdo palë që ka pranuar procesin e*

*ndërmjetësimi mendon se është informuar mjaftueshëm para fillimit të procesit dhe si rrjedhim vlera e këtij variabli nuk përmban informacion statistik për modelin; dhe gjithashtu, Pyetjes 12, të gjithë të intervistuarit i janë përgjigjur pozitivishtë, pra *palët në konflikt nuk i japin ndonjë rëndësi mjedisit ku zhvillohet ndërmjetësimi ose ata nuk kanë patur alternativë për të zgjedhur ambientin për të zhvilluar procesin e ndërmjetësimi.**

Në tabelën korrelative vihet re se kemi shumë cifte të cilët shfaqin nivele signifikative të mira dhe shumë të mira (rrjeshti i fundit i Tabelës 2 tregon nivelin klasifikues të signifikancës). Më poshtë po interpretojmë korrelacionet bivariate midis variablave të ndryshëm, duke u përqëndruar vetëm në ato cifte të cilat mendojmë se paraqesin interes në studimin tonë. Cdo studiues i këtyre fenomeneve mund të shfrytëzoj të dhënat e Tabelës 2 në funksion të studimit të tij.

Marrdhënia korrelative midis PP_7 dhe PP_8 ($p=0.049$ dhe $PCC=-0.078^*$) është me vlerë negative dhe tregon se *sa më shumë të zgjas procesi i ndërmjetësimi aq më pak i suksesshëm perceptohet procesi i ndërmjetësimi për palët në konflikt.*

Cifti PP_8 dhe PP_11, gjithëashtu shfaqin tendenca të zhvillimeve në kahe të kundërta për faktin se PCC e tyre është negative ($PCC=-0.114^{**}$ dhe $p=0.004$). Ky tendencë tregon se *sa më e gjatë është koha e procesit të ndërmjetësimi aq më i ulët është niveli i komunikimit miqësor midis palëve në konflikt. Kjo mund të coj nenevojën venien e kufijeve me të ulet të finalizimit të procesit të ndërmjetësimi.*

Një rezultat interesant shfaq studimi i korrelacioneve midis ciftit të variablave PP_11; PP_9_2 ($PCC=0.077^*$ dhe $p=0.050$) dhe ciftit PP_11; PP_9_1 ($PCC=-0.080^*$ dhe $p=0.043$). Koeficienti pozitiv i ciftit të parë tregon se *rritja e nivelit të seancave të vecanta shoqërohet me rritjen e nivelit të komunikimit miqësor midis palëve, ndërkohë që rritja e nivelit të numrit të seancave të përbashkëta shoqërohet me “acarimin” e marrdhënies komunikuese midis palëve.*

Së fundmi, korrelacioni pozitiv ($PCC=0.101^*$ dhe $p=0.010$) midis variablave PP_7 dhe PP_11 tregon se *përfundimi me sukses i procesit të ndërmjetësimi shoqërohet me një rritje të nivelit të komunikimit miqësor midis palëve në konflikt.*

Përbën një fakt interesant edhe korrelacioni pozitiv ($PCC=0.090^*$ dhe $p=0.023$) midis variablave të pavarur PP_1 dhe PP_10 tregon se *rritja e nivelit arsimor të palëve në konflikt shoqërohet me tendencën në rritje drejtë një pajtimi të plotë midis palëve.*

Gjithashtu, korrelacioni negativ midis PP_11 dhe PP_1 ($PCC=-0.101^*$ dhe $p=0.011$) tregon se rritja e nivelit arsimor të palëve në konflikt shoqërohet me një nivel në rënie të komunikimit midis palëve, gjë që krijon ndjesinë se procesi i ndërmjetësimit është i paaftë të realizoj një pajtim miqësor midis palëve kur këto posedojnë nivel të lartë arsimor, ose ndërmjetësit duhet të trainohen duke patur parasysh një klasifikim të nivelit arsimor të palëve në konflikt (rekomandim i mundshëm).

2.2. Lidhjet funksionale

Lidhjet funksionale midis variablit të varur dhe variablave të pavarur, sikurse u theksua në cështjen 2, e kemi trajtuar duke i klasifikuar variablat e pavarur në varësi të rolit që ato luajnë në procesin e ndërmjetësimit. Trajtimi i klasifikuar i lidhjeve funksionale, natyrishtë që është shoqëruar me verifikimin e hipotezës përkatëse që ngre pyetja studimore duke parë atë në vecanti në lidhje me secilin grup variablash të pavarur. Këtë e kemi bërë për të detajuar më mirë përgjigjen e pyetjes studimore (i). Në tabelën 3 jepen rezultatet e vlerësimit statistikor të koeficientëve të lidhjes funksionale midis variablit të varur PP_19 dhe grupit të variablave të pavarur: PP_7; PP_10 dhe PP_11 të cilët shprehin në këndvështrime të ndryshme nivelin e kënaqësisë mbi suksesin e procesit të ndërmjetësimit.

Tabela 3: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PP_19)

Variables in the Equation									
		B	S.E.	Ĕald	df	Sig.	Exp(B)	95% C.I.for EXP(B)	
								Loĕer	Upper
Step 1 ^a	PP_7	1.250	.342	13.371	1	.000	3.491	1.786	6.823
	PP_11	.244	.115	4.536	1	.033	1.277	1.020	1.598
	PP_10	-.354	.253	1.959	1	.162	.702	.427	1.152
	Constant	.845	.548	2.376	1	.123	2.327		
a. Variable(s) entered on step 1: PP_7, PP_11, PP_10.									

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Në Tabelën 3 vihet re se signifkancën e mjaftueshme ($0.000 < \text{Sig.} < 0.050$) për t'u përfshirë në model e sigurojnë vetëm variablat PP_7 (Sig.=0.000) dhe PP_11 (Sig.=0.033), prandaj për të ndërtuar një model më përfaqësues kemi aplikuar metodën Forëard-Stepëise (Conditional) të regresit logjistik e cila është e përfshirë në strukturën përpunuese të të dhënave të softëare-it SPSS v. 21, duke përfutuar të dhënat që paraqiten në Tabelën 4. Në aplikimin e

metodës Forëard-Stepëise (Conditional) kemi përjashtuar gjithëashtu edhe konstanten e modelit e cila nuk e siguron signifikançën e mjaftueshme (Sig.=0.123>0.050) për t'u përfshirë në model.

Tabela 4:Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PP 19)

Variables in the Equation									
		B	S.E.	Ĕald	df	Sig.	Exp(B)	95% C.I.for EXP(B)	
								Loĕr	Upper
Step 1 ^a	PP_11	.588	.037	251.897	1	.000	1.801	1.675	1.937
Step 2 ^b	PP_7	1.347	.303	19.771	1	.000	3.845	2.124	6.961
	PP_11	.362	.057	40.549	1	.000	1.437	1.285	1.606
a. Variable(s) entered on step 1: PP_11.									
b. Variable(s) entered on step 2: PP_7.									

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Forward-Stepwise (Conditional))

Metoda Forward-Stepwise (Conditional) bën përjashtimin automatik të variablave jo-signifikativ dhe pastaj bën rivlerësimin e koeficientëve të lidhjes funksionale dhe të nivelit të rëndësisë statistikore (signifikancës) të secilit prej tyre. Në Tabelën 4 vihet re se koeficientët B të modelit, në hapin e dytë të vlerësimit sigurojnë nivelin më të mirë të mundshëm të signifikançës (Sig.=0.000). Gjithëashtu, në hapin e dytë vihet re se nivelet e R² sipas Cox&Snell dhe Nagelkerke (Tabela 5) përmirësohen në krahasim me hapin e parë të vlerësimit të parametrave. Në këtë mënyrë, modeli i përfutur është gati për interpretimin e rezultateve dhe për verifikimin e hipotezës përkatëse.

Tabela 5:Përmbledhja e modelit

Model Summary			
Step	-2 Log likelihood	Cox & Snell R Square	Nagelkerke R Square
1	326.166 ^a	.585	.780
2	306.643 ^b	.598	.797
a. Estimation terminated at iteration number 5 because parameter estimates changed by less than .001.			
b. Estimation terminated at iteration number 6 because parameter estimates changed by less than .001.			

Burimi:SPSS v. 21

Rezultatet e Tabelës 4 na mundësojnë ndërtimin e lidhjes matematike-funksionale të variablilit të varur me variablat e pavarur:

$$\ln\left(\frac{p}{1-p}\right) = 1.347 (PP_7) + 0.362 (PP_11) + \varepsilon \quad (1)$$

- ku p shpreh probabilitetin që një palë që ka marrë pjesë në një proces ndërmjetësimi t'ia rekomandoj këtë proces një të interesuari tjetër;
- $\frac{p}{1-p}$ shpreh raportin e shansit (odd ratio) për të patur një rekomandim pozitiv përkundrejt një rekomandimi negativ në lidhje me procesin e ndërmjetësimit;
- ε shpreh marzhin e gabimit të modelit.

Referuar procedurës së verifikimit të hipotezave statistikore me anë të koeficientëve të regresionit logjistik mund të themi se: meqënëse koeficientët e regresionit, për dy nga variablat e pavarur, janë të ndryshme nga zero [$B(PP_7)=1.347$ dhe $B(PP_11)=0.362$], H_0 është e pranueshme statistikisht. Pra, *referuar faktorëve që shprehin nivelin e kënaqësisë për realizimin me sukses të procesit të ndërmjetësimit, palët janë të interesuara për shërbimin e ndërmjetësimit si mënyrë për zgjidhjen e konflikteve të tyre.*

Lidhjet funksionale të studiuar me anë të modelit të regresionit të shumëfishtë logjistik, përvecse verifikimit të hipotezave statistikore, ofrojnë edhe një mundësi përcaktimi statistikor të nivelit të ndikimit të variablave të pavarur mbi variablin e varur. Kështu, duke mbajtur konstant vlerën e njërit prej variablave të pavarur të barazimit (1), ne mund të përcaktojmë shkallën e ndikimit të variablilit tjetër të pavarur mbi variablin e varur PP_19. Konkretisht, duke mbajtur konstante vlerën e variablilit PP_11 dhe vlera e PP_7 ndryshon nga 0 në 1, pra që një ndërmjetësim të arrij të përfundoj me sukses me firmosjen e marrveshjes midis palëve, shanci që këto Palë ta rekomandojnë si pozitiv procesin e ndërmjetësimit, rritet gati 4 herë ($\text{Exp}(B)=3.845$; Tabela 4). Nga ana tjetër, në qoftë se mbajmë konstante vlerën e PP_7 dhe rritim me një njësi vlerën e PP_11, pra rritim me një njësi nivelin e komunikimit midis palëve, shanci për të patur një rekomandim pozitiv për procesin e ndërmjetësimit, rritet me gati 1.5 herë ($\text{Exp}(B)=1.437$; Tabela 4).

Lidhjen funksionale midis variablilit të varur PP_19 dhe faktorëve teknik (infrastrukturor) e kemi studiuar duke analizuar regresionin linear me variabla të pavarur PP_8; PP_9_1; PP_9_2 dhe PP_12.

Tabela 6: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PP 19)

Variables in the Equation									
		B	S.E.	Ėald	df	Sig.	Exp(B)	95% C.I. for EXP(B)	
								Loĕer	Upper
Step 1 ^a	PP_8	.099	.280	.125	1	.723	1.104	.638	1.910
	PP_9_1	.447	.308	2.105	1	.147	1.564	.855	2.860
	PP_9_2	-.679	.257	6.986	1	.008	.507	.307	.839
	Constant	2.853	.930	9.417	1	.002	17.333		
a. Variable(s) entered on step 1: PP_8, PP_9_1, PP_9_2.									

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Nga Tabela 6 vihet re se signifikançën e mjaftueshme për të marrë pjesë në model e sigurojnë vetëm variabli i pavarur PP_9_2 dhe kostantja e modelit, ndërsa variablat PP_8 (Sig.=0.723) dhe PP_9_1 (Sig.=0.147) kanë signifikançë mbi nivelin e pranueshëm. Në Tabelën 6 bie në sy mungesa e variablit PP_12, i cili nuk përfshihet fare në rezultatet e përpunimit statistikor, pavarësisht se ai është futur për trajtim. Ky është një rezultat i cili pritej për faktin se të dhënat e tij nuk përmbajnë informacion statistikor (Tabela 2).

Tabela 7: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PP 19)

Variables in the Equation									
		B	S.E.	Ėald	df	Sig.	Exp(B)	95% C.I. for EXP(B)	
								Lower	Upper
Step 1 ^a	PP_9_2	-.733	.253	8.425	1	.004	.480	.293	.788
	Constant	3.908	.502	60.657	1	.000	49.811		
a. Variable(s) entered on step 1: PP_9_2.									

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Forward-Stepwise (Conditional))

Rezultatet e tabelave 7 dhe 8 paraqesin rezultatet e përpunimit statistikor me anë të metodës Forëard-Stepëise (Conditional). Parametrat statistikorë për variablin e pavarur dhe kostanten e përmirësohen duke siguruar një nivel signifikançë shumë të mirë, (Sig.=0.000 dhe Sig.=0.004) respektivisht për kostanten dhe variablin e pavarur. Ekuacioni matematik i cili shpreh marrdhënien midis variablit të varur dhe variablit të pavarur PP_9_2 ka trajtën:

$$\ln\left(\frac{p}{1-p}\right) = 3.908 - 0.733 (PP_9_2) + \varepsilon \quad (2)$$

Nga ekuacioni shihet se koeficienti i variablit të pavarur PP_9_2 është negativ gjë që tregon se duke rritur me një njësi nivelin e numrit të seancave të përbashkëta të procesit të ndërmjetësimit, shanci për një perceptim pozitiv rekomandimi gati do të përgjysmohet, dhe pikërishtë në masën $(\text{Exp}(B)=0.480; \text{Tabela } 7)$.

Tabela 8: Përmbledhja e modelit


Model Summary			
Step	-2 Log likelihood	Cox & Snell R Square	Nagelkerke R Square
1	312.565 ^a	.013	.033
a. Estimation terminated at iteration number 6 because parameter estimates changed by less than .001.			

Burimi: SPSS v. 21

Duke e trajtuar fenomenin e ndërmjetësimit në lidhje me faktorët infrastrukturor, H_0 pranohet të jetë e qëndrueshme statistikishtë për faktin se koeficienti i njërit prej variablave është i ndryshëm nga zero $[B(\text{PP_9_2})=-0.733]$.

Duke patur parasysh se kohëzgjatja e një procesi (PP_8), në cdo rast, luan një ndikim të natyrshëm në perceptimin e suksesit të procesit (PP_19), e pam të arsyeshme studimin e marrdhënies ndërmjet tyre me anë të elementëve të statistikës deskriptive.

Grafiku 1 Shpërndarja e “kohëzgjatjes” sipas vlerave të “rekomandimit”



Burimi: SPSS v.21 (Chart Builder-Histogram)

Pavarësishtë se të dhënat e grumbulluara nuk siguruan një signifikançë të mjaftueshme për ta përfshir këtë variabël në modelin inferencial, Grafiku 1 tregon se pavarësishtë vlerës 0 apo 1 të PP_19, përqëndrimi i vlerave të PP_8 është i lartë në të dyja rastet rreth vlerave 1 dhe 2 të cilat u korrespondojnë shtrirjes një javore deri në një muaj të procesit të ndërmjetësimit. Megjithëate vihet re se për personat që do ta rekomandonin me kënaqësi procesin e ndërmjetësimit te persona të tjerë shfaqen edhe vlerat ekstremale të vrojtura (0 dhe 3). *Pra, mund të konkludojmë se kohëzgjatja është ende një faktor jo përcaktues për nivelin e interesit të Palëve ndaj procesit të ndërmjetësimit.*

Grupi i tretë i faktorëve që ndikojnë në përcaktimin e nivelit të interesit të shprehur me anë të nivelit të rekomandimit te persona të tjerë të interesuar, e përbëjnë variablat që shprehin nivelin e informimit mbi këtë proces. Në cështjen 2 të këtij kapitulli (Tabela 2), pamë se të gjithë të intervistuarit ishin të mendimit se e kishin marrë gjithë informacionin e mjaftueshëm përpara fillimit të procesit, pra ky variabël (PP_6) nuk përmban informacion statistikor për të studiuar marrdhëniet midis tij dhe variablit të varur PP_19. Për këtë arsye, variablin e varur e kemi studiuar me anë të regresionit univariat logjistik në lidhje me nivelin arsimor të Palëve, i cili padyshim që është një nga faktorët kryesor për studimin cdo risie.

Tabela 9: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PP_19)


Variables in the Equation								
	B	S.E.	Ėald	df	Sig.	Exp(B)	95% C.I. for EXP(B)	
							Loëer	Upper
Step 1 ^a PP_1	-.271	.174	2.414	1	.120	.763	.542	1.073
Constant	3.179	.424	56.319	1	.000	24.018		
a. Variable(s) entered on step 1: PP_1.								

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Nga Tabela 9 shihet se variabli i vetëm i pavarur PP_1 nuk e siguron signifikançën e mjaftueshme ($\text{Sig.} = 0.120 > 0.050$) për të ndërtuar një model inferencial të marrdhënies së tij me variablin e varur PP_19, prandaj ky model nuk mund të shërbej për verifikimin e hipotezës H_0 .

Për të parë shpërndarjen e tij në lidhje me vlerat e perceptimit të kënaqësisë për procesin e ndërmjetësimit, kemi përdorur statistikën deskriptive.

Grafiku 2 Shpërndarja PP_1 në lidhje me PP_19



Burimi: SPSS v.21 (Chart Builder-Boxplot)

Nga grafiku shihet se kemi një shpërndarje plotësisht të njëjtë të vlerave të nivelit arsimor përkundrejt vlerave të kënaqësisë ndaj procesit të ndërmjetësimit. *Pra, mund të konkludojmë se niveli arsimor i Palëve në procesin e ndërmjetësimit nuk luan asnjë rol mbi produktin e shprehur me anë të nivelit të kënaqësisë, ose e shprehur ndryshe, niveli arsimor i Palëve në konflikt nuk sjell asnjë ndikim mbi nivelin e rekomandimit të procesit të ndërmjetësimit në persona të tjerë të interesuar për të.*

3. Ndërmjetësit dhe procesi i ndërmjetësimit

A është efikas shërbimi i ndërmjetësimit dhe cilët janë faktorët që ndikojnë në këtë efikasitet ?

Për të studiuar efikasitetin e procesit të ndërmjetësimit dhe për t'i dhënë përgjigje pyetjes studimore kemi analizuar të dhëna të grumbulluara me anë të një pyëtësori cili është përdorur për të intervistuar Ndërmjetësit, si një nga aktorët e tjerë kryesor në procesin e ndërmjetësimit.

Pyetësi synon të grumbullojë të dhëna të cilat kanë të bëjnë me perceptimin individual të Ndërmjetësave për (i) fazen që i paraprin procesit të ndërmjetësimit, pra fazën përgatitore, (ii) për fazën e realizimit të ndërmjetësimit si proces dhe (iii) për faktorë që kanë

të bëjnë me përgatitjen profesionale të tij në lidhje me ndërmjetësimin si një risi për zgjidhjen e konflikteve.

Hipotezat statistikore, verifikimi i të cilave ka ndihmuar formulimin e përgjigjes dhe nxjerrjen e konkluzioneve për pyetjen e dytë studimore secondare, janë: hipoteza zero (hipoteza null): H_0 : “Shërbimi i ndërmjetësimit është një proces efikas (rezultativ) për zgjidhjen e konflikteve midis palëve”, v.s. hipotezën alternative H_a : ” Shërbimi i ndërmjetësimi nuk ka efikasitetin e pritur për zgjidhjen e konfliktit midis palëve”.

Për të verifikuar hipotezën H_0 me anë të modelit të regresionit të shumëfishtë logjistik, si variabël i varur është zgjedhur variabli PN_20 i cili përfaqëson pyetjen P20 të pyetësorit për Ndërmjetësit: *Në ndërmjetësimet që ke bërë, cili ka qene raporti mes ndërmjetësimeve me sukses dhe ndërmjetësimeve të dështuara ?* kemi menduar të zgjedhim këtë variabël si të varur në modelimin e tipit shkak-pasojë për faktin se përgjigja e kësaj pyetjeje shpreh në mënyrë të drejtëpërdrejtë perceptimin individual të Ndërmjetësit për efikasitetin (suksesin) e procesit të ndërmjetësimit. Në pyetësor, kësaj pyetjeje i janë dhënë katër alternativa përgjigjeje duke përfshirë edhe rastin «Nuk e di». Modeli i regresionit logjistik kërkon që variabli i varur të jetë dichotomus, pra dy vlerësh (0-1). Për këtë arsye, duke ndjekur logjikën se një fenomen apo ndërmarrje quhet e sukseshme kur *raporti mes ndërmjetësimeve me sukses dhe ndërmjetësimeve të dështuara* është më i madh se 1, vlerën e variablit të varur PN_20 e kemi shënuar me vlerën 1 kur Ndërmjetësi është përgjigjur «*Numri i ndërmjetësimeve të suksesshme është më i madh*», dhe me vlerën 0 në tre rastet e tjera.

Si variabla të pavarur për rastin e Ndërmjetësit janë marrë të gjitha pyetjet e pyetësorit të cilat mbartin një informacion statistikor të matshëm, ndërkohë, përgjigjet e pyetjeve të tjera janë përdorur për të krijuar një opinion dhe mendim më të qartë gjatë procesit të nxjerrjes së konkluzioneve dhe rekomandimeve që ky punim ofron për grupet e ndryshme të interesit.

Variablat e pavarur paraqiten në Tabelën 10. Sikurse u theksua në fillim të kësaj cështjeje, variablat e pavarur i kemi klasifikuar në tre grupe kryesore: (i) variabla që përfaqësojnë faktorët e fazës që i paraprin procesit të ndërmjetësimit : PN_2 ; PN_3 ; PN_4 ; PN_10 ; PN_12, (ii) variabla që përfaqësojnë faktorët e fazës së realizimit të ndërmjetësimit si proces : PN_2 ; PN_13 ; PN_14 ; PN_19_1 ; PN_19_2 ; PN_32 dhe (iii) variabla që përfaqësojnë faktorët që kanë të bëjnë me përgatitjen profesionale të tij në lidhje me ndërmjetësimin : PN_2 ; PN_26 ; PN_27 ; PN_28 ; PN_29 ; PN_30.

Tabela 10: Variablat e varur dhe të pavarur (Ndërmjetësit)

Variabli	Pyetja që përfaqëson variabli	Lloji i variablit	Vlerat e variablit
PN_20	Në ndërmjetësimet që ke bërë, cili ka qene raporti mes ndërmjetësimeve me sukses dhe ndërmjetësimeve të dështuara?	Dichotomus	0-1
PN_2	Sa kohë keni që ushtroni ndërmjetësimin?	Ordinale	1-5
PN_3	Cila është tendenca e përdorimit të ndërmjetësimit mes palëve në konflikt?	Ordinale	-1;0;1
PN_4	Sipas eksperiencës tënde personale, sa është afërsisht numri mesatar i ndërmjetësimeve që ke bërë gjatë një viti?	Ordinale	0-4
PN_10	Bazuar në eksperiencën tënde si ndërmjetës, a e praktikon gjykatata referimin në ndërmjetësim si alternativë zgjidhje konflikti?	Ordinale	0-1
PN_12	Në dijeninë tënde si ndërmjetës si vepron Gjykata kur do ti bëjë palët në konflikt ti drejtohen ndërmjetësimit?	Ordinale	0-4
PN_13	Në eksperiencën tënde si ndërmjetës, sa shpesh e praktikon Gjykata ndërmjetësimin si alternative zgjidhje?	Ordinale	1-5
PN_14	Si ndërmjetës, me cilin prej tipeve të ndërmjetësimit ndjehesh më shumë familjar dhe i prirur për të praktikuar?	Nominale	1;2;3;4
PN_19_1	Në ndërmjetësimet që ke bërë, cili ka qënë mesatarisht numri i séancave ndërmjetësuese që të është dashur të bësh për të arritur marrëveshje?(Seanca të përbashkëta)	Ordinale	0-3
PN_19_2	Në ndërmjetësimet që ke bërë, cili ka qënë mesatarisht numri i séancave ndërmjetësuese që të është dashur të bësh për të arritur marrëveshje? (Seanca të vecanta)	Ordinale	0-3
PN_26	Si ndërmjetës, cili është vlerësimi yt për kriteret që përcaktojnë se si mundtë bëhesh ndërmjetës në Shqipëri?	Ordinale	0-3
PN_27	Në dijeninë tënde më të mirë, cili nga opsionet poshtë përshkruan më mirë pregatitjen dhe trajnimin e ndërmjetësve?	Nominale	1-5
PN_28	Në dijeninë tënde më të mirë, sa shpesh ofrohen programe trajnimi për ndërmjetësuesit në Shqipëri?	Ordinale	1-5
PN_29	Sa është numri i programeve trajnuese në të cilat ju keni marrë pjesë?	Ordinale	1-4
PN_30	Sa efektive jane programet trajnuese per ndermjetes?	Ordinale	1-3
PN_32	Në rastet e ndërmjetësuar prej teje, sa kohë ka zgjatur konflikti mes paleve?	Ordinale	1-4

Burimi: Autori

Në klasifikimin në grupe, variablin e pavarur PN_2 e kemi futur në të gjitha grupet sepse mendojme se përvoja në proces ndikon drejtëpërdrejtë në të treja grupet e këtyre variablave. Gjithashtu, ndarja në grupe na ndihmon në nxjerrjen e përfundimeve dhe verifikimin e H_0 sipas të tre këndvështrimeve, por kjo nuk na ka penguar që të studiojmë lidhjen dhe marrdhënien midis variablave të pavarur nga grupe të ndryshme, të cilët mendojmë se kanë ndikim të drejtëpërdrejtë me njëri-tjetrin.

3.1.Lidhjet statistikore (Ndërmjetësit)

Marrdhëniet statistikore midis variablave të pavarur për rastin e Ndërmjetësit i kemi studiuar duke respektuar ndarjen në grupe të tyre me qëllim detajimin e rezultateve. Për të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime, natyrishtë që shfaqin interes edhe marrdhëniet statistikore midis variablave të pavarur që u përkasin grupeve të ndryshme.

Duke qënë se numri i variablave është relativishtë shumë i madh, ne kemi studiuar marrdhëniet statistikore midis disa prej cifteve me variabla nga grupe të ndryshëm. Këtë përzgjedhje e kemi bërë duke iu referuar interesit të studimit tonë, ndërkohë që tabela korrelative për gjithë variablat e pavarur (Tabela.....Apendiks.....) përmban shumë informacion në lidhje me korrelacionet bivariate midis variablave të ndryshëm, të cilën e vëmë në dispozicion të studiuesve të ndryshëm mbi çështjen e ndërmjetesimit si risi në zgjidhjen e konflikteve midis palëve.

Tabela 11: Korrelacionet bivariate Grupi I (Ndërmjetësit)

		Correlations				
		PN_2	PN_3	PN_4	PN_10	PN_12
PN_2	Pearson Correlation	1				
	Sig. (2-tailed)					
PN_3	Pearson Correlation	.048	1			
	Sig. (2-tailed)	.360				
PN_4	Pearson Correlation	.233**	.118*	1		
	Sig. (2-tailed)	.000	.024			
PN_10	Pearson Correlation	.149**	.132*	.088	1	
	Sig. (2-tailed)	.004	.012	.090		
PN_12	Pearson Correlation	.140**	-.006	.019	.028	1
	Sig. (2-tailed)	.007	.916	.721	.592	
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).						
*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).						

Burimi: SPSS. V. 21 (Correlations-Bivariate)

Korrelacionet bivariate midis variablave të pavarur të Grupit I tregojnë për lidhje të forta dhe shumë të forta midis shumë prej tyre, referuar nivelit të signifkancës (Tabela 11). Trajtimi individual i tyre përmban informacion të mjaftueshëm për të nxjerrë përfundime interesante në lidhje me procesin e ndërmjetësimit dhe faktorëve që luajn rol të rëndësishëm në efikasitetin e këtij procesi:

✚ Variablat e pavarur PP_2 dhe PP_4 të cilat përfaqësojnë respektivisht përvojën në vite të ushtrimit të profesionit të Ndërmjetësit dhe numrin e ndërmjetësimeve të kryera brënda një viti (Tabela 10), realizojnë një marrdhënie shumë të fortë dhe pozitive ndërmjet tyre me parametra $PCC=0.233^{**}$ dhe $p=0.000$. Kjo tregon se *rritja e nivelit në kohë e përvojës në procesin e ndërmjetësimit shoqërohet me rritjen e nivelit të numrit të konflikteve që pranojnë zgjidhje duke i besuar ndërmjetësimit*.

✚ Në tabelë vërehen korrelacionet pozitive dhe shumë të forta midis PN_2 dhe variablave PN_10 ($PCC=0.149^{**}$ dhe $p=0.004$) dhe PN_12 ($PCC=0.140^{**}$ dhe $p=0.007$) të cilat shprehin nivelin e perceptimit të ndërmjetësive në lidhje me angazhimin e gjykatave tona për praktikimin dhe informimin për procesin e ndërmjetësimit. Kjo marrdhënie statistikore krijon ndjesinë se *rritja e nivelit të përvojës shoqërohet me rritjen e nivelit të optimizmit të ndërmjetësive se gjykatat tona mund të bëhen më aktive dhe më suportuese në rekomandimin dhe aplikimin e procesit të ndërmjetësimit për zgjidhjen e konflikteve*.

✚ Korrelacionet pozitive dhe me signifkancë të mirë midis variablit të pavarur PN_3 dhe variablave të pavarur PN_4 ($PCC=0.118^{*}$ dhe $p=0.024$) dhe PN_10 ($PCC=0.132^{*}$ dhe $p=0.012$) janë të pritshme për faktin se niveli i perceptimit mbi tendencën është produkt i nivelit të suportimit nga institucioni i Gjykatës i procesit të ndërmjetësimit, dhe të dyja së bashku këto sjellin rritjen e numrit të ndërmjetësimeve të bëra nga një Ndërmjetës.

Në Grupin II të variablave të pavarur vihen re se kemi vetëm korrelacione shumë të forta midis atyre cifteve të variablave që korrelojnë midis tyre. Në këto lidhje korrelative vërehen disa rezultatet interesante:

✚ Korrelacioni i fortë dhe me vlera pozitive midis variablit të pavarur PN_2 dhe variablit PN_32, i cili shpreh nivelin e kohëzgjatjes për zgjidhjen e konfliktit ($PCC=0.235^{**}$ dhe $p=0.000$), lë ndjesinë se *niveli i përvojës në kohë i ndërmjetësit shoqërohet me rritjen e nivelit të kohës që ndërmjetësi vë në dispozicion të zgjidhjes së konfliktit, e thënë ndryshe, përvoja në*

procesin e ndërmjetësimit shoqërohet me rritjen e durimit dhe besimit se një konflikt mund të zgjidhet me anë të procesit të ndërmjetësimit.

✚ Korrelacioni i fortë dhe pozitiv ($PCC=0.162^{**}$ dhe $p=0.002$) midis PN_32 dhe PN_19_1 tregon se tendenca e vlerave të këtyre variablave ecën në të njëjtin kah (drejtim), *pra rritja e numrit seancave të përbashkëta me palët në konflikt shoqërohet me rritjen e nivelit të kohëzgjatjes së procesit deri në zgjidhjen e konfliktit midis palëve*. Do të ishte një rezultat konkludiv në qoftë se midis PN_32 dhe PN_19_2 do të kishim një korrelacion signifikativ dhe negativ, i cili do të na lejonte të përforconim idenë se kohëzgjatja e zgjidhjes së një konflikti do të ulej kur numri i seanca të vecanta me palët do të rritej. Në Tabelën 12 shihet se kjo marrëdhënie është e tipit negative ($PCC=-0.061$) por ajo nuk e siguron signifikancën e mjaftueshme ($p=0.239>0.050$) për të qënë një rezultat i pranueshëm statistikisht.

Tabela 12: Korrelacionet bivariate Grupi II (Ndërmjetësit)

Correlations						
		PN_2	PN_13	PN_19_1	PN_19_2	PN_32
PN_2	Pearson Correlation	1				
	Sig. (2-tailed)					
PN_13	Pearson Correlation	-.034	1			
	Sig. (2-tailed)	.512				
PN_19_1	Pearson Correlation	.008	-.009	1		
	Sig. (2-tailed)	.872	.859			
PN_19_2	Pearson Correlation	.066	-.096	.166**	1	
	Sig. (2-tailed)	.206	.064	.001		
PN_32	Pearson Correlation	.235**	-.030	.162**	-.061	1
	Sig. (2-tailed)	.000	.569	.002	.239	
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).						

Burimi: SPSS. V. 21 (Correlations-Bivariate)

✚ Një marrëdhënie interesante shfaq korrelacioni pozitiv dhe shumë signifikativ midis PN_19_1 dhe PN_19_2 ($PCC=0.166^{**}$ dhe $p=0.001$). Tendenca e rritjes së vlerave të këtyre variablave shkon në të njëjtin drejtim duke krijuar idenë *se zgjidhja e një konflikti me anë të ndërmjetësimit kërkon si komunikimin me palët në seanca individuale ashtu edhe komunikimin në seanca të përbashkëta*.

Edhe në përmbajtjen e Tabelës 13, e cila paraqet rezultatet e përpunimit statistikor me anë të softëare-it SPSS v.21 për koeficientët e korrelacionit midis variablave të Grupit III dhe signifikancën përkatëse, vihen re marrëdhënie interesante midis variablave.

🚦 Korrelacionet e forta dhe shumë të forta midis variablit PN_2 dhe përkatësisht variablave të pavarur PN_29 (PCC=0.124* dhe p=0.016) dhe PN_30 (PCC=0.147** dhe p=0.005), reflektojnë dy konkluzione shumë të rëndësishme: (i) rritja e nivelit të kohës që një ndërmjetës ushtron profesionin e ndërmjetësimit shoqërohet me rritjen e nevojës që ai ka ndier për t'u trainuar, gjë që sjell në vëmendje se procesi i ndërmjetësimit është një proces i cili ka nevojë të plotësohet me informacione teorike dhe suport të specializuar dhe (ii) rritja e nivelit të kohës që një ndërmjetës ushtron profesionin e ndërmjetësimit shoqërohet me rritjen e nivelit të kënaqësisë për efikasitetin e trainimeve në të cilat Ndërmjetësi ka marrë pjesë.

Tabela 13: Korrelacionet bivariate Grupi III (Ndërmjetësit)

Correlations						
		PN_2	PN_26	PN_28	PN_29	PN_30
PN_2	Pearson Correlation	1				
	Sig. (2-tailed)					
PN_26	Pearson Correlation	.019	1			
	Sig. (2-tailed)	.709				
PN_28	Pearson Correlation	.010	-.042	1		
	Sig. (2-tailed)	.854	.421			
PN_29	Pearson Correlation	.124*	.089	.171**	1	
	Sig. (2-tailed)	.016	.087	.001		
PN_30	Pearson Correlation	.147**	.061	.003	.513**	1
	Sig. (2-tailed)	.005	.239	.949	.000	
*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).						
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).						

Burimi: SPSS. V. 21 (Correlations-Bivariate)

🚦 Një marrëdhënie korrelative pozitive dhe shumë të forta për nga shifikaanca e tyre vërehen midis variablave PN_28 dhe PN_29 (PCC=-0.171** dhe p=0.001). Kjo tregon se rritja e numrit të programeve trainuese që zhvillohen në vëndin tonë për Ndërmjetësit shoqërohet me rritjen e numrit të trainimeve që i intervistuari merr pjesë. Kjo tregon se *interesi i Ndermjetësave është shumë i lartë për trainime në fushën e ndërmjetësimit*. Ky konkluzion mund të shihet si një konkluzion plotësues i asaj cka konkluduar në pikën e parë referuar Tabelës 13.

🚦 Se fundmi, duke u mbështetur në lidhjen korrelative shumë të fortë dhe pozitive midis PN_29 dhe PN_30 (PCC=0.513** dhe p=0.000) mund të themi se rritja e numrit të trainimeve të kryera nga ndërmjetësit shoqërohet me rritjen e nivelit të perceptimit të tyre mbi efikasitetin e këtyre trainimeve. Pra, trajnimet që po zhvillohen në vëndin tonë për qëllim zhvillimin e

njohurive mbi proceset e ndërmjetësimit, luajn një rol pozitiv në efikasitetin e procesit të ndërmjetësimit.

Në fillim të kësaj cështjeje u theksua se për të krijuar një tabllë më të qartë mbi ndërlidhjen e faktorëve që ndikojnë mbi efikasitetin e procesit të ndërmjetësimit, kemi interpretuar disa nga lidhjet statistikore që shprehin marrdhënie signifikative midis variablave të pavarur por që u takojnë grupeve të ndryshme të klasifikimit të tyre duke iu referuar Tabelës 1 (Apendiks.....). Studimi i marrdhënieve të tilla është plotësisht i mundur dhe me informacion të dobishëm statistikor për faktin se këto variabla shprehin perceptime të të njëjtit person të intervistuar në cilësinë e Ndërmjetësit, pra janë variabla që i përkasin të njëjtës mostër të marrë në studim.

✚ Kështu: Korrelacion pozitiv dhe me një signifikancë shumë të mirë ($PCC=0.374^{**}$ dhe $p=0.000$; Tabela 1, Apendix) shfaqet midis variablave të pavarur PN_10 dhe PN_26 të cilat shprehin respektivisht nivelin e referimit prej gjykatës për ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e konflikteve dhe nivelin e vlerësimit të kriterëve për tu bërë Ndërmjetës në Shqipëri. Pra, tendenca e zhvillimit të nivelit të perceptimit të këtyre dy variablave shkon në të njëjtin drejtim. Kjo krijon ndjesinë se *rritja nivelit të fortësisë së kriterëve, gje e sila mund të interpretohet si rritje e cilësisë së ndërmjetësimit, shoqërohet me rritjen e tendencës së gjykatave për ta referuar ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e konflikteve, e thënë ndryshe, niveli i referimit nga gjykatat varet korrelativisht nga rritja e besimit mbi cilësinë e aftësive të Ndërmjetësit.*

✚ Një korrelacion me vlera pozitive dhe shume signifikative ($PCC=0.275^{**}$ dhe $p=0.000$; Tabela 1, Apendix....) paraqesin edhe çifti i variablave të pavarur PN_28 dhe PN_4 që përfshihen përkatësisht në Grupin I dhe Grupin III në klasifikimin e tyre dhe që përfaqësojnë respektivisht nivelin e numrit të ndërmjetësimeve të kryera brënda një viti dhe shpëshhtësinë e trajnimeve që kryhen në vëndin tonë për ndërmjetësit. Vlerat e këtyre dy variablave shkojnë në të njëjtin drejtim, pra rritën ose zvogëlohen njëkohësisht. *Kjo tregon se rritja e numrit të trajnime shoqërohet me rritjen e numrit të ndërmjetësimeve që ndërmjetësit kryejnë brënda një harku kohor një vjeçar.*

✚ Marrdhënie të forta korrelative për nga signifikanca dhe gjithëashtu pozitive ($PCC=0.196^{**}$ dhe $p=0.000$; Tabela 1, Apendix....) shfaq çifti i variablave të pavarur PN_4 dhe PN_30 ku ky i fundit shpreh nivelin e perceptimit të efektivitetit të programeve trajnuese për

ndërmjetës. Kjo marrdhënie tregon se rritja e numrit të ndërmjetësimeve shoqerohet me rritjen e besimit mbi efektivitetin e trajnimeve për ndërmjetësit në Shqipëri.

3.2. Lidhjet funksionale (Ndërmjetësit)

Për studimin e lidhjeve funksionale dhe verifikimin e hipotezës H_0 të ngritur për rastin e Ndermjetësit kemi përdorur klasifikimin në grupe të cilin e përdorëm për studimin e lidhjeve statistikore korrelative. Në këtë mënyrë, verifikimin e hipotezës e kemi bërë për secilin grupu më vete.

Në Tabelën 10 të variablave që marrin pjesë në studim, vihen re dy variabla të pavarur PN_14 dhe PN_27. Këta variabla nuk mund të marrin pjesë në përpunimin statistikor me metodën e regresionit logjistik që kemi përdorur për verifikimin e hipotezës H_0 sepse ata janë variabla të tipit cilësor (me vlera nominale), për këtë arsye marrdhënien midis tyre dhe variablit të varur e kemi studiuar me anë të elementëve të statistikës deskriptive.

Përpunimi i të dhënave me anë të modelit të regresionit të shumfishtë logjistik, me metodën *Enter* jep rezultatet e paraqitura në Tabelën 14 dhe në Tabelën 15. Shihet se variablat PN_3, PN_12 dhe konstantja e modelit nuk e sigurojnë signifkancën e mjaftueshme për tu përfshirë në modelin inferencial.

Tabela 14: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PN 20-Grupi I)

Variables in the Equation									
		B	S.E.	Ėald	df	Sig.	Exp(B)	90% C.I. for EXP(B)	
								Lower	Upper
Step	PN_3	-.179	.365	.241	1	.623	.836	.459	1.524
1 ^a	PN_4	.799	.457	3.056	1	.080	2.224	1.048	4.719
	PN_10	-.604	.305	3.921	1	.048	.546	.331	.903
	PN_12	.057	.219	.068	1	.794	1.059	.738	1.519
	PN_2	.402	.164	5.976	1	.015	1.495	1.141	1.959
	Constant	-.906	.713	1.617	1	.203	.404		
a. Variable(s) entered on step 1: PN_3, PN_4, PN_10, PN_12, PN_2.									

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Duke aplikuar metodën *Forward-Stepwise (Conditional)*, në hapin e tretë të përpunimit të të dhënave përftohen vlerësimet më signifkative të mundshme (Tabela 16 dhe Tabela 17).

Tabela 15: Përmbledhja e modelit

Model Summary			
Step	-2 Log likelihood	Cox & Snell R Square	Nagelkerke R Square
1	428.213 ^a	.039	.055
a. Estimation terminated at iteration number 5 because parameter estimates changed by less than .001.			

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Qëllimi i studimit tonë nuk është trajtimi i mirëfilltë matematik i modelit parashikues por verifikimi i hipotezave dhe zbulimi i lidhjeve funksionale midis variablilit të varur dhe variablave të pavarur. Për këtë arsye, në vazhdim, do t'u referohemi informacionit të Output-eve në trajtë tabelash për të mbështetur arsyetimin.

Tabela 16: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PN 20-Grupi I)

Variables in the Equation								
		B	S.E.	Ëald	df	Sig.	Exp(B)	90% C.I. for EXP(B)
								Lower Upper
Step 1 ^a	PN_2	.419	.162	6.714	1	.010	1.520	1.165 1.983
	Constant	-.301	.455	.436	1	.509	.740	
Step 2 ^b	PN_10	-.540	.296	3.326	1	.068	.583	.358 .948
	PN_2	.457	.162	7.907	1	.005	1.579	1.209 2.062
	Constant	-.304	.453	.452	1	.502	.738	
Step 3 ^c	PN_4	.782	.457	2.930	1	.087	2.185	1.031 4.630
	PN_10	-.624	.303	4.239	1	.040	.536	.326 .882
	PN_2	.409	.164	6.228	1	.013	1.505	1.150 1.970
	Constant	-1.004	.629	2.550	1	.110	.366	
a. Variable(s) entered on step 1: PN_2.								
b. Variable(s) entered on step 2: PN_10.								
c. Variable(s) entered on step 3: PN_4.								

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Forward-Stepwise (Conditional))

Në Tabelën 16 shihet se në hapin e tretë, për variablat e pavarur PN_4; PN_10 dhe PN_2 kemi koeficient B të ndryshëm nga zero [B(PN_4)=0.782; B(PN_10)=-0.624; B(PN_2)=0.409],

gjë e cila siguron pranimin e hipotezës H_0 për Grupin I të variablave të pavarur. Pra, duke iu referuar marrdhënieve funksionale të përfuara nga të dhënat e grumbulluara nga pyetësi mund të themi me siguri 90% se: *Shërbimi i ndërmjetësimit është një proces efikas (rezultativ) për zgjidhjen e konflikteve midis palëve.*

Tabela 17: Përmbledhja e modelit

Model Summary			
Step	-2 Log likelihood	Cox & Snell R Square	Nagelkerke R Square
1	435.327 ^a	.020	.028
2	432.079 ^a	.029	.041
3	428.531 ^b	.038	.054
a. Estimation terminated at iteration number 4 because parameter estimates changed by less than .001.			
b. Estimation terminated at iteration number 5 because parameter estimates changed by less than .001.			

Burimi: SPSS v. 21 (Forward-Stepwise (Conditional))

Marrdhënia funksionale midis variablave, përveçse na siguron qëndrueshmërinë e hipotezës H_0 , na mundëson që po me të njëjtën siguri, të mund të flasim për shkallën e ndikimit të secilit variabël të pavarur që është signifkativ në model mbi variablin e varur. Kështu:

✚ Rritja me një njësi e nivelit të numrit mesatar të ndërmjetësimeve të bëra gjatë një viti (PN_4), duke mbajtur konstant dy faktorët e tjerë (PN_10 dhe PN_2), rrit shancin për një perceptim pozitiv mbi efikasitetin e procesit të ndërmjetësimit me një vlerë prej gati 2 herësh [Exp(B)=2.185, Tabela 16]. *Kjo do të thotë se në këndvështrimin e Ndërmjetësit, sa më shumë procese ndërmjetësimi që ata të përfaqësojnë, aq më shumë janë të bindur se ky proces është i aftë të zgjidh konflikte të ndryshme midis palëve.*

✚ Interesant është ndikimi i variablit PN_10, i cili shpreh perceptimin e Ndërmjetësit mbi nivelin e referimit të procesit të ndërmjetësimit si alternativ për zgjidhjen e konflikteve, mbi variablin e varur. Rezultati negativ i koeficientit të tij (B=-0.624, Tabela 16) tregon se rritja me një njësi e perceptimit të Ndërmjetësit për nivelin e referimit, sjell uljen e shancit për një proces efikas ndërmjetësimi, duke e përgjysmuar atë në vlerë [Exp(B)=0.536, Tabela 16]. *Natyrisht që pritej një rezultat i ndryshëm nga ky, gjë që tregon se egziston një konflikt i*

heshtur, i shprehur me një nivel mosbesimi, i Ndërmjetësit dhe institucionit të Gjykatës përse i takon promovimit që kjo e fundit i bën procesit të ndërmjetësimit.

Ashtu sikurse pritej, përvoja e gjatë në procesin e ndërmjetësimit, shoqërohet me një shkallë më të lartë të perceptimit për efikasitetin e procesit. Koeficienti pozitiv në model ($B=0.409$, Tabela 16) dhe niveli mbi 1 njësi i raportit të shancit [$\text{Exp}(B)=1.505$, Tabela 16] tregojnë për një optimizëm në rritje të Ndërmjetësve.

Për Grupin II të variablave të pavarur, Tabela 18 dhe Tabela 19, paraqesin rezultatet e përpunimit fillestar statistikor me metodën *Enter*. Vihet re se dy nga variablat e pavarur PN_13 dhe PN_19_2 nuk e sigurojnë rëndësinë e mjaftueshme statistikore për tu përfshirë në modelin inferencial për verifikimin e hipotezës H_0 .

Tabela 18: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PN 20-Grupi II)

Variables in the Equation								
	B	S.E.	Ėald	df	Sig.	Exp(B)	90% C.I. for EXP(B)	
							Lower	Upper
Step 1 ^a								
PN_2	.363	.167	4.735	1	.030	1.438	1.093	1.892
PN_13	.081	.264	.093	1	.760	1.084	.702	1.673
PN_19_1	.918	.470	3.812	1	.051	2.505	1.156	5.432
PN_19_2	-.210	.317	.440	1	.507	.810	.481	1.365
PN_32	.345	.162	4.528	1	.033	1.412	1.081	1.843
Constant	-2.488	1.301	3.655	1	.056	.083		

a. Variable(s) entered on step 1: PN_2, PN_13, PN_19_1, PN_19_2, PN_32.

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Përpunimi i të dhënave me metodën *Forëard-Stepëise (Conditional)*, në hapin e tretë të vlerësimit të parametrave të modelit na siguron rezultate me një siguri statistikore parashikuese prej 90% (Tabela 20 dhe Tabela 21).

Tabela 19: Përmbledhja e modelit

Model Summary			
Step	-2 Log likelihood	Cox & Snell R Square	Nagelkerke R Square
1	429.446 ^a	.049	.070

a. Estimation terminated at iteration number 5 because parameter estimates changed by less than .001.

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Edhe në rastin e variablave të pavarur të Grupit II, vihet re se sigurohet qëndrueshmëria e hipotezës H_0 : *Shërbimi i ndërmjetësimit është një proces efikas (rezultativ) për zgjidhjen e konflikteve midis palëve*. Këtë e sigurojnë koeficientët e regresionit logjistik për variablat PN_2 (B=0.348, Tabela 20); PN_19_1 (B=0.865, Tabela 20) dhe PN_32 (B=0.354, Tabela 20).

Tabela 20: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PN 20-Grupi II)

Variables in the Equation									
		B	S.E.	Ėald	df	Sig.	Exp(B)	90% C.I. for EXP(B)	
								Lower	Upper
Step 1 ^a	PN_32	.470	.154	9.285	1	.002	1.600	1.242	2.063
	Constant	-.058	.325	.031	1	.859	.944		
Step 2 ^b	PN_2	.340	.165	4.237	1	.040	1.404	1.071	1.842
	PN_32	.398	.159	6.252	1	.012	1.489	1.146	1.936
	Constant	-.857	.507	2.859	1	.091	.425		
Step 3 ^c	PN_2	.348	.165	4.467	1	.035	1.416	1.080	1.856
	PN_19_1	.865	.465	3.463	1	.063	2.376	1.106	5.104
	PN_32	.354	.161	4.841	1	.028	1.425	1.094	1.858
	Constant	-2.599	1.070	5.903	1	.015	.074		
a. Variable(s) entered on step 1: PN_32.									
b. Variable(s) entered on step 2: PN_2.									
c. Variable(s) entered on step 3: PN_19_1.									

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Forward-Stepwise (Conditional))

Për Grupin II të variablave të pavarur, paraqiten disa rezultate interesante përsa i përket shkallës së ndikimit të shumfishtë të tyre mbi variablin e varur:

🚦 Përvoja e përfaqësimit në proceset e ndërmjetësimit (PN_2) vazhdon të luaj të njëjtin ndikim pozitiv (B=0.348, Tabela 20) i cili reflekton një nivel të shancit më të madh se njësia në pothuajse të njëjtat nivele sikurse në rastin kur ky variabël trajtohej si komponent i grupit të variablave të pavarur të Grupit të parë.

Tabela 21: Përmbledhja e modelit

Model Summary			
Step	-2 Log likelihood	Cox & Snell R Square	Nagelkerke R Square
1	438.598 ^a	.026	.036
2	434.074 ^a	.037	.053
3	430.045 ^b	.048	.068
a. Estimation terminated at iteration number 4 because parameter estimates changed by less than .001.			
b. Estimation terminated at iteration number 5 because parameter estimates changed by less than .001.			

Burimi: SPSS v. 21 (Forward-Stepwise (Conditional))

✚ Rritja e nivelit të seancave të përbashkëta të ndërmjetësimit midis palëve, për Ndërmjetësin, shoqërohet me një rritje të shancit [$\text{Exp}(B)=2.376$, Tabela 20] për të patur perceptim në rritje të efikasitetit të procesit të ndërmjetësimit. Pra, për Ndërmjetësit, duket sikur në 90% të rasteve, shtimi me një njësi i numrit të seancave të përbashkëta me palët, rrit me gati 2,5 herë shancin për të përfunduar me sukses një proces ndërmjetësimi. Gjë e cila krijon ndjesinë *se bindja e palëve për të kryer seanca të përbashkëta ndërmjetësimi rrit me 2,5 herë optimizmin se procesi do të përfundoj me sukses (zgjidhje e konfliktit)*.

✚ Zgjatja e kohës së konfliktit në shumicën e rasteve është kuptuar si koha e mjaftueshme për t'i dhënë zgjidhje një konflikti me anë të ndërmjetësimit, ose e thënë ndryshe, është kuptuar si nivel i shprehur në kohë i durimit dhe këmbënguljes nga ana e Ndërmjetësit që palët ta zgjidhin konfliktin me anë të procesit të ndërmjetësimit. Ky arsyetim gjën mbështetje të plotë nga rezultatet e përpunimit statistikor me metodat inferenciale. Kështu, koeficienti pozitiv ($B=0.354$, Tabela 20) reflekton një rritje të shancit me gati 1,5 herë [$\text{Exp}(B)=1.425$, Tabela 20] për të patur një shërbim ndërmjetësimi efikas kur niveli i durimit i shprehur në kohë, rritet me një njësi. *Pra, durimi dhe besimi se një konflikt mund të zgjidhet pa ndërhyrjen e trupës gjyqësore rrit ndjeshëm efikasitetin e proceseve të ndërmjetësimit.*

Tabela 22: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PN 20-Grupi III)

Variables in the Equation									
		B	S.E.	Ėald	df	Sig.	Exp(B)	90% C.I. for EXP(B)	
								Lower	Upper
Step 1 ^a	PN_2	.500	.177	8.015	1	.005	1.649	1.233	2.206
	PN_26	.349	.201	3.020	1	.082	1.417	1.019	1.971
	PN_28	1.927	.331	33.796	1	.000	6.867	3.981	11.845
	PN_29	.511	.228	5.037	1	.025	1.667	1.146	2.425
	PN_30	-.489	.261	3.499	1	.061	.613	.399	.943
	Constant	-9.081	1.643	30.529	1	.000	.000		
a. Variable(s) entered on step 1: PN_2, PN_26, PN_28, PN_29, PN_30.									

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Grupi IIIIn i variablave përfshin variablat e pavarur të cilët përfaqësojnë faktorët që kanë të bëjnë me trajnimin dhe specifikat profesionale që duhet të posedojnë Ndërmjetësit me qëllim që të realizojnë një proces ndërmjetësimi efikas dhe rezultativ. Përpunimi i të dhënave me metodën *Enter* (Tabela 22 dhe Tabela 23) siguron pothuajse një gjithëpërfshirje të variablave të këtij grupi në modelin infrencial. Por, efektet multikolineare të cilat shpesh herë shoqërojnë studimet statistikore me anë të variablave që përfaqësojnë fenomene të ngjashme apo me lidhje shumë të ngushtë ndërvarësie, rrezikojnë të krijojnë modele jo të qarta përfaqësimi. Për shembull, PN_28 dhe PN_29 të cilat shprehin përkatësishtë numrin e trajnimeve që zhvillohen dhe numrin e trajnime në të cilat merr pjesë Ndërmjetësi, përfaqësohen nga e njejta shkallë perceptimi mbi nivelin e tyre.

Tabela 23: Përmbledhja e modelit

Model Summary			
Step	-2 Log likelihood	Cox & Snell R Square	Nagelkerke R Square
1	394.797 ^a	.134	.191
a. Estimation terminated at iteration number 5 because parameter estimates changed by less than .001.			

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Për këtë arsye, përdorimi i metodës *Forward-Stepwise (Conditional)* bëhet i pashmangshëm me qëllim përjashtimin nga modeli të atyre variablave që shfaqin rrezikun e multikolineariteti, pavarësisht që në përpunimin fillestar të të dhënave me metodën *Enter* ato sigurojnë signifikançën e mjaftueshme për të qënë të rëndësishme statistikisht.

Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave me anë të metodës *Forward-Stepwise (Conditional)*, në hapin e tretë dhe me një siguri 90% të parashikimit të modelit mundëson vlerësimin e koeficientëve të modelit të regresionit të shumëfishtë logjistik (Tabela 24 dhe Tabela 25). Nga tabela vihet re se variablat të cilat janë të cliruara nga efektet multikolineare dhe që sigurojnë signifikançën e mjaftueshme për tu përfshirë në model janë PN_2 ($p=0.006$, Tabela 24); PN_26 ($p=0.0583$, Tabela 24); PN_28 ($p=0.000$, Tabela 24).

Tabela 24: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PN 20-Grupi III)

Variables in the Equation								
	B	S.E.	Ėald	df	Sig.	Exp(B)	90% C.I. for EXP(B)	
							Lower	Upper
Step 1 ^a								
PN_28	1.710	.309	30.640	1	.000	5.529	3.326	9.190
Constant	-5.732	1.197	22.934	1	.000	.003		
Step 2 ^b								
PN_2	.476	.169	7.891	1	.005	1.609	1.218	2.126
PN_28	1.774	.319	30.982	1	.000	5.897	3.491	9.963
Constant	-7.304	1.370	28.441	1	.000	.001		
Step 3 ^c								
PN_2	.473	.170	7.699	1	.006	1.604	1.212	2.123
PN_26	.386	.199	3.751	1	.053	1.471	1.060	2.041
PN_28	1.742	.316	30.319	1	.000	5.709	3.393	9.607
Constant	-7.806	1.392	31.433	1	.000	.000		
a. Variable(s) entered on step 1: PN_28.								
b. Variable(s) entered on step 2: PN_2.								
c. Variable(s) entered on step 3: PN_26.								

Burimi: SPSS v. 21 (Forward-Stepwise (Conditional))

Ėshtë e qartë se qëndrueshmeria e hipotezës H_0 : *Shërbimi i ndërmjetësimit është një proces efikas (rezultativ) për zgjidhjen e konflikteve midis palëve*, vërtetohet plotësisht pasi koeficientët e regresionit të shumëfishtë logjistik për variablat PN_2 ($B=0.473$, Tabela 24); PN_26 ($B=0.386$, Tabela 24); PN_28 ($B=1.472$, Tabela 24) janë të ndryshëm nga zero.

Tabela 25: Përmbledhja e modelit

Model Summary			
Step	-2 Log likelihood	Cox & Snell R Square	Nagelkerke R Square
1	413.169 ^a	.090	.128
2	404.579 ^b	.111	.158
3	400.712 ^b	.120	.171
a. Estimation terminated at iteration number 4 because parameter estimates changed by less than .001.			
b. Estimation terminated at iteration number 5 because parameter estimates changed by less than .001.			

Burimi: SPSS v. 21 (Forward-Stepwise (Conditional))

Shkalla e ndikimit të secilit variabël mbi shancin për të patur një perceptim pozitiv mbi efikasitetin e procesit të ndërmjetësimit na con në disa konkluzione të rëndësishme. Konkretishtë:

✚ Qëndrueshmëria në pothuajse të njëjtat nivele e ndikimit të variablit PN_2 [Exp(B)=1.602, Tabela 24] mbi variablin e varur edhe për Grupin III tregon se në vëndin tonë po krijohet një grup Ndërmjetësish me ide dhe kërkesa të qarta profesionale, mendimi i të cilëve duhet marrë në konsideratë në hartimin e politikave për zhvillimin institucional të procesit të ndërmjetësimit.

✚ PN_26 e cila shpreh nivelin e fortësisë së kritereve për tu pajisur me licencën e Ndërmjetësimit, ushtron një ndikim me koeficient pozitiv (B=0.386, Tabela 24) dhe me një nivel të shancit [Exp(B)=1.471, Tabela 24] për të patur një perceptim pozitiv mbi efikasitetin e procesit të barabartë me gati 1,5 herë. Pra, forcimi i kritereve për tu pajisur me licencën e Ndërmjetësimit, rrit gati 1,5 herë shancin për të patur një proces ndërmjetësimi me rezultat pozitiv.


✚ Një konkluzion shumë i rëndësishëm del prej përpunimit statistikor në lidhje me variablin PN_28 i cili përfaqëson numrin e trajnimeve që zhvillohen për ndërmjetësimit në vëndin tonë. Koeficienti pozitiv në vlerë të lartë (B=1.742, Tabela 24) reflekton një nivel shanci [Exp(B)=5.709, Tabela 24] shumë të lartë. Kjo do të thotë se shpeshtimi me një njësi i trajnimeve për ndërmjetësimit, rrit me gati 6 herë shancin për të patur një proces

ndërmjetësimi eficient. E thënë ndryshe, Ndërmjetësit mendojnë se rritja e numrit të trajnimeve në fushën e ndërmjetësimit është një domosdoshmëri për suksesin e procesit të ndërmjetësimit.

Sikurse u theksua në fillim të çështjes, disa prej variablave, edhe pse të konsideruar të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të efikasitetit të procesit të ndërmjetësimit, duke qënë se janë të tipit nominal, nuk mund të trajtoheshin me anë të regresionit logjistik. Për këtë arsye, sjelljen dhe ndikimin e tyre në lidhje me variablin e varur e kemi studiuar me anë të elementëve të statistikës deskriptive.

Variabli PN_14 shpreh Tipin e Ndërmjetësimit më të cilin përballen ndërmjetësit në vëndin tonë. Grafiku 3 tregon se pavarësisht tipit të ndërmjetësimit, prirja për të patur një proces efikas është më e lartë se joefikas. Pra, e shprehur në trajtën e një konkluzioni mund të themi se: *për Ndërmjetësit, efikasiteti i procesit të ndërmjetësimit nuk varet nga Tipi i ndërmjetësimit. Për ta, cdo tip ndërmjetësimi është i njëjtë përball suksesit të procesit.*


Grafiku 3. Shpërndarja e “Tipit të ndërmjetësimeve”



Burimi: SPSS v.21 (Chart Builder-Histogram)

Variablin e pavarur PN_27, i cili shpreh opsionet e përgatitjes dhe trajnimit të Ndërmjetësave, e kemi studiuar në lidhje me variablin tjetër të pavarur PN_30, i cili shpreh nivelin e efektivitetit të programeve trajnuese për ndërmjetësit (Grafiku4).

Grafiku 4 Shpërndarja e PN_27 në lidhje me PN_30



Burimi: SPSS v.21 (Chart Builder-Boxplot)

Nga grafiku vihet re se të gjitha përgjigjet e të intervistuarëve janë përqëndruar në vlerën 2 për variablin PN_27, e cila i korresponon përgjigjes: “*Realizohen në programe dhe kurse trajnimi profesional*”, ndërkohë që shpërndarja e vlerave për perceptimin e efektivitetit të këtyre kurse përfaqëson vlera optimiste sepse gjithë përqëndrimi intervalor i PN_30 është mbi nivelin mesatar teorik të barabartë me 2. Vlera maksimale e intervalit të vlerësimit për qëndrën e vrojtimit është e barabartë me vlerën maksimale të vrojtuar. Kjo do të thotë se trajnimet e tyre, pavarësisht se nuk ofrohen në të gjitha opsionet e mundshme por vetëm në opsionin e kurseve dhe trajnimeve profesionale, janë efektive mbi nivelin mesatar të perceptimit nga Ndërmjetësit.

4. Gjyqtarët dhe Gjykata në procesin e ndërmjetësimit

Sa e predispozuar është Gjykata për të referuar mosmarrveshjet drejtë procesit të ndërmjetësimit?

Hipotezat statistikore që lindin nga pyetja e tretë studimore sekondare është H_0 : “Gjykata është e predispozuar për t’i referuar mosmarrveshjet drejtë procesit të ndërmjetësimit” v.s. “Gjykata nuk është e predispozuar për t’i referuar mosmarrveshjet drejtë procesit të ndërmjetësimit”. Për verifikimin e hipotezës H_0 me anë të variablave të përfthuara nga pyetësi, si variabël i varur është marrë variabli PGJ_12, i cili përfaqëson pyetjen P-12 në pyetësin ”Për Gjykatësit” (Apendix). Në parim, ky variabël nuk është dichotomus (dyvlerësh) sic e kërkon modeli i regresionit logjistik që ai të jetë. Variabli PGJ_12 është ordinal dhe vlerat e mundshme të tij janë shkallët (pesë) e Likertit nga 0 në 4 të cilat u përgjigjen respektivisht alternativave:

0=”në asnjë rast palëve nuk ju sugjerohet ndërmjetësimi”;

1=1%-9% të rasteve;


2=10%-39% të rasteve;

3=40%-74% të rasteve;

4=75%-100%

Nga verifikimi i përgjigjeve të marra për këtë pyetje u vu re se asnjë gjyqtar nuk dha përgjigje që u korespondojnë vlerave më të mëdha se 2 (Grafiku 5). Kjo e bëri më të lehtë konvertimin e këtij variabli nga një variabël i tipit ordinal në një variabël dichotomus.

Grafiku 5 : Shpërndarja e përgjigjeve për pyetjen PGJ-12



Burimi : Autori (Excel, Insert Graphs)

Në këtë mënyrë, të gjitha përgjigjet që i përkasin vlerës zero në klasifikimin ordinal u konvertuan në vlerën 0 të klasifikimit dichotomus, ndërsa vlerat 1 ndhe 2 të klasifikimit ordinal u konvertuan në vlerën 1 të klasifikimit dichotomus, duke përfutur kështu një variabël të përshtatshëm të varur për verifikimin e hipotezës H_0 (Tabela 26). Arsyeja pse u zgjodh ky variabël si i varur për të verifikuar H_0 është sepse ai mat në mënyrë të drejtëpërdrejtë shkallën e besimit të Gjykatës dhe Gjyqtarëve për procesin e ndërmjetësimit sipas parimit : *paraqes si alternativ një proces tek i cili besoj se do të jap rezultat*.

Tabela 26: Variablat e varur dhe të pavarur (Gjyqtarët dhe Gjykata)

Variabli	Pyetja që përfaqëson variabli	Lloji i variablit	Vlerat e variablit
PGJ_12	Në eksperiencën tënde si Gjyqtar, sa shpesh e praktikon ndërmjetësimin si alternative zgjidhje?	Dichotomus	0-1
PGJ_1	Sa kohe keni që punoni si Gjyqtar?	Ordinale	1-5
PGJ_2	Në dijeninë tuaj si Gjyqtar sa është afërsisht numri mesatar i rasteve gjyqësore që referohen për ndërmjetësim brënda një viti?	Ordinale	0-5
PGJ_3	Gjatë experiences tuaj si Gjyqtar, cila është tendenca e rasteve gjyqësore që referohen për ndërmjetësim?	Ordinale	-1;0;1
PGJ_4	Gjatë punës me rastet gjyqësore, sa raste mesatarisht në vit keni referuar në ndërmjetësim?	Ordinale	1-4
PGJ_7	A mendon se përballet me sfida ndërmjetësimi?	Dichotomus	0;1
PGJ_11	Në punën tënde si Gjyqtar, si vepron për ti bërë palët në konflikt të shkojnë në ndërmjetësim?	Ordinale	1-4

Burimi: Autori

Si variabla të pavarur janë marrë në studim të gjithë variablat e tjerë të Tabelës 26.

Gjatë përzgjedhjes së variablit të varur, identifikuam një rezultat i cili është jo vetëm i rëndësishëm si konkluzion, por shërben edhe si kufizim për verifikimin e hipotezës H_0 për rastin e Gjykatës dhe Gjyqtarëve. Nga Grafiku 5 vihet re menjëherë se për asnjë gjyqtar, ndërmjetësimi nuk është praktikuar si alternativë për zgjidhjen e mosmarrveshjeve në më shumë se 40% të rasteve, dhe për më tepër niveli 10%-39% ze vetëm 2.9% të rasteve në total të numrit të të intervistuarve (Grafiku 5). Gjithashtu, numri total i gjyqtarëve që e kanë praktikuar pozitivisht (1%-39% të rasteve) ndërmjetësimin si alternativë zë vetëm 37.8%, pra dominon reagimi negativ me 62.2% të rasteve (Grafiku 5). *Kjo nuk do të thotë se Gjyqtarët dhe Gjykata*

nuk janë të interesuar për procesin e Ndërmjetësimit, por janë faktorë të ndryshëm të cilët i bëjnë ata pesimistë për ta ofruar këtë proces si një alternativë të besueshme për zgjidhjen e konflikteve.

Prandaj, synimi ynë në studimin e kësaj marrdhënieje është fokusuar më shumë në faktorët frenues të fenomenit.

4.1. Lidhjet statistikore

Studimi i lidhjeve statistikore të shprehura me anë të korrelacioneve bivariate midis variablave të pavarur, i referohet Output-it të programit SPSS v.21 të paraqitur me anë të Tabelës 27.

Ajo cka bie menjëherë në sy është mungesa e vlerësimit statistikorë të koeficientëve të Pearson-it për variablin PGJ_2 (kollona 2, Tabela 5). Duke vrojtuar vlerat e këtij variabli shihet se ajo është konstante dhe e barabartë me 1. Pra, në perceptimin e gjyqtarëve të marrë në intervistë, në asnjë rast, numri mesatar i rasteve të referuara për ndërmjetësim, nuk i kalon 50 raste.

Tabela 27: Korrelacionet bivariate (Gjykatat dhe Gjyqtarët)

Correlations							
		PGJ_1	PGJ_2	PGJ_3	PGJ_4	PGJ_7	PGJ_11
PGJ_1	Pearson Correlation	1					
	Sig. (2-tailed)						
PGJ_2	Pearson Correlation	. ^a	. ^a				
	Sig. (2-tailed)						
PGJ_3	Pearson Correlation	-.057	. ^a	1			
	Sig. (2-tailed)	.202					
PGJ_4	Pearson Correlation	-.181 ^{**}	. ^a	.057	1		
	Sig. (2-tailed)	.000		.198			
PGJ_7	Pearson Correlation	-.088 [*]	. ^a	-.118 ^{**}	.051	1	
	Sig. (2-tailed)	.047		.007	.248		
PGJ_11	Pearson Correlation	-.052	. ^a	.015	.153 ^{**}	-.040	1
	Sig. (2-tailed)	.242		.726	.000	.370	
** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed). * . Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed). a. Cannot be computed because at least one of the variables is constant.							

Burimi: SPSS. V. 21 (Correlations-Bivariate)

Marrdhëniet korrelative ndërmjet variablave shfaqen të ndryshme për cifte të ndryshme.

Kështu:

✚ Cifti PGJ_1 dhe PGJ_4 i variablave të pavarur (Tabela 27) paraqitet me një marrdhënie shumë të fortë statistikore ($p=0.000$) dhe me koeficient negativ ($PCC=-0.181^{**}$). Variabli PGJ_1 përfaqëson moshën në profesion të Gjyqtarit, ndërsa variabli PGJ_4 përfaqëson rastet mesatare vjetore të referuara me ndërmjetësim. *Marrdhënia negative korrelative tregon se mosha në profesion e një gjyqtari shoqërohet me rënien e rasteve të referuara me ndërmjetësim. Kjo lë ndjesinë se fenomeni i konservatorizmit është efekt pengues në promovimin e Ndërmjetësimit si alternativë për zgjidhjen e konflikteve.*

✚ Konkluzionin e mësipërm e përforcon marrdhënia e fortë dhe negative korrelative ($p=0.047$; $PCC=-0.088^*$) midis PGJ_1 dhe PGJ_7 e cila shpreh perceptimin dyvlerësh të identifikimit të sfidave të ndryshme me të cilat përballet Ndërmjetësimi. Marrdhënia negative midis tyre tregon se përvoja e gjatë në profesionin e gjyqtarit minimizon ndjesinë e egzistencës të sfidave. *Pra, nuk janë sfidat ato që e bëjnë një gjyqtarë me përvojë të gjatë kohore në profesion të mos jetë optimist për aplikimin e procesit të Ndërmjetësimit.*

✚ Korrelacion me koeficient negativ të Pearson-it dhe me signifikançë të fortë shfaqin marrdhëniet midis variablave PGJ_7 dhe PGJ_3, ku ky i fundit shpreh tendencën e rasteve që referohen për ndërmjetësim. Është ky një rezultat logjik dhe *tregon se egzistenca e sfidave shoqërohet me uljen e tendencës për referim të rasteve drejt Ndërmjetësimit.*

✚ Marrdhënia e fundit signifikative është ajo midis variablave të pavarur PGJ_4 dhe PGJ_11 ($PCC=0.153^{**}$ dhe $p=0.000$; Tabela 27). *Koeficienti pozitiv shpreh qartë se, në mënyrë të pavullnetëshme, gjyqtarët e kanë të qartë që rritja e numrit të seancave informuese (PGJ_11) shoqërohet me rritjen e numrit mesatar të rasteve të referuara në Ndërmjetësim (PGJ_4).*

4.2. Lidhjet funksionale

Për verifikimin e hipotezes H_0 , edhe për rastin e Gjykatës dhe Gjyqtarëve kemi përdorur metodën e regresionit të shumfishtë logjistik përmes përpunimit të të dhënave me anë të softëare-it SPSS v.21.

Tabela 28: Vlerësimi i koeficientëve të regresit lojistik (PGJ 12)

Variables in the Equation								
	B	S.E.	Ėald	df	Sig.	Exp(B)	90% C.I. for EXP(B)	
							Lower	Upper
Step 1 ^a								
PGJ_1	.083	.105	.627	1	.429	1.087	.914	1.292
PGJ_3	.185	.126	2.142	1	.143	1.203	.977	1.480
PGJ_4	.485	.176	7.627	1	.006	1.624	1.217	2.168
PGJ_7	-.838	.361	5.399	1	.020	.432	.239	.783
PGJ_11	-.211	.108	3.785	1	.052	.810	.678	.968
Constant	.105	.629	.028	1	.868	1.110		

a. Variable(s) entered on step 1: PGJ_1, PGJ_3, PGJ_4, PGJ_7, PGJ_11.

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Vrojtimi i Tabelave 28 dhe 29 na lejon të identifikojmë se në përpunimin fillestar të të dhënave me metodën *Enter*, për të gjithë variablat e pavarur të paraqitura në Tabelën 26, disa nga këta variabla nuk e sigurojnë signifikançën e mjaftueshme për t'u përfshirë në modelin inferencial.

Tabela 29: Përmbledhja e modelit

Model Summary			
Step	-2 Log likelihood	Cox & Snell R Square	Nagelkerke R Square
1	658.237 ^a	.035	.048

a. Estimation terminated at iteration number 3 because parameter estimates changed by less than .001.

Burimi: SPSS v. 21 (Metoda Enter)

Ripërpunimi i të dhënave me metodën *Forward-Stepwise (Conditional)* identifikon variablat të cilat sigurojnë signifikançën e mjaftueshme për të qënë pjesë e modelit inferencial (Tabela 30 dhe Tabela 31). Variablat e pavarur PGJ_4, PGJ_7 dhe PGJ_11 rezultuan variabla signifikativ dhe si rrjedhim, janë ata që verifikojnë qëndrueshmërinë e hipotezës H_0 : “Gjykata është e predispozuar për t'i referuar mosmarrveshjet drejtë procesit të ndërmjetësimit”

Tabela 30: Vlerësimi i koeficientëve të regresit logjistik (PGJ 12)

Variables in the Equation									
		B	S.E.	Ėald	df	Sig.	Exp(B)	90% C.I. for EXP(B)	
								Loëer	Upper
Step 1 ^a	PGJ_7	-.832	.355	5.510	1	.019	.435	.243	.779
	Constant	.288	.342	.709	1	.400	1.333		
Step 2 ^b	PGJ_4	.417	.169	6.125	1	.013	1.518	1.150	2.003
	PGJ_7	-.887	.357	6.170	1	.013	.412	.229	.741
	Constant	.171	.346	.246	1	.620	1.187		
Step 3 ^c	PGJ_4	.476	.172	7.649	1	.006	1.610	1.213	2.137
	PGJ_7	-.926	.357	6.713	1	.010	.396	.220	.713
	PGJ_11	-.213	.108	3.885	1	.049	.808	.677	.965
	Constant	.518	.388	1.781	1	.182	1.679		
a. Variable(s) entered on step 1: PGJ_7.									
b. Variable(s) entered on step 2: PGJ_4.									
c. Variable(s) entered on step 3: PGJ_11.									

Burimi: SPSS v. 21 (Forward-Stepwise (Conditional))

Në fillim të kësaj cështjeje theksuam se verifikimi i hipotezës H_0 është bërë duke marrë si vlera pozitive dichotomus, vlerat minimale të mundshme të variablilit PGJ-12 i cili përfaqëson në mënyrë të drejtëpërdrejtë pyetjen përkatëse në pyetësor.

Pra, pavarësisht se H_0 është e qëndrueshme si hipotezë statistikore, nga ana praktike, për shkak të vlera minimale pozitive, duhet të themi se ajo vërtetohet (pranohet) në kuptimin e minimal të dëshirës së Gjykatës dhe Gjyqtarëve për ta praktikuar Ndërmjetësimin si një alternativë për zgjidhjen e konfliktit midis palëve.

Tabela 31: Përmbledhja e modelit

Model Summary			
Step	-2 Log likelihood	Cox & Snell R Square	Nagelkerke R Square
1	671.007 ^a	.011	.015
2	664.880 ^a	.023	.031
3	660.865 ^a	.030	.041
a. Estimation terminated at iteration number 3 because parameter estimates changed by less than .001.			

Burimi: SPSS v. 21 (Forward-Stepwise (Conditional))

Rezultatet e përpunimit statistikor për verifikimin e lidhjeve funksionale midis variablilit të varur dhe variablave të pavarur tregojnë për shkallë të ndryshme të ndikimit të

variabla të pavarur statistikisht mbi shancin që një konflikt të referohet procesit të Ndërmjetësimit nga Gjykata. Kështu, rritja me një njësi e nivelit të rasteve mesatare që Gjykatësi ka referuar në Ndërmjetësim (PGJ_4 ; $B=0.476$; $Exp(B)=1.610$) shoqërohet me një rritje të shansit me mbi 1.5 herë që ky gjykatës të jetë optimist për t'i referuar konfliktet drejt procesit të ndërmjetësimit. Këtu jemi të qartë se ky optimizëm, për studimin tonë nuk e kalon, në rastin më të mirë, referimin e 39% të rasteve.

Vlerat negative të koeficientit të variablit PGJ_7 ($B=-0.926$; $Exp(B)=0.396$) tregojnë se identifikimi i sfidave (rritja me një njësi për këtë variabël është thjeshtë kalimi nga perceptim negativ në pozitiv sepse është variabël dyvlerësh) ul ndjeshëm shancin [$Exp(B)=0.396<1$] (gati tre herë) për të patur referim të mosmarrveshjes (konfliktit) në Ndërmjetësim.

Interesant është rezultati i ndikimit të variablit të pavarur PGJ_11 mbi variablin e varur PGJ_12 . Koeficienti negativ ($B=-0.213$, Tabela 30) tregon se rritja me një njësi, (kuptohet që vlerat e dy variabla të tjerë të pavarur të qëndrojnë konstant), shoqërohet me ulje të shancit [$Exp(B)=0.808<1$] që të kemi referim pozitiv të rastit në Ndërmjetësim. Ky rezultat lë ndjesinë se Gjykatësi paraqëlqen më mirë të referoj zgjidhjen e konfliktit me mënyrën klasike të gjyqimit sesa të rris nivelin e informimit për të bindur palët që rastin tia referoj Ndërmjetësimit.

Nga rezultatet e pyetjeve të cilave nuk mund të bëhej një përpunim statistikor ka rezultuar se ndërmjetësimi ka një kohë të shkurtër që aplikohet, një pjesë e mirë e ndërmjetësve janë të sapo licensuar dhe pjesa me eksperiencë mbi shtatë vjet është shumë e vogël.

Referuar pyetjes 6 të pyetësorëve të ndërmjetësve, vërehet se perceptimi i ndërmjetësve për përfitimet nga përdorimi ndërmjetësimit për zgjidhjen e konfliktit mes dy palëve fokusohet kryesisht në koston e konfliktit, konfidencialitetit të procesit, kontrolli i palëve mbi dinamikën e ndërmjetësimit dhe gjendja psikologjike e shpirtërore e palëve në proces.

Referuar pyetjes 7 të pyetësorëve të ndërmjetësve, vërehet se pjesa më e madhe e ndërmjetësve mendojnë se sfidat kryesore me të cilat përballen ndërmjetësimi, janë arritja e profesionalizmit të duhur në mënyrë që të rritet besimi në këtë proces dhe rritja e mundësive të referimit të konflikteve në ndërmjetësim.

Referuar pyetjes 6 të pyetësorëve të ndërmjetësve, vërehet se nisur nga njohja e kuadrit ligjor, ndërmjetësit parashtrojnë se legjislacioni në fuqi nuk e inkurajon dhe/apo stimulon përdorimin e ndërmjetësimit.

Referuar pyetjes 11 të pyetësorëve të ndërmjetësve, vërehet se shumë pak ndërmjetës ishin në gjendje të evidentonin se në cilin vit Gjykata ka kërkuar për herë të parë palëve të shkojnë për ndërmjetësim.

Referuar pyetjes 15 të pyetësorëve të ndërmjetësve, vërehet se pjesa më e mirë e ndërmjetësve perceptojnë se lehtësimi i komunikimit, inkurajimi i palëve në konflikt, negocimi dhe përgatitja e një zgjidhjeje dhe ofrimi i kësaj zgjidhjeje palëve në konflikt janë qëllimi i veprimeve të ndërmjetësit. Ndër këto objektiva ndërmjetësit tentojnë të fokusohen më tepër në lehtësimin e komunikimit ndërmjet palëve në konflikt.

Nga përgjigjet e pyetjes 16 shikojmë një ndarje theksuar, pothuajse në dy perceptime të ndara në mënyrë të barabartë, ku disa ndërmjetës mbështesin ekzistencën e rrolit aktiv të ndërmjetësit, pra ndërmjetësi i orjenton palët në konflikt dhe disa ndërmjetës mbështesin ekzistencën e rrolit pasiv të ndërmjetësit, ku ndërmjetësi është më i tërhequr dhe lejon palët të ndihen në drëhtim të procesit të ndërmjetësimit. Kjo ka të bëjë me tipin e ndërmjetësimit që aplikohet, e cila në pjesën në pjesën më të madhe është e kushtëzuar jo vetëm nga natyra e ndërmjetësit por edhe nga tipi i konfliktit dhe palëve në konflikt.

Përshkrimet nga eksperiencia e Ndërmjetësve të vërejtura në pyetjen 17 sa i përket rrolit të palëve në konflikt tregojnë se nuk ka një natyrë mbizotëruese të sjelljes së palëve në konflikt. Ajo është e ndarë në palë të cilat janë më komode të jenë aktiv dhe mbizotërojnë procesin duke orjentuar ndërmjetësin, por edhe me palë të cilat janë pasive dhe pranojnë që të jetë ndërmjetësi ai që i orjenton ata gjatë procesit. Pjesa më e madhe e ndërmjetësve e shohin të nevojshme që palët të kenë informacionin e nevojshëm përpara se të marrin vendime. Në këtë mënyrë rezultati i vendimi të tyre do të jetë i qartë por edhe vendim marrja e tyre do të jetë më e thjeshtë. Ndërmjetësit pohojnë se strategjitë e tyre janë të shumta dhe të ndryshme, ata përdorin ushtrimin i presionit mbi palët në konflikt, kompensimi i palëve në konflikt, integrimi i pozicioneve të palëve në konflikt si dhe marrja e një pozicioni inaktiv. Perceptimi i ndërmjetësve për tiparet kryesore që duhet ti karakterizojë ata janë të qënies një dëgjues i mire, paanshmëria dhe të qënurit i duruar. Perceptimi të ndërmjetësit është se ndërmjetësimi ka patur zhvillimi positive me krijimin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve dhe numrit të

ndërmjetësimeve në rritje. Ndërsa zhvillimet negative sipas ndërmjetësve janë mungesa e trainimeve profesionale, moskrijimi i dhomave vendore të Ndërmjetësimit dhe mungesa e theksuar e referencave të organeve të drejtësisë në ndërmjetësim.

Referuar pyetësorëve të palëve, ka rezultuar se pjesa më e madhe e konflikteve të zgjidhura me ndërmjetësim, rezulton të jete në vitet 2013, 2014, 2015. Një pjesë e vogël e konflikteve janë zgjidhur në nga viti 1999 deri në 2011. Të pyetura si palë në konflikt se cili ka qënë përfitimi nga përdorimi i ndërmjetësimit për zgjidhjen e konfliktit, përgjigjet kanë qënë të alternuara ndërmjet: kostos së zgjidhjes së konfliktit; kontrollit që palët ka mbi dinamikën e gjetjes së zgjidhjes së konfliktit; kohës së shkurtër që merr zgjidhja e konfliktit dhe konfidencialitetit të procesit. Palët që i janë nënshtruar një procesi ndërmjetësimi për zgjidhjen e konfliktit të tyre, evidentojnë profesionalizmin, aftësitë komunikuese dhe vëmendjen që ndërmjetësi kushton në dëgjimin e detajeve të problematikave të tyre, si të cilësitet kryesore të qëndrimit dhe sjelljes së ndërmjetësve. Strategjia e ndërmjetësit rastin e konfliktit, nga palët vlerësohet se ka qënë kompleks. Ata nuk janë të aftë të përcaktojnë nëse ndërmjetësi ka ushtruar teknika të cilat përcojnë perceptimin e ushtrimit të presionit mbi palët në konflikt, marrjen e një pozicioni inaktiv apo duke aplikuar një teknikë që çon drejt kompesimit të palëve apo teknikë e cila synon integrimin e pozicioneve të palëve në konflikt. Ky rezultat i paraqitur na sqaron se ndërmjetësit kanë qënë të aftë të mbajnë një rol asnjëanës dhe kanë lejuar palët të jenë aktorët kryesorë të gjetjes së zgjidhjes së tyre.

Vërejmë se perceptimi i palëve për qelimin e ndërmjetësve është në rraport të drejtë me përcaktimet e pyetjeve të mëparshme, ata në pyetjet në vazhdim konfirmojnë që ndërmjetësi ka rritur që të përcojë perceptimin të palët se roli i tij është lehtësimi i komunikimit mes palëve në konflikt duke i aftësuar palët në aftësitë e tyre komunikuese dhe inkurajimi i palëve në konflikt për të bërë lëshime dhe gjetur ata vetë një zgjidhje. Në shumë pak raste është vërejtur se palët kanë qënë dakord dhe kanë lejuar ndërmjetësin të negociojë dhe përgatisë marrëveshjen ndërmjet tyre. Nga pyetjet 16, 17, 18 vërehet se palët janë të kënaqura nga procesi i ndërmjetësimit pamvarsisht arritjes apo jo të një zgjidhje dhe ato paraqiten të vendosura për të respektuar kushtet e vendosura në marrëveshje dhe se këto kushte konsistojnë në përcaktime afateve të caktuara për përmbushjen të kërkesave të njera-tjetrës.

Nga pyetja e gjyqtarëve se cili ka qënë përfitimi nga përdorimi i ndërmjetësimit për zgjidhjen e konfliktit, përgjigji ka qënë e alternuar ndërmjet: kostos së zgjidhjes së konfliktit; karakterit të dyanshëm të kontributit të palëve në procesin e gjetjës së zgjidhjes së konfliktit mes tyre; kohës së shkurtër që merr zgjidhja e konfliktit dhe konfidencialitetit të procesit.

Perceptimi i gjyqtarëve në raport kuadrin ligjor që egziston për ndërmjetësimin është i ndarë në dy qëndrime kryesore. Disa gjyqtarë janë të mendimit se kuadri ligjor e inkurajon dhe stimulon përdorimin e ndërmjetësimit ndërsa pjesa tjetër mendon sekuaadri ligjor as e inkurajon, as e stimulon përdorimin e ndërmjetësimit. Nga bisedat dhe debatet e bëra me gjyqtarët, rezulton se kjo ndarje ka në baze të saj, përcaktimet procedurile të ligjit, në rraport me referimin e çështjeve në ndërmjetësim. Informacioni i gjyqtarëve mbi funksionimin e sistemit të licensimit të ndërmjetësve fokusohet në përcaktimin e normave ligjore që përcaktojnë dhënien e liçencës për ndërmjetës dhe asnjë informacion tjetër sa i përket kushteve për ta ushtruar këtë profesion pas licensimit.

Sa i përket dijenisë së Gjyqtarëve se kur është kërkuar për herë të pare nga palët të shkojnë për ndërmjetësim, gjyqtarër nuk kanë asnjë informacion. Ndër tre kriteret që Gjyqtarët mendonë se janë të rëndësishme për të qënë ndërmjetës verehen të jenë: komunikimi; ekzistenca e tainimeve në masën e duhur dhe paraqitja e këtyre aftësive me profesionalizëm

Gjyqtarët përshkruajnë se përgatitja më e mirë e ndërmjetësve varet institucioni i cili përgatit ndërmjetësit. Pjesa më e madhe e tyre mendojnë se kjo përgatitje duhet të realizohet në programe dhe kurse trajnimi professional ose të realizohet në shkollat e juridikut.

Nga të dhënat e marra nga Shkolla e magjistraturës, jane trainuar nga viti 2011 e deri sot 32 gjyqtarë nga të cilët nuk përcaktohet sa janë gjyqtarë që kanë përfunduar shkollën e magjistraturës dhe sa jo.

Kanë pjesë të trainimit të tyre të vazhdueshëm në shkollën e magjistraturës dhe kanë marrë njohuritë e mjaftueshme mbi ndërmjetësimin 165 gjyqtarë nga të cilët vetëm 22 gjyqtarë kanë marrë informacion të mjaftueshëm mbi ligjin 10385 të vitit 2011 për ndërmjetësimin ndërsa pjesa tjetër 94 gjyqtarë janë trajnuar për ligjin e 2003 dhe 71 për ligjin e vitit 1999. Totali i gjyqtarëve ne shkallë të parë në Republikën e Shqipërisë është 235.

KAPITULLI VII: NDËRMJETËSIMI NË EKSPERIENCAT E SHTETEVE TË HUAJA

1. Ndërmjetësimi në kuadër të infrastrukturës gjyqësore në 11 shtete europiane

Dimensioni ndërkombëtar i ndërmjetëimit kontribuon në një shkëmbim të frytshëm të njohurive rreth ZAK, dhe më konkretisht, rreth ndërmjetëimit. Për këtë arsye nuk gjejmë zhvillime të ndërmjetëimit ndërkombëtar të izoluara.

Organizatat e ZAK-se, autoritet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe, gjithnjë e më shumë fusha gjyqësore janë frymëzuar dhe stimuluar nga zhvillimet jashtë vendit³⁷⁶. Individët (ndërmjetësit) janë organizuar dhe shpesh kanë marrë pjesë në kongrese ndërkombëtare dhe programe trajnimi. Këtë të fundit e gjejmë në çdo rast, tek të 11 shtetet që bëjnë pjesë në këtë studimin kërkimor.

Burime të rëndësishme për zhvillimin e ndërmjetëimit në këto 11 shtete, janë kryesisht, ato që lidhen me këtë praktikë në Shtetet e Bashkuar, Angli dhe Kanada.

Ndër këto tre shtete, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në veçanti, konsiderohen si djepi i ndërmjetëimit modern. Kjo na bën të kuptojmë se teknikat e ndërmjetëimit janë zhvilluar dhe rafinuar në bazë të eksperimenteve kërkimore³⁷⁷.

Pavarësisht nga ndikimet e jashtme, shumica e vendeve veprojnë duke u bazuar në zgjedhjet e tyre, të cilat shpesh përputhen me individualitetin e sistemeve ligjore të tyre.

Ky kapitull fillon, duke analizuar faktin, nëse në 11 shtetet e përzgjedhura, ndërmjetësimi respektohet dhe nëse mund të themi se kemi të bëjmë me një praktikë të ndërmjetëimit, dhe nëse është kështu, cila është shkalla e zhvillimeve të kësaj praktike që kemi në dispozicion. Këto të dhëna do të studiohen shkurtimisht. Sekuenca për trajtimin e 11 shteteve është e bazuar në klasifikimin, sipas traditës ligjore.

³⁷⁶ Shih raportin e OESO: OESO, Legal provisions related to business-to-consumer alternative dispute resolution in relation to privacy and consumer protection, OESO: Paris, 2002.

³⁷⁷ A. de Roo and R. Jagtenberg, Mediation in the Netherlands: Past – Present – Future, in: E. Hondius & C. Joustra eds., Netherlands Reports to the Sixteenth International Congress of Comparative Law, Antwerp: Intersentia, 2002, p. 127.

2. Franca

Franca është një shtet i centralizuar unitar, ku Presidenti i Republikës dhe qeveria kanë relativisht pjesën më të madhe të kompetencave, fuqinë ekzekutive. Kodifikimi i Napoleonit, i cili ka ndikuar fuqishëm në shumë vende, ka sjellë si pasojë faktin që, Franca të konsiderohej si sistemi nënë i së drejtës civile në kontinentin europian. Juristët francezë kanë ngritur rrjete të tilla, si: Shoqata Henri Capitant, në mënyrë që të konsolidonin ndikimin gjyqësor në mbarë botën. Gjithashtu ky ndikim është i dukshëm edhe në ligjin e Bashkimit Europian në fushën e ZAK-së³⁷⁸.

Në Francë, administrimi i drejtësisë në fushën e së drejtës private (dhe në atë të ligjit penal) është mbajtur rreptësisht i ndarë nga ai i së drejtës administrative. Të gjitha mosmarrëveshjet, në të cilat një organ publik bën pjesë, klasifikohen si mosmarrëveshje administrative ligjore dhe janë nën juridiksionin e Këshillit të Shtetit dhe Gjykatave Administrative.

Në France ende mbizotëron koncepti i shërbimit publik, i cili ekzekuton detyrimet e shtetit, në një afat që dominon në diskutimet e bëra në lidhje me reformat në kuadër të gjyqësorit; në të vërtetë, edhe ky është një shërbim publik.

Për këtë arsye, në Francë rezistenca kundrejt konceptit të tregut dhe efikasitetit është më e madhe.

Diskutimi mbi efikasitetin në administratën publike të drejtësisë dhe konceptin në lidhje me kostot ka filluar, kryesisht, për shkak të publikimit të Raportit Coulon, që më pas u quajt Jean-Marie Coulon. Coulon ishte kryetar i një komisioni në mesin e viteve 1990, i cili ishte ngritur për të shqyrtuar mënyrat e modernizimit të administratës publike të drejtësisë. Raporti përfundimtar i këtij komisioni, i quajtur “Refleksionet dhe propozimet mbi procedurën civile”, u publikua në vitin 1997. Propozimet e bëra lidheshin me reformat në ligjin aktual të procedurës, por këtu nuk gjejmë asnjë mungesë të sugjerimeve për të promovuar ZAK – për shembull, duke lejuar mundësinë e marrëveshjeve të zgjidhjes së konfliktit, të kalojnë nga një gjyqtar në formë të zbatueshme.

Organizimi gjyqësor francez, ndryshon nga ai shqipëtar, vetëm në disa aspekte. Në rastet civile, ne gjejmë tre struktura, Gjykatat Intermediate (TGI) si gjykatat e rregullta të

³⁷⁸ European Commission, (19 April 2002) The Green Paper concerning alternative ways of dispute settlement in the field of civil law and commercial law.

shkallës së parë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Kasacionit. Gjithashtu, gjejmë edhe Gjykatat e Magjistraturës.

Një ndryshim është formuar nga gjykatat e veçanta tregtare dhe të punës, respektivisht, gjykatat komerciale dhe këshillat e Prud'hommes, ku gjyqtarët administrojnë drejtësinë, në lidhje me çështjet tregtare dhe të punës, shpesh herë me anë të opsionit të apelit.

2.1. Ndërmjetësimi në Francë

Kompetencat e gjykatësit francez, për shumë vite, kanë qenë, gjithnjë e më shumë, në rënie³⁷⁹. Megjithatë, Metodot Alternative për Zgjidhjen e Konfliktëve (MARC) ose Mënyrat Alternative për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve (MARL) kanë pasur një rritje të dukshme në mesin e akademikeve, profesionit ligjor, magjistraturave dhe hartuesve të politikave³⁸⁰. Gjithsesi, interesi për alternativat në administratën publike të drejtësisë është një marrëveshje e vjetër, që i nënshtrohet një modeli ciklik. Gjatë periudhës 1791-1804, sistemi i Byrove krijoi zyrat e pajtimit dhe paqes, këto zyra u drejtuan kryesisht nga laikë, me rolin e pajtimit paraprak, në lidhje me të gjitha kontekstet, që kishin të bënin me kompetencat e gjykatës³⁸¹.

Fatet e këtij varianti historik të gjykatës, në lidhje me ndërmjetësimin, kanë zgjatur për një periudhë të gjatë dhe pikërisht për këtë arsye janë shumë të rëndësishme për debatin aktual të ZAK-ve.

Zhvillimet franceze mund t'i përmbledhim si më poshtë: së pari, detyra e parë paraprake e pajtimit është drejtuar drejtpërdrejtë nga gjykatësi (gjykatësi i paqes) e, më pas, ai gradualisht filloi të humbte rëndësinë e tij. Entuziazmi në mesin e njerëzve që kërkonin drejtësi të vërtetë, të cilët përdornin këtë alternative, ra midis viteve 1830-1930, nga 74% në 5% . Në vitin 1949, pajtimi paraprak u shfuqizua³⁸².

³⁷⁹Shih: Ministère de la Justice, Les chiffres-clés de la justice.

³⁸⁰ Me termin ADR (ZAK) ose MARC, për shumë autor Francez, nënkupton më shumë se metodat bazë të negocimit bazë. Për shembull procedura e ankimit dhe atributet janë, gjithashtu, të përmbledhura. Kjo mënyrë mund të gjendet edhe tek Karta Jeshile Europiane, tek ADR.

³⁸¹ Raa, Ch (1970). *Deoorsprong van de kantonrechter*, Deventer, pp.36.

³⁸² Art. 48 ff. of the old Code de Procédure Civile of 1806.

Në të njëjtën kohë, megjithatë, u prezantua një dispozitë e re, e cila përcaktonte që të dyja, si gjykata e parë, edhe ajo e lartë, në çdo fazë të çështjes, ka mundësinë të thërrasë të dyja palët për të bërë një përpjekje për ndërmjetësim. Në kodin e ri të procedurës civile, të vitit 1975, kjo dispozitë ka mbetur dhe bën pjesë në deklaratën e misionit të neni 21.

Megjithatë, pajtimi paraprak vazhdoi në gjykatat e specializuara të punës, ku popullariteti i tij ka rënë nga 90% rreth vitit 1830, në 10% në vitin 1980.

Në vitet 1970, zgjidhjet alternative për administratën publike të drejtësisë patën serish rendësi të madhe, veçanërisht, në kuadër të hyrjes në lëvizjen e drejtësisë. Sipas disa autoreve francez, kjo nuk kishte të bënte aq shumë me zgjidhjet alternative, sesa me të ashtuquajturën “zgjidhjet e mosmarrëveshjeve palliative”: përkatësisht, zhvillimin e institucioneve të arritshme, ku zgjidhjet e mosmarrëveshjeve janë bërë të mundura nga kërkimet, ndërmjetësimi, këshillimi apo imponimi i një vendimi, në kombinime të ndryshme³⁸³.

2.1.1. Mosmarrëveshjet civile përfshirë këtu edhe mosmarrëveshjet familjare

Si pasojë e hyrjes në lëvizjen e drejtësisë, në vitin 1978, instituti i Këshillit u krijua me anë të një dekreti: një rrjet kombëtar i ndërmjetësuesve laikë, me misionin për të lehtësuar zgjidhjet gjyqësore. Çdo palë e interesuar (person fizik apo juridik), por edhe çdo gjyqtar, mund të telefononin në Këshill, në bazë të dekretit, ndërsa instituti është pjesë e infrastrukturës gjyqësore. Dekreti përcakton, gjithashtu, se vendbanimet për të cilat palët heqin dore nga të drejtat, duhet t’i nënshtrohen një marrëveshjeje konstante dhe, gjithashtu, duhet të nënshkruhet nga Këshilli.

Nga një akt i 8 shkurtit të vitit 1995, instituti u emërtua nga Këshilli i Drejtësisë, për të cilin u dekretua se instanca e gjykimit mund të delegojë edhe mundësinë për t’u pajtuar, një përpjekje paraprake, me kërkesë të palëve. Në fakt, këto më pas, veprojnë në vend të vet gjyqtarit. Në vitin 1996, lidhja me gjyqtarin u përforcua edhe më tej, duke caktuar zgjedhjen dhe emërimin e pajtuesve ndaj instancës së gjykimit.

³⁸³ Termi “palliative” është huazuar nga Évelyne Serverin; É. Serverin, Les procédures de règlement amiables en France, entre théorie et pratique”, karta e procesit civil gjyqësorë në konferencën e shekullit 21, e mbajtur në Copenhagen, i datës 7-9 Korrik 2002. Shembuj të tjerë të cilët ia vlejné për t’u përmendur janë Boîte Postale 5000 në fushën e së drejtës të konsumatorit dhe Médiateur de la République në fushën administrative.

Shërbimet e këtyre pajtuesve janë false, dhe siç u përmend tashmë, për pajtuesit kjo është një punë vullnetare. Studimi empirik ka konfirmuar, se pajtuesi tipik është një individ profesional, që është në pension. Ka dallime në shkallën e organizimit të pajtuesve në çdo fushë dhe në strukturën e linjave të komunikimit me instancat përkatëse gjyqësore. Në vitin 2000, ishin 1728 pajtues që punonin dhe vepronin në Francë.

Nga i njëjti ligj i 8 shkurtit 1995, ku u forcua lidhja ndërmjet pajtuesve dhe instancës së gjyqësorit, hyri edhe një anëtar tjetër, përveç Këshillit: Ndërmjetësi. Dispozita ishte e tillë që, gjyqtari, me pëlqimin e palëve, në çdo fazë të çështjes mund të udhëzojë një person të trete për të ndihmuar në sqarimin e pikëpamjeve të palëve, në mënyrë që t'i japë mundësinë atyre për të gjetur një zgjidhje për mosmarrëveshjen e tyre³⁸⁴.

Ndryshe nga Këshilli, shërbimet e ndërmjetësve nuk janë falas. Palët duhet të paguajnë tarifat, nëse ata kanë të drejtë për ndihmë juridike. Një ligj i kohëve të fundit, i 4 marsit 2002, paraqet një rekomandim më pak vullnetar tek këta ndërmjetës, në fushën e kujdestarisë prindërore pas divorcit. Nëse (ish) bashkëshortët nuk mund të arrijnë asnjë marrëveshje, gjykatësi mund t'i drejtojë ata për të diskutuar edhe me ndërmjetësin, në mënyrë që ky i fundit, t'i shpjegojë atyre natyrën dhe qëllimin e ndërmjetësimit.

Ligjvënësi francez ka hedhur poshtë disa nga standardet e përgjithshme për ndërmjetësit dhe ndërmjetësimeve, pikërisht në nenin 131 NCPC. Këto përfshijnë kërkesat e pavarësisë dhe një detyrë ligjore të konfidencialitetit.

administrative, ndër të tjera, ende duket të mos ketë ndonjë kërkesë të madhe për ndërmjetësim në këtë fushë⁴²³.

9. Danimarka

Që nga viti 1849, Danimarka ka qenë një monarki kushtetuese, me një sistem parlamentar. Parlamenti, i cili përbëhet nga vetëm një dhomë, ka 179 anëtarë. Ligji themelor danez përdor parimin e ndarjes së pushteteve. Administrimi i rregullt danez i drejtësisë zhvillohet në tri raste. Në krye të organizimit gjyqësor danez qëndron Højesteret (Gjykata Supreme), e ndjekur nga dy Landsretter (Gjykata të Larta) dhe 82 Byretter (gjykata). Këto gjykata kanë juridiksion në të dyja rastet, penale dhe civile. Ka edhe fusha të specializuara si Arbejdsretten (Gjykatat e Punës). Danimarka ka gjykata administrative.

9.1. Ndërmjetësimi në Danimarkë.

ZAK-ja, në pajtim të veçantë, është zhvilluar plotësisht në Danimarkë, në lidhje me zgjidhjen e konflikteve të punës. Ka një shkallë të lartë të institucionalizimit dhe profesionalizimit. Kontekstet e tjera, duke përfshirë kontekstet familjare, janë zgjidhur herë pas here me anë të ndërmjetësimit modern. Që nga viti 1998, një komision ka punuar, me urdhër të Ministrisë Daneze të Drejtësisë, në shqyrtimin e ligjit procedural civil. Ky komision është i nevojshëm, në të njëjtën kohë, për të shqyrtuar mundësitë e referimit gjyqësor për ndërmjetësim. Në raportin e përkohshëm të komisionit, nuk thuhet ende asgjë në lidhje me ndërmjetësimin. Disa autorë danezë, në fushën e ndërmjetësimit, pyesin veten nëse kjo mund të interpretohet si një paragjykim i përgjithshëm kundër ndërmjetësimit⁴²⁴.

9.1.1. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës.

Marrëdhëniet daneze industriale janë karakterizuar nga një shkallë e lartë e organizimit të punonjësve dhe punëdhënësve, si rezultat, pozita ligjore e shumicës së

⁴²³ A. Gotwald & V. Gotwald, *Environmental Mediation in Europe – Status and Experiences*, Vienna, October 2000, pp. 57.

⁴²⁴ V, Vindelov. (2002). *Conciliation and mediation in Danish Law*, in: *Parts of Danish Law in Action*, National Reports XVIth Congress of the International Academy of Comparative Law, Brisbane .pp.15.

punonjësve daneze është e qeverisur nga marrëveshjet kolektive të punës. Për këtë arsye, një dallim i mprehtë është bërë në Danimarkë, veçanërisht, në mes të konflikteve kolektive të punës, mbi të drejtat dhe interesat respektive. Konfliktet individuale të punës janë trajtuar kryesisht me anë të klauzolave të konteksteve të përfshira në marrëveshjet kolektive të punës. Partnerët socialë janë shumë të lidhur me vetë-rregullimin.

Në parim, pajtimi danez është i detyrueshëm në konfliktet kolektive të punës. Kjo do të thotë që, para se një mosmarrëveshje të vihet përballë një ndërmjetësi të Statens Forligsinstitution (Pajtures Publik) ose Arbejdsretten (Gjykate të Punës), duhet të ketë qenë bërë tashmë një përpjekje pajtimi. Si rezultat, shumica e marrëveshjeve kolektive të punës parashikojnë klauzola të marrëveshjeve të pajtimit dhe marrëveshjeve të organizatës. Shumica e mosmarrëveshjeve zgjidhen në këto dy nivele.

Me futjen e Forligmandsloven (pajturesit Publik), në vitin 1908, për zgjidhjen e konflikteve kolektive të punës, pajtimi ose ndërmjetësimi u bë metoda mbizotëruese për zgjidhjen e punës kolektive⁴²⁵. Pasardhësi i menjëhershëm në këto pajtures publik nga 1908, është Statens Forligsinstitution⁴²⁶.

Ky shërbim, formalisht, vjen në Ministrinë e Punës, por kryen aktivitetet e veta në mënyrë të pavarur. Për më tepër, Statens Forligsinstitution ka buxhetin e vet dhe zyrat. Shërbimet e Forligsinstitution janë të lirë. Statens Forligsinstitution shërbehet nga tre Forligsmænd (pajtures) të caktuar nga Ministri i Punës, të cilët ndihmohen nga 21 Mæglingmænd (asistent ndërmjetës). Emërimi i ndërmjetësuesve bëhet pas konsultimit me punëdhënësit kryesor dhe punonjësit e organizatave. Statens Forligsinstitution ndërmjetëson kryesisht në konfliktet kolektive të punës, mbi krijimin, rishikimin dhe zgjerimin e marrëveshjeve kolektive të punës. Funkcioni i shërbimit është hedhur poshtë si ligj⁴²⁷. Pajturesit mund të fillojnë punën e tyre të ndërmjetësimit me iniciativën e vet ose me kërkesën e palëve dhe ata mund të bëjnë propozime të mæglingforslag (pajtimit). Përfaqësuesit e

⁴²⁵ A, de Roo & R, Jagtenberg. (1994). *Settling Labour disputes in Europe*, Deventer/Boston, pp. 321-325; J, Kristiansen. (2002). *Conciliation, mediation and arbitration: Denmark*, EU Project for the Study of Conciliation, Mediation, and Arbitration, Madrid/Brussels, pp. 3; O, Krarup. (2000). *Free Bargaining or State Coercion – Conciliation in the Danish Labour Market*, paper, University of Copenhagen.

⁴²⁶ Law of 1910 on Conciliation in Collective Labour conflicts, as last amended in 1997.

⁴²⁷ PO Aty. Art. 4 ff.

palëve, sindikatat dhe punëdhënësit janë të detyruar të paraqesin këto propozime përpara anëtarëve të tyre për ti votuar. Një shumicë e thjeshtë është e mjaftueshme për të refuzuar një propozim të tillë.

9.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës familjare.

Në Danimarkë, 90% e të gjitha divorceve trajtohen me anë të një procedure administrative. Organi publik kompetent për këtë procedurë është zyra administrative. Që të paraqesin një kërkesë të përbashkët divorci, palët duhet, së pari, të kenë arritur marrëveshje për kujdestarinë dhe të rendit të mirëmbajtjes. Të gjitha ndryshimet e tjera mund të diskutohen me zyrtarin pranë zyrës administrative, i cili luan rolin e ndërmjetësit dhe, përfundimisht, duhet të japë - ose jo - miratimin e tij për divorc.

Në vitin 2000, të gjitha këto zyra administrative filluan të ofrojnë ndërmjetësim nga ndërmjetës të trajnuar⁴²⁸ posaçërisht. Këta ndërmjetës, të cilët punojnë së bashku me një bashkë-ndërmjetësues, janë të punësuar në këto zyra dhe janë kryesisht, avokatë apo psikologë. Kur ndërmjetësimi dështon, çështja trajtohet më tej nga një koleg. Në bazë të informatave në dispozicion, si ato të shtatorit 2001, janë zhvilluar 12 ndërmjetësime⁴²⁹. Qëllimi ishte për të vlerësuar përvojat me këtë formë të ndërmjetësimit.

9.1.3. Mosmarrëveshjet në fushën e mjedisit.

Ndërmjetësimi mbetet një metodë e panjohur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mjedisit. Megjithatë, nga kërkimet rezulton, se procedurat ekzistuese janë të përshtatshme për zbatimin e ndërmjetësimit. Një shembull, që ia vlen të përmendet këtu, është (Komiteti i Veprimit në Mjedis) Miljøankenævnet, i cili përbëhet nga një gjyqtar - kryetar⁴³⁰.

⁴²⁸ The training of these mediators consists of a 4-day course paid for by the state.

⁴²⁹ V, Vindelov. (1996). *Commissie Herzieningscheidingsprocedure*, Rapport Anders Scheiden, The Hague, 2 October pp. 90.

⁴³⁰ A, Gotwald. & V, Gotwald. (2000). *Environmental Mediation in Europe – Status and Experiences*, Vienna, October, pp. 30-33.

10. Suedia

Ashtu si Danimarka, Mbretëria e Suedisë është një demokraci parlamentare. Ligji themelor suedez përbëhet nga tri ligje kushtetuese, Regeringsformen (Ligji Kushtetues), i Successionsordningen (Ligji i Vazhdimësisë së Fronit) dhe Tryckfrihetsförordningen (Liria e Aktit Press). Riksdag (Parlamenti) ka 349 vende dhe përbëhet nga një Dhomë. Ky është organi më i lartë legjislativ. Ndryshe nga Danimarka, Suedia ka gjykata administrative. Në krye të kolonës administrative qëndron Regeringsrätten (Gjykata Administrative e Lartë), në të cilën mund të bëhet ankim nëse interesi publik është në rrezik, ose në qoftë se ka një precedent, të nevojshëm për të qartësuar ligjin. Shtresa e ndërmjetme përbëhet nga katër Kammarrätterna (gjykatat e apelit Administrativ), pasuar nga Länsrätterna (gjykatat administrative Provinciale). Kolona civile (dhe penale) përbëhet nga Högsta Domstolen (Gjykata Supreme). Pastaj vijnë Hovrätterna (gjykatat e apelit). Tingsrätterna (Gjykatat e qarkut), të cilat formojnë gjykatat e shkallës së parë.

Pastaj, ka edhe gjykata të specializuara, të tilla si Arbetsdomstolen (Gjykata e Punës).

10.1. Ndërmjetësimi në Suedi

Metoda alternative të zgjidhjes së konflikteve dhe të organizatave të tyre kanë qenë prej kohësh pjesë e shoqërisë suedeze, më saktësisht sistemit ligjor. Në përgjithësi, pranohet se ZAK kontribuon në një reduktim të konsiderueshëm, në ngarkesën e gjykatave suedeze. ZAK, jo vetëm ka arritur një pozicion të përhershëm në gjykatat suedeze, por, përveç, praktikave që ka zhvilluar, ka çuar edhe në një proces të institucionalizimit. Pra, disa organizata ZAK kanë arritur status ligjor⁴³¹. Allmänna Reklamationsnämnden (Bordi Kombëtar për ankesa të konsumit) këtu është përmendur vetëm si shembull i një organizate ZAK me status ligjor. Në vitin 2002, Bordi trajton 8848 ankesa nga konsumatorët. Vendimet e Bordit, në formën e një rekomandimi, nuk janë të detyrueshme. Kjo nuk i heq faktin, se rreth 75% e prodhuesit dhe bizneseve të tjera, veprojnë në përputhje me rekomandimet e Bordit. Procedura në Allmänna Reklamationsnämnden është falas.

⁴³¹ Rregullore e cila jep udhëzime për Këshillin Kombëtar të konsumatorit(1988:1583).

10.1.1. Mosmarrëveshjet në fushën civile.

Kodi aktual i procedurës civile fillon nga viti 1948, dhe ka sjellë ndryshime të rëndësishme. Objektivi kryesor ishte parandalimi i vonesave dhe shtyrjeve të procedurave të mosmarrëveshjeve civile⁴³².

Është karakteristikë e ligjit suedez të Procedurës Civile, që është bërë një dallim mes të ashtuquajturës förberedelsen (procedurë paraprake) dhe huvudförhandlingen (seancë dëgjimore). Gjatë procedurës paraprake, e cilat zhvillohet nën drejtimin e gjyqtarit, rasti trajtohet në një mënyrë që seanca dëgjimore, në parim të jetë e mjaftueshme. Një tjetër objektiv i rëndësishëm i procedurës paraprake është përcaktimi nga gjyqtari i mënyrave për të zgjidhur mosmarrëveshjen me anë të förlika (pajtimit)⁴³³.

Gjyqtari-pajtues, në shkallë të parë, do të mbajë një diskutim me palët së bashku dhe, më pas, me secilin prej tyre, veç e veç. Kjo procedurë mundëson komunikime të shumta me palët, çka ka qënë shumë problematike në të kaluarën⁴³⁴. Në ditët e sotme, kjo metodë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga gjykatësi -pajtues pranohet, në përgjithësi, dhe praktikohet në të gjitha gjykatat suedeze. Kur arrihet një marrëveshje nëpërmjet ndërhyrjes së gjyqtarit-pajtuesit, kjo mund të konvertohet me kërkesën e palëve në një mënyrë të zgjidhjes. Me përjashtim të detyrimit për të paguar shpenzimet e gjyqësore, kjo procedurë pajtimi gjyqësor është falas⁴³⁵.

Shumica e konteksteve civile, që vihen para gjyqtarit për shqyrtim, zgjidhen në fazën e förberedelsen me anë të pajtimit. Me sa duket, palët vlerësojnë qëndrimin aktiv të gjyqtarit-pajtues suedez. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e tyre, me ndihmën e gjyqtarit-pajtues, atëherë gjyqtari-pajtues mund t'i referojë palët tek një ndërmjetës, i emëruar nga gjykata me pëlqimin e palëve. Ata, gjithashtu, mund të zgjedhin për të tërhequr çështjen e tyre. Kostot e kësaj forme të ndërmjetësimit janë të pagueshme në tërësi nga palët⁴³⁶.

⁴³² Regeringskansliet & National Courts Administration, The Swedish Judiciary – A Brief Introduction, Stockholm/Jönköping, 2003.

⁴³³ Shih kapitullin 42, seksionin 6.2, të Kodit të Procedurës Civile Suedeze.

⁴³⁴ Shih kapitullin 42, seksionin 17, të Kodit të Procedurës Civile Suedeze.

⁴³⁵ Shpenzimet gjyqësore janë SEK 450.

⁴³⁶ Regeringskansliet (Ministry of Justice), Memorandum Information regarding Alternative Disputes Resolution for the Council of Europe, 25 June 2002, Stockholm, pp. 2.

10.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës.

Në Suedi ka mënyra të ndryshme për të zgjidhur mosmarrëveshjet e punës. Zakonisht palët, punëdhënësit dhe punonjësit, së pari, do të përpiqen për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre me njëri-tjetrin. Nëse kjo nuk arrihet, mosmarrëveshja mund të paraqitet për vlerësim të gjyqtarëve të Arbetsdomstolen (gjykata e punës). Këta gjyqtarë, ashtu si kolegët e tyre të Tingsrätterna (Gjykatat e qarkut), kanë mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përmes pajtimit⁴³⁷. Ndërmjetësimi në Suedi është një metodë e provuar dhe e testuar, e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kolektive të punës.

10.1.3. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës familjare.

Mosmarrëveshjet mbi marrëveshjet e kujdestarisë dhe aksesit prindëror mund të paraqiten direkt tek gjyqtari kompetent, i cili, kur është e mundur, përpiqet për të zgjidhur konflikte të tilla, nëpërmjet pajtimit. Përveç kësaj, palët mund të përdorin shërbimet e ndërmjetësimit të organizatave vendore për punë sociale, veçanërisht, në rastet e situatave të krizës. Në Aktin e Punëve Sociale të Suedisë është përcaktuar se këto organizata mund të ndërmjetësojnë në mosmarrëveshje të tilla⁴³⁸. Në bazë të nenit 18, të ligjit të prindërve, gjyqtari mund t'i referojë palët në një organizatë lokale, si një masë e përkohshme për punë sociale⁴³⁹. Kjo është bërë praktikë standarde.

10.1.4. Mosmarrëveshjet në fushën administrative.

Në përgjithësi ajo që është e dukshme, është se procedurat suedeze administrative, të cilat ndryshojnë nga procedurat civile, janë kryer tërësisht me shkrim. Organet publike janë, pra, të detyruara të rishikojnë vendimet e marra nga ana e tyre, para se të paraqesin mosmarrëveshjen tek gjyqtari administrativ. Për më tepër, është bërë praktikë, tanimë, për palët, që të fillojnë një dialog përpara paraqitjes së një kërkesë.

⁴³⁷ Chapter 3, Section 7.9, De Arbeidsgeschillen (Rechterlijke Procedure) Wet 1974, SFS 1974:371

⁴³⁸ Chapter 5, Section 3, Social Work Act.

⁴³⁹ Chapter 6, Section 18, Parents' Law.

11. Norvegjia

Norvegjia është një monarki kushtetuese me një sistem parlamentar. Parlamenti norvegjez, Storting, është një nga më të vjetër në Evropë. Ligji norvegjez i përket traditës skandinave dhe është ndikuar gjatë shekujve nga ligjet zakonore gjermanike, ligjit gjerman, ligji danez, dhe madje, edhe ligji anglez. Ligji themelor norvegjez thotë pak për organizimin gjyqësor.

Ekziston një ligj i veçantë për këtë, *Low om Domstolene* (Ligji për Organizimin Gjyqësor) i 1915. Gjykatat në Norvegji janë: Tingetter (Gjykatat e Shkallës së Parë), pesë Lagmannsretter (Gjykatat e Apelit), dhe në krye e hierarkisë Høiesterett (Gjykata Supreme). Këto gjykata kanë një kompetencë të përgjithshme në të dy rastet civile (dhe penale) dhe administrative. Nuk ka gjykata të veçanta; të gjithë gjyqtarët konsiderohen si përgjithësues. Forliksrader (Këshilla pajtimi ose Gjykata Pajtimi) janë pjesë e gjykatave të rregullta. Forliksader ka një fuqi të kufizuar të gjykimit, në rastet e mbledhjes së borxheve dhe kërkesave të vogla - fuqia e tyre është e kufizuar në një kufi maksimal të vlerës. Në praktikë ka shumë raste në mungesë. Kjo fuqi gjykuese është, megjithatë, e kombinuar me Forliksader me një rol të përgjithshëm paraprak të pajtimit. Kushdo që do të sjellë një mosmarrëveshje para Tingretter detyrohet, së pari, të ndërmarrë një përpjekje pajtimi, në prani të Forliksrader (Këshilla pajtimi ose Gjykata Pajtimi). Gjykata e Lartë ka kompetencë vetëm të dëgjojë mosmarrëveshjet kolektive të punës, në bazë të marrëveshjeve ekzistuese të punës kolektive (CLAS). Përveç nga *Low om Domstolene* ekziston një ligj tjetër i rëndësishëm, *Twisteloven*, që daton nga viti 1915, i cili rregullon tërësisht ligjin procedural, pra, për civile dhe për kontekstet administrative. Karakteristikat e ligjit procedural norvegjez përfshijnë, ndër të tjera, një procedurë, pothuajse, tërësisht verbale dhe mungesa e përfaqësimit të detyrueshëm procedural.

11.1. Ndërmjetësimi në Norvegji

Në vitin 1999, Komisioni për Reformën (civile) e ligjit procedural është themeluar dhe ka dorëzuar raportin e tij përfundimtar, në vitin 2002, me një projekt për një kod krejtësisht të modernizuar procedural. Propozimet, përveç disa çështje aktuale procedurale, kanë të bëjnë me një masë të konsiderueshme të negociatave dhe ndërmjetësimit. Pra, një detyrim i përgjithshëm i imponohet palëve, para se të sjellë një rast para gjykatave, për të hetuar mundësitë për një zgjidhje miqësore me njëri-tjetrin.

Në fillim të viteve 90, disa juristë të rëndësishëm norvegjezë arritën në përfundimin, se në vendbanimet tradicionale, gjyqtari nuk ka pasur instrumentet e duhura, dhe palët nuk kanë garancitë e duhura. Në vitin 1993, gjyqtari Tore Schei, atëherë president i Høiesterett, bëri një propozim për një eksperiment kombëtar, me një formë të ndërmjetësimit që ishte nisur nga gjyqtari, por më shumë në përputhje me modelin e Harvardit. Nëse rezultatet e këtij eksperimenti ishin pozitive, kjo rettsmekling do të duhej të merrte një pozicion strukturor në ligjin procedural norvegjez.

11.1.1. Mosmarrëveshjet në fushën civile.

Në Norvegji negocimi i palëve mund të rindërtohet. Një tjetër aspekt me anë të së cilës shpresohet për rritjen e efikasitetit në administrimin e drejtësisë është mundësia e paraqitjes së propozimit të plotë, në fillim të procedurës për palët. Është interesante se Komisioni për herë të parë ka propozuar një rregullore për ndërmjetësime private. Ndërmjetësime të ngjashme tashmë të zhvillohen, për shembull, në sektorin e naftës dhe gazit. Por ato nuk janë të rregulluara me ligj. Asnjë informacion nuk është në dispozicion ende në këtë praktikë ndërmjetësimi. Rregulloret mbi ndërmjetësimet private, gjithashtu, përshkruajnë se kursi i ndërmjetësimit është i dokumentuar, dhe se me kërkesë të palëve, propozimet specifike janë të regjistruara.

11.1.2. Mosmarrëveshjet në fushën e së drejtës së punës.

Mosmarrëveshjet individuale të punës janë trajtuar në gjykatat e rregullta dhe, kështu, bien nën regjimin e ri të ndërmjetësimit gjyqësor ekzistues. Konfliktet kolektive të punës, në bazë të marrëveshjeve ekzistuese të punës kolektive (CLAS), gjykohen. Mosmarrëveshjet kolektive që lindin, në lidhje me një CLA rishtazi janë të negociueshme, megjithatë, duhet të paraqiten në Riksmeklingsmannen (ndërmjetësi i Shtetit).

Ky zyrtar emërohet nga Mbreti dhe vepron mbi një bazë të pavarur. Është e rëndësishme të theksohet se sindikatat, të cilat kanë për qëllim të thërrasin një grevë, duhet së pari, të informojnë punëdhënësin dhe Riksmeklingsmannen (ndërmjetësi i Shtetit). Për katër ditë, duke llogaritur nga njoftimi, nuk mund të quhet grevë. Në këtë periudhë, një përpjekje për ndërmjetësim duhet të ndërmerret në prani të Riksmeklingsmannen (ndërmjetësi i Shtetit). Nëse kjo është një grevë e planifikuar, e cila rrezikon seriozisht prishjen e jetës

publike, atëherë Riksmeklingsmannen(ndërmjetësi i Shtetit), përkohësisht, mund ta ndalojë grevën. Ditën e dhjetë, duke filluar numërimin që nga dita e ndalimit, sindikata mund të kërkojë fundin e ndërmjetësit. Riksmeklingsmannen(ndërmjetësi i Shtetit) trajton mesatarisht, pothuajse, njëqind raste në vit⁴⁴⁰.

11.1.3. Mosmarrëveshjet në fushën familjare

Në Norvegji askush nuk flet për ndërmjetësimin e divorcit, apo ndërmjetësimin familjar, por, për ndërmjetësim nëne. Kjo është për të theksuar përgjegjësinë e prindërve, duke përfshirë edhe prindërit e pamartuar. Ky ndërmjetësim është sjellë në vitin 1993, dhe ka një bazë ligjore, së pari, në Ekteskapsloven (Ligjin Martesor) dhe, së dyti, në Barneloven (Ligjin e fëmijëve). Rregullat përkatëse përshkruajnë, se prindërit që ndahen dhe kanë fëmijë nën 16 vjeç, janë të detyruar për të kryer një diskutim hyrës me një ndërmjetës. Për prindërit e martuar që duan të divorcohen, rregulli është se divorci nuk mund të zgjidhet derisa ata të kenë marrë pjesë në këtë takim njohës. Divorci, nëse është me pëlqim të dyanshëm, është trajtuar në fund të fundit nga Fylkesmann, një zyrtar provincial administrative.

Ndërmjetësit në fjalë duhet të jenë të kualifikuar, dhe të kenë marrë trajnime të veçanta (për psikologët - një program me njohuritë bazë psikologjike; për juristët - një program me njohuri themelore juridike). Ky ndërmjetësim ka të bëjë me kujdestarinë, kryesisht, dhe të drejtat. Prindërit janë të obliguar të marrin pjesë në një seancë hyrëse, edhe në qoftë se, me konsideratë të ndërsjellë, ata kanë hedhur poshtë të gjitha marrëveshjet që kanë të bëjnë me fëmijët, në letër. Është ende e mundur që ata të kenë anashkaluar një aspekt të rëndësishëm. Kjo formë e ndërmjetësit është pa pagesë, për shkak se ajo është financuar nga burimet publike, një afat kohor është vendosur: një maksimum prej 3 seancash në 4 orë.

11.1.4. Mosmarrëveshjet në fushën administrative.

Ende ka praktika të ndërmjetësit, që janë zhvilluar në këtë fushë, përveç në kuadër të ankesave të trajtuara nga Avokati i Popullit. Ky sistem u prezantua në vitin 1962, në Norvegji, dhe është një institucion i respektuar, i cili ka punësuar 30 persona staf me kohë të plotë.

⁴⁴⁰ A. Jacobs. (1993). *Conciliation, mediation and arbitration in industrial disputes in the countries of Western Europe*, Tilburg/Dublin, pp.53.

KAPITULLI VIII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

1. Rëndësia e aplikimit të ndërmjetësimit

a. Avantazhet e ndërmjetësimit i parë si proces

- Parë si proces, rëndësia e ndërmjetësimit buron nga fakti se bazohet mbi parimet e neutralitetit të ndërmjetësit, të mos parit e palës tjetër si armik, disponimit bashkëpunues, reagimit të përgjegjshëm, vetëvendosjes dhe autonomisë së palëve, si dhe udhëheqjes, që palët marrin nga ndërmjetësi gjatë procesit, në funksion të arritjes së zgjidhjes së konfliktit.
- Ndërmjetësimi shihet i aftë për të parandaluar konfliktin ose shkallëzimin e tij, për të qenë efektiv në konflikte emocionalisht komplekse për të arritur mirëkuptimin dhe pajtimin mes palëve dhe çuar në zgjidhje të pëlqyeshme për të dy palët.
- Ndërmjetësimi ofron privilegjin e mosparagjykit, d.m.th. çdo ofertë apo pohim i bërë nga palët nuk mund të përdoret si provë në gjykatë dhe iu mundëson palëve të mos heqin dorë nga përdorimi i sistemit të drejtësisë, të drejtat ligjore ose të kërkuarit e dëmshpërblimit përmes një procesi gjyqësor, nëse marrëveshja nuk arrihet.
- Ndërmjetësimi ofron mundësinë e eksplorimit të padrejtësive të së shkuarës, prekjen e një game çështjesh më të gjëra se ç'do të lejonte një proces gjyqësor, bën më të lehtë të falurin e tjetrit, gjeneron një shkallë më të lartë kënaqësie tek palët në konflikt, dhe kontribuon në ruajtjen e marrëdhënieve mes palëve edhe pas procesit.

b. Avantazhet e ndërmjetësimit i parë nga ana e palëve në konflikt

- Parë nga ana e palëve në konflikt, rëndësia e ndërmjetësimit buron nga fakti, se ai iu garanton palëve kontroll mbi procesin dhe rezultatin, reduktim të polarizimit, bashkëpunim dhe përfitim të dyanshëm, si dhe kohë të shkurtër e kosto të ulët të zgjidhjes së konfliktit.
- Ndërmjetësimi iu garanton palëve një mundësi të lartë të zbatimit të marrëveshjes, qoftë për shkak të arritjes së saj me pajtimin e dy palëve, qoftë për shkak të

imponimit që mund t'i bëjë gjykata zbatimit të marrëveshjes si dhe konfidencialitet të procesit.

- Ndërmjetësimi zhvillohet privatisht dhe askush veç palëve dhe ndërmjetësit nuk ka dijeni të ofertave apo pohimeve të bëra. Këto të fundit, nuk dokumentohen dhe ndërmjetësi, në rastet kur mban shënime, jo vetëm që i eliminon ato, por edhe është i detyruar të mos dëshmojë rreth tyre, nëse konflikti përfundon në gjykatë.
- Ndërmjetësimi ofron reduktion shpenzimet dhe kohën e nevojshme për zgjidhjen e konteksteve, duke u mundësuar palëve në konflikt, që të zgjedhin vetë mënyrat e zgjidhjes së kontekstit dhe të luajnë rol aktiv në proces për të arritur zgjidhjen më të mirë për ta. Pala e tretë vetëm i udhëzon palët drejt zgjidhjes, por nuk ua dikton atë. Qasja konsensuale vetëm që i shton gjasat se palët do t'i ruajnë marrëdhëniet e tyre pasi ta gjejnë zgjidhjen është në rregull sepse nënkupton mirëkuptim.

2. Dallimi i ndërmjetësimin nga alternativat e tjera të zgjidhjes së konfliktit.

- Elementët, që e bëjnë ndërmjetësimin të dallohet nga praktika të tjera të zgjidhjes së konfliktit. janë: 1) karakteri imponues ose jo i zgjidhjes, dhe 2) karakteri vullnetar apo i detyruar i pjesëmarrjes në proces. Në këtë kuptim, ndryshe nga arbitrazhi apo procesi gjyqësor, që karakterizohen nga fuqia imponuese, ndërmjetësimi bën pjesë, bashkë me negociimin dhe pajtimin, në grupin e atyre alternativave që kanë karakter jo imponues, dhe vihen në veprim vetëm kur ekziston vullneti i palëve për të zgjidhur konfliktin përmes pjesëmarrjes në proces.
- Dallimi më i përgjithshëm i ndërmjetësimin me të gjithë alternativat e tjera është, se ai i anashkalon procedurat tradicionale të ankimit, nuk është i varur në respektimin e proceseve dhe procedurave të vendosura që më parë dhe, gjithashtu, as nuk influencohet, as nuk merr parasysh të gjithë proceset apo marrëveshjet e mëparshme ekzistuese mes palëve, nisur nga logjika se palët në konflikt duhet të jenë të lira të negociojnë rezultatin e procesit dhe mosmarrëveshjes mes tyre.

3. Ndërmjetësimin në Shqipëri dhe Kuadri Ligjor

- Ndërmjetësimin në Shqipëri nuk ka një periudhë të caktuar se kur ka lindur. Unë mendoj se ndërmjetësimin ka lindur bashkë me njeriun dhe nevojën e tij për të. Ai është një instinkt njerëzor mbijetese dhe si i tillë nuk mund të datohet. Për sa kohë

problemet janë dhe kanë qenë pjesë e jetës tonë, për aq kohë edhe ndërmjetësimi ekziston si një mjet i përdorur në zgjidhjen e këtyre problemeve. Madje, mendoj se aftësimi në këtë fushë vjen pikërisht nga ekzistenca e ndërlikimeve të këtyre problemeve.

- Referuar historikut të ndërmjetësimit në Shqipëri, vërejmë se e gjejmë në të drejtën zakonore shqiptare e, veçanërisht, në Kanunet, si pjesë e rëndësishme e një sistemi juridik të pashkruar. Ky sistem i pashkruar i përcakton ndërmjetësit të drejta dhe detyrime, të cilat janë të sanksionuara sipas kësaj të drejte. Konfliktet dhe problemet shoqërore, e drejta zakonore i rregullonte me anë të figurave të tilla si pleqësia; dorëzanët e gjakut, pajtimi, ku si ndërmjetës ka qenë edhe ai që ka hyrë "për me da fjalët e kqia", pastaj prifti, si ndërmjetës në emër të "Famullis, n'emër të flamurit". Kjo traditë e ndërmjetësimit ka mbetur aktuale deri në ditët e sotme.
- Sot, është bërë e mundur që baza ligjore, e cila ka ekzistuar edhe më parë, të rishihet në përshtatje me kohën, legjislacionin e BE dhe me praktikën ndërkombëtare, për të arritur që, ndërmjetësimi të zbatohet si zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës familjare, civile, tregtare, të punës, si edhe në fushën penale, për çështje që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues ose me ankim të të dëmtuarit dhe, në ato raste, kur vetë ligji e lejon një gjë të tillë.
- Referuar Ligjit 10385, dt. 24.02.2011, "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve", vërejmë se dispozitat e këtij ligji janë dispozita, të cilat rregullojnë marrëdhënie që kanë karakter privat dhe marrëdhënie, të cilat kanë karakter publik. Në këtë konkluzion dalim, pasi ligji për ndërmjetësimin, siç kemi thënë dhe gjat studimit, mund të ndihmojë si në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, ashtu edhe atyre penale, sipas përcaktimeve dhe ndalesave të ligjit, duke u kufizuar vetëm në ato konflikte, për të cilat ligjvënësi nuk kërkon detyrimisht një zgjidhje gjyqësore.
- Ligji 10385, "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve" ka karakter ngushtësisht privat, që do të thotë se janë palët në konflikt të cilat zgjedhin, nëse duan ta zgjedhin mosmarrëveshjen e tyre nëpërmjet një ndërmjetësi apo jo. Në këtë ligj nuk kemi të bëjmë me forcën shtrënguese të shtetit, por me një veprimtari të

lirë, të cilën palët mund ta ushtrojnë ose jo, kjo varet nga vullneti i lirë i palëve, nëse duan ta zgjidhin konfliktin midis tyre me ndërmjetës apo t'i nënshtrohen procedurave formale gjyqësore.

- Qëllimi i ligjvënësit, në ligjin nr. 10385, për ndërmjetësimin, është që të shkarkojë gjykatat civile nga një mbingarkesë e çështjeve të këtij lloji me anë të procesit të ndërmjetësimit e të sigurojë një zgjidhje të shpejtë, fleksibilitet të procedimit, konfidencialitet, kursim dhe transparencë të tarifave, stimulime fiskale, profesionalizëm dhe seriozitet të agjencive dhe të ndërmjetësve.
- Ndërmjetësimi ka qenë edhe përpara se ligji ta bënte të detyrueshëm për rastet që përfshinin çështje të caktuara, por, në vendin tonë nuk ka pasur sukses të madh për shkak të një njohjeje të dobët të institucionit nga ana e palëve ndërgjyqëse, dhe nga mungesa e besimit, që i linte në dorë një pale tjetër, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- Ligjvënësi me reformën e ndërmjetësimit ka vendosur një palë të tretë, të paanshme dhe pa ndonjë fuqi vendimmarrëse dhe gjykuese, me detyrën që t'i vërë palët përballë njëra-tjetrës dhe do të jenë vetë ato, që do të gjejnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre (ndërmjetësimi lehtësues), ose ai do të propozojë një marrëveshje (ndërmjetësimi vlerësues), padyshim, që njëra zgjidhje ose tjetra duhet të ketë pëlqimin e të dyja palëve që të jetë efektive dhe detyruese.

4. Aplikimi i ndërmjetësimit në çështjet civile

- Përfundimisht, shohim se legjislacioni jonë civil, në përmbajtje të tij, ka shume elementë të cilët favorizojnë aplikimin e ndërmjetësimit. Vetë legjislacioni bazë, mbi të cilën funksionon zgjidhja e mosmarrëveshjeve civile i jep prioritet zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve. Këtë e vërejtëm në nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, “Pajtimi”. Në këtë dispozitë, ku në fakt referon edhe ligji për ndërmjetësimin, vërejmë që ligjvënësi, zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve, e ka trajtuar me prioritet. Është pikërisht, kjo dispozitë, e cila, nëse interpretohet në harmoni me ligjin për ndërmjetësimin, pastron të gjithë panoramën dhe pikëpyetjet që aplikuesit e ndërmjetësimit kanë, në lidhje me detyrueshmërinë e procesit të ndërmjetësimit. Procedura, që gjykata aplikon për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjes, nis pikërisht me detyrimin që kjo dispozitë iu ngarkon operatorëve të drejtësisë, në sistemin gjyqësor (gjyqtarët).

Nga vetë natyra e procesit gjyqësor, duhet të kemi parasysh që gjyqtari për administrimin e procesit, duhet dhe nuk mund ta administrojë atë, përveç se më vendime dhe urdhra. Procesi i ndërmjetësimit ka një karakter krejt të ndryshëm, në këtë proces, siç kemi parashtruar edhe në parimet e përmendura gjatë studimit, nuk ka procedura dhe rregulla strikte. Palët pjesëmarrëse janë krejt të lira në mënyrën se si e organizojnë këtë proces. Ato mund të zgjedhin të takohen të gjithë së bashku apo jo, të takohen në zyrë apo gjëkund, të trajtojnë prova ose jo, të marrin ekspertë apo jo etj.

5. Apliki i ndërmjetësimit në çështjet penale

- Gjithashtu përse i përket aplimit të ndërmjetësimit në çështjet penale, në legjislacionin tonë penal, disa janë ato vepra penale, të cilat mund të zgjidhen jashtë gjyqësorit. Në praktikën gjyqësore është vërtetuar se shumica e këtyre çështjeve është zgjidhur me pajtim. Për rastet e fyerjes, shpifjes, dhunimit të banesës, dëmtimit të shëndetit, shumica e çështjeve pushohen për shkak të pajtimit të palëve në konflikt. Është rasti të theksojmë këtu se, legjislacioni shqiptar për ndërmjetësim në çështjet penale, në Nenin 2, të ligjit nr. 10385, për ndërmjetësimin, parashikon përdorimin e ndërmjetësimit në çështje të caktuara penale, respektivisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale (më tej K. Pr. Penale). Sidoqoftë, K. Pr. Penale nuk specifikon kushtet për transferimin e çështjeve penale për t'u trajtuar përmes modeleve të drejtësisë restauruese. Kështu, gjithnjë sipas K. Pr. Penale, gjyqtari, prokurori, apo oficeri i policisë gjyqësore nuk mund të transferojë çështje për ndërmjetësim dhe kodi nuk përmban dispozita që të mund të bëjnë të mundur devijimin e procedimit penal dhe përdorimin e drejtësisë restauruese, në raste kur mund të jetë më e dobishme përdorimi i kësaj të fundit sesa ndalimi, hetimi, apo gjykimi i një të mituri.
- Një rol të rëndësishëm në zbatimin e ndërmjetësimit në konfliktet penale është luajtur nga sistemi gjyqësor shqiptar. Legjislacioni në këtë fushë, i njeh gjykatës të drejtën dhe detyrimin për të ndërmarrë veprime në zgjidhjen e çështjeve, që parashikohen nga ligji, përmes ndërmjetësimit dhe pajtimit. Prandaj, gjykata mund

ta bëjë këtë për rastet penale, të cilat nuk mund të procedohen, nëse nuk ka një akuzë kundër autorit të veprës penale.

6. Palët dhe procesi i ndërmjetësimit

Referuar çështjeve të trajtura në studim arrim në përfunimin se:

- Cdo palë që ka pranuar procesin e ndërmjetësimit mendon se është informuar mjaftueshëm para fillimit të procesit .
- Palët në konflikt nuk i japin ndonjë rëndësi mjedisit ku zhvillohet ndërmjetësimi ose ata nuk kanë patur alternativë për të zgjedhur ambjentin për të zhvilluar procesin e ndërmjetësimit.
- Sa më shumë të zgjas procesi i ndërmjetësimit aq më pak i suksesshëm perceptohet procesi i ndërmjetësimit për palët në konflikt. Kjo tendencë tregon se sa më e gjatë është koha e procesit të ndërmjetësimit aq më i ulët është niveli i komunikimit miqësor midis palëve në konflikt. Nje rekomandim në këtë aspekt do të ishte venia e kufijeve me te ulet te finalizimit te procesit te ndermjetesimit!!.
- Rritja e nivelit të seancave të vecanta shoqërohet me rritjen e nivelit të komunikimit miqësor midis palëve, ndërkohë që rritja e nivelit të numrit të seancave të përbashkëta shoqërohet me “acarimin” e marrdhënies komunikuese midis palëve.
- Përfundimi me sukses i procesit të ndërmjetësimit shoqërohet me një rritje të nivelit të komunikimit miqësor midis palëve në konflikt.
- Rritja e nivelit arsimor të palëve në konflikt mund të shoqërohet me tendencën në rritje drejtë një pajtimi të plotë midis palëve ose anasjelltas me një nivel në rënie të komunikimit midis palëve, gjë që mund të krijojë ndjesinë se procesi i ndërmjetësimit është i paaftë të realizoj një pajtim miqësor midis palëve kur këto posedojnë nivel të lartë arsimor. Ne kete aspekt një rekomandim do të ishte që ndërmjetësit të trainohen duke patur parasysh një klasifikim të nivelit arsimor të palëve në konflikt. Megjithatë, mund të konkludojmë se niveli arsimor i Palëve në procesin e ndërmjetësimit nuk luan asnjë rol mbi produktin e shprehur me anë të nivelit të kënaqësisë, ose e shprehur ndryshe, niveli arsimor i Palëve në konflikt

nuk sjell asnjë ndikim mbi nivelin e rekomandimit të procesit të ndërmjetësimit në persona të tjerë të interesuar për të.

7. Ndërmjetësit dhe procesi i ndërmjetësimit

Studimi tregon se:

- Për të ushtruar ndërmjetësimin nevojitet njohja e procedurës, aftësim profesional, duhet të shkollohen shtresat e ndryshme të shoqërisë, duke filluar nga gjykatësit e deri të avokatët, institucionet e ndryshme shkollore, vetë profesorët, sociologët, psikologët e të gjithë të tjerët që kanë interesim ta ushtrojnë këtë veprimtari.
- Rritja e nivelit në kohë e përvojës në procesin e ndërmjetësimit shoqërohet me rritjen e nivelit të numrit të konflikteve që pranojnë zgjidhje duke i besuar ndërmjetësimit.
- Rritja e nivelit të përvojës shoqërohet me rritjen e nivelit të optimizmit të ndërmjetësive se gjykatat tona mund të bëhen më aktive dhe më suportuese në rekomandimin dhe aplikimin e procesit të ndërmjetësimit për zgjidhjen e konflikteve.
- Niveli i përvojës në kohë i ndërmjetësit shoqërohet me rritjen e nivelit të kohës që ndërmjetësi vë në dispozicion të zgjidhjes së konfliktit, e thënë ndryshe, përvoja në procesin e ndërmjetësimit shoqërohet me rritjen e durimit dhe besimit se një konflikt mund të zgjidhet me anë të procesit të ndërmjetësimit.
- Zgjidhja e një konflikti me anë të ndërmjetësimit kërkon si komunikimin me palët në seanca individuale ashtu edhe komunikimin në seanca të përbashkëta.
- Rritja e nivelit të kohës që një ndërmjetës ushtron profesionin e ndërmjetësimit shoqërohet me rritjen e nevojës që ai ka ndier për t'u trainuar, gjë që sjell në vëmendje se procesi i ndërmjetësimit është një proces i cili ka nevojë të plotësohet me informacione teorike dhe suport të specializuar.
- Rritja e numrit të trainimeve të kryera nga ndërmjetësit shoqërohet me rritjen e nivelit të perceptimit të tyre mbi efikasitetin e këtyre trainimeve. Pra, trajnimet që po zhvillohen në vëndin tonë për qëllim zhvillimin e njohurive mbi proceset e ndërmjetësimit, luajn një rol pozitiv në efikasitetin e procesit të ndërmjetësimit.

- Rritja nivelit të fortësisë së kritereve, gje e sila mund të interpretohet si rritje e cilësisë së ndërmjetësimit, shoqërohet me rritjen e tendencës së gjykatave për ta referuar ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e konflikteve, e thënë ndryshe, niveli i referimit nga gjykatat varet korrelativisht nga rritja e besimit mbi cilësinë e aftësive të Ndërmjetësit.
- Zgjatja e kohës së konfliktit në shumicën e rasteve është kuptuar si koha e mjaftueshme për t'i dhënë zgjidhje një konflikti me anë të ndërmjetësimit, ose e thënë ndryshe, është kuptuar si nivel i shprehur në kohë i durimit dhe këmbënguljes nga ana e Ndërmjetësit që palët ta zgjidhin konfliktin me anë të procesit të ndërmjetësimit. Ky arsyetim gjën mbështetje të plotë nga rezultatet e përpunimit statistikor me metodat inferenciale. Pra, durimi dhe besimi se një konflikt mund të zgjidhet pa ndërhyrjen e trupës gjyqësore rrit ndjeshëm efikasitetin e proceseve të ndërmjetësimit.
- Në vëndin tonë po krijohet një grup Ndërmjetësish me ide dhe kërkesa të qarta profesionale, mendimi i të cilëve duhet marrë në konsideratë në hartimin e politikave për zhvillimin institucional të procesit të ndërmjetësimit.
- Për Ndërmjetësit, efikasiteti i procesit të ndërmjetësimit nuk varet nga Tipi i ndërmjetësimit. Për ta, cdo tip ndërmjetësimi është i njëjtë përball suksesit të procesit.

8. Gjyqtarët dhe Gjykata në procesin e ndërmjetësimit

Studimi tregon se:

- Mosha në profesion e një gjyqtari shoqërohet me rënien e rasteve të referuara me ndërmjetësim. Kjo lë ndjesinë se fenomeni i konservatorizmit është efekt pengues në promovimin e Ndërmjetësimit si alternativë për zgjidhjen e konflikteve.
- Gjykatësi paraqëlqen më mirë të referoj zgjidhjen e konfliktit me mënyrën klasike të gjykimit sesa të rris nivelin e informimit për të bindur palët që rastin tia referoj Ndërmjetësimit.

BIBLIOGRAFIA

A). LITERATURA

- Baldwin, P. (1978). *Environmental Mediation: An Effective Alternative*, RESOLVE Center for Environmental Conflict Resolution.
- Billikopf, G. (2014) *Party-Directed Mediation: Facilitating dialogue between individuals*, 3th Edition, University of California.
- Boulle, L.(2005). *Mediation: Principles, Processes, Practice*, Australia, Butterworths.
- Brown, H & Marriott, A. (2011). *ADR: Principles and Practice*, Third Edition. UK: Sweet & Maxwell.
- Brown, S & Cervenak, Ch & Fairman, D. (1998). *Alternative Dispute Resolution Practitioners Guide*, Cambridge, MA: Conflict Management Group.
- Bush, R. and J. Folger (1994) *The Promise of Mediation: Responding to Conflict through Empowerment and Recognition*, San Francisco: Jossey-Bass.
- Bush, R. A. B. & Joseph P. Folger. (1994). *The Promise of Mediation*. San Francisco: Jossey-Bass.
- Carnevale, P & Lim, J. D & Rodney G. McLaughlin. (1989). *Contingent Mediator Behavior and its Effectiveness*, in Kressel, Pruitt, et. al. (eds.) *Mediation Research*. San Francisco: Jossey-Bass.
- Charlton, R. (2000). *Dispute Resolution Guidebook*, 2 Ligare Pty Ltd, Riverwood NSW (eds.), Erskineville NSW: Star Printery Pty Ltd.
- Charlton, R. & M. Dewdney (2004). *The Mediator's Handbook. Skills and Strategies for Practitioners*.
- Chornenki, G. & Hart Ch. (2005). *Bypass Court*, Third Edition. Toronto: Butterworths.
- Cloke, K. (2001). *Mediating Dangerously: The Frontiers of Conflict Resolution*. San Francisco: Jossey-Bass.
- Cloke, K. & Goldsmith J. (2000). *Resolving Conflicts at Work: A Complete Guide for Everyone on the Job*, San Francisco: Jossey-Bass.

- Cremin, H. (2007). *Peer Mediation: Citizenship and Social Inclusion in Action*, Maidenhead: Open University Press.
- Dauer, E. A. (1994). *Manual of dispute resolution: ADR law and practice*.
- Fisher, R. & Brown S. (1988). *Getting together*.
- Fox, A. (1985). *Man Mismanagement*, London: Hutchinson & Co.
- Friedman, G. J. (1993). *A guide to divorce mediation*.
- Fritz, J. M. (2004). *Behind the Magic: Mediation Models, Approaches and Theories*.
- Fritz, J. M. (2006). *Approaches to Conflict: Social Theory and Mediation*.
- Gibbons, M. (2007). *Better Dispute Resolution: A Review of Employment Dispute Resolution in Great Britain*, London: Department of Trade and Industry.
- Golten, M. & Smith, M. (2007). *Hammers in Search of Nails: Responding to Critics of Collaborative Processes*.
- Huczynski, A. & Buchanan, D. (2007). *Organizational Behaviour*, Harlow: Prentice Hall.
- Johnson, E. & Kantor, J. & Schwartz E. (1977). *Outside the Courts: A Survey of Diversion Alternatives in Civil Cases*, National Center for State Courts.
- Lang, M. & Taylor A. (2000). *The Making of a Mediator: Developing Artistry in Practice*, San Francisco: Jossey Bass.
- Lax, D. A. & Sebenus J. K. (1986). *The manager as negotiator*.
- Liebmann, L. (2000). "History and Overview of Mediation in the UK", in *Mediation in Context*, London: Jessica Kingsley Publishers.
- Borgan M, & Spencer D. (2006). "Mediation Law and Practise", Cambridge University Press.
- McGillis, D. & Mullen J. (1977). *Neighborhood Justice Centers: An Analysis of Potential Models*, US Department of Justice.
- McGillis, D. & Mullen J. (1978). *Mediating Social Conflict*, Ford Foundation.
- Nicolau, G. (1978). *Community Mediator Training Manual for the Neighborhood Justice Center of Kansas City, Missouri*, Institute for Mediation and Conflict Resolution.

- Cheryl, P. & Bishop, P. & Ramkay, R. & Sargeant N. (2004). *The Art and Science of Mediation*, Toronto: Emond Montgomery Ltd.
- Howard, R. (1982). *The art and science of negotiation*.
- Ridley-Duff, R. J. (2006). *The Evolution of Corporate Cultures*, Sheffield Hallam University.
- Sander, F. (1977). *Report on the National Conference on Minor Dispute Resolution*, American Bar Association.
- Sander, F. & Snyder F. (1979). *Alternative Methods of Dispute Settlement: A Selected Bibliography*, American Bar Association.
- Simkin, W. E., (1971). *Mediation and the Dynamics of Collective Bargaining*, Bureau of National Affairs Books, Washington DC,
- Spencer, D. & Altobelli T. (2005). *Dispute Resolution in Australia. Cases, Commentary and Materials*. Riverwood NSW: Ligare Pty Ltd.
- Stitt, A. J. (2003). *Mediating Commercial Disputes*. Aurora, ON: Canada Law Book Inc.
- Van Gramberg, B. (2006). *Managing Workplace Conflict: Alternative Dispute Resolution in Australia*, The Federation Press, Sydney, Australia.
- Walton, R. E. & McKersie R. B. (1991). *A behavioral theory of labor negotiations*, 2nd Edition.
- White, M. (2000). *Narrative Mediation: A New Approach to Conflict Resolution*.
- Wilmot, W. W. & Joyce L. Hocker (1998). *Interpersonal Conflict*, 5th edition, New York: McGraw-Hill.
- Winslade, J. & Monk G. (2000) *Narrative Mediation: A New Approach to Conflict Resolution*. San Francisco: Jossey-Bass.
- Zutter, D. (2004). *Preliminary Mediation Practices*, Bond University, Australia: Unpublished Thesis.
- Zutter, D. (2005). *Preparing for Mediation: A Dispute Resolution Guide*. Toronto: Trafford Publishing.
- Folberg J. & Taylor A. (1984). *Mediation-A Comprehensive Guide to Resolving Conflicts without Litigation*, San Francisco.

- Baas, J. & Publishers, (1991). *Community Mediation : A Handbook For Practitioners And Researchers*, Guilford Publications.
- Bush R. & Folger J. (1994). *The Promise of Mediation : Responding to Conflict through Empowerment and Recognition*. San Francisco. Jossey Bass.
- Corsi M., & Sirignano C. (1999). *La mediazione Familiare. Problemi, prospettive, esperienze*. Vixta e Pensiero, Milano,
- Gjoka R. (2009). *Ndërmjetësimi midis viktimës-autorit të veprës penale, Manual për punonjësin e shërbimit të provës*. OSCE. Tirane.
- Gjoka R. (2009). *Ndërmjetësimi midis viktimës-autorit të veprës penale, Manual për punonjësin e shërbimit të provës*. OSCE. Tirane.
- Emmond P. & Zaka T. Zaka K. & Tashko. (2006). *Njohje me zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve*. RISTALINA-KH.
- Lax, D. A., & Sebenius, J. K. (1986). *Menaxheri si negociator*, free press.
- Brown, H. & Marriott, A. *ADR Principles and Practice*, 3rd ed., 2011)
- Chevalier, P. & Desdevises, Y. & Milburn P. (eds.). (2003). *Les modes alternatifs de règlement des litiges: les voies nouvelles d'une autre justice*, La documentation française, Paris.
- Gotwald & Gotwald, V. *Environmental mediation in Europe – Status and Experiences*, Vienna.
- Laenens, J. *Règlement Alternatif des Litiges en Belgique*, Report to the Sixteenth International Congress of Comparative Law, Bruxelles/Brisbane, 2002.
- Ch. de Vel, *De mediating judge, paper Conference on Judicial Mediation*, 9 October 2002, Brussels.
- Thilly, & Alexander. N. (2003). *La médiation familiale en droit belge*, in: *Global Trends in Mediation*, , Cologne: Otto Schmidt Verlag.
